

ENVER HOXHA

*Letra  
të zgjedhura*


1


TIRANË, 1985

**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH**

Letra  
të shtepia

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»





## PARATHËNIE

*Letërkëmbimi i shokut Enver Hoxha është pjesë përbërëse dhe e pandarë e veprimtarisë së dendur e të gjithanshme mbi 40-vjeçare të Udhëheqësit të dashur të Partisë e të popullit tonë. Fondi shumë i pasur i këtij letërkëmbimi ka përbërë e përbën një thesar të vyer ku pasqyrohet fryma e komunikimit të drejtpërdrejtë me popullin, lufta heroike për transformimin revolucionar të Shqipërisë, për ndërtimin e bazës e të superstrukturës së rendit socialist, për rritjen dhe edukimin e njeriut të ri, për zhvillimin e pandalshëm të fitoreve dhe ruajtjen e tyre nga armiqtë e brendshëm e të jashtëm, për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të çështjes së revolucionit e të popujve. Ky letërkëmbim është gjithashtu shprehje nga më të qartat e më të plotat e atyre lidhjeve të fuqishme shpirtërore e mendore të udhëheqësit me popullin, me komunistët e kuadrot, e dashurisë, nderimit dhe e respektit reciprok që gjallonin midis popullit dhe shokut*

Enver, është shprehje e metodës dhe e stilit të shkëlqyer revolucionar të punës së Udhëheqësit tonë të madh e të pavdekshëm.

Enver Hoxha ishte udhëheqës i madh popullor, jetonte me masat dhe masat jetonin me të, i shkruanin për suksese e fitore në punë e në jetë, për raste gëzimesh e hidhërimesh, për vështirësitë e përpjekjet që bënin për kapërcimin e tyre.

«Të marr dhe të lexoj letrat e popullit është për mua diçka pasionante», ka shkruar shoku Enver. Ai i lexonte me vëmendje të jashtëzakonshme letrat që i vinin dhe u kthente menjëherë përgjigje, duke nxjerrë dhe shtruar në to problemet më thelbësore.

Letërkëmbimi i shokut Enver Hoxha me popullin është një bisedë e ngrohtë dhe e çiltër, që nis që në vitet e luftës e vazhdon deri në ditët e fundit të jetës së Tij. Ky letërkëmbim ka një shtrirje të gjerë. Ai përfshin gjithë Shqipërinë, gjithë shtresat shoqërore të vendit tonë. Kolektiva punonjës, kooperativa bujqësore, fshatra e krahina, institucione të ndryshme shkencore e kulturore, punëtorë, kooperativistë, shokët e vet të punës, intelektualë, të rinj, nëna dëshmorësh e heronjsh, pionierë, kanë shkëmbyer vazhdimisht letra e telegrame me shokun Enver. Nëpërmjet këtij letërkëmbimi firma e dashur «Juaji Enver» hyri në zemrat e njerëzve duke i çuar ato peshë e duke lënë atje gjurmë të pashlyeshme. Ky letërkëmbim u solli njerëzve pranë mendit

min largpamës dhe dashurinë e pafund të Partisë, ai u bë pjesë e pandarë e jetës dhe sukseseve të popullit.

Në dy vëllimet e para të serisë së Veprave, domethënë fondi që i përket periudhës së Luftës Nacionalçlirimtare, letërkëmbimi i shokut Enver Hoxha është botuar thujtë i plotë, kurse nga fondi tepër i gjerë i periudhës së pasçlirimtës është botuar në shtypin e përditshëm e periodik, qendror ose lokal vetëm një pjesë e kufizuar e letërkëmbimit.

Një pamje më të plotë të letërkëmbimit të gjerë të shokut Enver Hoxha për periudhën 1945-1985 do të japë botimi i serisë me «Letra të zgjedhura», i cili çelet me këtë vëllim që del në prag të 77-vjetorit të ditëlindjes. Secili nga vëllimet me «Letra të zgjedhura» do të përmbajë dokumente që i takojnë gjithë kësaj periudhe 40-vjeçare duke pasur parasysh që në çdo vëllim të ruhet larmia tematike, shtrirja shoqërore e gjeografike, gjerësia e problematikës të letërkëmbimit të shokut Enver. Një pjesë e madhe e letrave dhe e telegrameve që përfshihen në këtë vëllim botohen për herë të parë. Kështu do të veprohet edhe në vëllimet që do ta pasojnë.

Në vëllimet me «Letra të zgjedhura» lexuesi do të rijetojë edhe një herë me historinë e lavdishme të Partisë e të atdheut, që nga vitet e para të çlirimit deri në ditët tona. Atje komunistët, punonjësit, rinia jonë do të gjejnë idetë e mëdha e mësimet e çmuara që udhëhoqën e fry-

mëzuan popullin tonë gjatë epokës së socializmit.  
Botimi i «Letrave të zgjedhura» është një mundësi tjetër që u jep Partia komunistëve dhe popullit për të njohur më thellë jetën dhe veprën e pavdekshme të shokut Enver Hoxha, kontributin e paçmuar që dha Ai për ndërtimin e Shqipërisë së re. Ky botim është një tjetër shenjë e dashurisë së thellë për Udhëheqësin e Paharruar të Partisë e të popullit.

## LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO

28 gusht 1945

I dashur Hysni<sup>1</sup>,

Me këtë letër dëshiroj t'ju bëj disa sugjerime lidhur me punën që duhet të përballosh për njohjen e luftës sonë, të nevojave tona, të vendit tonë, të Qeverisë sonë, prej vendeve të tjera demokratike. Kjo njohje nuk duhet bërë vetëm nga aleatët e mëdhenj, por edhe nga shtetet e tjera si: Franca, Çekosllovakia, Polonia. Ki parasysh: njohja e vendit tonë dhe e Qeverisë sonë nuk do të na vijë si peshqesh i gatshëm, por vetëm nga përpjekjet tona. Këto përpjekje ne duhet të dimë t'i koordinojmë dhe t'i harmonizojmë me ndihmën që na japin shtetet miq, me traditat e vjetra të miqësisë që ka vendi ynë me disa shtete etj.

---

1. Kjo letër i është dërguar shokut Hysni Kapo në Beograd, ku ai ishte ministër i Jashtëzakonshëm e Fuqiplotë i vendit tonë.

Të gjitha këto përbëjnë një kompleks të vetëm që po të dimë të punojmë me kujdes, me gjallëri, me takt dhe me prurëncë, mund të kemi përfitimë të shumta dhe mund të arrijmë rezultate të kënaqshme për vendin tonë. Një punë të tillë të bie ty ta bësh për arsye se je i pari dhe i vetmi ministër i Shqipërisë jashtë atdheut, i cili s'ka vetëm për detyrë të mbajë marrëdhëniet me Jugosllavinë por të krijojë kontakte, të lidhë miqësi, të kërktojë avantazhe prej të gjitha shteteve që kanë përfaqësitë e tyre në Beograd. Ti je përfaqësuesi ynë jo vetëm pranë Beogradit, por pranë gjithë shteteve të tjera evropiane, ose të kontinenteve të tjera, me të cilat ne s'kemi as më të voglin kontakt. Një punë të tillë nuk mund ta bëjnë as rusët dhe as jugosllavët, por mund ta bësh vetëm ti, prandaj duhet të kesh iniciativë.

Para së gjithash ti duhet të arrish që përfaqësuesit diplomatikë të shteteve demokratike të interesohen për çështjen tonë. Kjo gjë nuk mund të kryhet me një takim të rastit në zyrën e ndonjë funksionari të lartë apo në hotel dhe as duke mos pasur një legatë të përshtatshme. Duhet të kuptosh mentalitetet, afinitetet, ndjenjat, mendimet, idetë e këtyre njerëzve dhe, i armatosur me një eksperiencë të tillë, t'i futësh punës me gjallëri, për të mundur t'i afrosh këta njerëz, që ata të kenë simpati për ty e për vendin tonë, t'u imponohesh atyre jo me mirëpritjen në ndonjë darkë, por me zgjuarsinë tënde, me kulturën tënde të shëndoshë, të cilën përpiku ta zgjerosh, me

esprine<sup>1</sup> dhe me taktin diplomatik. Vetëm në këtë mënyrë atyre mund t'u forcosh bindjen, ti bësh miq, që të interesohen direkt për çështjet tona. Që t'u flasësh për vendin tënd, këtyre njerëzve, duhet të dish më parë t'u flasësh për vendin e tyre, për luftën e tyre, për historinë e popullit të tyre, për literaturën, shkencën e vendit të tyre. Të shohin ata se kanë të bëjnë me një njeri që s'di vetëm pesë fjalë për luftën e sotme, por që ka njohuri për Revolucionin Francez, për literaturën franceze, që ka njohuri për ndjenjat e popullit frëng, për heroizmin e tij, që di për historinë e popullit çek, për Jan Husin, për luftën e fshatarëve çekë, për industrinë e tyre të përparuar, për përpjekjet e Masarikut<sup>2</sup> dhe të Beneshit<sup>3</sup> në luftën e madhe e në luftën e sotme etj., etj. Këtyre njerëzve duhet t'u përkëdhelësh *amour propre*<sup>4</sup> nacional të tyre, që kështu të interesohen dhe ata për çështjet e tua. Nga ana tjetër, të interesohesh për mendimet e tyre politike që të mos biesh në gabime politike, pse mund të qëllojë, dhe kjo në më të shumtat e herës, që, bie fjala, ambasadori francez të jetë një njeri me ide të së djathtës. S'është as puna jote dhe as interesi yt t'i mbushësh mendjen se idetë e tij s'vlejnë as

1. Nga frëngjishtja — me mprehtësinë.

2. T. Masarik — më 1918 president i përkohshëm i republikës çekosllovake të sapoformuar; u zgjodh në këtë post edhe në vitet 1920, 1927 dhe 1934.

3. E. Benesh — bashkëpunëtor i ngushtë i Masarikut. Zuri vendin e tij, si president në vitin 1935.

4. Frëngjisht — sedrën.

një dhjetësh. Nga kjo nuk ke aspak fitim, sepse atij i është mbushur mendja top për punën e tij ashtu si të është mbushur dhe ty për punën tënde. Ty të intereson që t'i prekësh ata tela ku edhe ti ke interes por edhe ai ka interes. Ty nuk të intereson ambasadori në vetvete, por të intereson paraqitja që mund të bëjë në favor të vendit tënd, pranë qeverisë së tij. Ty të intereson që populli i atij përfaqësuesi diplomatik, të vihet në korant për Shqipërinë, për luftën tonë, për nevojat tona. Tash, pak më konkretisht:

Me Çekoslovakinë dhe me Poloninë, qeveritë e të cilave janë njohur prej aleatëve dhe që ne kemi interes të madh të njohin Qeverinë tonë. Ty të bie barra të përpiqesh që të kemi një rezultat pozitiv, me këto dy qeveri. Nuk ka asnjë arsye që ato të mos e njohin Qeverinë tonë. Me këto dy shtete duhet të kemi një afrim më të ngushtë, për të bërë të njohur luftën dhe vendin tonë. Me Çekoslovakinë mund të bëjmë edhe shkëmbime tregtare, për shembull, për makina e të tjera. Por tash, në radhë të parë, të stabilizojmë kontaktet. Te ne, aty pari, në Kongresin e Rinisë<sup>1</sup>, kishte ardhur një çekoslovak. Pse të mos dërgojmë ne nja dy përfaqësues të rinisë të bëjnë pjekje me rininë çeke dhe polake? Pse të mos dërgojmë ne disa gazetarë në këto vende dhe ata, gjithashtu, të dërgojnë gazetarët e tyre në vendin tonë? Bëji ti të gjitha këto sondazhe dhe përpiqu

---

1. Kongresi i 2-të i Rinisë u mbajt në Tiranë më 16 prill 1945.

të marrësh rezultate konkrete. Ne jemi një shtet i varfër dhe që kemi nevojë të madhe për kuadro e, sidomos, për kuadro të mësuar teknikë. Na duhet sigurisht që të dërgojmë në vende të ndryshme studentë të mësojnë nëpër universitete. Por me se t'i dërgojmë, dhe me ç'monedhë? Në të gjitha këto shtete ne jemi gati të dërgojmë studentë në fakultete të ndryshme, po të na japin disa bursa. Në këtë drejtim ti duhet të kërkosh nga të gjithë, nga çekët, nga polakët, nga bullgarët, rumunët dhe francezët.

Me diplomatin francez, pa marrë parasysh mendimet e tij, bisedo për traditën e kulturës franceze në Shqipëri, foli për Liceun e Korçës dhe për ish-Liceun e Gjirokastrës, nga ku kanë dalë me qindra nxënës, që tash gjenden në vendet drejtuese më me rëndësi. Duke kaluar nga kjo rrugë, i thuaj se është interesi jonë e i tij të na njohin Qeverinë në mënyrë që marrëdhëniet miqësore dhe kulturore të konkretizohen më mirë.

Me një fjalë, duhet të tregosh një interesim të jashtëzakonshëm që të mundim të kemi përfitime konkrete në lëmin e politikës ndërkombëtare. Ti e di, në përgjithësi, njohja e Qeverisë sonë nga ana e aleatëve po shkon shumë ngadalë. E kemi fjalën vetëm për qëndrimin amerikan dhe anglez këtu, në vendin tonë, pse sa për në shtypin ndërkombëtar, ti duhet të jesh në korent. Qëndrimi i tyre s'ka ndryshuar as një centimetër nga ai që ke lënë ti kur ke ikur. Amerikanët janë po ata të parët, pak më të afruar, në aparence, se

anglezët. Kohët e fundit Xheikobsi<sup>1</sup>, i cili shkoi në Uashington gjoja në një konferencë ku do të bisedohej njohja e Qeverisë sonë në Konferencën e Londrës, më tha se ishte i kënaqur për gjendjen e këtushme dhe se do të mbrojë shpejtimin e njohjes së Qeverisë sonë. Por këto janë fjalë veresie. Anglezët, po ata të parët, të ftohtë, arrogantë, s'lënë gjë pa thënë për ne, pësh-pësh andej-këndeje dhe asgjë s'u duket e mirë. Sikundër e di, me UNRRA-n ne e nënshkruam kontratën, por ndihmat janë fare fare të pakta, dhe po na sjellin vërdallë, «jo s'erdhi vapori» etj.

**Na bëj një raport të hollësishëm për situatën e atjeshme dhe përpiqu që me jugosllavët ose me rusët të stabilizohet një linjë e rregullt postare me aeroplan, nga Beogradi, të paktën një herë në javë dhe në një ditë fiks. Na vërë në korent për çdo gjë që ngjet në Jugosllavi, për rrymat e ndryshme politike, për forcën e tyre, për vendimet me rëndësi që merren. Me një fjalë për çdo gjë që ngjet atje do të jetë mirë që ne të kemi dijeni.**

Shumë të fala

Enver

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

---

1. Xheikobs — kryetari i misionit amerikan në Shqipëri

## **LETËR DREJTUAR FAN S. NOLIT**

**25 shtator 1945**

I nderuar zoti Noli,

Mesazhi i përzemërt që më dërguat më preku shumë dhe ju faleminderit. Për mua, për shokët e mi të luftës dhe për gjithë popullin shqiptar, fjalët Tuaja shprehin ndjenjat e larta patriotike dhe pasqyrojnë shpirtin demokrat të vëllezërve tanë të dashur të Amerikës dhe Tuajat, që keni qenë shpirti dhe mburrja e tyre.

Në vuajtjet e popullit tonë; në zjarrin e rreptë për çlirim, ku hodhëm pa rezerva gjithë forcat tona për kauzën e shenjtë të atdheut dhe të njerëzimit, ne mbanim të pashuar në zemër kujtimin dhe dashurinë për ju, o vëllezërit tanë të Amerikës, që në çdo moment keni luftuar për atdheun tonë të shenjtë dhe të përbashkët.

Shqipëria, për lirinë dhe pavarësinë e së cilës ranë me mijëra djem të popullit, Shqipëria

për të cilën, i nderuar zoti Noli, keni shkruar energjitë Tuaja, sot është e lirë; sot në qiellin e saj valon flamuri i pavarësisë dhe i demokracisë.

Populli ynë heroik që dha prova të shkëlqyera në këtë luftë, me besim të madh në forcat e veta, i është përveshur punës për të ndërtuar një të ardhme të lulëzuar. Dhe në përpjekjet tona për t'ia arritur këtij qëllimi do të jemi të gëzuar që Ju, si një luftëtar i palodhur për pavarësinë dhe demokracinë shqiptare, të jeni në gjirin e ngrohtë të popullit tuaj, për t'i dhënë ndihmën Tuaj të çmueshme dhe për të kurorëzuar përpjekjet e vlefshme në atdheun ku triumfuan ideat e popullit.

Mua ma do zemra që, në zgjedhjet e afërme për Asamblenë Kushtetuese, emri Juaj të figurojë tok me tanët dhe populli shqiptar, lirisht dhe demokratikisht të sanksionojë përpjekjet dhe veprat tona të përbashkëta. Ashtu si kemi qenë kurdoherë të bashkuar me zemër në luftën tonë, ashtu të jemi edhe tani e përgjithmonë për të mirën e popullit tonë të dashur dhe për mbrojtjen e paqes së njerëzimit.

Gjeneralkolonel

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 3, f. 92-93*

Gjendshkollor  
Zaner Hoxh  
LETËR DREJTUAR KËSHILLIT  
TË BASHKIMIT TË GRUAS ANTIFASHISTE  
TË GJIROKASTRËS

6 nëntor 1945

Mëma dhe motra të mia të Gjirokastrës,

Telegrami juaj më preku thellë, por me keqardhje më është e pamundur të mbush dëshirën tuaj, pse Komiteti Ekzekutiv i Frontit e gjeti me vend që unë të vë kandidaturën në kryeqytet.

Por në këto momente historike, me dashuri të madhe mendoj për qytetin tonë të dashur ku kam lindur dhe ku kam mësuar të dua popullin dhe të luftoj për të. Unë jam krejt i bindur se populli i Gjirokastrës, ashtu si u hodh i tëri në luftë për çlirimin e atdheut ashtu do të shkojë të votojë i tëri për kandidatët e Frontit, për ata që

luftuan për t'i siguruar atdheut fitoren dhe që  
do të luftojnë për t'i siguruar pavarësinë, demo-  
kracinë dhe lulëzimin.

Rroftë populli i Gjirokastrës!

Gjeneralkolonel

*Enver Hoxha*

LETËR DREJTUAR KESHILLIT  
DASHKIMIT TË GRUAS ANTIPASHISTE  
TË GJIROKASTRËS  
Vepra, vëll. 3, f. 169

8 nëntor 1943

Siç keni parë nga kjo letër, kam marrë pjesë në  
konferencën e Komitetit Ekzekutiv të Frontit të  
Liberimit Kombëtar të Gjirokastrës, të mbajtur  
në këto momente historike, me dashurinë  
dhe me mendimet për detyrën tonë të dasur  
në luftë dhe ku kam marrë pjesë me dashurinë  
dhe me mendimet për detyrën tonë të dasur  
në luftë për të. Unë jam krejt i bindur se  
Fronti i Gjirokastrës, ashtu si u hodh i fort  
për çlirimin e atdheut ashtu do të shkojë  
për të për kandidimet e Frontit, për ata që

## **LETËR DREJTUAR TË RINJVE VULLNETARË TË RRUGËS KUKËS—PESHKOPI**

**27 tetor 1946**

Të dashur shokë dhe shoqe të rinisë që ndër-  
tuat rrugën Kukës—Peshkopi,

E prisja me padurim këtë ditë të vija t'ju shihja dhe të gëzohesha me ju për suksesin e madh që korrët në fushën e rindërtimit të atdheut, por furtuna dhe shiu i tmerrshëm që shpërthyen në mbrëmjen e datës 23 e dëmet që u shkaktuan më kthyen nga rruga kur isha nisur për te ju. Detyrat qeveritare urgjente më penguan të nisesha përsëri, dhe unë e di se ju do të më kuptoni, por të jeni të sigurt se mendimet e mia më të mira dhe zemra ime është atje te ju, te ju që fituat, te ju që s'ka asnjë dyshim se do të fitoni kurdoherë, sepse në shpirtin tuaj keni të zhvilluar më tepër se kushdo tjetër ndjenjën e patriotizmit, të vetëmohimit dhe të sakrificës. Për

ju të rinjtë e vendit tonë këto ndjenja s'janë gjëra abstrakte, por janë të lidhura ngushtë dhe fort me luftën, me përpjekjet, me dëshirat, me shpresat, me realizimet, me perspektivën tonë për ndërtimin e një jete të lumtur për brezat e rinj të vendit tonë dhe për mbarë popullin shqiptar. Pa i pasë pasur këto ndjenja të zhvilluara në shkallën më të lartë, ashtu si i keni ju, ishte e pamundur të bëhej dhe të fitohej Lufta Nacionalçlirimtare që i dha Shqipërisë lirinë, independencën, sovranitetin; gjithashtu janë po këto ndjenja që na bëjnë të fortë dhe të pamposhtur në ndërtimin e jetës sonë të lumtur. Ju, djem të rinj dhe ju vajza të reja, që luftuat si luanë ndër ato male, ku latë me mijëra të vrarë nga shokët tuaj më të mirë, sot po derdhni djersën tuaj për të vazhduar rrugën e lavdishme të vaditur me gjakun e dëshmorëve tanë. Ashtu si luftuat me vetëmohim, ashtu po punoni edhe tani për një qëllim: Për Shqipërinë, për popullin. Për Shqipërinë, për popullin sakrificat më të mëdha s'janë kurrë të mjaftueshme. Këtë ju e keni kuptuar më së miri, kjo ju vë ju në pararojë dhe, për këtë gjë, populli ynë ju ka rrethuar me dashurinë dhe me dhembshurinë më të madhe.

Por gëzimi im do të ishte edhe më i madh sikur të ndodhesha edhe një herë në krahinat e Veriut të Shqipërisë, ndër ato vende dhe në mes të vëllezërve të Veriut, që kanë vuajtur shekuj me radhë në mjerime të patreguara të shkaktuara nga okupatorët e huaj dhe nga gjakpirë-

sit vendas. Gjithë Shqipëria ka vuajtur të zitetë e ullirit, por veçanërisht malësorët tanë të Veriut. Ndër ato vende kaq bujare, mbi ata malësorë kreshnikë, sundonte forca e bajraktarëve dhe e feudalëve, sundonte ligji gjakatar i tyre. Populli për këta bajraktarë hajdutë ishte skllav, ishte kafsha e punës dhe e mundimeve, ishte plaçka e tregut. Bajraktarët dhe bejlerët shtypës, priftërinjtë dhe hoxhallarët që u shërbenin krimin, vrasjeve, intrigave dhe vjedhjeve, sundonin mbi të mjerin shqiptar të Veriut. Çdo familje ishte në mëshirën e kanunit barbar, të intrigave të priftërinjve që bastardonin çdo ndjenjë të pastër, çdo zakon të vyer, që shkatërronin familjen, nderin e saj, ekonominë e saj. Dhe lufta u ndez në Shqipëri, lufta e shenjtë e çlirimit, ajo u rrit, u zmadhua, u bë e tmerrshme për armikun e huaj dhe për armiqtë e brendshëm të popullit shqiptar. Ata që luftonin në Shqipërinë e Jugut dhe në Shqipërinë e Veriut, kundër okupatorit dhe tradhtarëve, ata që udhëhoqën këtë luftë çlirimtare, ata që ranë në fushën e nderit, nuk mendonin: toskë e gegë, katolikë, ortodoksë e myslimanë, ata mendonin për çlirimin e një Shqipërie të vetme, për shpëtimin e një populli të vetëm dhe të bashkuar si një trup. Po kishte ardhur koha që populli të thoshte fjalën e tij dhe e tha. Forca e popullit është e madhërishme dhe e pathyeshme. As intrigat e bajraktarëve gjakpirës dhe të priftërinjve, as bajonetat e armikut të huaj, mbështetja e vetme e tyre, nuk e ndalën hovin e madh

revolucionar të popullit tonë të bashkuar. «Mos më shkëlpi në tokat e mia», bërtiste tradhtari Bazi i Canës, agjent i armikut okupator dhe këlysh i Ahmet Zogollit, po partizanët heroikë e përulanë atë dhe mercenarët e tij brenda tri orëve. Po kështhu bërtitnin, nga prehri i gjermanëve, tradhtarët Gjon Marka Gjoni, Muharrem Bajraktari, Fiqri Dine e të tjerë. Por brigadat e ushtrisë sonë të lavdishme, brigadat e popullit shqiptar, me një hov që s'është parë kurrë në historinë shekullore të vendit tonë, përshkuan si rrufeja këto male duke ndjekur këmba-këmbës gjermanët dhe bajraktarët tradhtarë e armiqtë të popullit. U vranë me mijëra shokë; ndër këto vende rreth e rrotull ranë heroikisht Nazmi Rushiti nga Dovolani, Demir Gashi dhe Riza Doda nga Reçi, Hasan Luma nga Peshkopia, Mexhit Tola nga Ostreni, Ahmet Cami nga Zerqani e shumë e shumë të tjerë. Por u çlirua Shqipëria e Veriut, u çlirua gjithë Shqipëria, populli mori frymë. Më kujtohet si tani një episod i kësaj lufte të madhe. Isha në malet e Korçës dhe në kohën kur forcat e ushtrisë sonë po ndiqnin këmba-këmbës mbeturinat e gjermanëve dhe të bajraktarëve përmes Mirditës, në Shtabin tonë kryesor ndodhej dhe një partizan plak prej Mirdite. Një mëngjes e shoh këtë partizan plak prej Mirdite të vijë me vrap tek unë dhe të më thotë me një frymë: «Shoku Komandant, kullat e Gjon Marka Gjonit u banë shkrumb e hi». Sytë i ndritnin nga gëzimi, ai ishte krejt i ndryshuar; për të lufta kishte mba-

ruar dhe ishte fituar. Unë vëreja supet e tij që pa u menduar i lëvizte pa pushim. Po, pa u menduar ai lëvizte supet sepse i ndiente të lehta; barra e rëndë shekullore e bajraktarit, Gjon Marka Gjonit, që ai e simbolizonte me kullat e Oroshit, kishte rënë dhe ishte zhdukur përgjithmonë. «Sulltani s'kish muejt dot me i djegë këto kulla, por shokët tanë i rrafshuen», vazhdonte të më thoshte partizani plak prej Mirdite. Tok me fashizmin okupator mori fund përgjithmonë mbretërimi barbar i Gjon Marka Gjonit dhe i priftërinjve që e ndihmonin, mori fund përgjithmonë sundimi dhe terrori i Muharrem Bajraktarit, i Fiqri Dines, i Pashuk Bibës, i Maliq Bushatit, i Prenk Calit e të tjerë banditë. Shqipëria tani është e popullit dhe vetëm e popullit, i cili ka fuqinë në dorë dhe askush nuk do të jetë në gjendje t'ia rrëmbejë. Këtë duhet ta kuptojnë dhe ta ndiejnë thellë vëllezërit tanë të Veriut. Në Shqipërinë e re nuk ka qeveri toskësh, por ka qeveri të popullit, për të cilën shqiptarët janë njësoj; në Shqipëri nuk sundojnë toskët, sikundër shpifin mbeturinat e fashizmit ndër ato anë, për të mbajtur gjallë metodat e vjetra përçarëse dhe shtypëse. Në Shqipërinë e re sundon populli shqiptar: toskë ose gegë qoftë, mysliman, katolik apo ortodoks, pa asnjë dallim, pa asnjë ndryshim. U zhduk përgjithmonë sundimi i njerëzve ose i klikave antipopullore. Duhet të vëmë gjithë forcat tona për t'ua bërë të qartë të gjithë njerëzve të Shqipërisë dhe veçanërisht në shumë raste

njerëzve të Veriut se si dhe qysh sundon populli dhe vetëqeveriset. Këtu qëndron programi ynë, dhe këtë duhet ta zbatojmë rigorozisht dhe pa as më të voglin lëshim. Malësorët e Veriut duhet të kuptojnë mirë se tani ata janë bërë zot të tokës, të fateve të tyre, se sot ka ardhur koha të vetëqeverisen, ta bëjnë ligjin vetë dhe ta zbatojnë vetë. Ata duhet të kuptojnë mirë ç'është pushteti i këshillave popullorë dhe cilët janë ata njerëz që duhet të vënë në ata këshilla popullorë. Çdo gjë do të zgjidhet, çdo gjë do të ecë në rrugën e mbarë të përparimit dhe jeta do të bëhet ditë-ditës më e mirë, në rast se ne e bëjmë të ndër-gjegjshëm malësin tonë për këtë armë të madhe që ai e ka fituar në regjimin e sotëm. Duhet të dimë se puna s'është aq e lehtë. Dhe nëse puna s'paraqitet aq e lehtë, sa paraqitet në Shqipërinë e Jugut, këtu s'është faji i malësorëve tanë. Këtë duhet ta kemi të qartë. Mercenarët e Jugut, vegla të verbra të Lumo Skëndos dhe të Ali Këlcyrës, që me armë vritnin, pritnin dhe grabitnin popullin për të mbrojtur dhe për të ndihmuar veprën e armikut okupator, ishin një mijë herë më shumë fajtorë se mercenarët e kriminelëve tradhtarë, Halil Alisë dhe Mark Gjon Markut.

Banditët e Ali Këlcyrës dhe të shokëve të tij dinin pse luftonin, por i mjeri katundar i Fushë-Alisë vritej për pesë napolona ose për një kapotë. Malësori i Veriut, që gënjehej nga bajraktarët dhe çohet e luftonte në Gjormin e Vlorës, habitej kur përtej shkëmbit i bërtiste partizani:

«Hej vëlla, pse po më vret, unë po luftoj për Shqipërinë, për mua dhe për ty, kundër italianit që na ka shkelur, që po na grabit pasuritë, ndërrin, tokën». I mjeri malësor kur shihte se ndër kodrat ku kishin zënë pozicion partizanët valonte flamuri i Shqipërisë, atëherë ai e kuptonte se ishte në tokën shqiptare, dhe luftonte kundër shqiptarëve, kundër vëllezërve të tij, dhe jo kundër grekëve, sikundër i kishin thënë bajraktarët e urryer. Kjo situatë ishte. Po vallë kjo situatë a ka ndryshuar në çdo skaj të Shqipërisë së Veriut? Unë them se ka përparime të mëdha. Por duhet punë e madhe, duhet patjetër që situata ekonomike, sociale, kulturore e krahinave të Veriut të ndryshojë qind për qind; katundari dhe punëtori i Veriut duhet të zhvillohen, të mësojnë, të shkruajnë e të lexojnë, të zhvillojnë njohuritë e tyre, pse kështu do të përmirësojnë jetën e tyre dhe do të bëhen të vlefshëm për atdheun. Katundari i Veriut duhet të ketë ndihmën më të madhe dhe përkrahjen më të madhe, pse konditat e së kaluarës e kanë lënë shumë pas atë; por ai është i zoti, i fortë, i zgjuar, të ecë përpara, të arrijë shokët dhe të bëhet një nga faktorët kryesorë të Shqipërisë së re. Kush humbet durimin, humbet edhe luftën, por njerëzit e Shqipërisë së re s'janë të kësaj kategorie. Ne dimë se që të arrijmë atje ku dëshirojmë, që malësori i Veriut të zërë vendin e merituar në Shqipërinë e re, do të hasim mjaft pengesa, por të gjitha të kapërcyeshme. Zakonet dhe traditat e këqija, që janë

të huaja për malësin tonë, por që bajraktarët dhe njerëzit e tyre janë munduar t'ua bëjnë si një jetë të dytë, do t'i hasim në rrugë. Këtu duhet të tregojmë zotësi dhe zgjuarsi për t'i zhdukur sa më shpejt këto. Malësi të kuptojë dhe të shohë dëmin që i sjellin këto të këqija, të cilat ishin ngritur në sistem prej gjakpirësve të popullit, me qëllim që malësi dhe katundari të ishte kurdoherë raja i beut dhe i bajraktarit ose i ndonjë prifti reaksionar. Katundari dhe malësi i Veriut të kuptojë mirë se ne nuk përzihemi me kishën e as me xhaminë, se ne nuk e ndalojmë atë të besojë, por ne luftojmë ata priftërinj ose ata civilë që fenë ose zakonet e këqija i përdorin për të skllavëruar dhe për të grabitur katundarin dhe malësin. Për një gjë të këtillë katundari dhe malësi është qind për qind me ne dhe jo me ata që e kanë gënjyer dhe i kanë pirë gjakun tërë jetën.

Të vëmë të gjitha forcat tona dhe të zhdukim injorancën në malësitë e Veriut, pse një gjë e tillë do t'ia kthjellojë horizontin malësorit tonë. Në këtë vepër të madhe përparimtare mbeturinat e bajraktarëve dhe të priftërinjve reaksionarë do të përpiqen të na pengojnë. Këtu unë po ju them se nuk do të kemi mëshirë. Për këtë gjë s'pranojmë asnjë arsye, asnjë konditë. Ai që nuk do të dërgojë djalin ose vajzën në shkollë, do të dënohet reптësisht. Të gjithë ata prapanikë ose priftërinj katolikë që do të tentojnë të gënjejnë malësin për rëndësinë e shkollës dhe të arsimit, dhe

do ta pengojnë atë që ta marrë këtë arsim, punët nuk do t'i kenë aspak mirë me ne. Kjo është e qartë. Sa dëshirë kanë malësorët e Veriut për hapjen e sa më shumë shkollave, këtë e tregojnë kërkesat e panumërta të tyre, këtë e tregojnë shkollat e reja që janë ngritur, këtë e tregon puna vetë e tyre se sa me dashuri po punojnë për ngritjen e këtyre shkollave. Po t'u hedhim një sy punimeve që janë bërë në gjithë krahinën e Shkodrës, të Kukësit dhe në vetë «Rrugën e Rinisë» do të shohim sa dëshirë të madhe ka populli të punojë kolektivisht, për përmirësimin e jetës së tij, që është forcimi i atdheut.

Të vëmë, pra, gjithë forcat tona për të ndër-tuar Shqipërinë dhe jetën tonë të re, të vëmë energjitë, dituritë dhe zotësitë tona që Veriu i Shqipërisë të përparojë, që jeta e katundarit dhe e malësorit tonë të përmirësohet nga çdo pikëpa-mje, që ata të shohin ditë më të lumtura, që ata të gëzojnë jetën si duhet në Shqipërinë e lirë, në Shqipërinë e tyre, në Shqipërinë e re. Kësaj gjë-je ne do t'ia arrijmë, pse kjo është dëshira dhe vullneti i gjithë popullit shqiptar, pse kjo është dëshira dhe qëllimi i Partisë Komuniste të Shqi-përisë.

Shokë të rinisë,

Druga që po inaugurojmë sot dhe që do të mbajë emrin tuaj të pavdekshëm, bën pjesë në

planin tonë që sapo tregova më lart, prandaj ju meritoni mirënjohjen e gjithë popullit shqiptar dhe veçanërisht të gjithë krahinës që do t'i shërbejë kjo rrugë. A keni menduar sa shërbime i keni bërë atdheut dhe popullit vetëm me hapjen e kësaj rruge? Fitimet materiale dhe morale që ka Shqipëria e re nga vepra juaj janë të paçmueshme. Kjo rrugë, që ju e ndërtuat me aq dashuri, do të jetë një faktor përparimi në gjithë këto krahina. Ç'fituam tjetër nga vepra juaj, që populli shqiptar i ndoqi punimet me aq vëmendje dhe dashuri? Ja pra: populli ynë tani e ka të qartë se me këtë rini që ka ai, e ardhmja e tij e lumtur është e siguruar. Në kasollet më të largëta të Malësisë së Veriut po flitet për ju, për veprën tuaj, për zotësinë tuaj që treguat. Muaj me radhë ju punuat duke kënduar dhe kënga juaj, entuziazmi juaj, elektrizoi gjithë Shqipërinë, forcoi shpresat dhe besimin, ngjalli ndërgjegjen në punë. A mendoni pak se ç'efekte morale ka bërë puna juaj në krahinat e Veriut? Ai malësor, që jeta e tij ishte një varr, kalon këtej dhe sheh një mizëri të rinjsh që çajnë malet me këngë në gojë. Por, «për kë punojnë këta njerëz?» — pyet malësori: — Për popullin e Veriut, për t'i lehtësuar vuajtjet malësorit, për ta ndihmuar të ngrihet dhe të përparojë, për ta bërë jetën e tij më të lumtur. — «Nga janë këta të rinj?» — pyet përsëri ai. — Ata janë nga të gjitha anët e Shqipërisë, ata janë katundarë, punëtorë, shkollarë, ata janë gjithë

Shqipëria që punon si një trup dhe për një qëllim: për popullin, për atdheun. Dhe malësori i Veriut, sikundër malësori i Jugut, mendon dhe nxjerr këto konkluzione të veta: «Forca qëndron në bashkimin e çeliktë; përparimi dhe mirëqenia i ka bazat në punën e ndërgjegjshme, të palodhur dhe të organizuar; një bashkim i tillë dhe një punë e tillë bëhen vetëm në Shqipërinë e re, në Shqipërinë e popullit». Të kemi sigurinë më të madhe se çdo shqiptar i ndershëm e ka bërë këtë hap të madh në rrugën e re të përparimit; na mbetet të ecim me këtë vrull që ia kemi nisur dhe ne do të ecim dhe do të përparojmë.

Shokë të dashur të rinisë,

Ju po ktheheni fitimtarë në familjet tuaja, por unë e di që s'jeni nga ata njerëz që t'ju dehin fitoret dhe t'ju zërë gjumi mbi dafina, ju e dini mirë rolin që luani në Shqipërinë e re, si edhe detyrat e reja që ju presin dhe që delegatët tuaj dhe të gjithë Rinisë Popullore të Shqipërisë i përcaktuan aq mirë e qartë në Kongresin e tyre të 3-të që sapo mori fund. Ju uroj suksese nga zemra në punë dhe në jetë, t'i kryeni detyrat tuaja me nder ashtu sikundër i keni kryer të gjitha deri tani. Atdheu ju është mirënjohës. Qeveria që kryesoj ju çon urimet më të nxehta dhe

ju siguron përkrahjen e pakufishme në çdo fushë të aktivitetit tuaj.

Rrofshin shokët dhe shoqet e rinisë që punuan në rrugën Kukës—Peshkopi!

Rroftë Rinia Popullore e Shqipërisë!

Rroftë populli shqiptar!

*Vepra, vëll. 3, f. 521*

**LETËR DREJTUAR  
ZONJËS VASILIA PAÇUKA**

*Lagjja Goricë-Berat*

**8 shkurt 1947**

Ju falënderoj për letrën që më çuat, e cila më gëzoi shumë për dy arsye: se keni mësuar të shkruani fare mirë dhe jeni një nënë plakë që djemtë i keni në shërbim të atdheut, në Ushtrinë tonë Kombëtare. Prandaj letrën tuaj e këndova me gëzim, ashtu sikundër i këndojnë djemtë e tu ushtarë, letrat që ju u dërgoni. Inkurajoni të gjitha shoqet tuaja, plaka dhe të reja, të mësojnë të shkruajnë e të këndojnë, pse sikundër më shkruani në letër, atyre do t'u hapen jo vetëm sytë, por dhe jeta do t'u bëhet më e lumtur, më e gëzuar, më e bardhë. Me postë do t'ju dërgoj një seri librash që t'i këndon, për të kuptuar më mirë sa të mëdha kanë qenë sakrificat e djemve

dhe të çupave që ju, mëmat e Shqipërisë, i rritët  
dhe ia falët atdheut si dhe për të kuptuar, gjitha-  
shtu, më mirë detyrat që ka sot populli në ndër-  
timin e jetës së tij më të mirë. Duke ju çuar të  
falat e mia ju uroj një pleqëri të bardhë.

*Enver Hoxha*

LETËR DREJTUAR  
KONKURSI VASILIA PACHKA  
Vepra, vëll. 4, f. 16

Lashje Gashi

8 shkurt 1971

[Faint, mirrored text, likely bleed-through from the reverse side of the page]

## TELEGRAM DËRGUAR VELO ALIKAJT

*Kuç-Kurvelesh*

1948

E studiova kërkesën tuaj të drejtë. Shkresa, numri i arkivolit dhe vendi ku është ndodhur trupi i panjohur që përmban ky arkivol, u gjetën. Tash është dërguar një oficer i Brigadës së III, që ka luftuar në Polis, për të kontrolluar dhe vërtetuar vendin e varrimit të djalit tuaj. Përfundimi do t'ju lajmërohet.

Për birin tuaj, Qani Alikaj, dëshmor i luftës së çlirimit, për meritat e tij dhe besnikërinë ndaj popullit dhe Partisë dhashë urdhër dhe u dekorua me Medaljen e Kujtimit, me Medaljen e Trimërisë dhe me Medaljen e Çlirimit. Medaljet e djalit tuaj shpejt do t'ju dërgohen.

Ju përshëndes ju dhe familjen tuaj.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR OFICERËVE PENSIONISTË RIZA KODHELI DHE AHMET STARAVECKA<sup>1</sup>**

**26 gusht 1949**

**SHOKËVE NËNKOLONEL RIZA KODHELI  
DHE KAPITEN AHMET STARAVECKA**

Unë e di se ju, si dhe gjithë luftëtarët trima të Luftës Nacionalçlirimtare, që çliruan atdheun nga okupacioni fashist, jeni gati të mbroni kurdoherë pavarësinë e vendit, fitoret e mëdha të Luftës Nacionalçlirimtare, punën paqësore të popullit tonë.

Armiku nuk mund të shkelë asnjë pëllëmbë të tokës sonë, pse populli ynë si kurdoherë është vigjilent dhe ushtria jonë trime është në roje të

---

1. Kjo letër iu dërgua këtyre oficerëve si përgjigje të gati-shmërisë së treguar nga ata për të luftuar në mbrojtje të kufijve shtetërorë të RPSH gjatë provokacioneve të muajit gusht 1949, të organizuara nga monarko-fashistët grekë, kundër vendit tonë.

pavarësisë, të paqes e të ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Ju falënderoj nga zemra ju dhe shokët e panumërt të luftës, që me letra e telegrame, shfaqin dashurinë e besnikërinë ndaj atdheut, popullit, Partisë sonë, ndaj kauzës së madhe të paqes e demokracisë dhe ndaj Stalinit të madh.

Gjeneralkolonel

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 6, f. 255*

## LETËR DREJTUAR FSHATARËVE TË TURANIT

*Tepelenë*

**12 qershor 1951**

E mora letrën tuaj që më drejtonit nga mbledhja juaj e përgjithshme e datës 4 qershor 1951, ku keni marrë në shqyrtim dhe keni vendosur përgatitjet për vitin e ri shkollor 1951-1952.

Kjo letër më ka gëzuar shumë, se në të shoh interesimin e madh që ju tregoni për një çështje kaq të madhe e kaq të rëndësishme siç është arsimi, që ndrit jetën tonë e na çon përpara në ndërtimin e socializmit.

Ju përgëzoj nga zemra për këtë iniciativë të bukur dhe ju uroj që të dilni faqebardhë në punë për kryerjen e zotimeve tuaja, për ta përgatitur sa më mirë vitin e ri shkollor 1951-1952.

Të gjithë e dimë, të dashur shokë fshatarë, se në çfarë errësire e patën lënë popullin tonë

klikat e regjimeve antipopullore, me qëllim që ta shtypnin e ta rripnin akoma më shumë.

Në sajë të luftës dhe të fitores së shkëlqyer të popujve mbi bishën naziste dhe në sajë të luftës heroike të popullit tonë trim, të udhëhequr nga Partia jonë e dashur, u vendos në Shqipëri pushteti popullor dhe, si çdo gjë tjetër, edhe arsimit u bë i masave punonjëse të qytetit e të fshatit. Krahas përparimeve të mëdha të bëra në vendin tonë brenda një kohe fare të shkurtër, në rrugën e ndërtimit të socializmit, arsimit ka marrë një zhvillim të paparë ndonjëherë. Këto suksese të mëdha në fushën arsimore, ashtu edhe në fushat e tjera të jetës sonë, janë korrur, pse populli është udhëhequr nga Partia jonë dhe pushteti popullor, të cilët kanë për qëllim e punojnë që arsimit e kultura të përfshijnë të gjitha masat punonjëse të vendit tonë.

Ju, shokë fshatarë, sigurisht do ta keni marrë vesh, me anën e shtypit që ju vjen në fshat, se këto ditë Kuvendi Popullor mori në shqyrtim dhe aprovoi buxhetin e shtetit për vitin 1951, viti i parë i planit pesëvjeçar që do t'ia ndërrojë faqen edhe më shumë atdheut tonë. Në këtë buxhet vetëm për arsimin janë caktuar 900 278 000 lekë, domethënë 276 552 000 lekë më shumë se në vitin 1950. Sivjet do të kemi më shumë shkolla fillore, shkolla 7-vjeçare, shkolla të mesme etj., ku do të mësojnë bijtë e bijat e popullit që të bëhen më të zotë, ta ndërtojnë dhe ta lulëzojnë atdheun tonë të dashur dhe ta bëjnë atë të fortë,

ta bëjnë një kala të vërtetë, ku të thyejnë kokën armiqtë e vendit tonë, imperialistët amerikano-anglezë dhe shërbëtorët e tyre, titistët, monarko-fashistët, neofashistët e të tjerë, që do të guxojnë të prekin punën tonë paqësore dhe përparimtare.

Jam shumë i gëzuar që ju, ashtu si i gjithë populli shqiptar, këtij kujdesi të madh që tregon Partia për të përhapur kudo dritën e arsimit, po i përgjigjeni sot me zotime se do të vini të gjitha forcat tuaja për ta përgatitur vitin e ri shkollor 1951-1952 në të gjitha pikëpamjet, se do ta kryeni qind për qind detyrimin shkollor, se do të dërgoni në shkollën 7-vjeçare të Tepelenës të gjithë fëmijët që janë planifikuar, se do ta pajisni e do ta rregulloni shkollën me të gjitha ç'i nevojiten dhe do ta ktheni 1 shtatorin, ditën e fillimit të mësimëve, në një ditë feste e gëzimi për fëmijët tuaj dhe për gjithë fshatin.

Ky është një zotim për t'u lavdëruar dhe Komiteti Qendror i Partisë, Qeveria dhe unë jemi të bindur se nën udhëheqjen e organizatës së Partisë, me mobilizimin total të organizatës së Frontit, të rinisë dhe të gruas në fshat dhe me ndihmën e pushtetit, do ta kryeni me nder këtë detyrë të madhe patriotike, ashtu siç keni kryer të gjitha detyrat e tjera që në kohën e luftës e deri sot, se kjo është për të mirën tuaj, të fëmijëve tuaj dhe për të mirën e atdheut.

Komitete Qendror, Qeveria dhe unë jemi të sigurt që kësaj iniciative të bukur që morët ju,

do t'i përgjigjen të gjithë punonjësit e qytetit e të fshatit të vendit tonë, se do të mobilizohet i madh e i vogël në mënyrë që viti i ri shkollor ta gjejë çdo gjë të përgatitur me kohë dhe dita e 1 shtatorit të kthehet në një festë të madhe në të gjithë Shqipërinë. Jam i sigurt se nën udhëheqjen e organizatave të Partisë dhe me mobilizimin e bashkimeve profesionale, të rinisë, të gruas, të Frontit Demokratik, me ndihmën e pushtetit popullor dhe me punën e palodhur të të gjithë punonjësve të arsimit, duke e kuptuar secilin arsimin si një nga çështjet më kryesore të popullit, viti i ri shkollor 1951-1952 do të përgatitet, do të fillojë e do të vazhdojë me sukses të plotë deri në fund dhe jemi të bindur se edhe në vitet e ardhshme populli ynë do të mobilizohet i tëri për këtë qëllim të lartë.

Komiteti Qendror, Qeveria dhe unë jemi të sigurt se nxënësit e fshatit tuaj dhe nxënësit e të gjitha shkollave të Shqipërisë do ta ndjekin shkollën rregullisht e me zell, do të mësojnë mirë dhe do t'i përvetësojnë si duhet mësimet, në mënyrë që të kenë nota më të mira në të gjitha lëndët.

Jemi të sigurt, gjithashtu se, edhe mësuesit nga ana e tyre do të mobilizohen akoma më shumë në kryerjen e detyrës së shenjtë që u ngarkon populli dhe Partia. Mësuesit duhet të nderohen, të respektohen dhe të ndihmohen nga nxënësit dhe nga populli. Ata i ka pasur dhe do t'i ketë përgjithmonë në kujdes shteti për të perfeksionuar përgatitjen e tyre kulturore, ideologjike dhe

profesionale dhe për të përmirësuar gjendjen e tyre ekonomike.

Edhe një herë ju uroj që të dilni faqebardhë, si ju ashtu dhe i gjithë populli në qytetet e fshatrat e tjera të vendit tonë dhe ju përhëndes nga zemra.

*Enver Hoxha*

*Veptra, vëll. 8, f. 254*

**PËRSHËNDETJE DËRGUAR KOLEKTIVIT  
PUNONJËS TË NDËRMARRJES SË NDËRTIMIT  
TË HIDROCENTRALIT «LENIN»**

*Tiranë*

**3 nëntor 1951**

I papërshekruar është gëzimi i popullit për mbarimin me sukses të të parit hidrocentral madhështor në vendin tonë. Populli shqiptar dhe veçanërisht ai i Tiranës do t'ju jetë mirënjohës përjetë juve, shokë punëtorë, teknikë dhe inxhinierë që me zotësinë e madhe dhe heroizmat e papërshekruar, realizuat në kohën e duhur këtë vepër të madhe të socializmit, që do të furnizojë me energji elektrike industrinë dhe do të bëjë të ndritë kryeqyteti i atdheut tonë të lirë e sovran.

Në këto ditë historike, kur populli ynë feston i gëzuar 10-vjetorin e Partisë sonë heroike dhe 34-vjetorin e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, zemrat e të gjithë shqiptarëve rrahin me

mirënjohje të thellë për Partinë tonë të Punës.  
Ju përgëzoj nxehtësisht për punën vetëmohuese që keni bërë dhe ju uroj suksese të mëtejshme në realizimin e veprave të tjera të tilla edhe më të mëdha që do të ndërtohen në të ardhmen.

Rroftë Partia jonë heroike e Punës!

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 8, f. 382*

## **LETËR DREJTUAR PIONIERËVE TË SHKOLLËS SË LUKOVËS**

*Sarandë*

**17 shkurt 1952**

Çetës së pionierëve të Lukovës,

Ju falënderoj nga zemra të gjithë ju pionierë të fshatit Lukovë për dhuratën e bukur që më dërguat.

Uroj që për familjet tuaja, viti i ardhshëm të jetë edhe shumë më i frytshëm në zhvillimin dhe prodhimin e portokajve, limonave etj., që kështu jeta juaj të bëhet më e begatshme, që të zhduken përgjithmonë nga zemrat tuaja të pastra e të njoma çdo brengë e çdo mërzi, që të keni ç'të dëshironi, që të rroni të lirë, të lumtur në atdheun tonë të lirë, të bukur e të shtrenjtë.

Të doni me gjithë shpirt Partinë që udhëheq popullin tonë në rrugën e jetës së lumtur, në socializëm.

Partia dhe Qeveria, që udhëheqin popullin tonë, luftojnë me këmbëngulje për të ardhmen tuaj të begatshme. Ne do të fitojmë. Populli me Partinë kurdoherë do të korrin fitore. Dhe ju, si bij të denjë të popullit tonë trim dhe të Partisë sonë heroike, duhet të mësoni, kurdoherë të mësoni dhe vazhdimisht të mësoni, pse vendi ynë ka shumë nevojë për njerëz të mësuar dhe dituria në djemtë e popullit është arma e fortë, me të cilën do të ndërtojmë më shpejt socializmin.

Ju përqafoj  
Miku juaj besnik

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 9, f. 119*

**LETËR DREJTUAR PRINDËRVE  
TË USHTARIT GOR TRIFONI, DHIMITËR  
DHE FOTINA TRIFONI**

*Fier*

**25 maj 1957**

Të dashur prindër të ushtarit Gor Trifoni,

Morëm letrën tuaj në të cilën shprehni ndjenjat tuaja më të thella të besnikërisë ndaj Partisë dhe Qeverisë sonë, me rastin e vdekjes së parakohshme të birit tuaj, ushtarit të popullit tonë, Gorit, në krye të punës për ndërtimin e Hidrocentralit të Ulzës.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, ju dërgon ngushëllimet e tij më të përzemërta për vdekjen e birit tuaj të shtrenjtë dhe ndërtuesit të socializmit në atdheun tonë, Gor Trifoni.

Kjo ngjarje e hidhur ka prekur thellë zemrat

tona. Ashtu sikurse shkruani ju, djali juaj dha jetën e tij në frontin e punës, për lulëzimin e atdheut, për ndërtimin e jetës së re dhe të lumtur. Qëllimi i shenjtë i Partisë sonë është ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit, për t'i siguruar popullit tonë një jetë të lumtur e të begatshme dhe për këtë qëllim punoi dhe vdiq biri juaj i shtrenjtë, Gori.

Partia jonë e Punës, duke u mbështetur në vullnetin dhe besimin e patundur të masave punonjëse për ndërtimin e socializmit, ashtu siç shkruani edhe ju, me siguri do ta bëjë atdheun tonë të dashur, në një kohë sa më të afërt, një kopsht të lulëzuar, në luftë të paprerë kundër armiqve që do të na pengojnë në këtë rrugë të lavdishme.

Vendosmëria, vullneti në punë dhe patriotizmi i birit tuaj, do të na mbeten të paharrueshëm, ata do të frymëzojnë brezin tonë të ri për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e paqes.

Për Komitetin Qendror të PPSH

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 14, f. 456*

**LETËR DREJTUAR PIONIERËVE TË ÇETËS  
SË SHKOLLËS 7-VJEÇARE «NAIM  
GJYLBEGU», SHPAL**

*Mirditë*

**19 tetor 1957**

Të dashur shokë pionierë,

Ju falënderoj me gjithë zemër për urimet që më dërguat me rastin e ditëlindjes sime.

Jam shumë i gëzuar që me këtë rast t'ju uroj edhe juve shëndet, lumturi dhe suksese në mësim për t'u bërë të vlefshëm për atdheun dhe Partinë tonë të dashur.

Shkolla juaj mban emrin e njërit prej herojnve të Vigut, Naim Gjylbegut, i cili, së bashku me shokët e tij, dha jetën duke luftuar kundër okupatorit nazist dhe tradhtarëve të vendit, për Shqipërinë e lirë dhe socialiste. Mbajeni lart emrin e këtij heroi, mësoni dhe gjithnjë mësoni, dë-

gjoni me kujdes dhe zbatoni këshillat e prindërve, të mësuesve dhe të edukatorëve tuaj, për t'u bërë të vlefshëm për veten, prindërit, për atdheun dhe Partinë tonë të dashur, e cila ka punuar dhe punon për të ardhmen më të lumtur të brezit tuaj të ri.

Edhe një herë ju uroj me gjithë zemër shëndet, lumturi dhe suksese kurdoherë më të mira në punët shkollore për t'u bërë bij të denjë të atdheut tonë të bukur socialist dhe të Partisë sonë të dashur.

Juaji

*Enver Hoxha*

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR SHOKUT  
MASAR SHKOZA**

*Tiranë*

**Dhjetor 1957**

I dashur shoku Masar,

Mora telegramin tuaj, me anën e të cilit më njoftoni se ndërmjet dy festave të mëdha të popullit tonë, 28 dhe 29 Nëntorit, ju ka lindur djalë dhe se kërkonti që unë të gjej emrin e tij.

Ju falënderoj që më keni zgjedhur mua për të gjetur emrin e djalit tuaj. Me këtë rast i uroj atij shëndet të mirë dhe lumturi në jetë. Uroj gjithashtu që të bëhet i vlefshëm për familjen dhe të rritet si bir i denjë i popullit tonë heroik. Unë jam i sigurt se ju, si anëtar i Partisë sonë, do ta edukoni atë me frymën e dashurisë së pakufishme për atdheun tonë socialist dhe për Partinë tonë të lavdishme.

Meqenëse djali juaj lindi në këto ditë gëzimi,  
dhe se e gëzuar do të jetë e ardhmja që po për-  
gatit Partia jonë për brezin eri, unë do të dëshiro-  
roja t'ia vinit djalit emrin Gëzim. Në qoftë se ju  
jeni dakord, atëherë e gëzofte emrin dhe me jetë  
të gjatë.

*Enver Hoxha*

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH

7 janar 1958

BYROSË POLITIKE TË KOMITETIT QENDROR TË  
PPSH

Të dashur shokë,

Më 11 janar do të inaugurohet një nga veprat më të mëdha të planit tonë të dytë pesëvjeçar, hidrocentrali «Enver». Kjo vepër e mrekullueshme u ndërtua nga klasa jonë punëtore heroike e udhëhequr nga Partia jonë e dashur.

Kjo fitore e madhe u arrit, si të gjitha fitoret e tjera që ka korrur populli ynë, për arsye se Partia jonë, Parti e tipit të ri leninist, është udhëhequr në çdo hap nga doktrina e pavdekshme e marksizëm-leninizmit. Partia jonë në ndërtimin e hidrocentraleve ka pasur kurdoherë parasysh fjalët e Leninit të madh:

*«Komunizmi është Pushteti Sovjetik plus elektrifikimi i të gjithë vendit...»<sup>1</sup>.*

Ky hidrocentral i madh, që ne do të inaugurojmë më 11 janar 1958, është quajtur që në fi-

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 31, f. 480.

llim me emrin tim. Ky është një nder shumë i madh që më është bërë nga ana e Partisë sonë të dashur, për të cilën kam shkruar dhe do të shkruaj të gjitha energjitë e mia.

Me këtë letër unë vij t'ju lutem, të dashur shokë, që të ndryshohet emri i hidrocentralit të Ulzës, ai të mos quhet më me emrin tim dhe i propozoj Byrosë Politike të Komitetit Qendror që kësaj veprë madhështore t'i vënë emrin e themeluesit dhe mësuesit të lavdishëm të komunizmit ndërkombëtar, Karl Marks<sup>1</sup>.

Unë falënderoj me mirënjohje të pafund Partinë tonë, Komitetin Qendror të saj dhe gjithë punëtorët heroikë, teknikët dhe inxhinierët që, duke punuar kaq vjet me radhë, i dhanë popullit tonë këtë vepër të madhe, e cila, bashkë me hidrocentralin e parë në Shqipëri, me emrin «Lenin», janë një bazë e shëndoshë elektrike, që i hapin rrugën ndërtimit të hidrocentraleve të tjera në vitet e ardhshme dhe elektrifikimit të të gjithë Shqipërisë në perspektivë, i hapin popullit tonë rrugën e begatisë dhe të lumturisë.

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 15, f. 151*

---

1. Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH mori parrasysh kërkesën e shokut Enver Hoxha dhe vendosi që hidrocentrali mbi lumin e Matit të quhet me emrin e themeluesit dhe mësuesit të lavdishëm të komunizmit ndërkombëtar, Karl Marks.

## **LETËR DËRGUAR FSHATARËVE TË ZHAVARËS**

**2 mars 1958**

**TË DASHUR SHOKË DHE SHOQE TË KOOPERATIVËS  
BUJQËSORE «BAJRAM CURRI» ZHAVARË**

Mora letrën tuaj dhe sihariqin që më jepni se ju formuat kooperativën. Ju them se kam ndier një gëzim shumë të madh, kur këndova letrën tuaj, të dashur vëllezër dhe motra; u gëzova pa masë, se tani jeta juaj do të përmirësohet shumë dhe me hapa shumë më të shpejtë. Populli thotë: «bashkimi bën fuqinë» dhe unë shtoj se bashkimi do t'ju sjellë dhe begatinë. E meritoni plotësisht që të rroni të lumtur e të gëzuar ju, bijtë e bijat tuaja si edhe brezat tuaj të ardhshëm.

---

1. Fshat në rrethin e Fierit, ku ishin vendosur familje të shpërngulura me dhunë nga Kosova në vitet 1924, 1935, 1936 etj., për shkak të persekutimeve nga qeveria jugosllave.

Ju jeni bij dhe bija të dashura të popullit tonë heroik. Vëllezërit tanë të Kosovës, gjatë gjithë historisë shekullore të popullit tonë kanë luftuar heroikisht për këtë truall; historia e viteve të fundit të shekullit të 19-të dhe të fillimit të shekullit të 20-të, është mbushur me luftëra legjendare të popullit trim shqiptar të Kosovës, për nënën Shqipëri, për Shqipërinë tonë të përbashkët, që ajo të bëhej e lirë, e pavarur, e popullit.

Ne tani jetojmë të lirë, në atdheun tonë që e çliruam me luftë të përgjakshme. Ne na udhëhoqi në fitore Partia jonë e lavdishme dhe tani ndërtojmë socializmin, jetën e begatshme.

Partia dhe Qeveria jonë, veçanërisht për ju, të dashur motra dhe vëllezër kosovarë, dëshirojnë që të zhduken krejtësisht hallet nga shtëpitë tuaja, të zhduket errësira, të lulëzojë në vatrat tuaja gëzimi, dashuria, dituria. Ju do të keni çdo dihmë nga ne. Unë do të jem i lumtur, t'ju përmbush, në rast se ju do të keni ndonjëherë, ndonjë nevojë për mbarëvajtjen e kooperativës suaj.

Sa shumë u gëzova që ju i vutë kooperativës suaj emrin e Bajram Currit, të heroit të lavdishëm të popullit shqiptar, të luanit të pamposhtur të Dragobisë, kujtimin e të cilit çdo shqiptar e mban në zemër.

Pra, të dashurit e mi, mbajeni lart emrin e Bajram Currit dhe me flamurin e Partisë sonë, që ishte dhe flamuri i Bajram Currit, pra, me këtë flamur, që u realizuan ëndrrat e këtij pa-

tricti të madh, ju të ecni përpara në rrugën e begatisë dhe të përparimit.

Unë kam bindjen e plotë se kooperativa «Bajram Curri» do të dalë në radhën e parë të kooperativave të rrethit, pse kosovarët janë njerëz të zgjuar, njerëz trima e punëtorë.

Ju përqafoj me mall ju dhe të gjithë vëllezërit e tjerë kosovarë, që s'janë në kooperativë. U bëni atyre shumë të fala nga unë. Ju këshilloj t'i doni ata, t'i ndihmoni, ani se s'janë futur në kooperativë. Ata janë vëllezërit tanë, nesër dhe ata do ta gjejnë rrugën e kooperativës, ashtu si gjen zogu folenë e tij. Ju uroj me gjithë shpirt suksese të mëdha!

Juaji

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 15, f. 240*

## **LETËR DREJTUAR KOSTANDINA LONDARIT<sup>1</sup>**

**Odriçan, Përmet**

**10 mars 1958**

E dashur mëmë Kostandinë,

Mora letrën tuaj dhe ju falënderoj nga zemra për sa shkruani. Mua më kujtohet fare mirë koha që kam kaluar, bashkë me shokët e mi, në shtëpinë tuaj mikpritëse, në ditët e vështira të luftës për çlirimin e atdheut. Unë ruaj kujtimet më të mira nga kujdesi që Ju, ashtu sikurse gjithë populli ynë, keni treguar për ne dhe për këtë ju jemi mirënjohës.

---

1. Kostandina Londari, nga fshati Odriçan i rrethit të Përmetit, me anë të një letre i kërkonte shokut Enver një fotografi të tij, për ta pasur pranë, në dhomën ku ai kishte punuar, gjatë verës së vitit 1944.

Duke plotësuar dëshirën tuaj, po ju dërgoj fotografinë së bashku me urimet e mia më të mira, për jetë të gjatë, shëndet dhe pleqëri të lumtur.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

LETËR DREJTUAR SHOKUT  
HAJDAR SHEHDULLA<sup>1</sup>

*Kavajë*

**17 prill 1959**

I nderuari Hajdar Shehdulla!

Mora letrën tuaj, bashkë me dokumentet e tjera, nga të cilat mësova mbi jetën dhe punën tuaj të gjatë si mësues i vjetër i gjuhës shqipe. Nga letra juaja mora vesh se, me gjithë kushtet e vështira, ndjekjet e persekutimet që u bëheshin nga pushtuesit turq e më vonë nga serbomëdhenjtë atyre që punonin për përhapjen e gjuhës shqipe e të ndjenjave patriotike ndërmjet shqiptarëve, ju keni punuar me guxim në këtë drejtim dhe keni kontribuar në çështjen e madhe kombëtare të popullit shqiptar.

---

1. Hajdar Shehdulla ka punuar si mësues për një kohë të gjatë në Kosovë.

Partia, pushteti popullor, gjithë populli ynë i çmojnë shumë dhe nuk kanë për t'i harruar kurrrë ata që kanë punuar për të mirën e tij, dhe ju mund të krenoheni që bëni pjesë në radhën e këtyre njerëzve.

Për sa u përket kërkesave tuaja, organet kompetente janë porositur t'i shikojnë ato dhe, në përputhje me ligjet në fuqi, të zgjidhin çështjet që ju shtroni.

Ju uroj shëndet të mirë juve, familjes dhe pleqëri të bardhë!

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR SHOKUT  
IDHOMENE BRATKO**

22 tetor 1959

I dashur shoku Idhomene Bratko,

Ju uroj nga zemra martesën e birit tuaj Maksit me Fatbardhën, e cila është dhe kushërira ime. Unë dhe familja ime u urojmë fëmijëve që martohen, të trashëgohen dhe të shkojnë një jetë të lumtur dhe të gëzuar dhe juve, prindërve të tyre, lumturi, jetë të gjatë dhe të gëzuar.

Unë do t'i këshilloja Maksin dhe Fatbardhën të punojnë me gjithë shpirt për popullin, për Partinë, pse kështu kanë punuar edhe për lumturinë e jetës së tyre dhe të kalamanëve që ata do të lindin më vonë. Unë do t'u uroj që ata të ndjekin shembullin e babait të tyre, Idhomene Bratkos, i cili është një patriot i shquar, që ka luftuar gjithë jetën për popullin shqiptar.

Më vjen shumë keq, i dashuri Idhomene që

s'vij dot në dasmë e të gëzohem tok me ju, pse punët në Tiranë më detyrojnë të mos largohem, por jam i bindur se ju do të më falni dhe do të më kuptoni. Por megjithëse s'do të jem me ju ditën e dasmës, përsëri zemra ime do të jetë me ju, shoku im i luftës, Idhomene.

Të falemnderit shumë për urimet që më bëni për ditëlindjen. Jeta ime është në shërbim të popullit dhe të Partisë.

Jepi shumë të fala dhe urimet e mia më të mira, gjithashtu mëmës së Maksit si dhe Areti Viosos nderimet e mia.

Ftesën që më bëni nuk do ta harroj. Kur të vij në Korçë më keni borxh një drekë.

Duke të përqafuar

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR NXËNËSVE DHE  
PEDAGOGËVE TË SHKOLLËS PEDAGOGJIKE  
«LUIGJ GURAKUQI»**

*Elbasan*

**30 nëntor 1959**

Të dashur nxënës, mësues dhe pedagogë të shkollës pedagogjike «Luigj Gurakuqi»

Ju përshëndes nga zemra dhe ju uroj nxeh-tësisht me rastin e 50-vjetorit të themelimit të shkollës suaj!

Ngritja e Shkollës Normale të Elbasanit në vitin 1909, kur Shqipëria ishte akoma nën sundimin e pushtesve otomanë, është një ngjarje e shënuar në historinë tonë kombëtare. Ajo, si e para shkollë e mesme te ne, shënon një tjetër sukses të madh në përpjekjet heroike të rilindësve dhe të të gjithë popullit tonë liridashës e përparimtar

për hapjen e sa më shumë shkollave në gjuhën amtare.

Që nga ajo kohë ka kaluar gjysmë shekulli. Ngjarje shumë të rëndësishme janë zhvilluar gjatë kësaj kohe në vendin tonë. Por Shkolla Normale e Elbasanit, megjithëse në kushtet e vështira të regjimeve antipopullore, u bë një vatrë e rëndësishme kulturore dhe arsimore për edukimin patriotik të nxënësve të saj, të cilët, pasi mbaronin studimet, shpërndareshin dhe përhapnin dritën e arsimit e të kulturës në masat punonjëse të vendit tonë.

Gjatë Luftës së lavdishme Nacionalçlirimtare, që e udhëhoqi me guxim dhe urtësi Partia e lavdishme Komuniste Shqiptare, Shkolla Normale e Elbasanit u bë një çerdhe e rëndësishme e luftës për lirinë e atdheut. Nxënësit e Normales së Elbasanit përçafuan me dashuri të madhe rrugën që u tregoi Partia, u bashkuan me luftën e popullit dhe luftuan me trimëri deri në çlirimin e plotë të atdheut.

Partia jonë e lavdishme, e udhëhequr nga mësimet e ndritura të marksizëm-leninizmit, ka vlerësuar dhe i ka ngritur lart traditat e shkëlqyera luftarake dhe përparimtare të popullit tonë. Ajo çmon gjithashtu shumë edhe kontributin e madh që ka dhënë gjatë gjithë kohës së saj Shkolla Normale e Elbasanit për përhapjen e arsimit e të kulturës dhe të ideve patriotike, liridashëse e përparimtare në masat e popullit tonë.

Me respekt do t'i kujtojnë kurdoherë populli

dhe Partia jonë emrat e drejtuesve dhe pedagogëve të tillë që kanë dhënë mësim në shkollën tuaj, si patriotin e shquar Luigj Gurakuqin, doktor profesor Aleksandër Xhuvanin e të tjerë, ose të nxënësve të asaj shkolle, si patriotin demokrat Avni Rustemin, të dëshmorëve të Luftës Nacionalçlirimtare, si Tomor Sinanin, Jordan Misjen, Abdyl Myzyrin e shumë të tjerëve.

Të gjithë ne, të dashur nxënës, mësues dhe pedagogë, jetojmë sot në atdheun tonë të lirë, kur populli, i udhëhequr nga Partia, po ecën përpara me sukses në rrugën e ndritur të socializmit. Pardje, i gjithë populli ynë festoi me madhësi 15-vjetorin e Çlirimit dhe bëri me këtë rast bilancin e fitoreve shumë të mëdha të realizuara gjatë kësaj periudhe të shkurtër historike. Sukseset që ka arritur deri tani populli shqiptar janë shumë të mëdha dhe një e ardhme akoma më e lumtur e pret atë. Por, për ta shpejtuar ritmin e ndërtimit të socializmit neve na duhen akoma më shumë njerëz të mësuar dhe në këtë çështje një rol të dorës së parë do të luani ju, të dashur nxënës të Shkollës Pedagogjike, që, pasi të mbaroni shkollën, do të shpërndaheni në të katër anët e atdheut për të mësuar djemtë dhe vajzat e popullit.

Populli do t'ju besojë juve gjënë më të shtrenjtë, fëmijët e tij për t'i mësuar dhe edukuar, brezin e ardhshëm të atdheut tonë. Detyra si arsimtarë të ardhshëm është që t'ia shpërbleni popullit këtë besim të madh me punë të palodhur,

duke vënë të gjitha forcat për kryerjen e detyrës me ndërgegje të lartë. Partia jonë e vlerëson lart detyrën fisnike të mësuesit, punën e tij shumë të rëndësishme dhe delikate, prandaj të keni kurdoherë parasysh që kur të mbaroni shkollën t'i përgjigjeni me entuziazëm dhe menjëherë thirrjes për të shkuar atje ku do të caktoheni, në çdo skaj të atdheut, të kryeni me nder misionin e lartë të arsimtarit të ri popullor dhe të justifikoni besimin e madh që kanë vënë mbi ju Partia dhe populli.

Por që ta kryeni si duhet detyrën, që tani në bankat e shkollës, bëni të gjitha përpjekjet që të mësoni sa më shumë, të dëgjoni me vëmendje dhe kujdes mësimet që ju japin mësuesit tuaj, të zbatoni porositë dhe këshillat e tyre dhe t'i respektoni, sepse ata kujdesen për t'ju përgatitur arsimtarë të vlefshëm dhe të aftë për të mësuar dhe edukuar brezin e ri me njohuri të shëndosha dhe me frymë të lartë patriotike, ashtu sikurse e ka traditë shkolla juaj. Shtoni përditë dashurinë për popullin tonë heroik, për mësuesen dhe udhëheqësen e tij të sprovuar, Partinë e Punës.

Me keqardhje ju njoftoj se nuk mund t'jua plotësoj dëshirën për të marrë pjesë në këtë gëzim të përbashkët, pasi në këto ditë punët e Partisë nuk më lejojnë, por ju siguroj se me zemër do të jem me ju në këto çaste kaq të gëzueshme.

Ju uroj edhe një herë shëndet, jetë të lumtur dhe suksese sa më të mëdha në mësimet, për të

mbajtur kurdoherë lart e më lart traditat dhe emrin e mirë të shkollës suaj!

Juaji

*Enver Hoxha*

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Vepra, vëll. 17, f. 476*

**TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR  
FAMILJES SË ILJAZ HOXHËS**

Gjirokastrë

21 mars 1960

GRUAS SË ILJAZ HOXHËS

Me hidhërim të madh mora vesh vdekjen e hidhur të burrit tuaj dhe mësuesit dhe mikut tim të dashur xha Iljazit. Duke ju përqafuar si mëmë, vij t'ju ngushëlloj nga ana ime dhe nga ana e Gju-los. Të rroni vetë me gjithë fëmijë. I dashuri xha Iljaz do të mbetet i paharruar për ne të afërmit e tij dhe për popullin e Gjirokastrës të cilit i ka shërbyer tërë jetën për një çështje të madhe.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT<sup>1</sup>

22 qershor 1960

I dashur shoku Hysni,

Telegramet tuaja dhe letrën i morëm dhe i studiuam në Byronë Politike. Mendojmë unanimitisht se gjendja paraqitet shumë e rëndë dhe zhvillohet në mënyrë jo të rregullt partie. Zhvillimin e ngjarjeve, ndezjen dhe përhapjen e konfliktit në mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës, në këtë mënyrë siç po bëhen, Byroja jonë Politike i quan shumë të gabuara, shumë të dëmshme dhe shumë të rrezikshme, prandaj nuk mund të pajtohet në asnjë mënyrë me metodat dhe me format që përdoren për të zgjidhur këtë konflikt që i kushton shtrenjtë kampit tonë të socializmit dhe

---

1. Në atë kohë kryetar i delegacionit të PPSH në Kongresin e 3-të të Partisë Punëtore të Rumanisë dhe në Mbledhjen e Partive Komuniste e Punëtore në Bukuresht.

komunizmit ndërkombëtar. Byroja jonë Politike qëndron e patundur si kurdoherë në vijën marksiste-leniniste që mosmarrëveshjet në mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës nuk duhej në asnjë mënyrë të liheshin të trasheshin, nuk duhet lejuar që të thellohet konflikti, por duhet të zgjidhet me rrugë dhe me metoda marksiste-leniniste.

Byroja Politike mendon se mosmarrëveshjet që ekzistojnë në mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës u janë bërë të njohura partive komuniste dhe punëtore jo sipas rregullave leniniste, por në mënyrë të rastit, nëpërmjet polemikash të hapëta dhe të tërthorta në shtyp dhe në mënyrë gojore. Kjo nuk është metoda e drejtë e zgjidhjes së një konflikti të tillë në rast se dëshirohej, siç e lyp marksizëm-leninizmi, që edhe partitë e tjera të ndërhyjnë dhe të ndihmonin me eksperiencën dhe me peshën e tyre. Kjo ndihmë nuk u kërkua deri tash në fund, por megjithatë, sipas telegrameve që na dërgove, edhe tash nga ana sovjetike synohet të evitohet kjo mënyrë e drejtë zgjidhjeje. Dalim, pra, me konkluzion se s'janë bërë të gjitha përpjekjet që të sqaroheshin këto çështje në mes dy partive më të mëdha të kampit socialist në mënyrë të rregullt dhe objektive, në rrugën marksiste-leniniste. Edhe zgjidhja e çështjes nga një mbledhje ku të marrin pjesë edhe partitë komuniste e punëtore të kampit tonë, na duket se nuk po merret aq seriozisht, derisa të dyja partitë që kanë mosmarrëveshjet nuk u kanë paraqitur **zyrtarisht** partive të tjera motra tezat

dhe pikëpamjet e tyre për këto mosmarrëveshje.

Byroja Politike konsideron se Partia jonë ka përgjegjësi po aq të madhe, sa dhe të gjitha partitë e tjera si për forcimin e unitetit të kampit socialist në rrugën marksiste-leniniste, ashtu edhe për ruajtjen e pastërtisë së Partisë dhe të marksizëm-leninizmit. Prandaj nuk na lejohet të bëjmë gabime, nuk na lejohet të futim Partinë në qorr-sokak dhe në konfuzione ideologjike dhe politike. Këtë s'e kemi bërë dhe nuk do ta bëjmë kurrë. Kur është fjala për të mbrojtur parimet, ne nuk marrim parasysh se mund t'i mbetet qejfi njërit ose tjetrit. Qëndrimet e drejta marksiste-leniniste e kanë udhëhequr dhe do ta udhëheqin vazhdimisht Partinë tonë dhe ajo do të karakterizohet kurdoherë nga guximi parimor marksist-leninist.

Tash çfarë qëndrimi duhet mbajtur përpara ngjarjeve që po zhvillohen atje? Për vijën e Partisë sonë ti je i qartë dhe s'është nevoja të zgjatemi. Por, gjersa kanë shpërthyer pasionet në forma jo të rregullta partie, duhet të jesh shumë i kujdesshëm. Përgjigjja duhet të jetë e matur dhe e peshuar mirë. Mendo kurdoherë interesin e Partisë dhe të marksizëm-leninizmit. Por kjo s'do të thotë që të mos i japësh përgjigjen e duhur dhe zjarr për zjarr kujtdo qoftë. Pse, për shembull, a nuk është qesharake dhe e papranueshme që të vijë njëfarë Mogjoroshi<sup>1</sup> të na bindë ne, shqiptarët, për drejtësinë e vijës së Bashkimit

---

1. A. Mogjorosh, në atë kohë anëtar i Byrosë Politike të KQ të PP të Rumanisë.

Sovjetik dhe për «fajet» e Kinës?! Mogjoroshi të vejë në tregje të tjera të shesë pallavrat e tij dhe jo te ne. S'kemi nevojë ne të vijë të na «sqarojë» Mogjoroshi për ato parime e të vërteta për të cilat Partia jonë ka luftuar dhe është gati të luftojë kurdoherë. Ose, për shembull, lëri mirë të kuptojë Andropovit se ne s'jemi dakord që sovjetikët të zënë shokët tanë, anëtarë të delegacionit në Kongresin e Partisë Punëtore të Rumanisë, dhe t'u thonë me habi: «Si, udhëheqja juaj nuk ju ka vënë në korent për këto gjëra?!». I kujto Andropovit se Mikojani ka dashur t'ia thoshte këto çështje<sup>1</sup> vetëm shokut Enver. Mikojani iu lut shokut Enver që të gjitha ato që i tha të mbahehin shumë sekret, dhe kur i thuhet kështu udhëheqjes sonë, ajo e mban fjalën, pse nuk e ka zakon t'i bëjë këto muhabete rrugësh. Por ne shohim, i thuaj Andropovit, te shokët sovjetikë që biseduan me shokët e delegacionit tonë, dy tendenca të rrezikshme: E para, të nënvleftësojnë rrezikun e revizionizmit, gjë me të cilën ne s'mund të jemi kurrë dakord, dhe e dyta, tendenca për të bërë fajtores, në sytë e shokëve tanë,

---

1. Në fillim të shkurtit të vitit 1960 shoku Enver Hoxha që ndodhej në Moskë në krye të delegacionit të PPSH për të marrë pjesë në mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste të Evropës për çështjet e zhvillimit të bujqësisë, u takua me A. Mikojanin me kërkesën e këtij të fundit. Mikojani për rreth 5 orë foli në këtë takim për mosmarrëveshjet ideologjike e politike që ekzistonin midis PK të BS dhe PK të Kinës.

udhëheqjen e Partisë sonë, që gjoja s'po i vë në korent. I thuj Andropovit që t'i ndërpresin menjëherë këto taktika antimarksiste, dhe se ata duhet të dinë se uniteti i udhëheqjes sonë është çelik, ashtu siç është çelik dhe uniteti i udhëheqjes sonë me gjithë Partinë e Punës dhe kush përpiqet, në një formë ose në një tjetër, të bëjë të tilla orvatje, të jetë i sigurt se do të presë grushte nga ne. I thuj, gjithashtu, Andropovit se nuk është as e rregullt as e nevojshme, që shokët sovjetikë të vënë në korent shokët tanë, pse udhëheqja jonë, që di të mbrojë marksizëm-leninizmin, di gjithashtu të vërë në korent anëtarët e saj, kur duhet dhe për çfarë duhet.

Këto thujaja Andropovit me gjakftohtësi, por ti e kupton mirë pse i duhen thënë. Ata po vepronë në mënyrë jo të rregullt dhe jo në rrugë partie dhe këtyre veprimeve është rasti t'u presim rrugën. I thuj, gjithashtu, Andropovit se «më ka ardhur shumë keq që solle me vete Mogjoroshin, jo si zot shtëpie, por që të më mbushte mendjen mua për drejtësinë e vijës së Bashkimit Sovjetik dhe për rrugën e shtrembër të Kinës. Vetëm mirësjellja, pse isha në shtëpinë e tij, më ndaloi, i thuj, të tregohesha «harbut» i drejtë».

Ose, kur të paraqitet rasti, si ai kur të tha Andropovi që «Partia Komuniste e Kinës, duke menduar se ju jeni të vendosur kundër jugosllavëve, do t'ju bënte me vete, por gaboi...» etj., u thuj se «kanë vdekur ato kohë, që Partia jonë e Punës dhe udhëheqja e saj të gabohet nga ndo-

kush dhe të bëhet partizane e vijave të shtrembra. Partia jonë është e kalitur në luftëra dhe s'shkel në dërrasë të kalbur. Ajo ka qëndruar dhe do të qëndrojë kurdoherë në rrugën e parimeve marksiste-leniniste».

Edhe disa çështje të kesh parasysht, se mund të të ndihmojnë, para se të vijmë në thelbin e problemit. Situatat po zhvillohen shtrembër, siç na shkruan dhe në letrën tënde, atje po kurdisen prapaskena e provokacione. Prandaj u qëndro fort dhe tregoj se në udhëheqjen tonë ka unitet, ka vendosmëri dhe guxim.

Në bazë të vendimeve të Byrosë Politike ti do të vepros si më poshtë:

I. — Thirre Andropovin dhe i thuaj në emër të udhëheqjes së Partisë (kurdoherë në emër të Partisë, në emër të udhëheqjes): «Ia komunikova udhëheqjes sime çfarë më thatë. Udhëheqja jonë ka qenë në dijeni në mënyrë të përgjithshme për këto mosmarrëveshje dhe i ka konsideruar shumë të rënda, shumë të dëmshme për çështjen tonë të përbashkët dhe shfaq përsëri mendimin se këto duhet të zgjidhen, dhe duhet të zgjidhen në rrugë të drejtë, sipas rregullave organizative marksiste-leniniste. Udhëheqja jonë ka shfaqur mendimin që këto mosmarrëveshje ideologjike dhe politike në mes Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës të zgjidhen në mënyrë marksiste-leniniste nëpërmjet bashkëbisedimesh në mes dy partive. Në qoftë se nuk do të zgjidheshin kështu, atëherë duhej të

thirreshin përfaqësuesit e partive komuniste e punëtore të kampit të socializmit, të diskutonin dhe të shfaqnin pikëpamjet e tyre. Qëndrimet që do të mbaheshin në këtë mbledhje mund të shtroheshin në një mbledhje më të gjerë të partive komuniste e punëtore si ajo e Moskës e vitit 1957.

Tash kjo mbledhje është vendosur të bëhet. Udhëheqja e Partisë sonë këtë vendim e ka quajtur të drejtë, ka qenë dakord, po përgatitet të shfaqë mendimin e vet mbi çështjet, dhe pret caktimin e datës. Thuaju se unë, [Hysniul, jam i autorizuar të diskutoj për caktimin e datës. Udhëheqja jonë ka caktuar dhe ka komunikuar gjithashtu që delegacioni ynë në mbledhjen e ardhshme do të kryesohet nga shoku Enver Hoxha. Mbledhjen që propozohet të bëhet tash në Bukuresht me të gjithë përfaqësuesit e partive komuniste e punëtore motra, që kanë ardhur në Kongresin e Partisë Punëtore të Rumanisë, për mosmarrëveshjet në mes PK të BS dhe PK të Kinës udhëheqja jonë e konsideron të parakohshme dhe shumë të dëmshme. Partia jonë e konsideron gjithashtu shumë të dëmshme një fushatë të maskuar ose të hapur në shtyp, për këto çështje kaq delikate. Kush ka të drejtë ose gabim le ta gjykojë mbledhja e ardhshme. Partia jonë do të vërë të gjitha forcat e veta dhe atë eksperiencë modeste që ka, për të zgjidhur në rrugën parimore marksiste-leniniste këto mosmarrëveshje të rënda. Partia jonë merr të gjitha përgjegjësitë,

ajo do të luftojë me nder dhe me guxim si kurdoherë për të mbrojtur vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste, për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, për të mbrojtur kampin e socializmit dhe unitetin e tij. Prandaj, udhëheqja jonë mendon dhe rithekson se gabimet, atje ku janë, të shikohen realisht në mbledhje dhe të bëhen të gjitha përpjekjet, të bëhet çmos në rrugë dhe me metoda marksiste-leniniste që të ndreqen për të mirën e socializmit e të komunizmit. Ky ka qenë mendimi zyrtar i udhëheqjes sonë kur mua më nisën për Bukuresht dhe ky mbetet edhe tash pasi i vura në dijeni për çka më komunikuat ju».

Gjithashtu thuaji Andropovit: «Unë [Hysniul] jam i autorizuar vetëm të përfaqësoj Partinë e Punës të Shqipërisë në Kongresin e Partisë Punëtore të Rumanisë dhe të bisedoj me përfaqësuesit e partive të tjera të kampit të socializmit për caktimin e datës së mbledhjes së afërme. Në rast se mbledhja që propozoni ju dhe Partia Punëtore e Rumanisë do të bëhet tani menjëherë në Bukuresht, sikundër e theksova edhe më parë, udhëheqja jonë e konsideron të parakohshme, megjithatë unë jam i autorizuar të marr pjesë.

Jam i autorizuar zyrtarisht t'jua komunikoj këto që t'ia transmetoni udhëheqjes suaj. Partia jonë çdo gjë që ka e thotë hapur dhe pa drujtje, në rrugë leniniste».

II. — Në mbledhjen që mund të bëhet qëndro gjakftohtë. Fjalë të matura. Për mosmarrëveshjet që ekzistojnë në mes Bashkimit Sovjetik

dhe Kinës nuk duhet të prononcohesh. Deklarata duhet të jetë e shkurtër dhe koncize.

Në esencë ti do të deklarojsh në emër të Partisë sonë:

1. — Partia jonë e Punës i ka aprovuar e i ka zbatuar vendimet e Mbledhjes së Moskës [1957].

2. — Thekso politikën e drejtë, konsekuente dhe parimore të Partisë sonë, besnikërinë e pafund ndaj marksizëm-leninizmit, dashurinë e madhe të Partisë dhe të popullit tonë për partitë dhe për popujt e vendeve të kampit të socializmit, për të gjitha partitë e tjera komuniste dhe punëto-re motra të botës, për unitetin e kampit tonë që s'duhet rrezikuar në asnjë mënyrë, por duhet forcuar dhe kalitur në rrugën marksiste-leniniste.

3. — Shpreh hidhërimin e Partisë sonë për këto mosmarrëveshje që kanë lindur në mes PK të Bashkimit Sovjetik dhe PK të Kinës, dhe shpreh bindjen që këto duhet të zgjidhen në rrugën marksiste-leniniste në mbledhjen e ardhshme të partive komuniste dhe punëto-re që do të mba-het më vonë.

4. — Shpreh vendosmërinë e Partisë sonë se ajo do të luftojë krah për krah me vendet socialiste, duke qenë kurdoherë vigjilente dhe duke demaskuar deri në fund dhe pa mëshirë imperializmin dhe agjentët e tyre, revizionistët.

Këto të bëjnë thelbin e ndërhyrjes tënde.

Besojmë se çdo gjë do të shkojë mirë. Ne jemi në rrugë të drejtë, prandaj ti ndiq situatat me

gjakftohtësinë e me guximin revolucionar që të karakterizojnë.

Na mbaj në korent për çdo gjë.

Një lajm gazmor: Dje ra shi i mirë kudo.

Të gjithë shokët të bëjnë të fala shumë dhe

unë të përqafoj

*Enver*

P.S.

Çdo tentative a sugjerimi nga ana e sovjetikëve për ardhjen time në Bukuresht duhet t'i përgjigjesh se ai nuk vjen.

*Vepra, vëll. 19, f. 8*

## **LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË**

**1 tetor 1960**

I dashur shoku Hysni,

Letrën dhe materialin që më dërgove, i mora dje në kohën kur po bënim mbledhjen e Byrosë Politike për të shqyrtuar projektdirektivat e Kongresit të 4-t të Partisë mbi planin e tretë pesëvjeçar si dhe raportin mbi riorganizimin e shkollës. Kur e mora materialin, arriti edhe radiogrami yt, me të cilin na njoftove që ky material duhet të të kthehet prapë, prandaj e dhamë për të shtypur. Të gjitha këto t'i them për të kuptuar se tash që po të shkruaj, nuk e kam filluar leximin e materialit që më dërgove, prandaj s'kam se ç'të të them tash për tash. Do të të jap mendim me radiogram ose me letër më të gjatë, të cilën do të ta nis me avion.

Duke u bashkuar me pikëpamjen tënde, edhe unë mendoj se sovjetikët po luajnë një manovër të poshtër me qëllime të caktuara.

Materiali që kanë dhënë, mund të jetë deri diku i pranueshëm, gjithashtu i hartuar dhe i predispozuar që të bëhen dhe korrigjime edhe më të forta. S'prish shumë punë për ta ky fakt!! «Po të doni, mund të thonë, e bëjmë edhe barut, por vetëm të mos bëjmë polemikë, çdo gjë të shkojë urtë e butë, pa sa për zbatimin e atyre që vëmë në kartë, e kemi merak vetë, me një fjalë vazhdojmë rrugën tonë, ta shkelim edhe këtë deklaratë, si atë të Moskës [1957] dhe, po të na akuzoni prapë, prapë mbledhim një Bukuresht të dytë dhe jua rregullojmë qejfin».

Në qoftë se sovjetikët kanë bërë disa lëshime ose janë të predispozuar që deklaratat të forcohet akoma, **ata e bëjnë këtë jo se kanë ndërruar pikëpamje, jo se njohin gabimet, por këto janë gjoja koncesione që na bëhen për t'u mbyllur muhabeti me kaq. Ata mendojnë se ne vuajmë dhe jemi sëmurë për deklaratat. Ne kemi marksizëm-leninizmin. Ne kemi nevojë dhe ngulim këmbë që sovjetikët të ndreqin gabimet e tyre oportuniste.** Deklarata duhet të jetë konkluzioni i këtyre diskutimeve. Pikërisht kjo i tremb sovjetikët, pikërisht kjo s'na tremb ne.

**Sovjetikët kanë frikë nga diskutimet,** pse jo vetëm që pas Bukureshtit kanë ndodhur tronditje në partitë e tjera, por këto tronditje do të bëhen

edhe më të forta pas nëntorit. Atëherë ata i dalin punës përpara, japin këtë deklaratë: «E forcojmë akoma po të doni», dhe, kështu, të gjithë dua-xhinjtë e tyre bërtasin dhe brohorasin: «Eureka! Kjo është, ka qenë e do të jetë vija jonë. Kurrë s'kemi gabuar. Kina reflektoi, rishikoi gabimet dhe erdhi në rrugë të drejtë! *Pra, Bukureshti që shumë «paljezno»<sup>1</sup>. Në partitë tona ne e dënuam Kinën dhe Shqipërinë si dogmatike etj.* Me dy gurë vramë dy zogj, edhe i demaskuam, edhe i shëruam, edhe hapëm rrugën që t'u themi prapë partive nesër, që të sëmuret nuk u shëruan plotësisht, sepse sëmundja e dogmatizmit u është ringjallur. Fundi, fituam në të dyja tablotë dhe vazhdojmë rrugën që kemi ndjekur». Ky është pak a shumë arsyetimi i sovjetikëve dhe i dua-xhinjve të tyre, mendoj unë. Nikita ia gjeti ilaçin Zhivkos e kompani.

**Ne në asnjë mënyrë nuk mund të biem në manovrat dredharake të revizionistëve sovjetikë. Ne duhet t'u lëmë të kuptojnë sovjetikëve dhe të tjerëve se jemi dakord ta përpunojmë këtë material, t'i heqim ose t'i shtojmë, por ky material do të jetë si konkluzion i diskutimeve të gjithanshme në nëntor dhe që do të synojnë: si janë zbatuar parimet e marksizëm-leninizmit dhe vendimet e Mbledhjes së Moskës [1957], kush është larguar dhe kush i ka zbatuar me konsekuencë.**

---

1. Nga rusishtja, që do të thotë i dobishëm.

Do të ribëhet rivlerësimi i Bukureshtit në bazë të fakteve dhe jo vetëm sovjetike, por në bazë edhe të fakteve që do të sjellin për këtë çështje edhe partitë e tjera.

Mbledhja e ardhshme e Moskës s'mund të jetë një mbledhje formale, as një mbledhje shterpë polemike, por një mbledhje me rëndësi të madhe konstruktive në bazë të marksizëm-leninizmit dhe të normave leniniste. Ajo nuk do të ketë kuptimin e një mbledhjeje pajtuese «pacificiste», për të mabuluar me një cipë gabimet e rënda, por një mbledhje që t'i zbulojë dhe t'i shërojë rrënjësisht gabimet. Tjetër rrugë s'ka, dhe nga ne të mos presin asnjë rrugëzgjdhje tjetër. Në qoftë se nuk shihen drejt në sy këto gabime, ne jemi të sigurt që revizionistët do të vazhdojnë më tej me vrull punën shkatërrimtare. Prandaj për ne ka vetëm një rrugë — luftë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe jo pajtim me gabimet oportuniste dhe revizioniste në ideologji dhe në politikë, siç bën Hrushovi dhe grupi i tij. Unë mendoj që lufta të fillojë që në komision, ku partitë e tjera, veç asaj të Kinës, kanë dërguar njerëz të dorës së katërt, pse, natyrisht, sovjetikët janë marrë vesh me ta, kanë adoptuar një taktikë dhe kërkojnë që hendekun që vetë e kanë thelluar, ta kapërcejnë me lehtësi dhe duke akuzuar Kinën e ne për një mijë gjëra. **Por ne s'i hamë këto.**

Tash ç'të të shkruaj më gjatë se ti i di vetë

çështjet. Kur të të dërgoj vërejtjet për materia-  
lin, mund të shkruaj më gjatë.


Ramizit dhe shokëve të fala.

Përçafime

*Enver*

Të shkruaj me shpejtësi pse ikën avioni,  
prandaj do të kesh zor në lexim.

*Vepra, vëll. 19, f. 279*



Faksimile e letrave të shokut Enver Hoxha drejtuar shokut Hysni Kapo



## LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË

13 tetor 1960

I dashur Hysni,

Duke lexuar edhe fjalimin e dytë të kinezit më forcohet bindja që të shpreha për fjalimin e parë. **Kinezët s'janë për atë që t'i shkojnë çështjes deri në fund**; ata janë për atë që të rregullohen çështjet me anë të frazave nëpër rezolucione ose deklarata. **Ata janë për atë që të ndreqet ç'mund të ndreqet, të tjerat t'i ndreqë koha.** Më duket se **ata nuk kuptojnë ç'rrezikshmëri paraqet grupi i Hrushovit për lëvizjen komuniste botërore dhe pranojnë të bashkëjetojnë me këtë grup.** Nuk varet nga ne nëse duhet të vazhdojë të jetë në fuqi apo jo ky grup, **por nga ne është e domosdoshme të demaskohet ky grup me Hrushovin në krye ashtu si e meriton.**

**Kinezët nuk bëjnë asgjë në këtë drejtim, por**

**bëjnë të kundërtën.** Atakojnë Stalinin dhe Hrushovin e barazojnë me Leninin. Dakord që duhet të bëjmë një komunikatë të mirë, ose disi, dakord që sovjetikët të heqin akuzat dhe shpifjet që kanë bërë karshi Kinës, por a është e mjaftueshme kjo? Për kinezët edhe gjysma po të arrihet, kam përshtypjen se janë të kënaqur. **Ne nuk mund të jemi të kënaqur.** Në të dy fjalimet e tyre në komision s'flitet asnjë fjalë **kundër gabuesit kryesor, Hrushovit,** bile flitet për mirë, se ka kritikuar drejt Stalinin. Kam përshtypjen se kinezët druhën dhe në rast se projektdeklarata bëhet disi e mirë, unë parashikoj se **diskutimi i tyre në Mbledhje do të jetë akoma më akademik,** siç janë fjalimet në komision. **Më duket se kinezët nuk po shohin se ky grup i rrezikshëm revizionistësh i ka pozitat shumë të dobëta si ideologjikisht ashtu dhe politikisht.** Atëherë do të kënaqemi të mbrohemi apo do të sulmojmë? Kinezët, sipas mendimit tim po mbrohen **e nuk sulmojnë dhe nuk do të sulmojnë edhe më vonë.** Kinezët i preokupon përshtypja dhe atmosfera që mund të krijojë sulmi i tyre në delegatët e Komisionit ose më vonë në Mbledhjen e Moskës. Kjo s'është e mirë. Ne nuk duhet t'u lëmë sovjetikëve fushë të lirë, ku të kullotin si të duan.

Por revizionisti i vendosur nuk ndërron rrugë, ata s'do të pranojnë asnjë nga gabimet e tyre. Ashtu si na «ndihmon» Titoja, duke shkuar çdo ditë nga tradhtia në tradhti, ashtu do të bëjnë edhe këta, revizionistët e rinj. Por dëmet do të je-

në të mëdha. **Unë mendoj se fjalimet e Ten Hsiao Pinit shprehin kërkesën e një kompromisi me sovjetikët.** Ata të heqin akuzat (kjo është një-farë tërheqjeje dhe demaskim) dhe ne të mos i atakojmë e të mos i demaskojmë deri në fund.

Unë po e përgatis fjalimin për në Mbledhjen e Moskës ashtu si e kemi vendosur, por siç mund ta marrësh me mend, as mund të barazohet me formën, tonin dhe përmbajtjen e fjalimeve të kinëzitet. Siç po del, edhe në këtë mbledhje qëndrimi ynë do të jetë unikal, të gjithë do të na zemërohen, të gjithë do të na shajnë, por ne kemi të drejtë dhe neve koha do të na japë të drejtë, se në mbledhje të jesh i sigurt, asnjëri nuk do të na japë hak. Por ne do të bëjmë detyrën tonë, do të mbrojmë marksizëm-leninizmin. **Grupi i Hrushovit ka bërë faj.** Në rast se nuk u vë gishtin fajtorëve, të ndash shapin nga sheqeri, atëherë i lidhe duart dhe dëmtove. Jo, ne nuk do të impresionohemi nga ata që thonë: «**Si mund të atakohet BS i lavdishëm ose PK e madhe e Leninit për fajin e disa horrave!?**». Ne themi: «**Tamam për të mbrojtur Bashkimin Sovjetik e Partinë e Leninit, duhen demaskuar këta «horra» e jo të zbutet kritika e të mbulohen deviatorët.**» Në këtë rast, pavarësisht se polle një deklaratë «atliçno», rreziku qëndron, bile bëhet më kërcënues si për kampin tonë, ashtu edhe për të gjithë lëvizjen komuniste e punëtoare. Por do të shohim, «dhëntë zoti», si thotë Hrushovi, dhe gabohem në gjykimet e mia. Vetëm s'po na thoni kur parashi-

kohet të mbarojë akti i parë, se po vete afro tri javë.

Këtej s'kemi gjë të re (nga ato të zakonshmet lidhur me sovjetikët e këtushëm ka plot).

Shumë të fala ty e Ramizit

*Enver*

P. S. Mendoj që para se të ktheheni në Shqipëri të bisedosh në vija të përgjithshme si mendojnë kinezët t'i shtrojnë këto çështje në Mbledhjen e Moskës, do t'i shtrojnë në «formë akademike» apo do t'i japin «zjarr» punës. Mirë është, në mënyrë të përgjithshme t'ua thuash mendimin tonë. Mos u thuaj «se ne kështu do të bëjmë», por «kështu duhet bërë».

*Enver*

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

## LETËR DREJTUAR SHOQES POLIKSENI LUARASI<sup>1</sup>

7 maj 1961

E nderuara nënë Polikseni Luarasi,

Me gëzim mora kujtimet tuaja që keni përgatitur me rastin e 50-vjetorit të lavdishëm të Shpalljes së Pavarësisë sonë Kombëtare. Përpjekjet për t'u lënë kujtimet e jetës dhe veprimtarisë suaj popullit, sidomos brezit të ri të vendit tonë, do të çmohen kurdoherë si një shembull i bukur i dashurisë për popull e atdhe.

Unë ju përgëzoj për punën fisnike e të lodhshme për moshën që keni, duke shkruar kujtimet e jetës suaj me rastin e jubileut të madh dhe duke ju falënderuar për dërgimin e tyre, ju njoh-

---

1. Disa nga kujtimet e Polikseni Luarasi, mbi veprimtarinë botuese të tipografisë «Mbrothësia» në Sofje, Selanik, ku shtypeshin libra të ndryshëm e sidomos libra shkollorë e shtypi periodik, janë botuar nga Instituti i Historisë e i Gjuhësisë.

toj se do të ndihmoj që ato të botohen. Me këtë rast ju uroj gjithashtu për festën e madhe ndërkombëtare të të gjithë punonjësve të botës, «1 Majit» dhe uroj të rroni akoma edhe shumë vjet dhe të gëzoni shëndet e pleqëri të qetë e të lumtur!

Juaji  
**Enver Hoxha**

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **RADIOGRAM DËRGUAR SHOKËVE HYSNI KAPO DHE RAMIZ ALIA<sup>1</sup>**

**23 maj 1962**

Shokëve Hysni dhe Ramiz,

Çdo gjë këtej shkon mirë. Fushata e zgjedhjeve<sup>2</sup> është në kulm dhe shkon për mrekulli. Do të flas edhe unë. Shokët, të gjithë, mbaruan së foluri.

---

1. Shoku Hysni Kapo kryesonte një delegacion të PPSH, ku bënte pjesë edhe shoku Ramiz Alia, që shkoi në Kinë për të biseduar me udhëheqjen kineze rreth disa çështjeve të rëndësishme, që kishin të bënin me strategjinë dhe taktikën e luftës së përbashkët në arenën ndërkombëtare, e veçanërisht me propozimin e disa partive për zhvillimin e një mbledhjeje me sovjetikët. Delegacioni u nis me vaporin «Vlora» më 18 maj 1962 dhe mbërriti në Kinë më 6 qershor 1962. Këtë radiogram dhe disa të tjerë shokët Hysni Kapo dhe Ramiz Alia i morën gjatë udhëtimit me vapor.

2. Është fjala për zgjedhjet e 3 qershorit 1962 për deputetë në Kuvendin Popullor.

Marrëdhëniet Bashkim Sovjetik—Jugosllavi, po zgjerohen. Sot flitet me insistim dhe Ministria e Jashtme Jugosllave deklaroi se Titoja është ftuar për pushime në Bashkimin Sovjetik. Nga ana tjetër, po i bëhet shumë reklamë nga perëndimorët vajtjes së Koça Popoviçit<sup>1</sup> në Uashington. Kardeli, mbrëmë, në një fjalim të gjatë, të cilin akoma nuk e kemi lexuar, vazhdon demagogjinë e Titos në fjalimin e Splitit<sup>2</sup>. Siç e shihni çdo gjë shkon në rregull, ngjarjet vërtetojnë katërcipërisht pikëpamjet e drejta të Partisë sonë. Revizionizmi jugosllav dhe ai sovjetik po polarizohen, po kryhet haptazi uniteti i tyre në ideologji dhe në politikë. Titos do t'i japin kredi të mëdha sovjetikët. Atij do t'i japin dhe amerikanët, të cilët, sipas shtypit të tyre, s'janë aspak të alarmuar nga kjo manovër e Titos drejt sovjetikëve, përkundrazi.

Pra, edhe një herë akoma, kinezët duhet ta kenë të qartë me kë kanë të bëjnë dhe ç'rreziqe sjell mosdemaskimi jo vetëm i Titos, por sidomos i Hrushovit.

Pauza, pushimi, që thoshte Partia jonë, u

---

1. Në atë kohë sekretar i shtetit për Punët e Jashtme të Jugosllavisë, me ftesën e qeverisë amerikane, bëri vizitë zyrtare në SHBA nga data 28 deri më 30 maj 1962.

2. Titoja mbajti në fillim të muajit maj në Split të Dalmacisë, një fjalim demagogjik, i cili nga fillimi deri në fund iu kushtua gjendjes katastrofike të ekonomisë jugosllave. Në këtë fjalim me qëllim nuk zbulohen shkaqet e kësaj gjendjeje dhe nuk tregohen rrugët për të dalë prej saj.

vërtetua, u zbulua dhe qëllimi i kësaj pauze. Gjynahqarë mos qofshim por kjo pauzë i përngjet pauzës që kërkonte Hrushovi dikur për të heshur kundër titistëve.

Hrushovianët nuk duan bisedime me ne, ata e dinë se s'nxjerrin nga këto asgjë të mirë për ta. Kërkesat e tyre dhe pretendimet për unitet janë blofe, dhe duhet të luftoni që kinezët të mos u zënë besë. Hrushovianët kanë shkollur hapur deklaratat e Moskës dhe bisedojnë seriozisht jo me ne, por me titistët. Ata po krijojnë bllokun ideologjik revizionist-reformist kundër marksizëm-leninizmit. Me i lënë të punojnë në qetësi është krim, ashtu siç bëjnë një krim revizionistët, që lënë të qetë imperialistët të organizohen, të armatosen, të propagandojnë në të gjitha fushat. Parullat që hedhin hrushovianët janë parulla për të frikësuar kinezët, për t'i detyruar që të heshtin dhe ata të vazhdojnë punën e tyre shkatërruese. Prandaj, me kujdes, por luftoni kundër këtyre parullave hrushoviane dhe përpiquni t'u hiqni frikën kinezëve.

Të fala shumë

*Enver*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **RADIOGRAM DËRGUAR SHOKËVE HYSNI KAPO DHE RAMIZ ALIA**

**13 qershor 1962**

Shokëve Hysni dhe Ramiz,

Duke studiuar përmbledhjen e diskutimit të Tenit<sup>1</sup>, na tërheq vëmendjen çështja se kinezët preokupohen shumë për akuzat që u bënë Hrushovi. Ata tentojnë të vërtetojnë me ne se dogmatikë janë hrushovianët dhe se dogmatizmi i tyre nuk e lufton dot revizionizmin. Revizionistët hrushovianë janë njëkohësisht dogmatikë në parim dhe në veprim. Ata as heqin dorë dhe as do të heqin dorë nga qëllimi dhe vija e tyre antimarksiste, të cilën kërkojnë ta kthejnë në një dogmë. Në rast se kinezët situatën aktuale e barazojnë me atë të kohës së Internacionales së Dytë, atëherë edhe

---

1. Është fjala për diskutimin e Ten Hsiao Pinit në takim e parë zyrtar në kuadrin e bisedimeve të delegacionit të PPSH me palën kineze, i zhvilluar më 11 qershor 1962.

masat për të luftuar kundër kësaj rryme armiqësore në lëvizjen komuniste ndërkombëtare duhet të orientohen nga metodat e drejta dhe të vetmet që përdori Lenini për shpartallimin e oportunistëve, domethënë, demaskimin e hapët të tyre, me artikuj, me broshura, me libra, me konferenca dhe me mbledhje me karakter ndërkombëtar. Edhe Leninin e kanë akuzuar armiqtë e marksizëm-leninizmit për dogmatik e për çfarë të duash, por ai s'u ndal dhe nuk zgjodhi rrugë të zbehta dhe ekspediane<sup>1</sup>.

Çështja shtrohet, për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, revizionizmi modern a përbën rrezikun më kryesor? Është më se e qartë se po. Nga kinezët janë shkruar artikuj, por me spunte, dhe jo drejtpërdrejt. Opinioni i komunizmit ndërkombëtar, sipas kinezëve, kërkon bisedime. Kjo mund të jetë e vërtetë deri në njëfarë shkalle, por nuk mund të pranohet *a priori* teza e tyre se në rast se nuk shprehet dëshira për bisedime, atëherë, ne do të humbasim kredinë në masat e komunistëve. Kjo s'është as e drejtë as reale. Vetëm në rast se gabojmë në vijë, në rast se braktisim parimet dhe bëjmë lëshime në to, vetëm atëherë mund të ngjasë një gjë e tillë.

Ne këtë rrugë as e kemi ndjekur dhe as do ta ndjekim kurrë. Për bisedime ne jemi, dhe duhet të jemi, por jo bisedime për bisedime, jo bi-

---

1. Nga frëngjishtja — masa gjysmake, mënyrë për të dalë përkohësisht nga vështirësitë, por pa i zgjidhur ato.

sedime në platformat antimarksiste të kundërshtarëve, ose të atij opinionit oportunist që nëpërmjet një mbledhjeje të komunizmit ndërkombëtar, kërkon njëfarë qetësie false duke sakrifikuar gjoja kokëfortësinë e shqiptarëve. Këtu s'është çështja e shqiptarëve, por edhe e kinezëve, e marksizëm-leninizmit, e të sotmes dhe e të ardhmes. Përse kinezët nuk vënë mirë në dukje që hrushovianët nuk duan mbledhje dhe refuzuan propozimet e Partisë Komuniste të Indonezisë<sup>1</sup> sepse kanë frikë nga e vërteta?

Në Bukuresht dhe në Moskë, s'na gjeti gjë që ishim në pakicë, përkundrazi, bëmë shumë mirë që i hoqëm petën lakrorit. Puna jonë ishte revolucionare dhe dha fryte. Por gjatë kësaj kohe çështjet u zhvilluan më tej dhe mund të themi, krejt në favorin tonë. Këto situata të favorshme për revolucionin, për marksizëm-leninizmin u krijuan, jo duke heshtur, por duke luftuar, duke bërë sakrifica të mëdha. Armiqtë revizionistë u qorollepsën, bënë gabime të rënda, u demaskuan nga veprimet tona. Duke respektuar normat ne kontribuam që problemi u bë ndërkombëtar e në rrugë të drejtë për komunizmin. Jashtë komunizmit ndërkombëtar, kontribuoi Hrushovi me tra-

---

1. PK e Indonezisë propozonte të bëhej ose mbledhje e tri partive: e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, e Partisë Komuniste të Kinës dhe e Partisë së Punës të Shqipërisë, ose mbledhje e partive komuniste e punëtore të 12 vendeve socialiste, ose mbledhje e të gjitha partive komuniste e punëtore të botës.

dhtitë e tij. Kinezët duhet të gjykojnë se situatat s'janë më si në Bukuresht dhe në Konferencën e Moskës të vitit 1960. Të tërhiqemi nga këto situata të favorshme revolucionare që i kemi fituar me luftë, është krim. Këtë gjë nuk mund ta bëjmë. Nuk na lejohet, nuk na falet po të bëjmë një gabim të tillë.

Thuhet se lufta do të jetë e gjatë. Kjo varet si ta mendosh, kjo varet si do të veprosh. Momentet revolucionare do të krijohen sipas kushteve të çdo partie, por me veprimet tona, mund ta shpejtojmë procesin, ashtu si mund dhe ta ngadalësojmë. Taktika e kinezëve e ngadalëson. Është e vërtetë që ne kemi të drejtën marksiste me vete, por edhe armiku vepron dhe s'rri duarlidhur. Kur ne themi se imperializmin duhet ta demaskojmë me të gjitha mjetet, kjo do të thotë ta bëjmë atë që t'i digjet toka nën këmbë, të mos e lëmë të fitojë kohë. Kjo vlen edhe kundër revizionizmit modern—agjenturë e rrezikshme e imperializmit dhe e borgjezisë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Për një vijë revolucionare s'kanë asnjë vlerë konsideratat, se jemi të dobët ekonomikisht, ose s'kemi bombën etj., etj. Armiku mund t'i ketë përkohësisht këto avantazhe, por ne kemi bombën më të fuqishme në botë, marksizëm-leninizmin, revolucionin. Këto janë armët tona më të sprovuara, kurdoherë fitimtare, që s'mund t'i kenë armiqtë, të cilët përpiqen të na dobësojnë. Ne nuk duhet ta lejojmë një gjë të tillë, por edhe sikur të ketë njerëz që ta bëjnë

këtë hata, ata do të dështojnë si kanë dështuar deri më sot. Çështja e taktikës dhe e strategjisë revolucionare, është një gjë me shumë rëndësi. Nga zbatimi i parimit drejt apo gabim, shpejt apo ngadalë, në momentin më të përshtatshëm, të bazuar fuqimisht apo të pabazuar në rrethanat reale dhe të dhënat konkrete varet o fitorja dhe ecja përpara, o tërheqja dhe disfata. Në këtë çështje zbatimi i drejtë apo gabim nuk mund të ekskludojë kërrkënd, qoftë parti e madhe, qoftë parti e vogël, qoftë me eksperiencë të madhe, qoftë edhe me më pak eksperiencë. Ju keni eksperiencën e madhe të Partisë sonë dhe nuk po ju them ndonjë gjë të re, që ju nuk e dini. Duke ju thënë këto, nuk bëj gjë tjetër veçse ju përsëris ato që ne i kemi rrahur e diskutuar kaq e kaq herë në udhëheqjen e Partisë sonë, prandaj më falni që u zgjata.

Ju përqafoj

*Enver*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **RADIOGRAM DËRGUAR SHOKËVE HYSNI KAPO DHE RAMIZ ALIA**

**15 qershor 1962**

Shokëve Hysni dhe Ramiz,

Isha në Korçë, bëra një xhiro dhe u ktheva. Çdo gjë atje shkon shumë mirë. Në Korçë e kudo në Shqipëri shi ra boll.

Radiogramet tuaja i lexova. Jemi dakord me vlerësimin që i bëni letrës së sovjetikëve<sup>1</sup>. Ajo

---

1. Bëhet fjalë për letrën drejtuar kinezëve, në datën 30 maj 1962. Duke parë qëndrimet jokonsekuente të udhëheqjes kineze dhe gatishmërinë e saj për unitet me sovjetikët, udhëheqja hrushoviane shfrytëzonte rastin për ta tërhequr atë në rrugën e saj, duke menduar se kështu mund të bënte për vete dhe parti të tjera, që qëndronin në pozita të drejta marksist-leniniste. Prej kohësh udhëheqja kineze, pa dijeninë e PPSH, kishte hyrë në tratativa me revizionistët sovjetikë për takime për mbledhje me ta. Në këtë letër prej 60 faqesh në 40 faqe flitet në mënyrë të shtrembër për marrëdhëniet e Bashkimit Sovjetik me Shqipërinë.

duhet t'i bindë edhe një herë kinezët me çfarë armiku kemi të bëjmë dhe të cilit nuk duhet t'i lejojmë asnjë lëshim. Me atë letër sovjetikët shkojnë edhe më tej, në shpifjet e tyre të paskrupullta. Hrushovianëve duhet t'u ketë rënë erë për vajtjen tuaj, dhe parashikojnë çështjet që do të trajtoni, prandaj në letrën e tyre, nxitin përçarjen, hedhin farën e dyshimit, duke thënë se ne duam të tërheqim në rrugën tonë edhe kinezët. Prandaj tërthorazi u thonë në letër kinezëve se në rast se na ndjekin ne, atëherë edhe me ju do të shkojmë si me shqiptarët. Kinezët tkurren. Letrës do t'i japim interpretim më të plotë kur ta marrim, por kjo s'luan asnjë rol. Ne, ato që thonë hrushovianët, i njohim më parë dhe jemi dakord me interpretimin e drejtë që u bëni.

Tash të vijmë tek takimi i parë<sup>1</sup>, dhe tek ekspozaja e Tenit. Duke u bazuar në ato që na shkruani, ekspozaja dhe argumentet e tij janë mjaft të dobëta. Kinezët nënvlerësojnë shumë dhe pa arsye të shëndosha, peshën e tyre në lëvizjen komuniste botërore dhe shprehin frikën e izolimit nga ajo. Kjo s'është një analizë reale, ajo shpreh frikën e tyre, për t'u përleshur me një armik që e dinë, e njohin dhe ia pranojnë rrezikshmërinë e madhe të tij. Mendojmë gjithashtu se ata, duke u nisur nga kjo vijë, nuk analizojnë realisht dhe në mënyrë revolucionare rezistencën kundër re-

---

1. Takimi i parë zyrtar në kuadrin e bisedimeve të delegacionit të PPSH me palën kineze u zhvillua më 11 qershor 1962.

vizionizmit modern dhe hrushovian të komunistëve në botë, mbivlerësojnë influencën e hrushovianëve dhe gjejnë rrugëdalje duke thënë se lufta do të jetë e gjatë. Ne s'kemi dyshim që lufta do të jetë e gjatë, dhe nuk themi se Hrushovi e ka humbur influencën, por kjo influencë qëndron te klikat udhëheqëse të një sërë partish dhe jo mbi shumicën e komunistëve. Kjo influencë e keqe po dobësohet. Ky dobësim i revizionistëve, kjo rezistencë e komunistëve në botë, ky hov që është në ngjitje, mendojmë se duhet të vlerësohet më realisht dhe në mënyrë revolucionare nga kinezët. Detyra e marksistëve është të mos e ndalojnë këtë hov, por, përkundrazi, ta forcojnë, deri në ndarjen përfundimtare me revizionistët. Kinezët i ruhen shumë kësaj ndarjeje, kanë frikë, tregohen oportunistë dhe përpiqen, pa argumente të forta, t'i hedhin ujë verës. Kjo paraqitet me dëshirën e madhe që të bëhet mbledhja<sup>1</sup> dhe të vemi në këtë mbledhje, bile, sipas tyre, në kondita të këqija për ne dhe të favorshme për hrushovianët, me aleatë të lëkundshëm, që parashikojnë të mos flasin hapur. Mendojmë se kinezët nuk e kanë drejt këtë taktikë. Për ç'arsye insistohet për mbledhje, kur t'i leverdisë kjo Hrushovit? Hrushovi mund ta bëjë mbledhjen kur t'i ketë situatat më të mira dhe deri atëherë ne të presim, të heshtim dhe kur t'i dojë qejfi atij, ne, amin të

---

1. Udhëheqësit kinezë synonin që PPSH të shkonte në mbledhjen e partive komuniste e punëtore, pa i vënë kushte Hrushovit.

vemi në mbledhje. Kjo është shumë gabim. Sipas kinezëve heshtja jonë e përkohshme e favorizon këtë situatë. Kjo është një taktikë e gabuar dhe e papranueshme për ne dhe mos lini pa ua shpjeguar, se nga një taktikë e tillë marksizëm-leninizmi nuk fiton gjë. Po të vemi në mbledhje, sipas tezës së kinezëve, kur t'i dojë dhe si t'i dojë qejfi tradhtarit Hrushov, do të thotë t'i përgatitim terrenin armikut dhe të luftojmë në konditat që do ai. Ç'do të fitojmë ne në një mbledhje të tillë: jo shumë gjëra, si shprehen vetë kinezët në biseditmet që po bëni, duke thënë se do të ketë disa njerëz që do na dëgjojnë, por asgjë. Tash është krijuar një situatë e favorshme revolucionare, përse ne ta ulim këtë hov dhe t'i lëmë Hrushovin dhe miqtë e tij të gënjejnë masat? Në qoftë se kinezët mendojnë të venë në mbledhje, për të arritur një *modus vivendi* me revizionistët, atëherë është gabim, në rast se mendojnë se Hrushovi do të ndreqet në këtë mbledhje, ne s'jemi dakord me këtë mendim, në rast se ata mendojnë të venë në mbledhje dhe të luftojnë ashpër e drejt dhe atje të ndahen një herë e përgjithmonë lakrat me revizionistët, atëherë ne jemi dakord me këtë pikëpamje. Por këtë pikëpamje ata nuk e shprehin, këtë posibilitet e quajnë teorik, e mbështetin në parim, ta bëjnë të tjerët, por jo ata. Kurse bota komuniste pret që ata të luftojnë. Ju e përfytyroni mbledhjen sipas këtij modeli të miqve. Hrushovianët do të na akuzojnë ne, ne ata dhe piqemi në mbledhje tjetër. Tri rrugëdalje ka.

E para, dhe më e mira, të vazhdohet lufta revolucionare kundër revizionizmit hrushovian, pa vajtur në mbledhje, e dyta, kinezët të venë në mbledhje me aleatë të fortë dhe me luftë të hapur frontale, zjarr kundër revizionistëve ose të gjujzohen ose të ndahemi; e treta, të vemi kështu si thonë miqtë, dhe të dalim si rruar, qethur.

Në qoftë se miqtë janë të vendosur të venë në mbledhje, mendimi ynë është se duhet të përgatiten për versionin e dytë. Ne do të vazhdojmë të parin. Të vijmë në thelb të çështjes. Kinezët kërkojnë mendimin tonë, ju ua thoni, ashtu si ka vendosur Komiteti Qendror. Konkretisht, ne jemi, në parim, për bisedime por në kondita të barabarta. Ne jemi për mbledhje, por, pa pranuar dhe pa zbatuar Hrushovi kushtet tona, ne në mbledhje nuk vemi. Letra e tyre e fundit i mbyll të gjitha shtigjet edhe pas këshillave që u dhanë kinezët. Hrushovi kërkon gjujzimin e Partisë sonë përpara revizionizmit. Këtë ne s'e bëjmë kurrë, për këtë kinezët duhet të jenë të qartë. Ne nuk pranojmë të vemi në një mbledhje ku të na bëhet gjyqi nga kriminelët revizionistë. Pozitat tona marksiste, revolucionare nuk i lëshojmë, dhe as i dobësojmë. Në qoftë se hrushovianët pranojnë konditat tona, gjë që s'ngjet kurrë, atëherë ne vemi në mbledhje, për variantin e dytë. Për variantin e tretë as që bisedohet, ne nuk vemi në mbledhje të tilla. Ne nuk i ndalojmë kinezët të venë. Pozitat tona nuk janë të njëllojta me të tyret, për të vajtur në një mbledhje të çfarëdolloji. Ne do të luftojmë

dhe do t'i ndihmojmë nga jashtë, pavarësisht se do të tërheqim zjarr të madh mbi vete. Jemi mësuar, por jemi në rrugë të drejtë dhe do të fitojmë.

Kinezët mendojnë se këtë vit nuk do të ketë mbledhje. Duke qenë kështu, do të kenë kohë të reflektojnë mbi qëndrimin tonë, dhe po reflektojnë drejt, kjo sjell rezultate pozitive. Në mes të tjerash, u thoni, se ne nuk mund të vazhdojmë heshtjen ndaj Hrushovit, pas letrës që u dërgoi ai kinezëve dhe ku shpifte për ne dhe pas gjithë këtyre mbledhjeve<sup>1</sup> që bëjnë në Moskë pa ne. Ai na sulmon haptazi, botërisht, në këto mbledhje, dhe ne do t'ia mësojmë. Këtë shokët kinezë ta kenë të qartë. Ju shkrova gjatë, më falni, por ju i keni të qarta këto dhe nuk ju them ndonjë gjë të re. Pikëpamjet tona i shprehni në frymën marksiste-leniniste.

Ju përqafoj

*Enver*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

---

1. Është fjala për mbledhjen e KNER-it mbajtur më 6 qershor 1962 në Moskë dhe Mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, mbajtur në Moskë, më 7 qershor 1962. Këto mbledhje në deklaratat e Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë u quajtën të paligjshme.

**LETËR DREJTUAR NXËNËSVE  
DHE MËSUESVE TË GJIMNAZIT  
«ASIM ZENELI» GJIROKASTËR**

**17 shtator 1962**

Të dashur xha Thoma Papapano, nxënës e mësues të gjimnazit «Asim Zeneli»,

Ju falënderoj nga zemra që më kujtoni, por edhe unë kurrë s'ju harroj. Kërkesën që më keni bërë dhe që ma ripërsëritni, ju siguroj se nuk e kam harruar. Zemrën e kam plot kujtime për shkollën time të parë, për mësuesit e mi të dashur. Por dëshirën tuaj nuk jua plotësova më parë, jo se përtoja të shkruaja, se shkolla ku unë mësova abëcënë nuk na mësoi përtacë, por letrën time dëshiroja ta shoqëroja me diçka që më kërkoni, si të them me diçka që të plotësonte dëshirën tuaj dhe timen, me diçka që të më kujtonte vegjëlinë time.

Ju e dini, xha Thoma, se 47 vjet kanë kaluar

nga dita që kur unë u paraqita për herë të parë në bankën e shkollës përpara jush. Një jetë e tërë ka kaluar, por dita e parë e shkollës nuk harrohet. Në zemër ndieja gëzim të përzier me frikën e parë, por fjalët e ëmbla të mësuesit tim dhe copa e kulaçit të misërt me pak djathë e një qepë që mëma më kishte futur në qesen e librave, kur më përcolli për në shkollë, sikur ma ngrohnin zemrën, ma hiqnin ndrydhjen.

Furtuna kaluan mbi atdheun që nga ajo kohë kur ju, basho Thoma, hapët shkollën e parë shqipe në Gjirokastër, dhe unë hapa për herë të parë sytë në jetë. Jeta e familjes sime dhe imja, si jeta e gjithë bashkëqytetarëve të mi, kaloi herë me brenja, herë me gëzime, por kurdoherë me shpresa për të ardhmen. Ju e mbani mend, xha Thoma, kur neve na u dogj shtëpia në kohën e okupacionit të parë të grekëve. Unë atëherë isha i vogël, por mbaj mend se mëma, e llahtaritur, më shkundi nga gjumi dhe më shtyu përpara në mes të flakëve dhe të tymit për të më shpëtuar. Në shkallët që po digjeshin, nuk e harroj as tash, ktheva kryet dhe shikova mëmën në mes të tymit që në një sjetull mbante motrën time, foshnjë të vogël, dhe në sjetullën tjetër një sahat të vjetër që e ruante varur në odën e gjumit dhe që zilja e tij e zgjoi atë nga gjumi në atë natë të frikshme. Çdo gjë na e dogji zjarri, motra më e vogël na vdiq, por unë dhe sahati jetuam. Këtë sahat, të vetmen gjë të shtrenjtë që kam të familjes, po ia dërgoj shkollës sime të dashur, më-

suesit tim të vjetër, nxënësve dhe mësuesve të rinj.

Të dashur shoqe dhe shokë të rinj, poet dhe shkrimtar unë s'jam, por, kur isha dhe unë i ri si ju, ëndërroja për poezi, për dashuri, këtë ua them se unë i besoj poetët kur ata thonë se edhe sendet kanë jetën e tyre dhe «ligjërojnë» historinë e tyre. Sahati që po ju dërgoj s'është veç një mekanizëm i thjeshtë dhe i vjetër, i lyer me pak bojë për t'i fshehur pleqërinë, ashtu siç bënë dikur nënat tona plaka që vinin këna në flokë për të fshehur thinjat e bardha. Sipas mëmës, ky sahat ka afro një shekull që i shërben familjes sime. Një shekull s'është pak, por dëgjojeni me kujdes, ai këndon vazhdimisht si... bilbil. Mos t'ju vijë keq, i nderuari xha Thoma, edhe ju nuk jeni i ri, por zëri juaj vazhdon të këndojë si ngahera nga klasa në klasë, nga viti në vit për më shumë se 50 vjet me radhë vjershat dhe këngët e bukura të Naimit që i këndonte Shqipërisë dhe së ardhmes, këngët e fuqishme të punonjësve të rinj që ndërtojnë socializmin me vrullin rinor. Sahati që po ju dërgoj dhuratë, është i thjeshtë, por për mua është i dhembshur. Kur i mora leje mëmës që t'jua dërgoja juve, ajo më tha: «Hallall e pastë shkolla jote, dërgojua! Zilja e këtij sahati të zgjonte çdo mëngjes kur të nisja për shkollë, dhe shkolla ku ti mësove të hapi sytë. S'kemi tjetër gjë nga e kaluara t'u dërgojmë të rinjve dhe të rejave, biro». Nëna ime më porositi t'ju them juve se ajo ju çon të fala dhe ju puth sytë. Ju

këshillon të doni atdheun, popullin dhe Partinë si shpirtin, dhe të mësoni mirë e bukur. Ajo m'u lut gjithashtu t'ju tregoj juve edhe «jetën», historinë e sahatit.

«U thuaj djemve dhe bilave<sup>1</sup> të Gjirokastrës se të gjitha gëzimet dhe hidhërimet e zemrës na i ka parë dhe dëgjuar, na i di ki sahat i shkretë. Ki sahat ka parë mullanë<sup>2</sup> të bisedonte fshehurazi me Çerçizë, me Duro Gurë dhe Idriz Gurë. Tiktaket e sahatit rrihnin si zemrat tona dhe të gjithë gjirokastritëve, kur mullai iu përgjigj ultimatumit të gjeneralit grek që donte të digjte Gjirokastrën. Të gjithë pritnim vdekjen nga ora në çast, pritnim të na digjeshin shtëpitë dhe ne brenda, por Venizellosit dhe Zografos nuk i dorëzohehim. Përpara trimërisë së popullit, gjenerali grek u zmbrops. Qyteti shpëtoi nga djegia. Më vonë na pllakosi varfëria, ki sahat na i di hadhet, por nuk u turpëruam. Një pjesë të fëmijëve i përcolla në varr, ki sahat m'i njuh hidhërimet. Ki ma di llahtarën time kur na zaptuan italianët dhe gjermanët. Sahati e di mirë frikën dhe dhimbjen që ndieja në zemër, kur ti, biro, biri im, dhe djemtë e mëmave të tjera shqiptare dolën ilegalë me Partinë, kur luftonin në demonstrata, kur shkuan

---

1. Kështu quhen në Gjirokastrë vajzat.

2. Hysen Hoxha — patriot, iniciator për çeljen e shkollës së parë shqipe në Gjirokastrë dhe kryetar i shoqërisë «Bashkimi» dhe «Pleqënisë» së klubit «Drita». Në vitin 1913-1914 kundërshtoi lëvizjen për autonomi të «Vorio-Epirit».

në luftë e s'i pashë më, derisa u çlirua Shqipëria. Orët më dukeshin ditë dhe ditët vite. Kërcitnin çdo natë pushkët e bombat në Tiranë dhe sikur më goditnin në zemër. Binte zilja e këtij të flamosurit sahat. Mendoja djalin tim, mendoja djemtë e bilat e nënave që kishin dalë në mal partizanë dhe luftonin për popullin me flamur të kuq në dorë. . . Por ja u kthyen nga mali fitimtarë, qeshi nga gëzimi gjithë Tirana, gjithë Shqipëria. Tani zile e sahatit më dukesh si këngë e bukur. Një ditë, duke shikuar sahatin, i thaçë atij: ditëshkurtër, sa shumë kemi vojtur ti dhe unë, por ç'e zë dhe nuk e kalon njeriu. Njeriu është më i fortë se ti, më i fortë se hekuri. Tani i thaçë sahatit: këndo se s'do ketë më ditë të zeza as për popullin, as për ne, as për ti».

Këtë sahat, pra, po i dërgoj si dhuratë të thjeshtë shkollës sime të parë e të dashur. Unë e mbaja këtë në odën e punës, por mendoj se te ju do të jetë më mirë, pse pleqtë gëzojnë dhe kanë nevojë të rrinë me të rinjtë, pse u kujtohet rinia e tyre, pse duan kurdoherë të jenë të rinj, pse duan të gëzojnë, të punojnë si të rinjtë, pse, kur rrinë me të rinjtë, të vjetrit marrin forca të reja për t'u shërbyer deri në mbrëmjen e jetës së tyre të resë, atdheut socialist, Partisë sonë të lavdishme.

Edhe unë ju siguroj, të dashur shokë, shoqe e miq të gjimnazit «Asim Zeneli» të Gjirokastrës, se me të gjitha forcat e mia, sa të kem fuqi do të punoj, do të luftoj deri në fund, si ushtar i Par-

tisë dhe i popullit, për lumturinë e njerëzve të  
Shqipërisë, për lumturinë e brezit të ri.

Të rrojë në shekuj, në lavdi e në lumturi,  
populli ynë i mrekullueshëm, Partia jonë e lavdi-  
shme, rinia jonë heroike!

Ju përqafoj dhe mirupafshim  
shokë dhe miq të mi të vjetër dhe të rinj

Juaji

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 23, f. 414*

**LETËR FALËNDERIMI DREJTUAR  
PROFESORIT TË SHKENCAVE  
MATEMATIKE KRISTAQ FUNDOS**

**3 maj 1964**

I dashur shoku Kristaq Fundo,

Ju falënderoj për letrën e ngrohtë që më dërguat dhe për veprën tuaj të çmuar «Studim i evolutave dhe i evolventeve të kurbave të hapësirës», që i dhuroni Partisë me rastin e 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

Me kënaqësi të veçantë mora dijeni për vlerësimin që i ka bërë kësaj vepre Akademia e Shkencave e Çekoslovakisë.

Kjo vepër është një dëshmi tjetër që tregon për talentin tuaj si matematikan. Në të njëjtën kohë kjo vepër si edhe veprat tuaja të tjera, të vëna në dispozicion të studentëve të shkollave tona të larta: «Gjeometria plane», «Aritmetika racionale» (teorike dhe praktike), «Algjebra ele-

mentare», «Trigonometria plane», «Gjeometria analitike plane», «Gjeometria analitike me tri dimensione» etj., dëshmojnë si për vullnetin tuaj të madh dhe pasionin e zjarrtë për matematikën, ashtu edhe për patriotizmin tuaj, për kontributin tuaj të vlefshëm në edukimin e brezit të ri, në përgatitjen e kuadrove të rinj shkencorë për atdheun tonë socialist. Për të gjitha këto ju përgëzoj nga zemra!

Në luftën që po bën gjithë populli, nën udhëheqjen e Partisë, për ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit, një vend nderi zënë dhe punonjësit e kuadrot tanë të talentuar të shkencave të përpikta. Një meritë të veçantë këtu kanë edhe mësuesit, pedagogët dhe kuadrot e tjerë të lartë të matematikës, të cilët po ngrenë kulturën e masave edhe në këtë fushë, që ka një rëndësi shumë të madhe në epokën tonë. Matematika është bërë armë e fuqishme e progresit tekniko-shkencor të njerëzimit, ajo është jo vetëm kyç për shkencat e tjera të përpikta, por po futet dhe në shkencat humanitare, ajo po hap gjithnjë e më shumë dyert e kozmosit. Ja pse matematika nët po bëhen nga njerëzit më të respektuar e të dashur si në botë, edhe në vendin tonë.

Uroj që rinia jonë shkollore e studenteske të frymëzohet gjithnjë nga shembulli, vullneti dhe pasioni i matematikanëve të mëdhenj të kohëve të mbarë botës dhe të matematikanëve tanë, ta dojë sa më shumë këtë shkencë, që i jep krah mendimit krijues të njeriut për të depërtuar me

guxim drejt çdo të panjohure e për ta bërë zot mbi të fshehtat e natyrës, uroj nga zemra që të shtohen sa më shumë radhët e kësaj armate të re që krijoi Partia — të matematikanëve tanë popullorë!

Partia ju porositi, ju dhe kolegët tuaj, që të studioni vazhdimisht, të jeni në korent të çdo realizimi botëror në fushën e matematikës dhe të mos kënaqeni me atë çka është arritur, por të përpiqeni kurdoherë të jepni kontributin tuaj sado modest në fushën e kësaj shkence të madhe. Rritni dhe aftësitë tuaja pedagogjiko-metodike, për t'ia hapur sa më shumë rrugën matematikës në brezin e ri.

Partia, që udhëheq e frymëzon të gjithë popullin në luftën për një të ardhme sa më të ndritur, do të jetë, si kurdoherë, pranë jush, pranë matematikanëve dhe të gjithë dijetarëve të tjerë, që u janë kushtuar shkencës, lumturisë njerëzore, lavdisë së atdheut të tyre, socializmit.

Edhe një herë urime e përshëndetje revolucionare juve dhe të gjithë kolegëve tuaj të nderuar!

*Enver Hoxha*

«Për shkencën (Përmbledhje  
veprash)», vëll. 1, f. 230

**LETËR DREJTUAR SHOQATËS PATRIOTIKE  
«SKËNDERBEU» ARGJENTINË, ME RASTIN  
E 20-VJETORIT TË THEMELIMIT TË SAJ**

11 maj 1964

Të dashur bashkëdhetarë,  
Vëllezër dhe motra,

Në emër të Partisë së Punës të Shqipërisë, të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të të gjithë popullit shqiptar, ju dërgoj përsë-ndetjet më të ngrohta vëllazërore dhe marr pjesë me gjithë zemër në gëzimin tuaj të madh, me rastin e 20-vjetorit të themelimit të shoqatës patriotike «Skënderbeu» të shqiptarëve me banim në Argjentinë.

Shoqata juaj patriotike «Skënderbeu», gjatë këtyre 20 vjetëve, ka zhvilluar një veprimtari të shquar patriotike, duke ruajtur dhe zhvilluar tek anëtarët e saj ndjenjat e dashurisë për atdheun, gjuhën, zakonet fisnike të shqiptarit dhe respek-

tin e ligjshëm për fitoret e mëdha historike të arritura nga populli ynë në luftën e tij kundër pushtuesve nazifashistë dhe tradhtarëve të vendit dhe në luftën për ndërtimin e jetës së re në Shqipëri. Shumë janë përpjekur dhe përpiqen armiqtë e të gjithë flamujve për të përçarë shoqatën tuaj patriotike, për të prishur bashkimin dhe për të shkelur besën e dhënë për ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të popullit shqiptar. Por ata nuk ia kanë arritur qëllimit të tyre djallëzor dhe nuk do t'ia arrijnë kurrë, sepse shoqata juaj patriotike, që mban emrin e heroit tonë kombëtar, kryetrimt Skënderbe, ka ditur t'i bëjë pluhur dhe hi përpjekjet e armiqve dhe të gjithë shërbëtorëve të tyre, sa herë që ata kanë marrë guximin të veprojnë. Kështu, të gjithë ju, të dashur bashkatdhetarë, keni treguar më së miri aty, larg mëmëdheut, tিপaret më të larta të popullit shqiptar: besën, trimërinë, mprehtësinë dhe urtësinë.

Festa e 20-vjetorit të themelimit të shoqatës suaj bie në një vit me jubileun e madh të 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Populli shqiptar, i cili në shekuj ka qenë i robëruar, i shfrytëzuar, kurrë nuk u përku! dhe nuk i ktheu shpinën armikut, fitoi lirinë dhe pavarësinë e vërtetë në nëntor të vitit 1944. Gjatë kësaj kohe populli ynë nën udhëheqjen e Partisë së tij të Punës dhe të pushtetit popullor ka arritur suksese të papara në të gjitha drejtimet. Shqipëria, nga një vend i prapambetur që ishte në të kaluarën, tani ka një industri moderne, një bujqësi të zhvilluar, një kul-

turë të përparuar. Fëmijët e punëtorëve dhe të fshatarëve mbushin të gjitha shkollat e republikës deri në universitet. Më parë, shqiptari mërgonte në kurbet për të siguruar bukën. Tani, bijtë e Shqipërisë në vendin e tyre punojnë për begatinë dhe mirëqenien e popullit, për forcimin, zhvillimin e mëtejshëm e lulëzimin e atdheut të tyre, ata punojnë për vete dhe nuk i shfrytëzon njeri si më parë. Pushteti popullor vuri në vend nderin dhe dinjitetin e popullit shqiptar. Tani prestigji i Republikës Popullore të Shqipërisë në fushën ndërkombëtare është më i lartë se kurrë; atë s'ka armik që do të guxojë ta prekë, sepse ajo është e fortë si malet tona dhe ka kudo miq të fortë e besnikë.

Populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë së tij të Punës, duke mbajtur në një dorë kazmën e në tjetrën pushkën, do të vazhdojë me vendosmëri të patundur luftën për të ardhmen e lumtur, për çështjen e paqes, lirisë, demokracisë e socializmit në botë, kundër imperialistëve, me ata të SHBA-së në krye dhe kundër agjentëve të tyre, revizionistëve Tito-Hrushov e të tjerë. Populli ynë u është mirënjohës bijve të tij jashtë atdheut, siç janë patriotët e shoqatës «Skënderbeu» të Argjentinës, të cilët kanë qenë dhe janë përkrah tij në këtë luftë fisnike.

Unë kam besim se shoqata patriotike «Skënderbeu», edhe në të ardhmen, do të vazhdojë në rrugën e saj patriotike, do të mbajë kurdoherë me nder emrin e Skënderbeut, nderin e të parëve

dhe të partizanëve tanë të rënë për lirinë e Shqipërisë, duke mbajtur të fortë te çdo anëtar i saj ndjenjën e dashurisë dhe të respektit për atdheun tonë të lavdishëm, për Republikën Popullore të Shqipërisë.

Të gjithë bashkatdhetarëve patriotë shqiptarë me banim në Argjentinë u uroj shëndet, nder dhe gëzime.

Rroftë shoqata patriotike «Skënderbeu».

Përhëndetje vëllazërore

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 26, f. 333*

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR PUNONJËSVE  
TË TEATRIT ME RASTIN E 20-VJETORIT  
TË KRIJIMIT TË TEATRIT POPULLOR**

**30 maj 1964**

Të dashur shokë e shoqe,

Sot së bashku me ju, punonjësit e Teatrit Popullor, që festoni 20-vjetorin e krijimit të teatrit tuaj, janë të gëzuar dhe qindra e mijëra pjesëtarë të teatrove të tjerë profesionistë e amatorë, dramaturgët, kritikët e teatrit e spektatorët e panumërt të artit skenik. Të gjithë këta, nën udhëheqjen e Partisë sonë të Punës dhe duke vënë me besnikëri në jetë porositë e saj të çmuara, i kanë dhënë atdheut një nga tribunat më të vyera për edukimin e njeriut të epokës së socializmit e të komunizmit, teatrin tonë të ri. Prandaj më lejoni që, me këtë rast, t'ju dërgoj të gjithëve përshëndetjet më të ngrohta të Partisë dhe të miat personalisht.

Populli ynë ka vuajtur shumë për të ruajtur ekzistencën e tij, për një jetë të lirë e të denjë njerëzore. Ai ka luftuar për të ruajtur traditat fisnike dhe kulturën e tij të lashtë. Dallgët e pamëshirshme të jetës s'e thyen dot kurrë as vullnetin e tij të hekurt dhe optimizmin revolucionar, as humorin e tij të hollë e ndjenjën e së bukurës. Pushkën, këngën, vallen si dhe pasqyrimin skenik të fenomeneve të jetës shoqërore politike, qoftë dhe në format më të thjeshta, ai i ka gërshtuar me njëra-tjetrën, i ka bërë pjesë të pandara të jetës.

Në kohën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare këto karakteristika dhe armë të tij morën një zhvillim të paparë deri atëherë. Kujtoni se si, pas betejave të përgjakshme me armiqtë, partizanët çlodheshin, këndonin e jepnin shfaqje të shkurtra pranë zjarrit; se si në burgje, ku shokët tanë i torturonin, i vritnin apo i varnin fashistët, zemrat e bijve të popullit rimerrnin zjarr akoma më me furi nga këngët dhe shfaqjet revolucionare të grupeve artistike amatore; se si ngrihej peshë populli i robëruar i lagjeve të qyteteve apo i fshatrave nga shfaqjet ilegale ku kumbonte zëri i Partisë! Atje, në luftë, Partia zbuloi në sytë e të gjithëve dhe futi thellë në ndërgjegjen e masave forcën e madhe transformuese të artit në përgjithësi, të artit teatral në veçanti.

Njëzet vjet po mbushen që kur Shqipëria e re nisi ekzistencën e vet me një flamur të madh të shpalosur — me flamurin e Partisë; që atëherë

ajo qëndron kështjellë graniti me të vërtetë e lirë, qëndron me kazmën në një dorë e pushkën në tjetrën; që atëherë ajo nisi marshimin e revolucionit të ri ekonomik-shoqëror, duke ndërtuar bazën ekonomike të socializmit dhe, krenare dhe e patundur, vazhdon luftën për ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit; ajo nisi dhe vazhdon me sukses të plotë revolucionin e madh ideologjik e kulturor; ajo po thotë gjithnjë e më me forcë fjalën e saj, mendimin e saj në fushat më të ndryshme.

Teatri ynë, pjesë e pandarë e jetës së popullit, eci në një hap me të, duke i ngjitur një nga një, me luftë e përpjekje, shkallët e jetës së re socialiste. Dhe kjo ngjau sepse njerëzit e teatrit profesionist e amator, dramaturgët etj., të lidhur ngushtë me të, luftuan, nën udhëheqjen e Partisë, me shpirt e zemër, të ndërgjegjshëm për misionin e tyre të lartë.

Pra, lufta e Partisë, lufta e popullit, lufta e njerëzve të artit skenik e dramatik, kjo luftë e madhe, ka vënë vulën e saj në teatrin tonë dhe po kristalizon në një formë gjithnjë e më të plotë teatrin tonë kombëtar, socialist.

Shqiptari s'ka qenë kurrë sositës i thjeshtë i jetës, imitues i verbër, skllav i kulturës së të tjerëve. Përkundrazi, ai, duke mësuar nga eksperiencia e tij dhe e të tjerëve, gjithmonë ka qenë dhe, aq më tepër sot, është aktiv ndaj saj, është përpjekur dhe përpiqet të japë kontributin e tij sado modest në kulturën botërore. Kështu është

puna dhe në teatrin tonë. Ne sot kemi aktorë të talentuar, kemi regjisorë e piktorë skene të zotë, kemi një dramaturgjë tonën që e ushqen gjithnjë e më shumë këtë teatër. Forcat e tyre janë përqendruar me sukses dhe do të përqendrohen akoma më shumë në të ardhmen, drejt një objektivit të përbashkët, drejt pasqyrit të jetës sonë socialiste në zhvillimin e saj revolucionar.

Në të njëjtën kohë të bëhet zemra mal kur shikon se scena e teatrit shqiptar nuk është pronë vetëm e disa njerëzve, se në të hyjnë bijtë e talentuar të popullit, se aty është ngjitur punëtori e fshatari ynë i ri, që mishëron e pasqyron në artin skenik veçoritë e epokës së re historike!

Kështu, teatri ynë përshkohet nga fryma e një patriotizmi të thellë socialist. Por, veç kësaj, ai, duke qenë i lidhur ngushtë me popullin e Partinë, përshkohet po aq dhe nga fryma e internacionalizmit proletar. Në skenat e Teatrit Popullor e të teatrove të tjerë profesionistë e amatorë janë vënë me talent edhe mjaft vepra të huaja përparimtare, klasike e të sotme. Duke bërë një punë serioze në këtë drejtim, artistët dhe regjisorët tanë njëkohësisht i kanë prerë rrugën penetrimit të pjesëve dekadente, borgjeze e kundërrevolucionare të Perëndimit, që sot me aq zell përvetësohen dhe imitohen nga revizionistët modernë. Në këtë mënyrë, artistët dhe punonjësit e tjerë të artit skenik marrin pjesë aktive në luftën e madhe politike e ideologjike që zhvillojnë Partia dhe populli ynë kundër imperializmit, me atë të SHBA-së në

krye, dhe kundër revizionizmit modern, me tradhtarët Hrushov e Tito në krye, për triumfin e çështjes fisnike të paqes, lirisë, demokracisë e socializmit në botë. Artistët tanë, ashtu siç i mëson Partia, ushqejnë veten dhe masat me idetë e pavdekshme të marksizëm-leninizmit.

Por, natyrisht, të dashur shokë, neve të gjithëve na mbetet akoma shumë për të bërë në të gjitha fushat, pra dhe juve ju mbetet të bëni akoma më shumë për zhvillimin e mëtejshëm të teatrit tonë, që është pjesë e rëndësishme e kulturës sonë kombëtare. Prandaj kurrë të mos deheni nga sukseset, por me kurajën që na mëson Partia të shihni dhe të metat e boshllëqet, si në çështjet e realizimit skenik të veprave ashtu dhe në pasqyrimin e saktë e të drejtë, në frymë kurdoherë revolucionare, të realitetit në dramaturgji. Sepse çështja e artit është nga çështjet më të vështira e të komplikuar. Edhe kërkesat e masave ndaj tij janë rritur e rriten vazhdimisht në përputhje me ngritjen e nivelit të tyre të gjithanshëm.

Teatri, në përgjithësi, është kultivues i ndërgjegjes së masave. Teatri ynë, në veçanti, është kultivues i ndërgjegjes revolucionare të tyre; ai ka për mision të ndihmojë në formimin e forcimin e saj, në brumosjen e njerëzve me vetitë e moralit komunist. Ai duhet të pasqyrojë jetën në zhvillim, ndryshimet që ndodhin në shoqëri, aspiratat dhe luftën e popullit. Teatri, si çdo art tjetër yni i realizimit socialist, duhet të marrë pjesë në këtë luftë, duke i ushqyer masat

me vijën e Partisë, me idetë e marksizëm-leninizmit, të edukojë patriotë të vërtetë e internacionalistë, njerëz me shpirt të madh, luftëtarë të patrembur për kauzën e popullit. Pra, teatri duhet të jetë shkollë e masave, kurse artisti frymëzues i tyre i dashur.

Por për të qenë kështu është e nevojshme që në radhë të parë artistët, regjisorët, dramaturgët të vënë në jetë, me forcë gjithnjë e më të madhe, vijën e Partisë, të njohin sa më mirë realitetin dhe estetikën marksiste, të pajisen me dituri të gjera. Dhe burimi i kësaj diturie janë populli, jeta dhe librat. Të gjithë artistët e mëdhenj i kanë pasur rrënjët te populli, kanë qenë të lidhur ngushtë me të dhe kanë mësuar nga gjenia e tij e pashtershme, nga kritikrat e vërejtjet e tij; të gjithë ata kanë pasur miq të tyre më të ngushtë popullin dhe librin. Modestia, shkrirja me popullin dhe etja për dituri e kulturë janë, ashtu si për çdo punonjës tjetër, nga vetitë më të çmuara të një artisti të vërtetë.

Në të njëjtën kohë artistët, aktori apo regjisori, janë njerëz krijues. Ata duhet të futin në rolet apo shfaqjet «të tyre», ta ngrenë realitetin në art me forcë krijuese dhe sa më emocionuese, se vetëm kështu heronjtë dhe rrethanat tipike do të paraqiten në zhvillimin e vet sa më të plotë, dinamike, revolucionare. Por kjo arrihet duke bërë përpjekje për t'u ngritur sa më shumë e vazhdimisht nga ana profesionale. Nuk mjafton të jesh i talentuar për një çështje; talenti mund

të shpërthejë me vrull vetëm po të mbështetet nga studimi e puna këmbëngulëse, ndryshe venitet e fishket.

Aktorët, regjisorët, piktorët e skenës, dramaturgët, kritikët e të tjerë, përbëjnë një detashment monolit. Ata janë të lidhur midis tyre në mënyrë të tillë që pa njëri-tjetrin s'bëjnë dot. Interesi i artit teatral, interesi i popullit, kërkon që në këtë detashment të sundojë sa më shumë motoja: «Një për të gjithë, të gjithë për një». Lavdia e atdheut, lavdia e artit, lavdia e kolektivit dhe ajo e individit janë një dhe të pandara. Prandaj është e nevojshme që midis aktorëve, regjisorëve, dramaturgëve e të tjerë, të sundojë kurdoherë ndjenja e harmonisë, e ndihmës reciproke dhe e kritikës parimore shoqërore. Kjo do të ndihmojë që arti ynë teatral të përparojë me shpejtësi.

Të dashur shokë e shoqe,

Teatri Popullor në këtë jubile sheh rrugën e tij të lavdishme 20-vjeçare, sheh dhe detyrat e mëdha që i dalin përpara. Ai është pionier i teatrit tonë të ri, ai ka mësuar të tjerët dhe ka mësuar nga të tjerët, ai i ka dhënë shumë popullit, por akoma më shumë duhet e do t'i japë në të ardhmen.

Le të bëhet teatri ynë gjithnjë më i afërt dhe i kuptueshëm për popullin, le të jetë për të kur-

doherë një armë e fuqishme, për të çarë përpara drejt një të ardhmeje gjithnjë e më të lumtur! Le të mbushen radhët e teatrove profesionistë me gjak të ri nga Shkolla e Lartë e Aktorëve, nga teatrot amatorë, nga bijtë e talentuar të popullit!

Le të udhëhiqeni në punën tuaj nga motivi: sa kënaqësi i jepni popullit, sa zjarr i jepni rinisë, sa bëni për edukimin e njeriut të ri. Si kurdoherë do të gjeni shpërblimin e madh të punës suaj te dashuria e pakufishme e popullit tonë heroik dhe e Partisë sonë të lavdishme për ju.

Dalshi kurdoherë faqebardhë në misionin tuaj aq të bukur dhe fisnik!

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 26, f. 448*

**LETËR DREJTUAR NËNAVE  
DHE FAMILJEVE TË DËSHMORËVE  
TË RRETHIT TË TEPELENËS**

**8 nëntor 1964**

Të dashura nëna, shokë dhe shoqe,

Ju falënderoj nga zemra për letrën që më dërguat me rastin e takimit për të përkujtuar dëshmorët e rrethit tuaj. Fjalët tuaja prekëse dhe të ngrohta, drejtuar Partisë sonë të lavdishme, janë për të një frymëzim dhe mbështetje e madhe, sepse ato shprehin patriotizmin e zjarrtë dhe besimin tuaj të patundur e të mbarë popullit të Partia, e cila do ta çojë deri në fund amanetin e dëshmorëve, do ta udhëheqë, si kurdoherë, popullin në rrugën e drejtë deri në fitoren e plotë të socializmit e të komunizmit dhe do ta mbrojë, sa të jetë jeta, çështjen e pavdekshme të marksizëm-leninizmit.

Sot populli ynë feston 23-vjetorin e Themeli-

mit të Partisë. Së shpejti ai do të festojë 20-vjetorin e Çlirimit të Atdheut. Në flamujt e revolucionit e të fitoreve të popullit, të udhëhequr nga Partia, janë mishëruar, në radhë të parë, gjaku dhe vepra e dëshmorëve tanë.

Bijtë e bijat, vëllezërit e motrat, prindërit e të afërmit tuaj dëshmorë, ashtu si të gjithë dëshmorët e atdheut, bënë për lirinë e lumturinë e popullit më shumë se kushdo tjetër, dhanë për të edhe jetën. Por duke dhënë jetën për atdhe e socializëm, ata u bënë të pavdekshëm dhe sot rrojnë në zemrat tona, në zemrat e brezit të ri dhe të mbarë popullit, duke na ndriçuar me shembullin e tyre rrugën e nderit, rrugën e luftërave të reja pa kompromis kundër armiqve të betuar imperialistë e tradhtarëve revizionistë, për triumfin përfundimtar të çështjes së paqes, lirisë, demokracisë e socializmit.

Për ju, nëna, baballarë, familje të dëshmorëve, populli e Partia kanë një dashuri e respekt të madh, sepse jeni një nga shtyllat e çelika të Shqipërisë së re, pasi ju, ashtu si nuk kursyet dje asgjë për lirinë e ndërtimin e mëmëdheut, po ashtu sot nuk kurseni djersën e jeni gati të bëni çdo sakrificë për ruajtjen e fitoreve dhe për lulëzimin e mëtejshëm të vendit tonë socialist.

Nënat dhe baballarët e dëshmorëve kanë bij e bija tërë popullin, fëmijët e dëshmorëve kanë nënë e babë Partinë. Duke jetuar e duke luftuar në gjirin e popullit e të Partisë dhe për popullin e Partinë ata kanë gjetur dhe do të gjejnë kur-

doherë lumturinë dhe gëzimin e vërtetë në jetë.

Le të jeni ju edhe në të ardhmen agjitorë të zjarrtë dhe luftëtarë të palodhur për çështjen e Partisë e të socializmit!

Le t'i transmetoni brezit të ri shembullin e ndritur të bijve e të prindërve tuaj dëshmorë dhe patriotizmin e shpirtin tuaj revolucionar!

Populli, atdheu, Partia do t'ju jenë përjetë mirënjohës!

Lavdi dëshmorëve!

Lavdi atdheut, Partisë, marksizëm-leninizmit!

Juaji

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 28, f. 103*

## **PËRSHËNDETJE DREJTUAR FORCAVE TË KUFIRIT**

**25 prill 1965**

Të dashur shokë kufitarë,

Me rastin e festës suaj jubilarë, 20-vjetorit të themelimit të forcave të kufirit, jam i lumtur t'ju dërgoj në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të gjithë komunistëve dhe popullit tonë, si dhe në emrin tim personal, përshëndetjet më të zjarrrta. Arma e lavdishme e kufirit, roje vigjilente e tërësisë tokësore të Republikës sonë Popullore, është pjesë e pandarë e forcave tona të armatosura, së cilës i përket nderi i madh të qëndrojë ditë e natë syptrembur në mbrojtje të kufijve të shtrenjtë të atdheut tonë socialist. Këtë detyrë kaq të shenjtë dhe fisnike që ju është ngarkuar e keni kryer dhe po e kryeni me nder e vetëmohim, duke justifikuar plotësisht besimin e madh që ushqejnë te ju Partia dhe populli. Prandaj festën tuaj të shënuar, së bashku me ju, e

gëzojnë i gjithë populli dhe forcat e tij të armatosura.

Qysh nga krijimi i tyre, 20 vjet më parë e gjer më sot, duke qenë plotësisht të ndërgjegjshme për misionin e tyre të lartë, ruajtjen e paprekur të kufijve dhe garantimin e punës paqësore të popullit tonë, që ndërton me sukses socializmin, forcat e kufirit, pa marrë parasysh vështirësi e sakrifica të panumërta, i kanë kryer kurdoherë me nder e lavdi detyrat që u ka ngarkuar Partia. Në sajë të besnikërisë së pakufishme ndaj popullit, Partisë e atdheut, vigjilencës së lartë, zgjuarsisë, guximit, trimërisë dhe heroizmit të kufitarëve tanë, të përkrahur me të gjitha forcat nga populli ynë patriot e liridashës, janë kapur të gjallë ose janë shfarosur sa e sa agjentë, spiunë e diversantë të dërguar nga armiqtë e jashtëm për të penguar e për të dobësuar punën paqësore të popullit tonë, janë prapsur me sukses dhe kanë dështuar provokacionet e shumta të kurdisura nga imperialistët e revizionistët që e kanë halë në sy Republikën Popullore të Shqipërisë.

Është për këtë arsye që populli dhe Partia jonë ushqejnë një dashuri të thellë për bijtë trimë kufitarë, të cilët kanë dhënë edhe gjakun e tyre të kulluar për t'i bërë të pakapërcyeshëm kufijtë e atdheut. I gjithë populli ynë, në fshat dhe në qytet, në ara, në fabrika, në shkolla e kudo punon i qetë, se e di që kufijtë e shenjtë të atdheut janë në duar të sigurta.

Të edukuar nga Partia, me ndjenjat e larta të patriotizmit socialist dhe të internacionalizmit proletar, ju ushqeni një dashuri të pakufishme për atdheun tonë dhe çështjen e madhe të socializmit. Prandaj, duke bërë roje ditë e natë në kufi, ju mbroni me vendosmëri e me heroizëm fitoret historike të Luftës Nacionalçlirimtare, pushtetin tuaj popullor, sukseset e korrura gjatë këtyre 20 vjetëve të ndërtimit të socializmit, kur Shqipëria, e udhëhequr nga Partia jonë e lavdishme që ndjek me besnikëri mësimet e marksizëm-leninizmit, është kthyer nga një vend i prapambetur në një vend të përparuar socialist. Duke bërë roje natë e ditë në skajet më të largëta të atdheut, juve ju kujtohen nëna që ju dha gji dhe ju rriti, babai, motrat e vëllezërit, njerëzit tuaj më të dashur, fshati apo qyteti i lindjes, përfytyroni gjithë Shqipërinë, ku zien vrulli i jetës së re socialiste, prandaj forcat e vendosmëria ju qindfishohen, syri e mendja ju bëhen më të mprehtë, sepse e ndieni thellë në zemrat tuaja të çelikta detyrën aq të lartë, delikate e me shumë përgjegjësi që keni mbi supe.

Në gjendjen aktuale ndërkombëtare, kur imperialistët, dhe në radhë të parë ata amerikanë, të përkrahur edhe nga shërbëtorët e tyre, tradhtarët e çështjes së madhe të socializmit, revizionistët hrushovianë, titistë e të tjerë, po luajnë me fatet e popujve, si të gjitha forcave tona të armatosura, ashtu edhe juve, shokë kufitarë, ju vihet detyra që paskëtaj të shtoni përpjekjet për

edukimin tuaj të vazhdueshëm ideopolitik, të forconi më tej vigjilencën dhe disiplinën, të rritni aftësitë tuaja tekniko-ushtarake, t'i çelikosni edhe më shumë lidhjet me masat e popullsisë kufitare, në mënyrë që ta bëni brezin kufitar të pakapërcyeshëm nga cilido armik që do të orvatej ta prekte sadopak atë.

Partia dhe populli ynë kanë besim të plotë në patriotizmin tuaj të lartë, shokë kufitarë, se, duke ndjekur traditat luftarake revolucionare të të parëve tanë dhe të paraardhësve tuaj që bënë Luftën heroike Nacionalçlirimtare, edhe në të ardhmen do të punoni e do të luftoni për të vënë në jetë mësimet e Partisë së Punës të Shqipërisë, për ta rritur më tej lavdinë e forcave të lavdishme të kufirit, për t'i bërë si kurdoherë të pakapërcyeshëm nga çdo armik kufijtë e shenjtë të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Duke përfituar nga festa juaj e gëzueshme, ju uroj, të dashur shokë kufitarë, suksese gjithnjë më të mëdha në ruajtjen dhe në mbrojtjen e kufijve të atdheut, Republikës Popullore të Shqipërisë, kësaj kështjelle të pamposhtur të socializmit dhe të paqes!

*Enver Hoxha*

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Vepra, vëll. 29, f. 392*

## **LETËR DREJTUAR ARBËRESHIT JOSIF DE RADA**

7 shtator 1965

I nderuar zoti Josif de Rada,  
Macchia Albanese (Cosenza)

U gëzova shumë për letrën aq të ngrohtë që më dërguat, ku shprehni mallin dhe dashurinë e thellë të arbëreshëve që rrebeshi i pushtimit turk i detyroi të vendosen në dhe të huaj.

Ju, ashtu si të gjithë vëllezërit arbëreshë të ndershëm e patriotë, keni shumë të drejtë t'u gëzoheni përparimeve të mëdha që ka bërë atdheu ynë i dashur pas Çlirimit nga pushtimi nazifashist.

Populli ynë i vogël, me një të kaluar aq të lavdishme, që çuditi botën, duke mbrojtur për 25 vjet me radhë qytetërimin evropian nga hordhitë otomane, i prirë nga heroi ynë legjendar, Gjergj Kastrioti — Skënderbeu, pasi shporri të huajt nga

vatra shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore, nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, çliroi një herë e përgjithmonë tokën e shenjtë të larë me lumenj gjaku për liri e pavarësi gjatë shekujve nga gjyshërit e stërgjyshërit tanë. Tani stërnipërit e ilirëve e të Kastriotit, zotër të vërtetë në atdheun e tyre të lirë e sovran, punojnë pa u lodhur për ta bërë Shqipërinë e re socialiste një vend çdo vit e më të bukur, më të lulëzuar, më të fortë e të paprekshëm nga çdo armik, për të mirën e vet dhe për gëzimin e miqve të panumërt që ka sot në botë Republika Popullore e Shqipërisë.

Për përparimet e mëdha që ka bërë vendi ynë gjatë këtyre 21 vjetëve pas Çlirimit, gëzohen, gjithashtu, edhe vëllezërit arbëreshë që vazhdimisht e kanë dashur dhe e duan me gjithë shpirt atdheun e tyre të lashtë, duke e shprehur këtë dashuri me ruajtjen dhe me kultivimin e gjuhës së ëmbël shqipe, të kujtimeve të të parëve tanë, të traditave dhe të zakoneve të bukura shqiptare, të folklorit dhe të gjithçkaje fisnike që ka lidhje me jetën e popullit shqiptar. Dashurinë e madhe për atdheun e tyre të lashtë arbëreshët e kanë shprehur, gjithashtu, në përpjekjet e pareshtura dhe në përkrahjen e zjarrtë të luftës së gjatë çlirimtare gati pesëshekullore, në veprat e shumta të shkrimtarëve e të poetëve të talentuar arbëreshë që i kanë kënduar me tërë hovin e shpirtit të tyre atdheut të largët e të robëruar nën zgjedhën turke, për të cilin punuan

dhe luftuan ta shihnin të lirë, të lulëzuar e të fortë ashtu sikurse është sot. Në Shqipërinë e re demokratike popullore gjithë ky trashëgim i madh shpirtëror, i ruajtur dhe i përpunuar me aq kujdes nga arbëreshët, vlerësohet si një pasuri shumë e çmuar e thesarit të përgjithshëm të kulturës sonë kombëtare.

Brezit tonë i takoi nderi i madh për të vënë në jetë dëshirat dhe aspiratat e të parëve tanë, ëndrrat fisnike të patriotëve të mëdhenj të Rilindjes sonë Kombëtare, si Jeronim de Rada e Naim Frashëri, që punuan pa u lodhur e luftuan gjithë jetën e tyre për çlirimin e mëmëdheut tonë të shtrenjtë, për një Shqipëri të popullit e zonjë të nderuar në botë, ku të lulëzojnë jeta e lumtur dhe virtytet e larta të popullit shqiptar. Socializmi ia solli këto ditë të shkëlqyera atdheut tonë.

Ju uroj, i nderuari De Rada, të rroni dhe shumë vjet akoma, të keni shëndet të plotë dhe pleqëri të gëzuar.

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 30, f. 196*

## **TELEGRAM DËRGUAR FAMILJES SË PATRIOTIT SELIM HASANI (BRATAJ)**

*Brataj-Vlorë*

**4 dhjetor 1965**

FAMILJES SË TË NDJERIT, PATRIOTIT XHA SELIM,

Mësova me hidhërim lajmin për vdekjen e patriotit dhe rapsodit të shquar, këngëtarit zemërzjarr të trimërive legjendare të popullit shqiptar në luftërat për liri e pavarësi kundër pushtuesve të huaj e tradhtarëve të vendit, birit të nderuar të popullit të Vlorës, xha Selimit tonë.

Marr pjesë në pikëllimin e familjes suaj dhe ju dërgoj ngushëllimet e mia të dhimbshme.

Le të jetë jeta e luftëtarit partizan, pjesëmarrësit qysh në ditët e para në Luftën Nacionalçlirimtare, vjershëtorit popullor, xha Selimit, një shembull frymëzimi për brezin e ri të vendit tonë.

Le të rrojë kujtimi i tij brez pas brezi në këngët e bukura popullore revolucionare që ai me dashurinë e zemrës thuri tërë jetën e tij për lavdinë e Partisë e të atdheut dhe që sot ia lë trashëgim të vyer popullit të vet që aq shumë e deshi dhe i këndoi.

*Enver Hoxha*

«Zëri i popullit», nr. 296 (5392),  
10 dhjetor 1965

## LETËR DREJTUAR SHOKUT ZIHNI SAKO

17 shkurt 1966

I dashur shoku Zihni,

E mora letrën tënde ditën që ishe nisur për në Gjirokastrë, më 16 shkurt. Unë e kuptoj shqetësimin që ke për fjalët që qarkullojnë mbi ndarjen më dysh të Institutit të Folklorit, në sektorin muzikor, pranë Ministrisë së Kulturës dhe të Arteve, dhe në sektorin e folklorit gojor, pranë Institutit të Historisë e të Gjuhësisë.

Mendimet që kanë shfaqur disa shokë për këtë ndarje janë mendimet e tyre personale. Natyrisht, për të mirën e punës, secili ka të drejtë të mendojë e të bëjë propozime. Kjo, përveç së mirës, nuk ka asgjë të keqe.

Për këtë çështje kam të njëjtin mendim me ty, prandaj, po të vijë puna që të diskutohet për të, unë do ta mbroj atë, sepse kam bindjen që ky mendim për ekzistencën e Institutit të Folklorit, është i drejtë.

Unë u gëzova shumë që, si shkrimtar komunist, bashkë me shumë shokë të tjerë shkrimtarë, edhe ti iu përgjigje menjëherë thirrjes së Partisë për të punuar e për të jetuar në gjirin e atij populli, ku kemi lindur e kemi kaluar periudhën më të bukur të jetës, moshën e rinisë sonë të parë. Të them të drejtën, pa qenë lokalist, të kam zili, për atë që bëre, sepse, sa më tepër kalon mosha, aq më shumë më merr malli, më ndizet dashuria e thellë, në radhë të parë, për gjithë njerëzit e vendlindjes, për shokët e miqtë e mi, po njëkohësisht edhe për qytetin, për rrugët e deri për gurët e Gjirokastrës, vetëm se detyra që më ka ngarkuar Partia, nuk ma lejon edhe mua ta realizoj një dëshirë të tillë. Unë të përgëzoj, i dashur shoku Zihni, për vendimin që more dhe të uroj me gjithë zemër shëndet, lumturi dhe punë të mbarë e të frytshme për të mirën e popullit dhe të Partisë sonë të lavdishme.

Juaji

*Enver Hoxha*

*«Për shkencën (Përmbledhje  
veprash)», vëll. 1, f. 266*

## LETËR DREJTUAR SHOKUT MANUSH MYFTIU

27 maj 1966

I dashur shoku Manush,

Të përqafoj dhe të uroj shërim të shpejtë. Shokët e atjeshëm më kanë vënë në korent të kurave që të bëhen dhe të gjendjes. Unë kam besim se çdo gjë do të kalojë dhe do të normalizohet. Prandaj të këshilloj të mos mërzitesh, por të bësh durim. Mos ki aspak merak, pse do të rrish disa kohë atje sa të bëhesh mirë. Shërimi yt i plotë ka rëndësi për ty, për Partinë dhe për ne, shokët e tu. Kjo ka rëndësi të madhe, çdo gjë tjetër s'ka asnjë vlerë. Prandaj bëj durim, i dashur Manush, bëj kurat në rregull, mos rri mbyllur në odë, por përfito dhe shih ca Parisin, pa, kur të vish, mos ki merak, do të të ngarkojmë me punë sa të lodhesh.

Këtej çdo gjë shkon mirë. Bujqësia lulëzon,

shokët janë mirë dhe të bëjnë shumë të fala.  
Nexhmija, veçanërisht, të bën shumë të fala ty  
edhe Nefos. Në shtëpi i ke shumë mirë.

Prandaj edhe një herë, të këshilloj, hiqe  
mërzinë dhe mos u bëj merak për këtëj.

Të na vish shëndoshë e mirë dhe, duke të  
pritur, të përqafoj fort. Jepi shumë të fala Nefos  
dhe gjithë shokëve.

Yti

*Enver*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR PROFESOR  
SPIRO N. KONDEË**

**19 korrik 1966**

I nderuar profesor Spiro N. Konda,

E mora letrën tuaj të 6 korrikut 1966 dhe dëshiroj t'ju njoftoj se jam në dijeni të studimeve tuaja, të cilat i kam ndjekur me vëmendje.

Nëpërmjet kësaj letre ju shpreh falënderimet më të përzemërta për punën tuaj të palodhur e të gjatë, të frymëzuar nga ndjenjat e dashurisë për atdheun.

Përpjekjet dhe kontributi juaj, si në veprën e parë «Albanët (shqiptarët) dhe problemi pellazgjik», ashtu dhe në të dytën «Studime parahistorike», kanë një rëndësi të veçantë për studimet shkencore në fushën e historisë tepër të lashtë të atdheut tonë të dashur. Partia dhe pushteti ynë popullor kurdoherë kanë treguar dhe do të tregojnë një kujdes e interesim të madh për studimet në këto fusha kaq të rëndësishme.

Veprat tuaja do të ndihmojnë, gjithashtu, në fushën e albanologjisë për të vërtetuar vjetërsinë e popullit shqiptar e për të vënë në dukje akoma më mirë traditat e thesaret e kulturës së tij të lashtë.

Armiqtë e vendit tonë në të kaluarën nuk mundën të thyejnë vullnetin dhe dëshirën tuaj për t'i shërbyer mëmëdheut. Dëshirat tuaja gjatën mundësi zhvillimi vetëm me vendosjen e pushtetit popullor dhe në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila, ashtu si gjithë popullit, edhe juve, si gjithë studiuesve e shkencëtarëve tanë, ju dha energji të reja. Puna dhe përpjekjet tuaja të palodhshme le të shërbejnë si një shembull frymëzimi.

Edhe një herë ju uroj suksese në punën tuaj, shëndet e pleqëri të lumtur!

Ju përshëndes me respekt të thellë.

*Enver Hoxha*

*«Për shkencën (Përmbledhje  
veprash)», vëll. 1, f. 271*

**TELEGRAM DËRGUAR SHOQEVE  
GJELA PAL GEGA DHE  
MARIE PAL ÇUPI**

**21 dhjetor 1966**

SHOQEVE GJELA PAL GEGA DHE  
MARIE PAL ÇUPI

*Lagjja SMT, Lezhë*

Ju falemnderit shumë për urimet që më dërguat me rastin e Vitiit të Ri. Partia ju ka e do t'ju ketë kurdoherë në zemër ju, nënë e nderuar dhe motër e shokut tonë të shtrenjtë Llesh Palit, që i fali jetën e tij të re çështjes së madhe të popullit, mbrojtjes së kufijve të shenjtë të atdheut.

Unë ju uroj që Viti i Ri 1967 të jetë, si për gjithë popullin tonë, edhe për ju një vit pune e përpjekjesh në dobi të lulëzimit dhe forcimit të mëtejshëm të Republikës sonë Popullore dhe t'ju bëjë akoma më të forta ju, trimëresha të malësisë sonë kreshnike, për të mbajtur si vazhdimisht

lart me nder emrin e djalit dhe vëllait tuaj, birit  
të lavdishëm të popullit tonë, Llesh Pal Çupit.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR PIONIERËVE  
TË QYTETIT TË BERATIT**

27 janar 1967

Të dashur pionierë,

U gëzova pa masë sot kur mora vesh se ju, të dashur djem dhe vajza të shkollave 8-vjeçare të qytetit, u organizuat, u armatosët me çekiçë e me dalta dhe, nën drejtimin e mësuesve e të gurgdhendësve pensionistë, filluat të ndërtoni në kohën tuaj të lirë kalldrëmet e qytetit.

Ju lumtë! Ju mësoheni që të vegjël të ecni në rrugën e muratorëve e të gurgdhendësve të lavdishëm të vendit tonë, që shekuj me radhë e deri më sot kanë ushtruar një nga mjeshtëritë, një nga artet më të mrekullueshme të njerëzimit. Veprat e këtyre baballarëve, gjyshërve e stërgjyshërve tanë janë të pavdekshme, ne i shohim ato kudo në vendin tonë dhe i admirojmë, si domos në qytetin tuaj muze. Ju e filloni me gu-

rët e kalldrëmeve dhe me këtë do t'ju ngjallet një dashuri e madhe për gurin, me të cilin do të bëni vepra të mëdha e të mrekullueshme për vendin. Në gur ju do të fiksoni përjetë veprën madhështore të Partisë dhe të popullit tonë.

Unë i kam dashur, i dua dhe i respektoj shumë muratorët dhe punonjësit e gurit, prandaj vij sot te ju, të dashur pionierë dhe vogëlushë, t'ju përqafoj dhe t'ju puth me dashuri që morët këtë iniciativë kaq të mirë. Ju siguroj se kur të vij në Berat, gjëja e parë që do të bëj, është të piqem me ju dhe të shoh punën tuaj<sup>1</sup>.

Ju puth me mall të gjithë

*Enver*

*Vepra, vëll. 34, f. 413*

---

1. Gjatë qëndrimit në rrethin e Beratit, nga 24 deri 27 shkurt 1969, shoku Enver Hoxha bëri disa vizita dhe mori pjesë në mbledhjen e byrosë të Komitetit të Partisë të Rrethit. Vizitën e parë në qytetin e Beratit ai e bëri në shkollën «7 Nëntori», ku u takua me nxënësit e kësaj shkolle, iniciatorë të punës për shtrimin e rrugëve të qytetit me kalldrëm.

## **LETËR DREJTUAR PLEQVE TË KOOPERATIVËS LAPARDHA—MORAVË**

*Berat*

**4 shkurt 1967**

Të dashur vëllezër dhe shokë të shtrenjtë  
të kooperativës Lapardha-Moravë,

Letra që më dërguat më gëzoi shumë, më  
mallëngjeu, më shtoi forcat për të punuar e luf-  
tuar akoma më shumë në rrugën e lavdishme  
të socializmit në të cilën na udhëheq Partia jonë  
heroike.

Ju jeni më pleqtë e kooperativës suaj, por  
ju jeni heronj dhe të pamposhtur, si vajzat dhe  
djemtë tuaj të rinj, që dhanë një shembull të  
madh, për gjithë rininë e vendit tonë, duke shku-  
ar në malësi për të hapur toka të reja. I vetmi  
ndryshim juaji me të rinjtë mund të jetë mosha,  
por ju keni një përvojë të madhe për çdo gjë. Tash

unë e kuptoj akoma më mirë ç'mbështetje e madhe komuniste, revolucionare keni qenë për djetmë e vajzat, nipërit e mbesat tuaja që iu qepën malit. Nderi i flamurit që ju sollën të rinjtë e të rejat ju përket edhe juve baballarë të lavdishëm që, me këshillat dhe punën tuaj, dini t'i frymëzoni aq mirë fëmijët në rrugën e patriotizmit të zjarrtë, në rrugën e ndritur të Partisë.

Vëllezër të dashur,

Mosha mund të na ikë, por zemra s'na plakët kurrë. Ne deri në fund do të jemi zjarr i pashuar kurrë, pse Partia jonë e lavdishme qëndron kurdoherë e re dhe çdo ditë bëhet më e fortë, se ka popullin shqiptar të fortë, pse ju ka ju të fortë, pse ka rininë të fortë si çeliku. Partia na frymëzon, na udhëheq dhe na bën çdo ditë e më të rinj në mendime, në gjykime, në veprimë.

Ju dua dhe ju respektoj shumë, ju pleq të Lapardhasë, pse ju i kuptoni mirë të rinjtë dhe të rejat dhe ata, duke ju pasur prindër dhe gjyshër, ju kanë njëkohësisht shokë. Të rinjtë ju duan, pse ju i këshilloni drejt, ju duan se ju këni vuajtur shumë nga regjimet shtypëse dhe nga ideologjia e tyre shtypëse dhe pse keni vuajtur shumë, prandaj bëni çmos dhe luftoni paragjykimet prapanike të së kaluarës, siç janë shtypja e gruas, fanatizmi etj. që të mos vuajnë vajzat dhe mbesat tuaja, djemtë dhe nipërit tuaj.

Partia ju përshëndet dhe ju falënderon, unë  
ju përqafoj, ju uroj jetë të gjatë, me shëndet,  
me punë dhe me suksese plot!

Juaji

**Enver Hoxha**

«Zëri i popullit», nr. 31 (5756),  
5 shkurt 1967

## **LETËR DREJTUAR KUVENDIT TË 75 PLEQVE TË RREHIT TË KUKËSIT<sup>1</sup>**

**14 shkurt 1967**

**Të dashur vëllezër të Kukësit!**

Ju falënderoj nxehtësisht për letrën që më dërguat, ku shprehni ndjenjat tuaja të zjarrta të dashurisë, të besimit dhe të besnikërisë ndaj Partisë sonë të dashur.

Ju malësorë kreshnikë të Kukësit, me thjeshtësinë tuaj madhështore të popullit, menduat se i shkruat një letër të thjeshtë birit dhe vëllait tuaj dhe, sigurisht, nuk menduat sa vlerë të madhe ka letra juaj për mua dhe për shokët e mi.

---

1. 75 pleq të e Kukësit, që përfaqësonin gjithë pleq të patriotë të 69 kooperativave bujqësore të reja të rrehitit u mblodhën në kuvend më 9 shkurt 1967 dhe biseduan për kolektivizimin e bujqësisë dhe për patriotizmin e hovin revolucionar, për vështirësitë dhe pengesat, si dhe për detyrat që u dilnin për të forcuar kooperativat e tyre të reja.

Pikësëpari, pse ajo vjen nga populli, vjen nga malësorët që u bashkuan me një frymë të madhe patriotike në kooperativat bujqësore. Vendosmëria juaj për të përqaftuar me bindje rrugën e kolektivizimit nuk është një datë historike vetëm për ju, po për gjithë Shqipërinë dhe një vërtetim i ri për Partinë se rruga e saj është e drejtë.

Në rrugën e kolektivizimit malësitë e vendit tonë do të bëjnë përparime akoma më të mëdha, pasi tani të bashkuar, fuqia juaj mendore dhe fizike, forca krijuese dhe organizative tuaja, do të bëjnë mrekulli.

Bashkimi bën fuqinë. Kësaj force vendimtare tuaj do t'i shtohet ndihma e Partisë, e Qeverisë dhe e gjithë Shqipërisë fushore me këshilla, me kredi, me eksperiencë, që edhe malësia jonë të lulëzojë si fusha.

Vëllezër malësorë syapatrembur të Kukësit që keni njohur shtypjen dhe skllavërinë e pushtesve dhe të bajraktarëve, që keni luftuar me trimëri për çlirimin e atdheut dhe ndërtimin e socializmit, që i keni dhënë atdheut djemtë dhe vajzat tuaja më të mira, që qëndroni kurdoherë vigjilentë për të ruajtur të paprekur kufijtë, është e natyrshme dhe shembullore që zemrën ju e keni gur dhe e shihni me besim të ardhmen.

Së dyti, dëshiroj t'ju them se mënyra se si i shtruat në kuvendin tuaj këto probleme dhe sa hapur e kthjellët m'i shprehët mua në letër, është tamam popullore, në traditat e guximit të

malësorëve dhe që ne, sipas mësimëve të Partisë, tani i quajmë demokratike dhe revolucionare. Pra, vetëm nga gjiri i popullit burojnë demokracia dhe revolucionarizimi i vërtetë. Prandaj Partia na këshillon të lidhemi vazhdimisht me popullin, të dëgjojmë popullin dhe të realizojmë dëshirat e popullit.

Ju më thoni se hasët edhe pengesa nga disa të paqartë e disa dallaveraxhinj në punën e kolektivizimit të fshatrave tuaja dhe se i kapërcyët këto vështirësi. E kuptoj fare mirë si njëjërën ashtu edhe tjetrën. Edhe lindja e jetës bëhet me mundime, por vullneti mund çdo pengesë, e reja mund të vjetrën. Ju jeni populli, ju jeni Partia, jeni e reja që triumfon.

Ju i shikoni çështjet qartë, njëjloj siç i shikon edhe Partia, se edhe në ndërtimin e së resë, të mëkëmbjes dhe të forcimit të kooperativave që ngritëm rishtas në malësi, do të hasim në pengesa, në vështirësi. Kjo është e drejtë, siç është e sigurt edhe ajo se ne do t'i kapërcejmë me sukses ato, mjaft të kemi besim, vullnet dhe të luftojmë. Këto neve nuk na kanë munguar dhe nuk do të na mungojnë kurrë; përkundrazi, do të na shtohen dhe ne kurdoherë do të fitojmë.

Së treti, më gëzoi shumë kritika e drejtë dhe e hapur që ju u bëni komunistëve të organizatës-bazë të katundit Resk, të cilët në fillim nuk qëndruan drejt përpara këtij problemi të madh, si dhe kritika e drejtë që i bëni kryetarit të këshillit popullor të katundit Lojme, i cili e pengoi punën

dhe dha shëmbullin e keq. Ju lumtë ju malësorëve për këtë punë të mirë që bëtë! Kështu duhet, kështu na mëson Partia, kështu forcohen Partia dhe anëtarët e saj! Njerëzit që gabojnë duhen kritikuar që të ndreqen dhe kritikrat e drejta e të guximshme të popullit njerëzit t'i vënë vëth në vesh dhe jo t'i marrë era, pasi atëherë është keq për ta.

As Partia, as populli, as pushteti ynë popullor nuk mund të pajtohen kurrë me ata njerëz që mendojnë se duke u bërë anëtarë partie, kryetarë kooperative, ose çdo lloj funksionar shteti, u lejohet të bëhen kapadainj, mëndjemëdhën timer dhe të veprojnë sipas kokës së tyre. Ju bëni shumë mirë që i kritikoni njerëz të tillë, pasi të tillë ka, dhe jo vetëm në rrethin tuaj. Prandaj kritika juaj duhet të merret si shëmbull dhe të ndiqet nga të gjithë.

Ka disa njerëz në Parti, në organet e pushtetit dhe në kryesitë e kooperativave bujqësore që e ndiejnë veten përgjegjës për punën dhe sjelljet e tyre vetëm përpara eprorëve të tyre në funksione dhe harrojnë se ata janë më parë përgjegjës për çdo gjë përpara popullit dhe masës së Partisë, pasi edhe eprorët e tyre në funksione, edhe organet e zgjedhura të Partisë dhe të pushtetit, janë përgjegjës, në radhë të parë, përpara popullit, përpara masës së Partisë. Prandaj, që t'ua çrrënjosisim këto pikëpamje të sëmura këtyre njerëzve, duhet t'i vëmë nën kontrollin e popullit dhe të Partisë. Ky është i vetmi shërim i tyre. Nuk

duhet të kënaqemi vetëm nga ajo që një njeri i tillë mund të thotë «e njoha gabimin», atë ne duhet ta kontrollojmë në jetë. Të mos kënaqemi gjithashtu vetëm se ai mund të thotë «jam dakord, do të marr masa». Derisa të marrë masa, populli dhe Partia duhet ta kontrollojnë atë.

Pikëpamjet e dënueshme të disave e kanë burimin në mbeturinat e këqija të së kaluarës dhe në metodën e punës së vjetruar burokratike që Partia po e revolucionarizon. Do të ketë njerëz që çështjen kaq të madhe të revolucionarizimit të njerëzve dhe të punës, me dashje ose pa dashje, do ta frenojnë, pasi revolucionarizimi u qit telashe, u nxjerr bakrin, u ul hundën, u kërkon llogari. Kjo disave nuk u pëlqen, disa të tjerë i tërheq e vjetra. Kush mund t'i shërojë, pra, të gjithë këta nga këto të meta? Natyrisht, vetëm ata që nuk vuajnë nga të tilla të meta, ata që nuk i kanë këmbët të zëna nga këto ferra. Kush janë këta? Populli, masa e Partisë, të gjithë kuadrot e Partisë dhe të pushtetit, që në masën dërrmuese janë besnikë të Partisë dhe të popullit, deri në vdekje.

Së katërti, më gëzuar jashtëzakonisht shumë dhe nuk di si t'juaj shpreh këtë gëzim kur më thonin në letër se «do të luftoni me këmbëngulje kundër zakoneve prapanike dhe nuk do të lejoni që vajzat t'i fejojnë në moshë të vogël dhe jashtë dëshirës së tyre, që të drejtat e grave të merren nëpër këmbë». Një kuptim i tillë i drejtë i këtyre problemeve me kaq rëndësi për të ardhmen e mbarë popullit dhe vendimi juaj burrëror do të

kenë një jehonë të madhe në popull. Zakonet e këqija duhet t'i zhdukim, na mëson Partia. Më falni t'ju flas hapur, ashtu siç më folët edhe ju. Me këtë që do t'ju them, unë s'kam asnjë qëllim të prek besimet tuaja, por ju lutem thellohuni mbi çdo ves dhe zakon të keq dhe do të dilni në atë që burimi i tyre nuk është në ndjenjat e pastra të popullit, por në ato mendime shtypëse e prapanike të feudalëve dhe të fesë, të çfarëdo feje.

Bajraktarët e konsideronin fshatarin rob dhe e shitnin kur të donin. Zaten këtej kishte hyrë kjo fjalë e ndyrë edhe në fjalorin e njeriut të varfër. Kur e pyesnin ndonjërin «sa veta je në shtëpi», ai përgjigjej «6 rob»; ose kur thuhej: «rob të kujt ishin këta?» «Robnit e bajraktarit dhe të fesë».

Feja i qepej njeriut pas trupit dhe pas mendjes që kur lindte e derisa vdiste, s'e linte të qetë dhe ia thurte gëzimet e hidhërimet, punën dhe mendimin e tij me një mijë e një ndodhira të imagjinuara, të kurdisura apostafat për ta shtypur njeriun, për ta frikësuar atë me një fuqi imagjinare, që në atë kohë në realitet nuk ishte veç kamxhiku dhe plumbi i beut dhe i bajraktarit. Feja është e huaj për njerëzit. «Feja e shqiptarit, — ka thënë një poet yni, — është shqiptaria». Sa mirë e ka thënë ai dhe sa drejt e keni kuptuar ju këtë! Si mund të lejojmë ne që të vuajnë nënat dhe bijat tona nga këto të këqija të së kaluarës? Me vendimin tuaj revolu-

cionar të malësorëve i thoni gjithë popullit tonë:  
«Shihni, ne pleq jemi, por nga zemra, nga ndjenjat jemi të rinj, jemi në rrugën e Partisë, kurdoherë dhe për çdo gjë».

Kaq desha t'ju thosha, vëllezër të mi të dashur, dhe ju uroj shëndet e suksese në përparimin e kooperativave tuaja.

Ju përqafoj

Juaji

*Enver Hoxha*

«Zëri i popullit», nr. 39 (5764),  
15 shkurt 1967

**LETËR DREJTUAR POPULLIT  
TË KATUNDIT SHËMRI TË RRETHIT  
TË TIRANËS<sup>1</sup>**

**8 mars 1967**

I dashur popull i katundit Shëmri të rrethit të Tiranës,

Më gëzuan jashtëzakonisht shumë vendimet tuaja prej trimash dhe trimneshash, vendime historike që dëshmojnë pjekurinë, ngritjen politike dhe patriotizmin tuaj të madh. Ashtu si ujët e burimeve tuaja të kulluara që mbajnë gjallë jetën e banorëve të kryeqytetit, edhe këto mendime dhe vendime përparimtare tuajat, të frymëzuara nga Partia jonë e lavdishme, do të prekin ndje-

---

1. Në letrën drejtuar shokut Enver Hoxha populli i katundit të Shëmrisë premtan se do të zhdukë zakonet e këqija që rëndonin në kurriz të grave dhe vajzave, si ngarkesa e tyre, fejesat dhe martesat që në mituri, pajat e mëdha, shpenzimet e tepërta në dasma etj.

njat më të pastra të popullit, do të vënë në lëvizje atë forcë të madhe shpirtërore për të zhdukur nga jeta jonë çdo gjë të keqe.

Sa detyra të mëdha dhe të shenjta kemi ne burrat ndaj nënave, grave, motrave dhe vajzave tona! Sa detyrime kemi ne ndaj tyre! Mirënjohja, dashuria dhe respekti për to duhet të jenë të pafund, pse e rëndë ka qenë në të kaluarën situata për to.

Askush nuk mund të thotë se jam i lirë, kur nuk lufton për çlirimin e të tjerëve dhe në radhë të parë të gruas shqiptare. Mos harroni këshillat e Partisë, vëllezër dhe motra, se pa çlirimin e plotë të gruas, pa barazinë e plotë të gruas me burrin, pa unitetin, pa dashurinë e kthjellët dhe respektin në mes tyre, nuk mund të ketë Shqipëri plotësisht të lirë, nuk mund të ndërtohet socializmi dhe jeta e lumtur për popullin me atë shpejtësi dhe me atë hov që kërkon Partia.

Unë ju njoh juve nga afër, motra dhe vëllezër, pse kam qenë në fshatrat tuaja, në kasollet tuaja, në ditët më të vështira të Luftës Nacionalçlirimtare. As burrat, as gratë nuk e njihnin frikën, në zemrat tuaja unë shihja të pasqyrohej ngrohtësia dhe trimëria e malësorëve tanë që u bëjnë ballë stuhive të kohëve dhe fitojnë. Partia dhe populli fituan dhe sot që po ju shkruaj këto fjalë është 8 Marsi, festa e grave, nga zemra e me gjithë shpirt ju uroj juve motrave të Shëmrisë dhe gjithë grave të Shqipërisë

jetë të lumtur, të gëzuar. Partia ju thotë juve  
grave të Shqipërisë çani me heroizëm përpara  
që të lulëzojë akoma më mirë Shqipëria socia-  
liste!

Shumë të fala

Enver Hoxha

«Zëri i popullit», nr. 58 (5783),  
9 mars 1967

## LETËR DREJTUAR SHOKUT RIZA HASIMAJ<sup>1</sup>

*Tepelenë*

26 korrik 1967

I dashur xha Riza,

U preka thellë nga ndjenjat e pastra, burrërore, patriotike e revolucionare që më shprehnit në letrën që më dërguat para disa ditësh, të cilat tregojnë figurën e lartë të familjeve dhe të prindërve shqiptarë, që, ashtu siç u ka hije, kurdoherë e mbi të gjitha, edhe në çastet më të vështira, vënë interesat e lartë të çështjes së madhe të lirisë e pavarësisë së atdheut, të socializmit, të mirën e gjithë popullit.

Partia dhe familja juaj kanë të drejtë të krenohen me aktin e lartë heroik të djalit tuaj, të bi-

---

1. Djali i tij Qazim Hasimaj ra në krye të detyrës. Me vendim të Presidiumit të Kuvendit Popullor atij iu dha titulli i lartë «Hero i Punës Socialiste». Në letrën e tij, plaku 83-vjeçar Riza Hasimaj shpreh mirënjohjen e thellë ndaj Partisë për këtë nder të madh që iu bë të birit.

rit të Partisë, dhe tuajit, Qazimit, i cili, i rritur dhe i edukuar me vetitë më të larta të komunistit, me besnikërinë e pakufishme ndaj popullit e socializmit, diti të mbajë të pastër e me nder, gjer në çastet e fundit të jetës së tij, taserën e kuqe të Partisë, duke mos kursyer asnjëherë as mundin, as djersën e, më në fund, edhe jetën e tij për zbatimin e vijës së Partisë, për zhvillimin e ekonomisë dhe forcimin e pushtetit tonë popullor. I frymëzuar nga vija e drejtë e Partisë, nga vendimet historike të Kongresit të saj të 5-të, në këtë hov të madh revolucionar që ka shpërthyer si vullkan në të katër anët e vendit, me aktin e tij të lartë, Qazimi dha një shembull të shkëlqyer, një mësim të madh për të gjithë komunistët dhe punonjësit e vendit tonë.

Nënat e baballarët e Shqipërisë janë e do të jenë kryelartë për bijtë e bijat që kanë rritur e do të rritin, që ecin me vendosmëri e gjer në fund në rrugën që u tregon Partia. Së bashku me qumështin e nënës, prindët shqiptarë atyre u futin thellë në shpirt dashurinë e pakufishme për popullin dhe atdheun, për të qenë besnikë deri në fund ndaj çështjes së Partisë e të revolucionit socialist, siç ishte Qazimi, i mësojnë djemtë dhe vajzat të jenë kurdoherë të guximshëm e kurrë të mos ulin kokën e as të tremben para armikut dhe para çdo rreziku, i edukojnë me virtytet më të mira të trashëguara nga të parët tanë, virtyte që Partia po i kalit në një shkallë gjithnjë më të lartë.

Ju uroj, i dashuri xha Riza, shëndet të mirë, të na rroni akoma për të mirën e familjes suaj të nderuar, që të gëzoni edhe paskëtaj për punët e mëdha që po bëhen çdo ditë e më shumë në Shqipëri nën udhëheqjen e Partisë së lavdishme të Punës në rrugën e lirisë dhe të pavarësisë së atdheut tonë të shtrenjtë, në rrugën e ndritur të socializmit, për të cilin djali juaj nuk kurseu as jetën e tij.

Juaji-

*Enver Hoxha*

«Zëri i popullit», nr. 181 (5906),  
29 korrik 1967

**LETËR DREJTUAR PRINDËRVE TË 108  
ÇIKAVE TË BRIGADËS VULLNETARE  
«GJELOSH RAMA» LEKBIBAJ**

*Tropojë*

**12 gusht 1967**

Të dashur prindër të 108 çikave të brigadës  
vullnetare «Gjelosh Rama»!

Pritja aq e ngrohtë dhe e gëzueshme që ju  
u bëtë 108 çikave tuaja anëtare të brigadës vull-  
netare «Gjelosh Rama» që u kthyen fitimtare nga  
fronti i ndërtimit të hekurudhës Rrogozhinë—Fi-  
er, është një gjest që gëzon pa masë Partinë, po-  
pullin, gjithë Shqipërinë, një gjest që më ka  
gëzuar dhe prekur thellë.

Duke e shndërruar në ditë feste ditën e kthi-  
mit të çikave nga aksioni i madh i rinisë sonë të  
lavdishme, ju nderuat dhe gëzuat çikat tuaja, nde-  
ruat krahinën dhe veten tuaj. Përkrahja që ju

u dhatë vajzave tuaja që me guxim flakën zakonet e vjetra dhe përçafuan zakonet e reja, përparimtare, është një inkurajim i madh, që vërteton se mësimet dhe vija e Partisë për çlirimin e plotë të grave dhe vajzave tona janë të drejta dhe aprovohen nga populli.

Bijat tuaja, me punën e palodhur e heroike që bënë në hekurudhë, me sjelljet e tyre shembullore, me respektin e madh që treguan ndaj prindërve, e meritonin plotësisht pritjen që ju u bëtë. Akoma më shumë ato do t'i duan e do t'i nderojnë prindët e tyre, si në familje ashtu edhe në shoqëri, pasi kështu i edukojnë ato Partia dhe organizata e rinisë.

Fjalët tuaja se u bashkuat njëzëri me vendimin e çikave për të qenë gjithmonë vullnetarë të brigadës «Gjelosh Rama», janë një inkurajim i madh për vajzat e djemtë tuaj, për gjithë rininë tonë. Ato janë betimi i malësorëve tanë trima, që dorë për dorë me fëmijët e tyre, me devotshmëri e besnikëri të patundur, do të shkojnë përpara, nën flamurin e Partisë, duke kapërcyer çdo pengesë, duke bërë çdo sakrificë për ta çuar deri në triumfin e plotë kauzën e revolucionit tonë proletar, socialist.

Edhe një herë, të dashur prindër të vullnetarëve të brigadës «Gjelosh Rama», ju përshëndes nga zemra dhe shpreh bindjen e plotë se ju dhe gjithë malësorët trima të Tropojës, trashëgimtarë të traditave patriotike e revolucionare të patriotit tonë të madh Bajram Curri, do të

vini të gjitha forcat për lulëzimin e mëtejshëm të atdheut tonë socialist dhe, krahas kazmës dhe pushkës, do të dini me guximin dhe me urtësinë që ju karakterizon, të luftoni për të zbatuar më së miri edhe direktivat e Partisë për emancipimin e gruas e të vajzës shqiptare.

Ju çoj të fala si prind çikave tuaja trime e përparimtare.

Me respekt

Juaji

Enver Hoxha

«Zëri i popullit», nr. 194 (5919),

13 gusht 1967

## **LETËR DREJTUAR SHOKUT PAL VATA**

**9 nëntor 1967**

I dashur shoku Pal,

Në këto ditë të mëdha hovi revolucionar që po kalon vendi ynë për ndërtimin e jetës së re socialiste, vargut të madh të mijëra dëshmorëve të lavdishëm të luftës dhe të punës iu shtua edhe emri i bijës suaj Shkurta, malësore revolucionare, anëtares së organizatës së BRPSH, bijës së paharruar të popullit shqiptar.

Megjithëse e vogël nga mosha, pse të pesëmbëdhjetat sapo i kishte mbushur, por tepër e madhe, e pjekur, e zgjuar dhe e vendosur nga vepra, si bijë e denjë e një familjeje patriotike, bijë e popullit të malësive tona kreshnike që kanë qëndruar kryelarta e të papërkulura kundër çdo armiku e rrebeshi, me aktin e saj heroik e trimëror Shkurta dha një shembull të lartë patriotizmi,

trimërie e dashurie të pakufishme për atdheun, për Partinë dhe popullin e vet. Akti i saj do të frymëzojë rininë heroike dhe gjithë punonjësit e vendit tonë se si duhet të punohet e të luftohet për socializëm, si duhet të mposhten pa u përkulur çdo vështirësi e pengesë, zakonet prapanike, feja e kanunet poshtëruese ndaj femrës shqiptare, prandaj kujtimi i saj do të mbetet i paharruar e do të nderohet kurdoherë me respektin më të madh nga të gjithë.

Ju më njoftuat në letër, i nderuari shoku Pal, se çikën nuk e qatë, pse ashtu siç i ka hije shqiptarit, trimëreshat nuk qahen dhe së bashku me mbesën, vendosët dhe shkuaat në hekurudhë në vend të saj për ta zëvendësuar. Ky është një tjetër shembull patriotizmi të lartë socialist që jepni ju, një akt tjetër i madh atdhedashurie e besnikërie ndaj Partisë, popullit dhe atdheut, është një përtëritje në një shkallë më të lartë e traditës patriotike të familjes suaj, gjyshit, axhës e babës suaj që derdhën gjakun duke luftuar kundër pushtuesve turq, malazez e regjimit satrap të Zogut. Duke mposhtur dhimbjen e thellë që ju shkaktoi humbja e vajzës së dashur, Shkurtës, në pranverën e jetës së saj, ju vutë mbi të gjitha interesin e përgjithshëm mbi atë të familjes dhe, megjithëse i shkuar në moshë, u drejtuat në hekurudhë që ajo të ndërtohet në kohën e duhur për të mirën e gjithë popullit, për lulëzimin e forcimin e atdheut.

Partia krenohet me bija dhe bij të tillë të

dalë nga gjiri i popullit tonë, i malësorëve trima e të papërkulur që me burrërinë, mençurinë, besnikërinë e frymën e lartë të sakrificës dhe me heroizëm në luftë e në punë, pa u thyer përpara asnjë vështirësie zbatojnë në jetë me një vendosmëri të admirueshme mësimet dritëdhënëse të Partisë në zhvillimin më lart të traditave të lavdishme të të parëve tanë.

Populli ynë nuk do t'i harrojë kurrë dhe rapsojë gojartë e poetët tanë të talentuar do t'u këndojnë brez pas brezi dhe do të përjetësojnë në shekuj emrat e bijave dhe bijve të këtij trualli që nuk kursejnë as gjënë më të shtrenjtë për lirinë e pavarësinë e atdheut, për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit.

Ju uroj shëndet e punë të mbarë në hekurudhë e në fshatin tuaj malor dhe familjes suaj patriotike gjithë të mirat. Zemra juaj bujare paskëtaj qoftë kurdoherë e gëzuar dhe e lumtur në atdheun tonë të lirë socialist, për të cilin bija juaj Shkurta dha gjënë më të shtrenjtë, jetën e saj të re.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 37, f. 24*

## **LETËR DREJTUAR SHOKUT FUAT ÇELA**

**15 nëntor 1967**

**Fort i dashur Fuat Çela,**

Çdo mëngjes e filloj punën duke lexuar në radhë të parë letrat që më drejton populli, i cili i hap zemrën Partisë së tij të shtrenjtë. Te populli ne gjejmë pjekurinë, heroizmin, entuziazmin, mësimet, këshillat e urta që ai na jep, perspektivat që na çel me një kthjelltësi të mahnitshme. Populli na tërheq vëmendjen për çdo gjë, na korrigjon ne kur gabojmë, na tregon rrugët dhe shtigjet nga duhet të ecim, na jep zgjidhjet e drejta edhe për problemet më të koklavitura. Te populli e ka forcën e saj kolosale Partia.

Sot, mbi tryezën time të punës, në mes letrave të tjera gjeta dhe letrën tënde të dashur, i dashuri shok i rinisë Fuat. Ajo më frymëzoi jashtëzakonisht dhe pse të ta fsheh, ajo më emocionoi gjithashtu shumë.

Sot gjithë mëngjesin e tash që po të shkruaj letrën, po rroj me ty afër, me mendje, me zemër, me shpirt, po të ndjek nga larg në punët e tua, në Vërzhezhën tënde ku ke lindur e ku unë kam luftuar kur kam qenë partizan.

Skrapari i trimave do të lindë kurdoherë trima dhe trimëresha, por ti je trim mbi trimat, se je trim pa sy.

Për popullin shqiptar Partia e ka bërë natën ditë dhe ti, bir i popullit, i rinisë dhe i Partisë, me vullnetin e hekurt që të ka ngulur në gji Partia, po e kthen natën e përjetshme që të ka shkaktuar verbëria, në një ditë të shkëlqyeshme, me një diell që s'do të shuhet kurrë dhe që është dielli i Partisë.

Ti, shoku ynë i shtrenjtë Fuat, pa sy ndien, mendon, lufton, shikon me ndjenjat, me mendjen, me stilin luftarak dhe me syrin shqiponjë të Partisë sonë. Edhe pse pa sy, ti je një ushtar i pararojës, je një flamur për të gjithë.

Unë kam një dëshirë të madhe që letrën tënde ta lexojë i madh e i vogël në Shqipërinë tonë, edhe jashtë kufijve të atdheut, po të ketë mundësi.

Puna jote bëhet një çështje e ndërgjegjes për të gjithë. I madh e i vogël në vendin tonë do t'i vërë pyetjen vetes: Kur i verbër Fuat Çela, me vullnetin e tij të çeliktë, zbaton në mënyrë të mrekullueshme vijën e Partisë dhe korr rezultate të mahnitshme, atëherë ç'duhet të bëj unë që i kam sytë në vend?

I dashur Fuat,  
Unë jam i bindur se kur më shkrove, ti as nuk mendove ç'gjëra të çuditshme do të shkaktonte letra jote, ç'forca do të ngjallë ajo në popull, në rini, në Parti, ç'zjarr do të ndezësh ti nga Skrapari në zemrat e njerëzve, ç'entuziazëm, ç'patriotizëm do t'u shtohet entuziazmit, patriotizmit dhe shpirtit revolucionar të njerëzve tanë të mrekullueshëm që edukon e kalit Partia jonë. Partia dhe populli të falënderojnë, shoku Fuat Çela. Ec kurdoherë përpara me vullnetin e Partisë, me mendjen e kthjellët të Partisë me sytë e ndritshëm të Partisë.

Të përqafoj me mall dhe të uroj shëndet.

Yti

Enver

«Zëri i popullit», nr. 278 (6003),  
19 nëntor 1967

## **LETËR DREJTUAR FAMILJES SË PJETËR LLESHIT<sup>1</sup>**

**20 nëntor 1967**

Të dashurit e mi, nana e Pjetrit Xhelë, shoqja Lizë e Pjetër Lleshit, të dashur fëmijë të Lizës e të Pjetrit, Mrikë, Zef, Mark, Pashkë dhe Llesh.

Po vij me këtë letër në Domgjon të Fanit, në shtëpinë tuaj, në votrën e zjarrit, ku sonte jeni grumbulluar, t'ju puth e t'ju përqafoj, ashtu sikundër vinte pas pune, Pjetri juaj, Pjetri ynë.

Fort më ka gëzu letra jote Lizë, ku më shkruaje për nënën e Pjetrit dhe për fëmijët që janë të gjithë mirë nga shëndeti. U gëzova shumë për Mrikën që vazhdon 8-vjeçaren në konviktin e Krumës. Mos u ba merak se Mrikën dhe të

---

1. Pjetër Llesh Doda ra në krye të detyrës më 30.12.1966, duke punuar për mirëmbajtjen e linjës telefonike Kukës-Fan.

gjithë vocërrakët e tjerë, nëna jonë Parti do t'i rritë si jo ma mirë, do t'i mësojë, do t'i edukojë, do t'i bëjë trima dhe trimnesha si babën dhe mëmën e tyre.

Fal me shëndet, o nana e Pjetrit, që linde dhe rrite këtë djalë dragua. Dy fjalë desha me të thanë: Lizën e Pjetrit e ke një burrneshë që punon e lufton në kooperativë për me i rrit fëmijët si duhet, për me zbukuru jetën e kooperativës. Ju jeni shumë në familje dhe kam frikë se ditët e punës të Lizës dhe pensioni i Pjetrit mund të mos jenë aq të mjaftueshëm. Po të rronte Pjetri, për ndonjë nevojë ti do t'i drejtoheshe atij, por Pjetri rron në Partinë tonë të madhe, prandaj ti mos mungo me iu drejtu Partisë, me më shkru mu drejtpërdrejt për ndonjë nevojë, sikur me i shkru Pjetrit. Po ta bëj ty këtë lutje, o nanë, pse e di që po t'ia shkruaj Lizës, ajo si komuniste nuk do të na shkruajë.

Çështja është sa të rriten fëmijët, sa të mbarojnë shkollën Mrika dhe të tjerët dhe të fitojnë jetën me djersën e ballit.

Qofshi të lumtur dhe të gëzuar të gjithë në atdheun tonë socialist që udhëheq Partia.

Shoqja ime Nexhmija ruan edhe ajo si unë një kujtim të paharruar për ty, shoqja Lizë, që kur u njohëm në Kongresin e 6-të të Gruas dhe fëmijët tanë Ilir, Sokol dhe Pranverë ju përqafojnë me mall. Iliri mëson për inxhinier mekanik, Sokoli është në klasën e 10-të dhe Pranvera në klasën e 8-të. Pranvera sivjet do të hyjë në rini,

ajo merr pjesë gjallërisht, sidomos në stërvitjet ushtarake.

Do të gëzohem shumë që herë pas here të më kujtoni me ndonjë letër. Ju uroj gëzuar festat e 28 dhe 29 Nëntorit.

Ju përqafoj të gjithë me radhë

Juaji

*Enver*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## LETËR DREJTUAR TATJANA REKËS

Durrës

22 nëntor 1967

E dashura Tatjana,

Më gëzove shumë me letrën që më dërgove plot me ndjenja të pastra rinore e revolucionare për mëmën Parti. Të falënderoj shumë për letrën, njëkohësisht të uroj nga zemra që u pranove në organizatën e rinisë.

Ti Tatjana, bija e komunistit hero, shokut tonë të paharruar Adem Reka, do të jesh kurdoherë bijë e Partisë, bijë e nderuar e popullit shqiptar. Fjalët e tua aq të ngrohta dhe të dashura që më shkrove, më prekën së tepërmi.

Optimizmi me të cilin e shikon ti Tatjana të ardhmen, më gëzon shumë. Atë unë e ndjeva në letrën tënde, në ndjenjat e tua të pastra dhe në dashurinë e madhe për Partinë, mëmën tonë të

madhe. Urimet më të mira të dërgoj që të mësosh e të punosh si babai, të jesh kurdoherë luftarake në mbrojtje të vijës së Partisë, ashtu si të mëson organizata e rinisë dhe Partia jote. Mbaje lart taserën e rinisë, që nesër të meritosh edhe taserën e kuqe të Partisë, atë taser që babai yt e skuqi edhe më shumë me gjakun e tij të pastër. Shebull të jesh kudo, pse kështu do të nderosh akoma më tepër organizatën tënde, Partinë dhe emrin e babait.

Mëmës tënde të nderuar, shoqes Ismete, motrës Shpresë, Skënderit dhe vogëlushit Shpëtim u dërgoj të falat më të përzemërta dhe u uroj shëndet e gjithë të mirat. Para disa ditësh, si të gjithë komunistët dhe populli ynë, edhe unë kujtova me respekt përvjetorin e parë të rënies në krye të detyrës të Ademit<sup>1</sup>, babait tuaj dhe shokut tonë të dashur. Po ju them se me zemër dhe me mendje isha dhe jam kurdoherë pranë jush.

Ju, kurrë mos u druani të më shkruani për çdo gjë, Partia është e do të jetë kurdoherë afër jush, do të kujdeset e do t'ju ndihmojë që ti, Shpresa, Skënderi dhe Shpëtimi të rriteni, të mësoni e të bëheni të zotë që të punoni pa u lodhur për socializmin, për të mirën dhe lumturinë e popullit dhe të atdheut dhe me përpjekje e punë të palodhur ta gëzoni jetën e bukur në Shqipërinë tonë të re.

---

1. Adem Reka ra në krye të detyrës më 17 nëntor 1966

Edhe një herë të gjithëve në familje ju uroj  
shëndet, punë të mbarë dhe suksese në mësim  
edhe në aktivitetet e organizatave ku bëni pjesë  
ti, Shpresa, Skënderi e Shpëtimi.

Të përqafoj me dashuri

*Enver*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR TË RINJVE DHE TË REJAVE DROPULLITE TË KATUNDIT BULARAT**

**22 nëntor 1967**

Të dashur të rinj dhe të reja dropullitë të katundit Bularat,

Ju më gëzuar shumë me letrën që më dërguat, pse ajo është plot zjarr revolucionar, plot dashuri dhe besnikëri të pafund për Partinë dhe atdheun tonë të shtrenjtë. Ju jeni vajzat dhe bijtë e atij populli heroik, të thjeshtë e punëtor të Dropullit, që ka vuajtur shumë në të kaluarën, si i gjithë populli shqiptar, por që tash rron i lirë, i lumtur, në unitet të çeliktë me të gjithë popullin shqiptar.

Dropulli tash lulëzon dhe çdo vit do të lulëzojë akoma më shumë. Ju keni ndërtuar shtëpi të reja, tash keni ujë të pijshëm, vatra e shtëpi

kulture, kudo keni shkolla në gjuhën e nënës dhe në gjuhën shqipe, rrugët tuaja u asfaltuan, fare shpejt do të elektrifikohet i gjithë Dropulli, kurse fusha juaj pjellore po bonifikohet dhe po punohet me vrull për ujitjen e saj etj., etj.

E gjithë kjo është vepra e Partisë, vepra juaj, vepra e gjithë popullit tonë.

Sa gëzon Partia dhe populli shqiptar që rinia dropulite është hedhur në sulm për të korrur fitore të reja në çdo lëmë: në ekonomi, në kulturë, në fuqizimin e mbrojtjes së atdheut që na i kanë zili armiqtë, imperialistët amerikanë, revisionistët sovjetikë dhe të tjerë reaksionarë. Por armiqtë le të lehin, një popull si yni, një Parti si kjo jona, nuk mund të mposhten kurrë.

Baballarë, motra e vëllezër tuaj ranë heroikisht në Luftën Nacionalçlirimtare, ndërsa sot ju dhe i gjithë populli, me flamurin e Partisë shpallorur, po e cni kurdoherë përpara në gjurmët e heronjve dhe të heroinave.

Është entuziazmuese dhe frymëzuese për ne heroizmi i Shkurtës dhe vullneti i hekurt i Fuat Çelës. Kur i shkrova shokut të verbër Fuat Çela, unë mendova shumë edhe për shokun tonë komunist Ilija Gazhgen, të cilin e njoh personalisht, kam biseduar me të dhe e di që ai është një komunist heroik i verbër, shumë aktiv dhe i gjallë në mbledhjet e Partisë dhe në çdo mbledhje, ai u mëson fëmijëve në shkolla violinën etj. E përqafoji me mall nga unë Ilian, duke i uruar nga

zemra atij dhe të gjithë juve suksese dhe kurdoherë fitore.

Ju përqafoj ju, prindërit, motrat dhe vëllezërit tuaj të të gjithë Dropullit dhe ju uroj t'i kaloni të gëzuar festat e 28 dhe 29 Nëntorit.

Juaji

*Enver Hoxha*

«Dy popuj miq», f. 128

## **LETËR DREJTUAR VETERANËVE TË LUFTËS DHE TË PUNËS TË RRETHIT TË VLORËS**

**3 janar 1968**

Të dashur shokë veteranë të luftës dhe të punës të rrethit të Vlorës,

Me gëzim të madh këndova letrën tuaj aq të zjarhtë e revolucionare të përshkuar nga një ndjenjë e thellë atdhedashurie.

Ju, të dashur shokë dhe vëllezër, jeni nga ata që keni jetuar të kaluarën e hidhur, vuajtjet e mjerimet e papërshkruara të popullit tonë në regjimet antipopullore. Me armë në dorë ju keni qenë në radhët e para të luftëtarëve për shpalljen e pavarësisë, për mbrojtjen e tërësisë tokësore të atdheut nga imperialistët e huaj dhe ia bëtë fora më 1920 duke hedhur në det ushtritë pushtuese të imperializmit italian, e më vonë u përleshët me shtypësit e regjimit satrap të Ahmet Zogut.

Populli heroik i Vlorës, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste Shqiptare, shkroi një nga faqet më të lavdishme në historinë e re të Shqipërisë, në përpjekjet e mëdha për liri e pavarësi

kombëtare gjatë Luftës legjendare Nacionalçlirimtare, në të cilën shumë nga ju, të dashur veteranë, dhatë kontributin tuaj për çka populli, rinia, brezat e ardhshëm, Partia dhe atdheu do t'ju jenë kurdoherë mirënjohës.

I ruani dhe i zhvilloni më tej këto tradita të shkëlqyera të trashëguara brez pas brezi dhe sot, të brumosura me idealet e larta të Partisë, futjani ato në gjak e në zemër rinisë sonë heroike që, ashtu si gjatë luftërave shekullore, edhe sot, gjatë ndërtimit të socializmit, ajo, së bashku me gjithë popullin e rrethit tuaj, të shquhet dhe Vlora e Ismail Qemalit, e Selam Musait dhe e qindra dëshmorëve të Luftës Nacionalçlirimtare, krahas me të gjitha rrethet e vendit tonë, me flamurin e Partisë gjithnjë përpara, të lulëzojë siç na e do zemra.

Mua më gëzuan pa masë optimizmi juaj revolucionar, vendosmëria dhe vullneti me të cilin ju, edhe pse të kaluar nga mosha, punoni e luftoni krah për krah gjithë punonjësve për përpërimin dhe begatinë e atdheut. Partia dhe Komiteti Qendror ju përgëzojnë për gjithçka po bëni për shembullin tuaj të lartë dhe frymëzues.

Ju, të dashur shokë e miq, që keni një stazh të gjatë pune e përvoje në sektorët më të ndryshëm të punës së Partisë, të pushtetit, të ushtrisë, të ekonomisë, të arsimit, të kulturës e të shkencës, mbani lidhje sa më të ngushta me sektorët ku keni punuar ose ku e ndieni se mund të kontribuoni, thoni kudo fjalën dhe këshillat tuaja,

duke e ndier veten gjithnjë pjesëtarë të kolektivave e sektorëve ku keni punuar; ndihmoni me të gjitha forcat dhe mënyrat për t'ua kaluar përvojën tuaj të vlefshme punonjësve e kuadrove të rinj, bëhuni përkrahësit e së resë, ndihmoni që vrulli revolucionar i masave të rritet çdo ditë e më tepër. Duke qenë midis masave, dëgjoni me kujdes zërin e tyre, luftoni për propagandimin e vijës së Partisë, i sqaroni masat për problemet politike, ideologjike, ekonomike, ushtarake, kulturore të kohës, qëndroni si kurdoherë, aktivistë shoqërorë të dalluar.

Unë kam bindjen se puna e palodhur dhe shembulli juaj do të frymëzojnë të gjithë veteranët, gjithë pensionistët e vendit tonë, të cilët, të kalitur në kudhrën e Partisë e me përvojën e tyre të pasur, do të japin kontributin e çmuar në çdo fushë veprimtarie. Ndihma dhe këshillat tuaja do të luajnë një rol me rëndësi në zhvillimin e ekonomisë, në përparimin e jetës së fshatit, për zhdukjen e plotë të zakoneve të vjetra reaksionare e patriarkale, për emancipimin e gjithanshëm të gruas etj. Ju mund të ndihmoni duke shfrytëzuar arkivat dhe dokumentet e qendrave të punës apo të institucioneve ku keni punuar, për të bërë studime apo përgjithësime të përvojës së pasur, gjë që është shumë e dobishme për sot dhe për të ardhmen e vendit tonë.

Partia ka besim të madh te ju dhe tek të gjithë veteranët e pensionistët në të katër anët e vendit se do të tregoni, si edhe gjer tani, shpirtin

tuaj të lartë luftarak, zjarrin e madh revolucionar që gufon pa pushim në zemrat tuaja. Çdo qytetar patriot, pavarësisht nga mosha, kurdoherë me aq sa mundet dhe ku mundet, duhet t'i shërbejë atdheut tonë socialist dhe popullit tonë punëtor.

Punë të mëdha na presin, të dashur shokë dhe miq! Populli ynë po marshon çdo ditë e më shumë me ritme të papara në rrugën ku e udhëheq Partia. Krijimtaria e tij zhvillohet me hapa të shpejtë në të gjitha fushat e jetës, revolucioni ynë socialist po thellohet në çdo drejtim. Prandaj të gjithëve, pleq e të rinj, gra e burra, na duhet të punojmë akoma më shumë, me energji e forca të reja, me stil e metoda revolucionare, për ta bërë atdheun tonë gjithnjë më të fortë, më të bukur e më të pasur, për lumturinë e popullit tonë, për gëzimin e miqve dhe që asnjë armik të mos ketë ç'të na bëjë kurrë.

Ju uroj nga zemra, të dashurit e mi, shëndet e pleqëri të mbarë, lumturi në familje dhe suksese të detyrave aq fisnike që keni marrë përsipër! Ju uroj gjithashtu që Viti i Ri 1968 të jetë vit fitoresh akoma më të mëdha për ju, për popullin heroik të Vlorës dhe të të gjithë Shqipërisë!

Juaji

Enver Hoxha

«Zëri i popullit», nr. 3 (6402),  
4 janar 1968

## **LETËR DREJTUAR MAKBULE DHE BESIM REXHËS**

*Bulgazë*

**19 mars 1968**

Të dashur Makbule dhe Besim Rexha,

E këndova me gëzim letrën me të cilën më njoftonit lindjen e vajzës suaj. Lindja e çdo fëmije është një ngjarje shumë e gëzueshme, por gëzimi me këtë rast ishte akoma më i madh jo vetëm për ju, po për gjithë vendin tonë, pse ardhja në jetë e qytetares së re, Dritës së vogël, solli diçka të veçantë te ne, me atë Republika jonë Popullore mbushi dy milionë banorë. Prandaj sihariqi që u dha edhe me shtyp, u prit me gëzim të papërshkruar nga i gjithë populli shqiptar, që sheh se si në sajë të vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë, me rritjen e mirëqenies së pandërpreurë të të gjitha masave punonjëse, brenda më pak

se një çerek shekulli, popullsia jonë gati u dyfishua.

Me këtë rast të gëzueshëm, vogëlushes suaj, qytetares së dymiliontë të atdheut tonë të bukur socialist, i uroj jetë të gjatë e shëndet që të bëhet ashtu si do Partia, patriote e zjarrtë dhe ndërtuese e denjë e vendit tonë, pasardhëse e merituar e brezit luftarak revolucionar që, nën udhëheqjen e Partisë sonë të lavdishme të Punës, në luftë me çdo armik dhe duke kapërcyer me një vendosmëri shembullore çdo pengesë e vështirësi, po e bën Shqipërinë një vend të fortë, të lulëzuar e të begatshëm dhe popullin e vet nga dita në ditë më të lumtur.

Përgëzime dhe përqafime

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR PRINDËRVE TË ISMET BRUÇAJT**

**7 dhjetor 1968**

Të dashur prindër të nderuar të dëshmorit  
Ismet Bruçaj!

Letra që më dërguat më ka prekur thellë dhe në të njëjtën kohë më mbushi me krenari të re për popullin tonë patriot e revolucionar, që, si gurrë e pashtershme, nxjerr nga gjiri i tij bij të tillë të denjë si Ismeti, për nënat e baballarët si ju, që edhe çastet e dhimbjes më të fortë, kur ajo është e lidhur me interesat e atdheut, dinë t'i kapërcejnë e t'i kthejnë në burim force dhe optimizmi revolucionar. Ju humbët birin tuaj që e kishit si dritën e syve, fëmijët e Likajt, në mes bjeshkëve — mësuesin e tyre të shtrenjtë, nxënësit e shkollës pedagogjike «Shejnaze Juka» — kolegun e tyre të dashur, reparti ku do të shkonte ushtar — luftëtarin e ri, organizata e rinisë humbi një militant të saj. Populli humbi një re-

volucionar të vërtetë. Megjithatë ne nuk ligështohemi, pasi ai që bie në krye të detyrës për atdheun e socializmin rron e do të rrojë përgjithmonë në zemrën e popullit, ai rreshtohet përkrah gjithë dëshmorëve, si flamur i ri në rrjedhën e fuqishme të revolucionit tonë ngadhënjimtar.

Ismeti, ky bir i denjë i Shqipërisë dhe i Kosovës, ishte i ri. Po ai me tërë jetën e tij të shkurtër dhe aktin e sakrificës supreme tregoi se që pajisur me traditat patriotike të prindërve, gjyshërve e stërgjyshërve, se pati thithur e bërë pjesë organike, ashtu si dikur qumështin e nënës, normat e moralit komunist, mësimet dritëdhënëse e të pavdekshme të Partisë sonë të lavdishme të Punës. Janë këto që e bënë Ismetin ta shihte lumturinë dhe kuptimin e jetës së tij në pjesëmarrjen aktive në të gjitha fushat e revolucionit: që nga aktiviteti i gjerë në organizatën e BRPSH, në këtë ndihmëse besnike dhe rezervë luftarake të Partisë, deri në bankat e shkollës ku ishte shembullor, në hekurudhën Rrogozhinë—Fier ku doli katër herë sulmues, midis bjeshkëve të Veriut si komisar i dritës. Janë urdhrat e ndërjegjes së tij revolucionare që e nxitën të lërë qytetin, festat në gjirin e familjes, shokët e tij, për t'i bërë këmbët me baltë, për t'iu ngjitur shkrepave të thepisur, për të çarë përmes tufanit pa marrë parasysh edhe vdekjen, vetëm e vetëm që të gjendej pranë nxënësve, të vazhdonte me ta mësimin, t'i ushqente me idetë e Partisë, t'i kremtonte festat midis malësorëve trima dhe pa-

triotë që i janë përveshur punës për lulëzimin dhe begatinë e maleve tona legjendare.

Ja pse Ismeti, ashtu si të gjithë dëshmorët, si Shejnazja dhe Ademi, si Shkurta dhe Muhameti është një shembull i madh për brezin e ri, për arsimtarët tanë, për të gjithë.

Një bije — mijëra ngrihen, ky motiv i madh i revolucionarëve është bërë pjesë organike e jetës sonë. U gëzova pa masë kur mora vesh se pjesëtarët e familjes dhe qindra, mijëra të rinj e të reja shprehën gatishmërinë për të zënë vendin e Ismetit në shkollën e Likajt dhe në radhët e ushtrisë. Po, ata të gjithë, siç i mëson Partia, do të punojnë si komisarë drite, si Ismeti, kudo që ta lypë nevoja dhe s'do t'u dridhet dora t'i shkrepë plumbin në lule të ballit kujt do që do të guxonte të prekte sadopak atdheun tonë të shtrenjtë, ashtu si do të bënte Ismeti.

E dashura nënë, i dashur baba i Ismetit,

Ju i dhuruat atdheut birin tuaj të shtrenjtë, Partia, populli dhe atdheu ju shprehin juve mirënjohjen e tyre të pakufishme.

Me dashuri dhe respekt,

Juaji

*Enver Hoxha*

«Zëri i popullit», nr. 294 (6333)

8 dhjetor 1968

## **LETËR DREJTUAR BRIGADIERIT ALO QOSJA NGA SOJNIKU I GRAMSHIT**

**23 janar 1969**

I dashur shoku brigadier Alo Qosja,

Të çoj shumë të fala të përzemërta. Me punën tënde u njoha nga shkrimi i korrespondentit të «Zërit të popullit», Jorgji Papa, i cili shkruan për ty realisht dhe me entuziazëm.

Jam gëzuar shumë dhe Partia jonë duhet të mburret me anëtarët e saj si ti, që e kuptojnë dhe e zbatojnë aq drejt dhe me aq sukses në jetë vijën e saj. Ti, me punën, me guximin tënd prej komunisti dhe me rezultate konkrete jo vetëm nderon Partinë dhe popullin në detyrën që të kanë besuar, por me shembullin e punës që po bën, vërteton njëkohësisht drejtësinë e orientimeve të Partisë në bujqësi, u tregon të tjerëve se mund të drejtosh, por edhe të prodhosh dhe se ai që prodhon, drejton më mirë. Dhe ky është drejtimi më i mirë, se është antiburokratik.

Puna jote vërteton, gjithashtu, sa vlera të mëdha materiale dhe morale krijon dhe nxit një drejtim joburokratik, kur ai përputhet ngushtë me punën konkrete, me njerëzit e thjeshtë që punojnë, luftojnë e që krijojnë dhe kur njerëzit e punës shikojnë punën e mirë të drejtuesve të tyre, binden se drejtimi më i përsosur qëndron në veprimtarinë krijuese të përbashkët.

Udhëheqës i mirë nuk është ai që jep urdhra dhe direktiva nga larg, por ai që i zbaton edhe vetë këto direktiva, që i vërteton këta urdhra e direktiva me zbatimin konkret të tyre, që merr pjesë aktivisht në zbatimin e tyre dhe jep i pari shembullin dhe shembullin e mirë, që dëgjon me kujdes zërin e masës, se masa është njëkohësisht prodhuesi dhe drejtuesi kryesor. Të gjitha këto çështje ti po i zbaton në mënyrë shembullore, prandaj unë jam aq shumë i gëzuar me punën tënde dhe frymëzohem prej saj, shoku komunist Alo Qose.

Kur ishe kooperativist i thjeshtë, ti bëje 400 ditë-punë në vit dhe në frontet më të vështira, kurse shokët e tu kooperativistë me vështirësi i plotësonin 280 ditë-punë. Kur shokët kooperativistë të caktuan si brigadierin e tyre, ty nuk t'u rrit mendja, por t'u rrit ndjenja e përgjegjësisë për të kryer detyrën, t'u shtua guximi, t'u shumëfishuan forcat fizike dhe morale. «Vështirë të dalloje brigadierin nga kooperativistët në punë», shkruan korrespondenti i «Zërit të popullit».

Edhe gjatë vitit 1967, si brigadier, ti bëre

180 ditë-punë të normuara, kurse brigadierët e tjerë mezi bënë 60. Por ti nuk fjete mbi dafina. Si njeri i talentuar i punës dhe i drejtimit që kudo ku shkoje kazmën dhe shatin i mbaje me vete, ti kontrolloje, këshilloje dhe punoje, nuk ishe i kënaqur me veten tënde, prandaj në vitin 1968 bëre 230 ditë-punë të normuara. Me shembullin e mirë, ti jo vetëm u fitoje zemrën kooperativistëve, por rezultatet e tua në punë tronditën edhe një dembel të brigadës. Ti, shoku Alo Qosja, kur u diskutua në brigadë çështja e tij, e trajtove drejt atë, si komunist, dhe me këtë bëre që ai të ndryshonte nga dembel në një punëtor të dalluar.

Tok me kolektivin me të cilin punuat së bashku, ti vërtetove gjithashtu të mirën e normave kolektive, që të kuptohej se thelbi i këtyre normave është puna fizike, por edhe puna politike për ngritjen e ndërgjegjes komuniste të kooperativistëve. Kjo bëri që çdo gjë në brigadën tuaj të ngrihej lart, të rritej rendimenti i punës, të hapeshin toka të reja dhe të tejkalohesh plani i tyre dhe i prodhimeve.

Shembulli yt personal në punë mobilizon brigadën. Nga 15 metra qilizëm në ditë që bënte një pjesëtar brigade, ti propozove që norma të ngrihej në 25 metra. Dikush në brigadë tha se 25 metra qilizëm në ditë në pyll nuk bëheshin dot. Por ti more kazmën dhe realizove 35 metra. Me shembullin tënd frymëzues dhe me shpirtin tënd prej organizatori të talentuar, shokë të tjerë të

brigadës e tejkaluan normën, ata arritën të bëjnë 38 metra dhe s'ka dyshim që kjo ty të gëzoi. Në brigadë bëheshin 350 metra prashitje misri në ditë. Ti gjykove se kjo ishte pak dhe propozove të ngrihej norma në 500 metra në ditë. Si shumë e ngrite, të thanë disa kooperativistë. Por ti more vetë shatin dhe duke bërë 700 metra në ditë, vërtetove në praktikë se propozimi yt ishte real. Dhe në shembullin tënd kooperativistët arritën të bëjnë edhe më shumë nga sa propozove ti, nga 500 metra ata prashitën 600, pati bile të tjerë që ta kaluan edhe ty, brigadierit të talentuar, dhe bënë 800 metra.

Shembulli yt kaq i mirë i frymëzoi e i mobilizoi gjithë brigadierët e tjerë të kooperativës malore të Sojnikut, të cilët e ngritën pjesëmarrjen e tyre në punën drejtpërdrejt në prodhim në 180 ditë-punë në vit, kurse ti u zotove që këtë vit të bësh 300 ditë-punë.

Të përgëzoj me gjithë zemër, i dashuri shok komunist, dhe uroj që gjithë brigadierët, kooperativistët, kryetarët e kooperativave dhe drejtorët e të gjitha ndërmarreve shtetërore të ndjekin shembullin tënd në punë dhe në drejtim.

Unë personalisht ruaj kujtime nga më të mirat të kohës heroike të Luftës Nacionalçlirimtare, që kam kaluar në fshatrat e malësisë së Gramshit, ku kam jetuar dhe luftuar tok me fshatarët e Holtës, Poroçanit, Kishtës, Sojnikut, Grabovës, Shënepremtes etj. dhe nga afër kam ndier të rrahin zemrat trime dhe bujare të fsha-

tarëve dhe të fshatareve patriote të këtij rrethi për Partinë Komuniste, tash Partia e Punës e Shqipërisë.

Sot edhe rrethi i Gramshit po zhvillohet, po përparon e po lulëzon. Një e ardhme akoma më e bukur e pret popullin e asaj krahine. Këtë e siguron dhe po e bën Partia jonë e madhe në krye të popullit tonë të mrekullueshëm.

Të përqafoj, i dashur shok, dhe të uroj shëndet dhe shumë suksese në shërbim të popullit, në rrugën e nën udhëheqjen e Partisë.

Yti

Enver

*Vepra, vëll. 40, f. 78*

**LETËR DREJTUAR SHOQES ATHINA MILE,  
MËSUESE NË OROSH**

*Mirditë*

**4 shkurt 1969**

E dashur shoqja Athina,

Siç do ta kesh kënduar dhe vetë, edhe unë lexova një shkrim shumë të vlefshëm, me karakter shoqëror të Dritëro Agollit dhe Vangjush Zallëmit në «Zërin e popullit» të datës 22 janar të këtij viti.

Në këtë shkrim bëhej fjalë, në mes të tjera-ve, edhe për ty, për një ngjarje të shënuar të jetës tënde, për martesën tënde me një mirditor nga Oroshi. Ti je mësuese në Orosh, bashkëshorti yt është kooperativist, ti je nga Përmeti, ai është nga Oroshi, ti je intelektuale, ai është fshatar, ti je nga qyteti, ai është nga fshati.

Mua më gëzon, në radhë të parë, lumturia

jote dhe e shokut tënd që, pavarësisht se nuk ju njoh personalisht, ju dua njëlloj si fëmijët e mi, prandaj ju uroj që të dyve një jetë të lumtur, të gëzuar, të kulturuar, plot dashuri dhe plot fëmijë.

Çështja e dytë që më gëzon shumë është se që të dy ju, me prejardhje dhe me gjendje të ndryshme shoqërore, nga dy vende të ndryshme dhe të largëta të atdheut, e kuptoni dhe e zbatoni si duhet vijën e Partisë në lidhje me detyrën ndaj atdheut në punë, në lidhje me ligjet dhe zakonet e shoqërisë sonë të re socialiste, mbi njohjen e lirë, mbi dashurinë e pastër e të sinqertë, mbi bashkëjetesën dhe familjen.

Dikush mund të thotë se ç'gjë të re ka këtu nën qiellin e Shqipërisë, martesë është një gjë e domosdoshme në jetën e njeriut dhe në marrëdhënie të tilla lidhen me qindra e qindra njerëz në ditë. Kjo është e vërtetë. Si rasti yt, natyrisht ka edhe të tjera, por për fat të keq nuk ndodhin akoma me qindra në ditë, kurse paskëta duhet të ngjasin me dhjetëra në ditë, prandaj merr një rëndësi të veçantë shoqërore rasti i martesës tënde. Ti je një vajzë e thjeshtë e popullit dhe mbase të vjen rëndë që unë e bëj shembull një veprim të natyrshëm tëndin. Për këtë të kërkoj ndjesë, por dëshiroj që shembullin tënd të mirë ta ndjekin edhe të tjerë e të tjera. Besoj se ti do të jesh dakord me mua për këtë gjë.

Ti, Athina, je një vajzë përmetare, nga qyteti historik e i bukur i Përmetit, me fshatra të bukura përreth, me ujë e plot blerime, ku lulëzon

e piqet qershia më parë se kudo, por në të njëjtën kohë, ti je në radhë të parë një vajzë shqiptare. E gjithë Shqipëria jonë e mrekullueshme socialiste është atdheu yt. E gjithë Shqipëria me njerëzit e saj trima e bujarë, me natyrën e saj të mahnitshme, me pasuritë e saj të mëdha, të mbitokës dhe të nëntokës, është jotja, janë të tuat, o bijë e popullit! Këtë mrekulli e krijoi në vendin tonë Partia dhe gjaku që derdhi si lumë në beteja legjendare populli yt.

Partia ty të hapi sytë dhe të bëri të shikosh më larg se rrethi i familjes tënde, të shikosh më tej se fshati ose qyteti yt, Partia të hapi horizonte të gjera e pa kufi, të brumosi në zemrën tënde një dashuri të zjarrtë për gjithë tokën amtare, për popullin tënd, të vuri në dispozicion të gjitha mjetet dhe të mësoi, të armatosi për veprime të guximshme revolucionare. Partia të tha: «Shqipëria është jotja, Athina, hidhu pra përpara, kontribuo edhe ti që ajo të bëhet çdo ditë e më e begatshme, më e bukur, më e lumtur, krijo lumturinë për njerëzit dhe atje ku do të derdhësh djersën për lumturinë e përgjithshme, atje do të gjesh edhe ti lumturinë tënde».

Ti, Athina, mbarove shkollën dhe nuk u srollate andej-këtej që të të çonin në Përmet, afër prindërve që ti i do dhe ata të duan shumë, por, si një ushtar e popullit, me ndjenja dhe me zemër rinore, i the Partisë: «Çomë atje ku është nevoja të shërbej, ku të ketë nevojë atdheu». Dhe Partia të çoi në Orosh, të cilin mundet edhe nuk

e dije se ku binte. Por, kur shkove në Mirditë, kur more kontakt dhe u lidhe me atë popull trim, punëtor, besnik, të zgjuar, të atyre vendeve, kur ti u lidhe në shkollë e nëpër familjet e oroshjanëve me kalamanët e tyre dhe u dashurove me ta, kur ti mësove historinë e dhimbshme, vuajtjet dhe luftërat e përgjakshme të fshatarëve mirditorë kundër Gjon Marka Gjonit e bajraktarëve të tjerë, kur ti pe mrekullitë që ka bërë si kudo edhe në këto anë Partia, minierat, fabrikat, fushat e pyjet e lulëzuara, atëherë kuptove edhe më mirë sa e madhe është ideja e Partisë. Kjo të pushtoi ty gjithçka. Për ty, vajzën e re përmetare, Mirdita u bë jotja, ti aty zgjodhe edhe shokun e jetës, atë që dashurove dhe të dashuroi ty, ti krijove kështu familjen tënde të re, në baza të shëndosha, duke flakur tej zakonet e vjetra të mblesërisë, të intrigave e thashethemeve mikroborgjeze, të përçmimit të vjetër të qytetarit ndaj fshatarit, të përçmimit mikroborgjez të intelektualit për njeriun e punës, të nostalgjisë së sëmurë për qytetin dhe pikëpamjet mikroborgjeze për të. Ti i fshive me fshesë të madhe të gjitha këto, harmonizove dhe bashkove në një e të pandarë dashurinë e madhe për atdheun, për njerëzit, për detyrën, me ndjenjat dhe sentimentet e tua.

Këto desha të të thosha ty, e dashur shoqja Athina, kur mora penën të të shkruaj.

Po përse po të shkruaj ty, Athina, dhe nuk po i drejtohem ndonjë të riu që edhe ai ka ve-

pruar kështu si ti? Se për të riun është më lehtë ta bëjë një gjë të tillë, kurse për të renë ka akoma ca vështirësi. Është pikërisht për këtë që unë të mora ty si shembull për të përgjithësuar guximin, trimërinë dhe pjekurinë e vashës sonë të re. Le ta ndjekin të gjithë të rinjtë shembullin tënd.

Po përse është më e vështirë për të renë, sesa për të riun kjo çështje? Pikërisht nga paragjykimet dhe mbeturinat e botës së vjetër për gruan. 40 vjet më parë, rrallë gjeje ndonjë gjirokastrit, o gjirokastrite të martohet me një, që nuk ishte nga Gjirokastra dhe shumë pak, për të mos thënë aspak, jepte ose merrte vajzë nga fshati. Në botën e mbyllur familjare sundonte mashkulli, jeta e vajzës, e gruas, drejtohej prej tij, në interesin ekonomik dhe moral të pronës private, të familjes, të sojit (fisit). Gruan atëherë, sipas zakoneve të shariatit ose të kishës, e ndante burri kur t'i donte qejfi dhe ajo, duke mos pasur punë apo zanat dhe duke qenë e robëruar, nuk kishte tjetër mbështetje veç derës së babës, ku kthehej në një barrë për prindërit dhe njëkohësisht në një shërbyese. Në një gjendje të tillë shoqërore, si prindërit, si vajza (që nuk pyetej) kishin shumë frikë nga të papriturat, nga të panjohurat, nga fatkeqësitë e jetës dhe kujtonin se e zgjidhnin drejt çështjen ose u bënë ballë më mirë këtyre të papriturave duke i lidhur martesat brenda një rrethi të ngushtë e të njohur.

Duke e konsideruar gruan si një krijesë të

dobët e pa mbrojtje, u vendos pak nga pak një zakon i tillë që jo vetëm vajza, por edhe djali zor se martohej larg qytetit ose fshatit të tij. Zhvillimi i qytetit, artizanati, tregtia i lëkundën disi këto zakone, por jo shumë. Megjithatë vajzat e qytetit qëndruan atje ku ishin, pse ato qenë të mbyllura, shumë pak prej tyre venin në shkollat që sapo hapeshin dhe për to nuk kishte vend pune jashtë derës së shtëpisë. Kurse në fshatra çështja qëndronte më ndryshe, vajzat e fshatit martoheshin edhe jashtë fshatit të tyre, por kurdoherë edhe kjo bëhej pa pëlqimin e tyre.

Më vonë, me zhvillimin e qyteteve, lindën zakone të reja; meshkujt mbaronin disa shkolla, disa bëheshin nëpunës, të tjerë mësonin zanate ose hapnin dyqane me çirakë, bënë tregti dhe çështja e fshatit për ta u bë më e largët; fshati, i prapambetur nga çdo pikëpamje, ishte për këta qytetarë edhe një objekt shfrytëzimi. Asnjëri nga qyteti nuk i pëlqente të vinte në fshat, pale të jepte dhe të merrte grua ose burra nga fshati, me përjashtime shumë të rralla, të shtytra nga interesa ekonomikë.

Natyrisht pas Çlirimit dhe Luftës Nacionalçlirimtare çdo gjë ndryshoi. Partia bëri një revolucion të madh në të gjitha këto çështje dhe po e thellon vazhdimisht këtë revolucion. T'i thashë të gjitha këto, e dashura motër Athina, se megjithëkëtë mbeturinat mikroborgjeze që kanë lidhje me këto çështje ekzistojnë akoma dhe na pengojnë. Në vendin tonë ndërtohet socializmi,

zhvillohet industria, zhvillohet bujqësia moderne, është përhapur kudo arsimi dhe kultura socialiste, ka një zhvillim dhe një lëvizje të harmonishme, por të madhe të popullsisë, po afrohet fshati me qytetin nga çdo pikëpamje. Me mijëra punëtorë zbresin nga fshatrat tona në fabrika e miniera, me mijëra janë edhe qytetarët që shkojnë e punojnë në fabrika (dhe jo vetëm në fabrikat e qytetit të tyre), po edhe në kooperativa. Të rinj e të reja si ti, hidhen çdo vit në jetë, kuadro të mësuar kalojnë nga qytetet në fshatra dhe anasjelltas. Mund të merret, pra, me mend, sa anakronike bëhen sot zakonet e vjetra që përmenda më lart, ose mbeturinat e tyre në ndërgjegjen e njerëzve.

Ka shembuj të mirë, shoqja Athina, në këtë drejtim, por ka edhe jo të mirë. Do të të them disa. Ka disa intelektualë qytetesh që u vjen shumë zor të largohen nga qytetet kryesore dhe, kur dërgohen të punojnë në ndonjë qytet të vogël, i varin buzët, pale kur dërgohen në fshat që nuk u pëlqen fare dhe në këtë rastin e fundit e ndiejnë veten si të përkohshëm, pra punojnë dhe rrojnë si i themi ne mbi gjemba, as që lidhen si duhet me punën, me fshatin, pale të mendojnë pastaj të martohen me vajza fshati. Të tillë njerëz që nuk mendojnë si revolucionarë, mendjen e kanë te qyteti dhe bëjnë çmos të transferohen. Por njerëz me mentalitete të tilla gjë edhe në radhët e disa punëtorëve. Do të të jap shembullin e një grupi punëtorësh dhe inxhinierësh nga Ti-

rana, që u caktuan të punojnë në një fabrikë nga më modernet në rrethin e Gramshit. Ata kanë atje më shumë se dy vjet që punojnë dhe duhet thënë drejt se nuk punojnë keq, por mendjen e kanë «çarçaf», siç themi ne në Gjirokastër. Me një fjalë nuk janë në rregull, sepse nuk po i çojnë familjet në Gramsh, i lënë në Tiranë, duke shpresuar të kthehen këtu, se u pëlqen kryeqyteti. Ti mundet që nuk e ke parë Gramshin, por po të them unë se ai është bërë një qytet i bukur, me shumë pallate, me rrugë të asfaltuara, me drita neon, me parqe, shkolla, kinema, teatro dhe gjithçka. Të gjithë punonjësve të këtij grupi që të përmenda organet përkatëse ua kanë rezervuar edhe apartamentet për banim, por këto vazhdojnë të qëndrojnë bosh.

Nga vendimi yt guximtar duhet të marrin shembull edhe gratë e këtyre punonjësve. Ti shkove në një fshat malor dhe krijove një familje të re, kurse disa bashkëshorte preferojnë të rrinë më mirë në qytet sesa pranë burrit, i cili, duke qenë afër të dashurve të tij, gruas e fëmijëve, do të ndiejë bashkë me gëzimin e punës edhe ngrohësinë familjare e do të punojë më mirë në frontin që i është caktuar, atje ku e do interesi i atdheut, i popullit, i socializmit.

Partia duhet të bëjë që punonjësit tanë, si burrat dhe gratë, të cilat janë aq të papërtuara në punë, të kapërcejnë me vendosmëri këto koncepte të vjetra që i çojnë në qëndrime të tilla që

janë në kundërshtim me frymën revolucionare që karakterizon jetën e vendit tonë.

Siç e di, shoqja Athina, ka edhe mësuese që nuk i zgjidhin drejt problemet shoqërore, ashtu sikurse ke vepruar ti. Disa mësuese nga Korça, të mira, të zonjat, patriotë të flakta, të papërtuara në punë, të gjitha cilësitë e mira i kanë, vetëm për një gjë nuk mendojnë drejt. Ato shfaqën dëshirën të transferoheshin në Korçë, pse kishin shumë vjet në fshatrat e Librazhdit dhe kishin mbetur edhe pa martuar. Po të kishin menduar drejt me kohë, edhe për këtë çështje, ato do të gjenin në fshatrat e Librazhdit sokola, ashtu siç gjete ti aty në Orosh. Vajzat korçare kanë qenë të njohura gjithnjë si vajza punëtore. Por sot ato nuk punojnë më si dikur brenda katër mureve të shtëpisë mbi vegjet e qëndisimat e tyre, por në fabrika, uzina madhështore e kooperativa nga më të lulëzuarat dhe jo vetëm të Korçës. Shumë prej tyre kanë shkuar për të ndihmuar kooperativat bujqësore malore. Edhe këto ditë mora lajmin se mbi 200 prej tyre u nisën nga Korça për të punuar përgjithmonë në Kombinatin e Tekstilëve në Berat. Atje ato do të punojnë, atje do të gëzojnë jetën, do të martohen, do të krijojnë familjen dhe lumturinë e tyre. Sa bukur! Kështu do të ngjasë edhe me vajzat heroike të Shkodrës e të rrethëve të tjera të atdheut tonë që venë në malësi, mësuese, kooperativiste, infermiere, mjekë, agronome e që shumë prej tyre do të martohen atje me djemtë e fshatit e të malësisë. Kë-

shtu bëjnë tash me mijëra të rinj revolucionarë të zjarrtë që u janë qepur kooperativave, që po lidhen ngushtë me jetën e me njerëzit e tyre, me punën, me përparimin e vendit dhe martohen atje ku punojnë me vajzat e fshatit, që janë po aq punëtore, të mira, të zgjuara, të shëndetshme, të bukura nga trupi dhe nga shpirti.

Ja kjo është rruga e Shqipërisë së re për këto çështje. Prandaj unë të mora ty si shembull dhe kisha dëshirë që me këtë rast të të uroj ty dhe shokut tënd me gjithë zemër jetë të lumtur e të gëzuar në familjen tuaj të re dhe në punë.

Të fala shoqërore

*Enver Hoxha*

«Raporte e fjalime 1969-1970»,  
f. 36

## LETËR DREJTUAR LINDITA SESERIT

Tiranë

13 shkurt 1969

E dashur Lindita e vogël,

Urimet që më bëje për Vitin e Ri dhe dhurata që më dërgove më gëzuan shumë. Ti qysh tani që je 5 vjeçe dhe sa bukur e kishe qëndisur lulen në copën që më dërgove, me të cilën unë do të mbuloj gotën time. Pale pastaj kur të rritesh, sa gjëra të bukura do të bësh. Atëherë kushedi, do të prodhosh basma e stofra të bukura, ose do të ndërtosh shtëpi e pallate, do të prodhosh a montosh radio, makina e të tjera gjëra që e bëjnë më të bukur e më të lehtë punën e njerëzve. Apo ke qejf të bëhesh mësuese, agronome, doktoreshë? Të gjitha punët janë të mira, dhe kur të rritesh, ti do të zgjedhësh një nga ato që do të të pëlqejë më shumë.

Tani që je akoma e vogël, po të dërgoj një top e një lodër që të lozësh. Besoj se je vajzë e urtë, nuk mërzit babagjyshin e mamanë, por i ndihmon me sa mundesh që tani. Jam i bindur gjithashtu se, edhe kur të vesh në shkollë, do të mësosh mirë.

Unë dëshiroj që, kur të rritesh, të bëhesh revolucionare e komuniste e mirë, ashtu si gjyshit yt, Meti, që është shoku im i vjetër, partizan e komunist, që luftoi për çlirimin e Shqipërisë, ashtu si babai yt që është oficer dhe punon për mbrojtjen e atdheut tonë të dashur socialist.

Shumë të fala nga unë dhe shoqja ime Nexhmije për babagjyshin, mamanë dhe babanë.

Ju përqafojmë, e dashura Lindita e vogël, ty dhe vëllanë tënd.

*Enver*

«Për shokët e mi pionierë»,

f. 343

**LETËR DREJTUAR SHOKUT  
BIB PRENG HYSENI, SHKOPET**

*Burrel*

**31 mars 1969**

I dashur Bib Preng Hyseni,

Me emocion të thellë lexova letrën, në të cilën më shkruan për veprimtarinë patriotike të nënës tënde, bijë besnike e popullit, që punoi pa u kursyer dhe ndihmoi gjer në fund organet e sigurimit të shtetit për zbulimin e bandave të diversantëve, gjersa u vra në mënyrën më mizore prej tyre, si edhe për jetën dhe punën e babait tënd që edhe ai u vra nga duart e kriminelëve.

Është një mbarim tragjik ky i prindërve të tu, por rruga që ata ndoqën është e lavdishme. Ata, duke bërë të tyret mësimet e urta të Partisë, ia kushtuan jetën e tyre të re çështjes së saj të madhe, mbrojtjes së lirisë së atdheut, lumturisë

së popullit, prandaj do të mbeten të paharruar nga malësorët trima e patriotë të rrethit të Matit e mbarë populli shqiptar dhe do të jenë kurdoherë për të gjithë një shembull i lartë i patriotizmit socialist.

Armiqtë e popullit e vranë barbarisht nënë tënde sokoleshë, kur ti ishe akoma foshnjë tremuajshe dhe kishe më tepër nevojë se kurrë për të. Kriminelët vranë më vonë pabesisht edhe babanë tënd. Por Partia, populli dhe forcat tona të diktaturës së proletariatit ua morën hakun atyre dhe gjithë luftëtarëve që dhanë jetën për çështjen e Partisë dhe lumturinë e njerëzve tanë, kriminelët dhe bandat e armatosura një nga një u asgjësuan. Ti, Bib, nuk mbete në mes të udhës, siç mendonin dhe deshën armiqtë, por, nën kujdesin e Partisë dhe të afërmeve të tu, u rrite dhe tash së shpejti do të shkosh në radhët e ushtrisë sonë popullore për t'u përgatitur e bërë i aftë për mbrojtjen e atyre fitoreve për të cilat prindërit e tu dhanë jetën. Unë të uroj të dalësh faqebardhë në kryemjen e kësaj detyre të dorës së parë për çdo nënshtetas të republikës.

Tash, i dashur Bib, ti je rritur dhe e kupton përse populli ynë, sado i vogël në numër, ka mundur të jetojë gjatë shekujve dhe të mbrojë tokën amtare, gjuhën, traditat dhe zakonet e tij të mira. Kjo ka ndodhur se ai kurrë nuk është trembur e përkulur përpara armiqve, por e ka mbajtur kurdoherë gishtin në këmbëzën e pushkës. Tani që ai udhëhiqet nga Partia jonë marksiste-

-leniniste dhe ndërton jetën e lumtur socialiste, traditat e shkëlqyera të të parëve tanë janë zhvilluar e ngritur shumë më lart, uniteti i tij rreth Partisë është bërë i pathyeshëm, prandaj forcat e tij janë qindfishuar. Asnjë armik sot nuk guxon ta prekë Shqipërinë socialiste, pse e di që këtu e pret vdekja.

Sikur të rronin prindërit e tu aq të mirë, të dashur e patriotë të flaktë, me siguri do të të këshillonin ta duash me të gjitha forcat e tua Partinë, popullin dhe atdheun, të bëhesh punëtor i palodhur në punë, njeri i sakrificës për të mirën e përgjithshme, i sjellshëm e i dashur me njerëzit dhe kurdoherë vigjilent ndaj armiqve. Unë jam i bindur se ti, si bir i denjë i prindërve të tu patriotë e sypatrembur, me dashurinë e madhe që ushqen për Partinë dhe popullin, me punën, sjelljen dhe çdo veprim tëndin, do të përpiqesh që ta mbash kurdoherë lart emrin e nderuar të prindërve të tu, ashtu siç i mban lart e i nderon me respekt të thellë Partia dhe gjithë populli ynë.

Të rrok për qafe me dashuri!

Yti

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR SHOKUT DUL ALIA NË KOOPERATIVËN BUJQËSORE DRAGOBI**

*Tropojë*

**3 prill 1969**

I dashur Dul,

Para së gjithash të uroj akoma jetë të gjatë e shëndet të mirë, ty malësorit trim, bashkëluftëtarit të «plakut të maleve», heroit të popullit tonë, Bajram Currit.

Letra jote aq e ngrohtë, plot gjallëri e optimizëm për të ardhmen e vendit tonë, më gëzoi pa masë. Tek ajo unë pashë jetën e një patrioti konsekuent 95-vjeçar që aq shumë ka vuajtur në të kaluarën, por kurrë nuk është përkulur përpara armiqve e tradhtarëve, kurse sot, me gjithë peshën e rëndë të moteve, me ato forca të pakta fizike që i kanë mbetur, por me një patriotizëm të flaktë në gji, ashtu si tërë populli trim e pa-

triot i malësive të Tropojës, është akoma i vendosur të japë diçka për të mirën e popullit. Realiteti i atdheut tonë të lirë e socialist përtërin e i jep forca të reja çdo shqiptari, ai shndrit si dita plot diell që nuk do të shuhet kurrë.

Duke krahasuar vuajtjet e panumërta të popullit shqiptar në të kaluarën me të tashmen e lumtur që çdo ditë e më shumë zbukurohet me punën e palodhur krijuese të njerëzve tanë të talentuar, ditën kur ju erdhi drita në fshat ti, i dashur Dul, nuk e përmbajte dot hovin e ndjenjave, rroke pushkën dhe shtive për të shprehur ngazëllimin tënd në ato çaste, për t'iu gëzuar ashtu si e mendoje dhuratës së madhe që ju solli Partia në fshatin dhe familjet tuaja.

Shqiptarët pushkën e kanë mbajtur dhe e mbajnë kurdoherë pranë, në kohë të mira e të vështira, pse vazhdimisht kanë qenë të kërcënuar prej armiqve. Ne kurrë nuk i kemi rënë kujt në qafë, por atyre që janë përpjekur të na dhunojnë vatrat tona, plumbin s'ua kemi kursyer. Këtë traditë luftarake të rrënjësuar brez pas brezi nga dëshira për të jetuar në liri në truallin tonë, si dhe virtyte të tjera të larta të popullit, Partia e Punës e Shqipërisë i ka zhvilluar më tej, në një shkallë akoma më të lartë për të edukuar brezat e rinj besnikë deri në fund ndaj Partisë, popullit dhe atdheut.

Edhe ti, i dashur Dul, si qindra e mijëra pleq të tjerë, e ke kuptuar drejt dhe e zbaton mirë detyrën që ka shtruar Partia për të kaluarit në

moshë, në mënyrë të veçantë për edukimin e rinisë, prandaj nuk po kursehe as tash për t'i treguar asaj sa luftë, gjak e sakrifica i janë dashur Partisë dhe popullit për të arritur këto fitore të mëdha historike që gëzojmë sot. Zelli për të dëgjuar leximin e Historisë së Partisë dhe vendosmëria për zbatimin e mësimëve të saj të urta dhe shpëtimtare, është gjithashtu një frymëzim i madh dhe shembull për të gjithë, për të rinj e të reja, burra dhe gra.

Duke përfunduar dëshiroj edhe një herë të të uroj me gjithë zemër rrofsh edhe më shumë që të shikosh ditë akoma më të bardha që do të vijne paskëtaj për popullin dhe atdheun tonë të shtrenjtë socialist!

Të përqafoj me respekt

Yti

*Enver*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR SKULPTORËVE  
KRISTAQ RAMA, MUNTAZ DHRAMI  
E SHABAN HADËRI**

**26 qershor 1969**

Të dashur shokë skulptorë Kristaq Rama,  
Muntaz Dhrami e Shaban Hadëri,

Ju bëj shumë të fala.

Ditën që vizitova studion tuaj për të parë maketin e Monumentit të Shpalljes së Pavarësisë në Vlorë, ju dhashë disa këshilla dhe ju bëra disa vërejtje shoqërore. Qëllimi ishte që frymëzimin tuaj patriotik ju ta pasuronim akoma më shumë me studimin më të thellë të historisë së Shqipërisë, të folklorit të madh të popullit dhe të dokumenteve të Partisë.

Natyrisht ju e dini ç'rëndësi të madhe ka kjo përmendore për popullin dhe për brezat e ardhshëm, prandaj ajo duhet të bëhet e atillë që,

duke përjetësuar në bronz ngjarjen historike të Vlorës, të bëjë sintezën e gjallë dhe dinamike të luftërave heroike të popullit shqiptar, të luftërave të lavdishme çlirimtare kundër pushtuesve, për liri, pavarësi dhe sovranitet kombëtar.

Populli në këtë monument të shikojë kurdoherë se liria fitohet dhe mbrohet me pushkë, ashtu siç u fitua me Luftën Nacionalçlirimtare të udhëhequr nga Partia, ashtu siç mbrohet sot nga diktatura e proletariatit.

Sigurisht, ju më kuptoni se në kompozimin e monumentit unë nuk mendoj të futen motive të Luftës Nacionalçlirimtare, bile edhe kur ju thashë nëse ka mundësi të shkrihen disa motive nga Lufta e Vlorës e vitit 1920, mendimi im konsistonte në atë që Monumenti i Pavarësisë të përfaqësojë jo vetëm arritjen e një caku, por sulmin përpara për të arritur caqe të tjera akoma më të rëndësishme, që të shihet në të se revolucioni ynë ecën përpara, është në ngjitje; imagjinata e popullit të shohë në veprën që do të bëni ju, atë që ai realizoi në Luftën e lavdishme Nacionalçlirimtare, atë që po realizon sot gjatë ndërtimit të socializmit.

Një gjë e tillë nuk është aspak e domosdoshme të bëhet duke përzier motivet e periudhave të ndryshme, se atëherë do të ndryshonte subjekti i monumentit, por, duke ruajtur subjektin e periudhës së caktuar historike në të, nëpërmjet talentit tuaj të lavdërueshëm, të dalin të gjallë në relief forca e madhe e karakterit të shqiptar-

rit, trimëria, heroizmi, shpirti i sakrificës, zgjuarsia, hovi i tij luftarak dhe revolucionar i vazhdueshëm, karakteristika këto për të gjithë brezat e Shqipërisë, për të kaluarit, të tashmit dhe të ardhshmit. Se si mund të dalin këto në një monument, atë e dini ju, pse ju jeni skulptorë dhe një skulptor i mirë, mendoj unë, duhet të jetë njëkohësisht jo vetëm artist, por edhe poet, edhe shkrimtar, edhe luftëtar revolucionar, edhe dijetar i lidhur ngushtë me popullin. Të tëra këto ju i keni, atëherë veproni!

Më falni, në qoftë se gabo hem, por kompozimi i ansambilit të monumentit, vendosja e personave dhe e simbolit, ekspresionet e personazheve janë ato që mund t'i japin monumentit ato kuptime dhe shprehje për të cilat fola më lart.

Kam reflektuar për këtë çështje që nga dita që ju vizitova në studion tuaj dhe më lejoni tani të shfaq disa mendime të miat. Qysh në fillim po ju them se ato mund të mos jenë edhe aq të bazuara, imagjinata ime mund të më gabojë, mbase s'pata edhe shumë kohë për të vërejtur me kujdes maketin tuaj, të cilin e gjej kurdoherë të vlefshëm. Ju më thatë se do ta përpunoni e do ta përpunoni më tej atë, prandaj po jua them këto mendime modeste të miat.

I tërë ansambli i monumentit duhet të japë ndjenjën e unitetit të çeliktë të popullit tonë dhe të forcës së tij për të mposhtur robërinë shekullore e çdo pengesë që has përpara.

I tërë ansambli i monumentit duhet të jetë

në sulm, kështu edhe personazhet që do ta përbëjnë atë duhet të mos jenë në gjendje statike. Përveç kosovarit ose shqiptarit të Veriut, dy të tjerët, shqiptarët e Jugut, janë në poza statike, pushka e tyre është «në pushim». Këta ndiejnë satisfaksionin se me luftë u ngrit flamuri dhe kjo është një gjë e domosdoshme që duhet shprehur, pse përfaqëson idenë e pavarësisë, por nuk është e tëra, duhet mbrojtur kjo pavarësi, duhet vazhduar lufta, duhet të ngjitet revolucioni.

Figurat e personave, përveç atij plakut të Vlorës, që më duket se është vënë drejt, janë ca konvencionale; për të dalluar krahinat e ndryshme, është dashur të stilizohen kostumet më tepër nga sa duhet. Jo vetëm që luftëtarët e atyre kohëve nuk visheshin të gjithë me fustanella, por lufta hidhte tej stilin dhe paradat. Personazhi i kosovarit me gjoksin hapur është më real.

Flamurit që valëvitet, më duket i është dhënë një formë e trashë, e fryrë, nuk ka ngjyrën e flamurit të betejave heroike që ka kaluar zjarre e furtuna. Kjo ka rëndësi, pse është një figurë qendrore, ai duhet të jetë, si me thënë, i shkathët e i mprehtë, si shqiptari, si shqiponja që ka në mes.

Unë jam dakord me ju që në tërë ansamblin e monumentit figura e Ismail Qemalit të jetë një figurë qendrore, ashtu siç e keni vënë ju, por nga i gjithë ansambli të dalë se vepra e tij është si konsekuencë e luftës legjendare të popullit.

Më në fund në ansamblin e monumentit nuk

del gjëkund lufta e madhe e rilindësve tanë me penë, luftë kjo që nuk mund të harrohet, as të shkëputet nga ajo me armë, pse është pjesë integrale e periudhës për të cilën ne ngremë monumentin. Prandaj studiojeni edhe një herë këtë moment për statutin.

Të dashur shokë,

Kur isha në studion tuaj, ju fola për rëndësinë e folklorit të mrekullueshëm të vendit tonë. Unë për veten time jam një admirues i folklorit të popullit dhe i të gjithë atyre skulptorëve, artistëve, poetëve, shkrimtarëve e dijetarëve që kri-dhen në të e frymëzohen nga ai. Në gurrën e pashtershme e jetëdhënëse të krijimtarisë së popullit, ne do të gjejmë atë frymëzim të madh për të realizuar vepra të bukura e madhështore për popullin tonë. Nga veprat që nxirrni prej duarve tuaja, njerëzit tanë frymëzohen, prandaj frymë-zohuni edhe ju nga inspirimet e tyre.

Në numrin e fundit të «Dritës» lexova bala-dën e poetit të talentuar Agim Shehu «Përpara bustit të Selam Musait». Lexoni ç' thotë ai për ve-prat tuaja:

*Ja, kështu në bronz*

*Ty të ka liria.*

*Lule, Selam labi,*

*Selam Salaria.*

Frymëzohuni edhe ju për monumentin tuaj  
nga frymëzimi i tij:

*Rri, po nuk të rrihet,  
Ndaj të vijnë mornica...  
Vrapi yt po endet  
«Poshtë nga Babica».*

*Lugjesh, në ato netë  
Zbrite si veri,  
Projektorët ndiqnin  
Sharkun tënd të zi.*

*Flaka nëpër duar  
Me rrëmbim të futej.  
Gjalmi mbi dyfek  
Dridhej, mos këputej.*

Dëgjoni ç' thotë më tej:

*Çdo tufan, zbërthyer  
Gjoksin ty ta gjeti.  
Sharku si legjendë  
Përmbi tel të mbeti.*

Nuk do t'i citoj të gjitha vargjet e kësaj poezie të bukur, por këtë e bëj pse të gjithë duam që monumenti për të cilin po punoni të jetë një kryevepër frymëzimi popullor për heroizmat e të

parëve tanë, për kohën tonë dhe për brezat e ardhshëm që edukon dhe frymëzon Partia.

Edhe një herë po jua përsëris se vërejtjet e mia kanë karakter shoqëror. Unë kam besim të madh te patriotizmi, partishmëria, frymëzimi e talenti juaj dhe jam i sigurt se ju do të nxirrni një vepër të bukur, me një nivel më të lartë nga veprat tuaja të bukura që i keni dhënë deri tash atdheut.

Juaji

*Enver*

*Vepra, vëll. 41, f. 309*

## **LETËR DREJTUAR SHOKUT MARK GJOKA NË KATUNDIN MASHTËRKOR TË OROSHIT**

*Mirditë*

**26 qershor 1969**

I dashur Mark Gjoka,

Mora vesh martesën e bijës tënde Dranes me të riun punëtor Qazim Arif Pecin nga katundi Arrëz i Kukësit dhe u gëzova shumë, jo vetëm se martesë është një gëzim dhe akt me rëndësi të madhe në jetën e një çifti, pse ka të bëjë me të ardhmen e dy të rinjve, porse ajo u bë me vullnetin e tyre të lirë, me pjekuri e përgjegjësi, faktorë këta që ndihmojnë për krijimin e një familjeje të shëndoshë socialiste. Por, i dashur Mark, mësova njëkohësisht se ti, pavarësisht se nuk kishe ndonjë kundërshtim për këtë martesë, shprehe frikën se mos Qazimi e ndan dhe ta lë Dranen rrugëve.

Shqetësimi yt është i kuptueshëm. Ne prindërit dëshirojmë t'u përgatitim bijve dhe bijave tona, që i duam aq shumë, jetë të lumtur e të gëzuar, por shpesh te disa njerëz e vjetra bëhet pengesë për të parë drejt rrjedhën e kohës që shkon përpara. Ata nuk kuptojnë se, duke vepruar edhe me fëmijët ashtu siç kanë vepruar prindërit me ta, ua errësojnë jetën atyre, në vend që t'ua bëjnë të lumtur, siç dëshirojnë. Në një rrugë të tillë i çojnë ata shpeshherë zakonet prapanike dhe mbeturinat e fesë, të rrënjosura në ndërgjegje prej shumë kohe, gjatë periudhës së vështirë me skamje, varfëri e padituri në të cilën ka jetuar populli ynë në të kaluarën. Ndryshe ndodh me të rinjtë e të rejat që janë rritur dhe edukuar me mësimet e Partisë, ata e kanë më lehtë t'i hedhin tej më me vendosmëri të këqijat e së kaluarës.

Ne shqiptarët bij të këtij trualli që jemi të një gjuhe e të një gjaku, për qindra vjet me radhë na kanë ndarë e përçarë të huajt dhe feudalët e bajraktarët me anën e fesë e të dallimeve krahinore, me qëllim që të na sundonin më lehtë. Kishat, xhamitë dhe klerikët, njëloj si edhe pushuesit e tradhtarët e vendit, i kanë shërbyer me zell kësaj politike antipopullore. Kaq është e vërtetë sa shqiptarët myslimanë feja i konsideronte «turq», ortodoksët i konsideronte «grekë», megjithëse shqiptarët për shekuj me radhë kanë luftuar kundër hordhëve të sulltanëve barbarë, dhe kundër synimeve të shovinistëve. Ishte kisha

ajo që bashkë me tradhtarët e vendit me aq zell përkrahu pushtuesit fashistë dhe u bënte thirrje katolikëve të mos luftonin kundër tyre se ata ishin të një feje. Por populli shqiptar, i bashkuar rreth Partisë Komuniste Shqiptare (sot Partia e Punës) i shporri okupatorët e tradhtarët dhe më vonë edhe mbështetjet e tyre siç ishin kishat e xhamitë.

Po t'i shkruaj këto, i dashur Mark, për të të treguar se s'ka asgjë të keqe që vajza jote u martua me një djalë që vjen nga një familje «myslimane». Përkundrazi, gjersa ajo mori atë që deshi vetë, është për t'u përgëzuar. Unë jam i bindur se ti, si burrë i ndershëm, patriot dhe besnik i Partisë, që e do me gjithë shpirt Dranen që rrite me kujdes e përpjekje, do ta pranosh në shtëpi, do t'i hedhësh tej thashethemet e atyre që akoma nuk e kanë kuptuar qëllimin e lartë të Partisë për bashkimin e çelikosjen e unitetit të popullit tonë, nuk do të lejosh që bija jote, gjaku i gjakut tënd, pa pasur asnjë faj të vritet shpirtërisht dhe të jetojë e brengosur, si rrjedhim i politikës përçarëse të pushtuesve të huaj, të klasave shfrytëzuese dhe të ideologjisë së tyre, refleksi i të cilëve janë edhe normat e egra të fesë e të kanunit që mbarë populli ynë tashmë i ka hedhur poshtë me neveri.

Edhe e martuar vajza, Mark, ka nevojë për dashurinë tënde si baba, për dashurinë e nënës dhe njerëzve të tjerë të familjes ku ajo u rrit gjersa u bë nuse. Prandaj pranoje me zemër të

çiltër Dranen në shtëpinë ku lindi dhe u rrit, në atë shtëpi ku qeshi e lozi plot gaz si fëmijë. Përqafoje, puthe dhe uroje të trashëgohet e të jetë e gëzuar dhe, ashtu siç ka merituar përkrahjen e Partisë, të ketë edhe përkrahjen dhe dashurinë e prindërve të vet.

Jam i bindur se, duke vepruar kështu, ti do ta ndiesh veten të lehtësuar e më të fortë dhe e gjithë familja, së bashku me Dranen tuaj, do të vazhdoni të punoni e të jetoni të lumtur.

Të fala të përzemërta ty dhe gjithë pjesëtarëve të familjes.

Yti

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR SHOKUT ALEKS ÇAÇI

Tiranë

14 shtator 1969

I dashur shoku Aleks,

Mora poemën tënde «Ti je Myzeqe?» që pate mirësinë shoqërore të më dërgoje, e këndova me kënaqësi të madhe dhe më pëlqeu shumë.

Kur biseduam bashkë, isha i bindur se ti do të nxirrje një gjë të mirë, pse zemrën e ke të zjarrtë për Myzeqenë dhe të këndon për të si për gjithë Shqipërinë, për revolucionin, pse je bir besnik i popullit dhe i Partisë.

Unë e respektoj shumë modestinë tënde kur më thua se vepra ka edhe të meta. Nuk e kam zakon t'i mburr njerëzit, por po të them se poema jote ka aq shumë gjëra të bukura, sa që nuk i gjeta dot këto të meta. Mundet që këtë punë ta bëjnë kritikët, por unë, shok i dashur, po të

shpreh atë gëzim dhe kënaqësi që ndjeva kur lexova poemën tënde.

Të uroj shëndet të plotë, jetë të gjatë dhe punë të frytshme si kurdoherë në shërbim të popullit dhe të Partisë sonë heroike.

Përqafime

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR MALËSORËVE TË  
KOOPERATIVËS BUJQËSORE TË LËPUSHËS  
TË KRAHINËS SË KELMENDIT**

**22 shtator 1969**

Të dashur shoqe e shokë,

Letra juaj e thjeshtë dhe e dëlirë, si zemrat tuaja, më gëzoi pa masë. Mbi të gjitha më gëzuan sukseset e para fillestare të punës suaj të përbashkët të palodhur që keni arritur në zhvillimin e lopës dhe në prodhimin e qumështit.

Kur u takova parvjet me ju, malësorë trima të Kelmendit, ju sapo ishit bashkuar në kooperativë, nuk e kishit krijuar ende tufën e lopëve, por pata besim se do ta plotësonit këtë porosi të rëndësishme të Partisë, pse pashë në sytë tuaj jo vetëm patriotë të zjarrtë e sypatrembur si të parët tuaj, por edhe punëtore e punëtorë të palodhur, luftëtarë besnikë e të vendosur të vijës së drejtë të Partisë sonë të lavdishme, njerëz të

urtë që fjalën s'e ndajnë nga vepra, që flasin pak, por punojnë shumë e me vetëmohim. Këto janë karakteristika shumë të çmuara të malësorëve tanë. Me njerëz të tillë, me një popull të tillë të mrekullueshëm, siç është mbarë populli ynë, Partia ka ecur dhe do të ecë kurdoherë përpara pa u ndalur, do të kapërcejë çdo dallgë e furtunë, sado të rrepta që të jenë ato.

Duke zbatuar mësimet e Kongresit të 5-të të Partisë që edhe malet tona të bëhen burim qumështi, mishi, gjalpi, djathi etj., ju krijuat vitin e kaluar një tufë lopësh prej 24 krerësh dhe arritët të merrni 644 litra qumësht nga çdo lopë foragjere, në krahasim me 172 litra që merrnit më parë, ndërsa nga lopët e racës keni marrë deri 2 000 litra qumësht. Për këto rezultate ju sigurisht luftuat pa u lodhur për zbatimin e vijës së drejtë të Partisë kundër koncepteve të ngushta e konservatore. Nëpërmjet shembullit konkret ju arritët të bindni e të tërhiqni pas vetes edhe ata shokë e shoqe që lëkundeshin e nuk kishin besim, duke çarë kështu përpara të gjithë së bashku, si vëllezër e motra për një qëllim të përbashkët, për forcimin e ekonomisë kolektive dhe për përmirësimin e jetës suaj. Mbi të gjitha, ju po mësoni të zhvilloni një blegtori të përparuar që t'u përshtatet kushteve klimatike dhe terrenit tuaj shumë të thyer, keni luftuar dhe luftoni kundër acarit e dëborës për të rrëmbyer tokën nga shkëmbinjtë e thepisur dhe nga shpatet e maleve. Edhe masat që keni marrë për strehimin dhe për

ushqimin e mirë e të pandërprerë të lopëve si në verë, ashtu edhe në dimër, do t'ju lejojnë të arrini suksese të tjera më të mëdha në të ardhmen. Unë kam bindjen se, ashtu si kurdoherë, nën udhëheqjen e drejtë të Partisë dhe me ndihmën e organeve shtetërore dhe ekonomike të rrethit, ju do të mund të ngrini edhe punishte industriale të vogla moderne për përpunimin e qumështit, si dhe të prodhimeve të tjera bujqësore.

Rezultatet e arritura dhe zotimet e guximshme që merrni, janë një nxitje e madhe dhe frymëzim për suksese të reja në luftën për forcimin e mëtejshëm organizativo-ekonomik të kooperativës suaj, për rritjen e mëtejshme të ndërgjegjes dhe të hovit revolucionar në punë, për përmirësimin e kushteve të jetesës, për përpunimin arsimor, kulturor e për higjienizimin e fshatit, për të zhvilluar edhe më fort luftën kundër fesë, zakoneve prapanike e gjithçkaje tjetër të vjetër konservatore e reaksionare që pengon zhvillimin tuaj dhe për ta çuar gjithnjë përpara edhe aty, në bjeshkët alpine, revolucionin tonë të pandalshëm.

Në të gjithë vendin tonë punohet me hov revolucionar për të pritur jubileun e lavdishëm të 25-vjetorit të Çlirimit me duar plot. Nga të katër anët e atdheut, nga Kelmendi e deri në Konispol, vijnë lajme të gëzueshme për rezultatet që arrijnë masat tona punonjëse në revolucionarizimin e jetës në të gjitha drejtimet, në rritjen e vigjilencës revolucionare kundër çdo

armiku, të jashtëm apo të brendshëm, dhe në plotësimin e në tejkalimin e detyrave të planit të katërt pesëvjeçar. Atdheu ynë i dashur socialist zbukurohet e lulëzon vazhdimisht dhe po bëhet çdo ditë më i fortë e më i begatshëm. Armiqtë tanë, imperialistët, revizionistët sovjetikë, titistët jugosllavë e të tjerë do të mposhten me siguri nga revolucioni, në ballë të të cilit qëndron edhe vendi ynë, nga marksizëm-leninizmi kurdoherë fitimtar dhe nga lufta e gjithë popujve të shtypur e të shfrytëzuar të botës.

Motra dhe vëllezër të dashur të Lëpushës,

Ju përgëzoj nga zemra për sukseset që keni arritur. Ato gëzojnë mbarë popullin dhe Partinë tonë. Ju uroj me këtë rast të gjithë malësoreve e malësorëve trima të kooperativës suaj e të mbarë Kelmendit punë të mbarë, fitore të reja përherë e më të mëdha për forcimin dhe për zhvillimin e gjithanshëm të kooperativës suaj bujqësore për të mirën e popullit e të atdheut tonë dhe për të mirën tuaj. Qofshi kurdoherë me shëndet, të gëzuar e të lumtur!

Ju përqafoj

Juaji

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 41, f. 487*

## **LETËR DREJTUAR FAMILJES SË HEROIT TË PUNËS SOCIALISTE ISUF PLOÇI**

14 nëntor 1969

Të dashur Fahrije, Hava, Riza, Sanije  
dhe Lene,

Akti shembullor i Isufit për mbrojtjen e pa-  
surisë socialiste, si dhe letra që më dërguat me  
shprehjet e dashurisë e të besimit të madh për  
Partinë më kanë prekur thellë.

Shoku ynë i dashur, biri i shtrenjtë i Par-  
tisë dhe djali, bashkëshorti, vëllai e i dashuri  
juaj, komunisti Isuf Ploçi, lindur dhe rritur në  
atë vatër të thjeshtë malësori, njohu që në fëmi-  
jëri mjerimin dhe varfërinë, prandaj ai përqa-  
foi pa ngurrim thirrjen e Partisë, rroku pushkën  
dhe luftoi me trimëri për çlirimin e atdheut nga  
pushtuesit e nga tradhtarët në radhët e batalio-  
nit partizan që udhëhiqte në pyjet dhe në bjesh-

kët tuaja Heroi i Popullit, Baba Faja Martaneshi. Pas Çlirimit, me të njëjtën devotshmëri, Isufi punoi me nder si komunist për ndërtimin e Shqipërisë socialiste, duke mbajtur lart gjer në fund të jetës emrin e anëtarit të Partisë.

I vetëm në mes të pyllit dhe përballë flakëve që i përvëluan trupin, duke përçmuar vdekjen dhe duke vënë mbi çdo gjë tjetër interesat e popullit dhe të Partisë, ai luftoi me guxim prej komunisti, patrioti e luftëtari të papërkulur për të shpëtuar pronën e përbashkët socialiste, pyllin, që ai e vlerësonte lart, si një pasuri me vlerë të madhe për ekonominë popullore. Si një komunist i vendosur dhe me një kuptim të lartë për qenien e tij si anëtar i Partisë së lavdishme të Punës, në ato momente supreme e shumë të vështira, kur rrobat dhe trupi po i digjeshin, ai mendoi me gjakftohtësi dhe mbrojti të paprekur nga zjarri taserën e Partisë, duke treguar me këtë akt tjetër të lartë çfarë komunisti ishte. Isufi luftoi dhe fitoi sepse ishte trim, sepse të tillë e kishin rritur populli dhe familja, të tillë e kishte edukuar dhe e kishte kalitur atë Partia, në gjirin e së cilës militoi për shumë vjet.

Duke çmuar aktin e shokut tonë Isuf Pllaçi, Presidiumi i Kuvendit Popullor, me propozimin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë, i akordoi atij titullin e lartë «Hero i Punës Socialiste».

Me të tillë heronj krenohen Partia dhe populli, krenoheni me të drejtë edhe ju. Jeta dhe

vepra e Isufit janë të pavdekshme. Ato, bashkë me veprat e heronjve të tjerë, do të mbeten përjetë pishtarë që do t'u ndriçojnë rrugën brezave të sotëm dhe të ardhshëm të Shqipërisë, që, nën udhëheqjen e Partisë, ndërtojnë socializmin dhe më vonë komunizmin.

Mua më gëzoi shumë qëndrimi juaj burror. Me gjithë dhimbjen e madhe për humbjen e papritur të të dashurit tuaj, ju nuk e lëshuat veten, përkundrazi, sa morët vesh lajmin e hidhur, ndiet krenarinë e veprës së lavdishme të Isufit, që, sikurse më shkruani, gjithë pjesëtarëve të familjes suaj ua shtoi kurajën, u shumëfishoi forcat dhe vendosmërinë që edhe ju të gjithë të jeni kurdoherë ushtarë besnikë të Partisë, siç ishte ai. Unë jam i bindur për ato që më shkruani, sepse martaneshasit, me burra e gra, i njoh personalisht për trimërinë, për patriotizmin e për dashurinë e madhe për atdheun dhe për Partinë, pasi në kohët e vështira të Luftës Nacionalçlirimtare kam punuar e kam jetuar në kasollet e tyre.

Me rastin e pranimit të Sanijes në radhët e Partisë, dëshiroj t'i uroj asaj, si komuniste e re, suksese në punë dhe kam besim se, në shebullin e xhaxhait, ajo do të ecë gjithnjë përpara si trimëreshë, do të kapërcejë me sukses çdo pengesë e vështirësi në përpjekjet e përditshme për të zbatuar çfarëdo detyre që do t'i ngarkohet. Sot ajo, nesër fëmijët e shokut tonë

të paharruar, Isufit, do të bëhen revolucionarë të vërtetë si babai i tyre.

Ju uroj shëndet dhe ju përqafoj të gjithë me dashuri.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 42, f. 91*

**LETËR DREJTUAR PUNËTORES  
SË NDËRMARRJES BUJQËSORE  
«GJERGJ DIMITROV», LIJE XHAJA**

**11 dhjetor 1969**

E dashur shoqja Lije,

Mua dhe Nexhmijen na gëzoi shumë lajmi i lindjes së fëmijës suaj, por pasi kam qenë mjaft i zënë me rastin e festave të mëdha, më fal për përgjigjen me vonesë. Me këtë rast vijmë të dy t'ju sjellim urimet tona më të nxehta!

Ardhja në jetë e një njeriu te ne shton gëzimin në radhë të parë për mëmën që lind dhe përtërin jetën, ndjenjë kjo që ti, shoqja Lije, ke pasur kënaqësinë ta provosh për të dymbëdhjetën herë, por njëkohësisht lindja gëzon familjen dhe gjithë shoqërinë tonë socialiste. Aq më i madh bëhet ky gëzim në rastin tënd, që i ke dhënë atdheut dymbëdhjetë filizë të rinj, të cilët

nesër, si pasardhësit e denjë të brezit që po çelikos Partia, do ta çojnë edhe më përpara çështjen e ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit në Shqipëri.

Dëshirojmë, me këtë rast, të të përgëzojmë me gjithë zemër edhe për faktin se ti, shoqja Lije, megjithëse nënë e shumë fëmijëve, nuk u mbylle brenda katër mureve të shtëpisë, por ke vazhduar të japësh kontributin si qytetare e republikës edhe në frontin e madh të ndërtimit të socializmit, duke qëndruar në ballë të punës në prodhim, si dhe në kryerjen mirë të detyrave shoqërore që të janë ngarkuar, pa lënë pas dore detyrën e madhe si nënë dhe si një amvisë e mirë. Të lumtë, motër e dashur, që me vullnetin tënd të fortë i ke përballuar me sukses të gjitha punët që të janë ngarkuar, duke vënë kështu në jetë si duhet mësimet e Partisë sonë të dashur!

Megjenëse na ke nderuar me kërkesën për t'ia vënë emrin birit tuaj të vogël, mendojmë që ai të mbajë emrin e djalit tonë më të madh, Ilirit, prandaj, po të jeni dakord me bashkëshortin dhe me fëmijët, bashkë me Nexhmijen ju urojmë që ta gëzojë dhe të bëhet, siç na e do zemra të gjithëve, një qytetar i ndershëm dhe ushtar besnik i Partisë, ashtu si dhe prindërit e tij! Si kujtim po ju dërgojmë për vogëlushin edhe një dhuratë të thjeshtë.

Duke përfunduar, shoqja Lije, të urojmë ty edhe një herë gëzim e lumturi në familje, shën-

det, suksese gjithnjë e më të mëdha në punë dhe si aktiviste shoqërore! Gjithë të mirat u urojmë, gjithashtu, bashkëshortit tënd dhe të dymbëdhjetë fëmijëve!

T u a j t

*Enver Hoxha*  
*Nexhmije Hoxha*

*Vepra, vëll. 42, f. 278*

**TELEGRAM DËRGUAR  
ZOTIT SOTIR PANDO, AUSTRALI**

**19 dhjetor 1969**

Sotir Pando,

Ju falënderoj nga zemra për letrën që më dërguat me shprehje aq prekëse për atdheun e rilindur që shkon çdo ditë përpara në rrugën e begatisë dhe lumturisë së popullit ku e udhëheq Partia. Shqipëria e re është atdheu edhe i gjithë shqiptarëve të ndershëm e patriotë që jetojnë në vise të tjera të botës, prandaj i dashur bashkatdhetar kurrë mos e ndiej veten vetëm, pse atdheu, populli dhe Partia i duan si bijtë e vet shqiptarët e mërguar.

Të uroj me këtë rast ty dhe gjithë bashkatdhetarët patriotë të Australisë gëzuar Vitin e Ri 1970 dhe suksese në veprimtarinë tuaj patriotike.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR SHOKUT SHABAN  
REXHË HAJDARMATAJ NË KOOPERATIVËN  
BUJQËSORE TË KATUNDIT ZOGAJ**

*Tropojë*

26 janar 1970

I dashur shoku Shaban,

Këndova me kënaqësi letrën me të cilën ti falënderon Partinë dhe pushtetin për vlerësimin që të bënë, duke të dhënë titullin e lartë të «Herroit të Punës Socialiste» dhe aty njëkohësisht zotoheshe se do të jesh gjithmonë i gatshëm për të kryer me nder detyrat për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut.

Puna shembullore që ke bërë e vazhdon të bësh dhe ngröhtësia e letrës që më dërgove, më nxitën dëshirën të të përgjigjem me këtë letër. Partia dhe populli, duke çmuar lart optimizmin tënd revolucionar, vullnetin e hekurt për të ka-

përçyer vështirësitë e rënda që të sjell prerja e të dyja këmbëve, si dhe rezultatet që ti shok i vlefshëm ke arritur në punë me përpjekje të vazhdueshme, të ndërgjegjshme e të palodhshme, të nderuan me atë dekoratë të lartë. Ky nder i merituar që t'u bë, sikurse më shkruan, të ka dhënë krahë për të punuar akoma më mirë e më me vendosmëri aty ku je që jeta e kooperativistëve të Zogajt nga viti në vit, si kudo në vendin tonë, të bëhet më e gëzuar e më e lumtur.

Në të kaluarën njerëzit me të meta dhe gjymtime fizike, duke mos pasur asnjë përkrahje nga shoqëria e vjetër që përmbysëm me Luftën Nacionalçlirimtare dhe revolucionin popullor, endeshin të përbuzur lart e poshtë dhe katandiseshin në lypës rrugësh. Sot shoqëria jonë socialiste u jep dorën dhe i ngre lart, i ndihmon materialisht dhe moralisht që këta të ruajnë dinjitetin si njerëz dhe kur punojnë me vullnet e heroizëm si ti, i bën deri heronj.

U gëzova, gjithashtu, së tepërmi që ti, krahas punës shembullore në kooperativë, ndjek me zell shkollën 8-vjeçare me korrespondencë, sepse e ke të qartë se ndërtimi me sukses i socializmit në vendin tonë, përveç përpjekjeve të tjera të shumanshme, kërkon edhe dije e kulturë.

Veprim revolucionar është edhe ai që ti, së bashku me shoqet dhe shokët merr pjesë në stërvitjet që bëni për përgatitjen ushtarake, çka tregon sa drejt e kupton ti detyrën e mbrojtjes së atdheut nga çdo armik.

Gjithë puna, qëndrimet dhe veprimtaria jote revolucionare në të mirën e popullit dhe të atdheut edhe pse në kushte të vështira fizike, janë një shembull i lartë i vënies në jetë me këmbëngulje të mësimeve dritëdhënëse të Partisë dhe burim frymëzimi për gjithë punonjësit e vendit tonë. Prandaj të përgëzoj për sa ke bërë dhe po bën dhe me këtë rast të uroj nga zemra suksese në punë, shëndet dhe gëzime në jetë ty, familjes tënde dhe gjithë bashkëfshatarëve të tu kooperativistë.

Yti

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**TELEGRAM NGUSHËLLIMI, DËRGUAR  
SHOKUT HAKI KETA**

Tiranë

19 shkurt 1970

Shoku Haki,

Na preku thellë lajmi i vdekjes së nënë Eminesë, aq e dashur dhe e shtrenjtë për ju dhe për të gjithë ne shokët e luftës që kemi parë tek ajo një patriote të zjarrtë e luftëtare të vendosur e besnike të çështjes së Partisë dhe të popullit.

Me këtë rast kaq të hidhur vijnë t'ju shprehim ngushëllimet tona më të përzemërta.

*Enver Hoxha  
Nexhmije Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR 300 GRAVE TË KUVENDIT TË KUKËSIT**

**28 korrik 1970**

Të dashura shoqe dhe motra,

Më gëzoi pa masë letra<sup>1</sup> që më dërguat në emër të grave kuksiane të cilat vazhdojnë shkollën 8-vjeçare pa shkëputje nga puna. Sa më shumë radhë të letrës që këndoja, aq më tepër më shtohet gëzimi dhe zemra m'u bë mal kur pashë se nga 2 400 shoqe kaluan klasën 1 890 prej tyre. T'ju them të drejtën një ndjenjë e thellë respekti më pushtoi zemrën për ju, gratë e mrekullueshme, që jo vetëm punoni e luftoni, por me këmbëngulje vazhdoni edhe të mësoni.

Unë isha në dijeni të iniciativës suaj porsa

---

1. 300 gratë kuksiane të mbledhura në kuvend i shkruan shokut Enver Hoxha për përfundimin me sukses të vitit shkollor pa shkëputje nga puna.

e filluat shkollën. Kur vizitova rrethin e Kukësit<sup>1</sup>, për të cilin ruaj kujtime të bukura, shokët e Partisë dhe të pushtetit më njoftuan se si luftonit ju e ç'vendosmëri ju karakterizonte për të fituar klasën. Dhe ja, kjo ditë erdhi. U gëzova shumë kur, bashkë me letrën, pashë një listë të gjatë me emrat dhe firmat tuaja, të cilat më sollën ndër mend atë gjendje të rëndë, kur, dikur, gratë e Shqipërisë, duke qenë analfabete, në vend të firmës, vinin nëpër letra gishtin e dorës të lyer me bojë. Por ajo kohë ka marrë fund e s'kthehet kurrë më. Partia na ka çelur të gjithëve sytë, na kthjellon mendjen, na ndriçon jetën, na ka nxjerrë nga errësira në dritë.

Ju, gratë e Kukësit, që unë ju njoh nga afër, jeni trimëresha, si të gjitha gratë e vendit tonë, dhe e kuptoni fare mirë se për të ndër-tuar socializmin, nuk mjafton trimëria, por duhet edhe dituria, e cila nuk është një stoli që na zbukuron, por një armë e fortë që na ndihmon si të punojmë e të luftojmë më mirë për lulëzimin dhe mbrojtjen e atdheut tonë të dashur. Kjo është edhe arsyeja që ju mësoni me një zell aq të madh. Sa gjë e bukur është kjo, sa e lartë dhe fisnike është për njeriun tonë që, bashkë me kazmën në dorë dhe pushkën në sup, mban edhe librin në xhep! Të tilla jeni edhe ju, shoqet dhe motrat tona të luftës, të punës e të shkollës, që keni sulmuar

---

1. Shoku Enver Hoxha vizitoi rrethin e Kukësit më 27 maj 1970.

me të tëra forcat si në frontin e prodhimit e të mbrojtjes ashtu edhe në atë të mësimit. Kjo e ngre akoma më lart personalitetin e gruas shqiptare dhe është një shprehje e gjallë e luftës që bën ajo, nën udhëheqjen e Partisë, për të realizuar në jetë barazinë e plotë të gruas me burrin. Jam i bindur, gjithashtu, se në këtë rrugë keni gjetur e do të gjeni akoma më shumë edhe përkrahjen e burrave dhe të pjesëtarëve të tjerë të familjeve tuaja.

Partia e kupton sa vështirë e kanë gratë për të vazhduar shkollën pa shkëputje nga puna, pasi e vërteta është se pas punës në arë, në fabrikë apo në klasë, ato i presin edhe mjaft punë të shtëpisë, i presin kalamajtë, i presin detyra shoqërore. Por jeta tregon se me gjithë këto vështirësi të mëdha, gratë revolucionare të vendit tonë çajnë përpara me vullnet e guxim dhe dalin kudo fitimtare, pasi ato i prin Partia e tyre e dashur, vija e saj e drejtë marksiste-leniniste.

Ju e thoni edhe vetë, të dashura shoqe e motra kuksiane, se tani e ndieni më shumë nevojën për të mësuar dhe keni vendosur ta mbaroni patjetër shkollën 8-vjeçare. Ky është një shembull i lartë i lavdërueshëm, i cili, bashkë me shembullin e mijëra grave të vendit tonë që vazhdojnë shkollat pa shkëputje nga puna, do të ndiqet me siguri edhe nga mijëra e mijëra të tjera. Unë kam besim të patundur se ju dhe gjithë shoqet e tjera, me po atë vrull që punoni, edhe do të mësoni dhe zgjedhjet e 20 shtatorit, që janë ak-

sioni më i madh politik i kohës, ashtu si gjithë populli ynë, do t'i pritni duarplot.

Ju uroj nga zemra ta mbaroni me sukses shkollën 8-vjeçare!

Shumë të fala e shëndet juve dhe gjithë mo-trave e vëllezërve të dashur kuksianë.

Juaji

*Enver Hoxha*

«Zëri i popullit», nr. 179 (6843),  
29 korrik 1970

**LETËR DREJTUAR 40 VAJZAVE  
TË RRETHIT TË ELBASANIT QË MBARUAN  
TË PARAT SHKOLLËN 3-VJEÇARE  
TË MAMIVE**

12 shtator 1970

Të dashura shoqe,

Këndova me kënaqësi të veçantë letrën që më dërguat, në të cilën pashë atë dashuri të zjarrtë që vlon në zemrat tuaja të reja për Partinë tonë të shtrenjtë, qartësinë e sinqeritetin tuaj për vijën e saj të drejtë, optimizmin revolucionar për jetën tonë socialiste dhe pasionin e madh për profesionin tuaj të nderuar.

Fjalët që më çuat në letër sollën tek unë një tog lajmesh të mira, që më gëzuan shumë.

Në radhë të parë dëshiroj t'ju përgëzoj me gjithë zemër për gatishmërinë që treguat duke shkuar të shërbeni atje ku e kërkojnë interesat e atdheut. Ky është një shembull i lartë i atij patriotizmi të shkëlqyer që karakterizon mbarë

rininë e vendit tonë, në flamurin e kuq të së cilës është shkruar si një betim «Atdheu mbi të gjitha!». Ju, të dashura shoqe, që jeni brumosur me mësimet e Partisë, keni zbatuar pikërisht këtë betim, duke vënë mbi gjithçka interesat e përgjithshëm të popullit, pasi e dini që atje gjen garancinë e plotë edhe lumturia personale. Prandaj janë për t'u lavdëruar gatishmëria dhe vendosmëria juaj, që shkuat t'i shërbeni popullit me ndërgjegje të lartë revolucionare gjer në skajet më të largëta të rrethit.

Në letër më njoftoni, gjithashtu, se çdo kooperativë bujqësore në Elbasan, për nder të zgjedhjeve të reja të pushtetit dhe të gjykatave popullore, ndërtoi me forcat e veta shtëpinë e lindjes. Kjo është një punë tjetër e bukur, një fitore e re në vargun e gjatë të fitoreve që ka arritur populli patriot i atij rrethi. Shumë njerëz të kaluar nga mosha, kur shohin këtë kujdes të Partisë për nënën, nuk mund të mos kujtojnë ato kohë të vështira kur gruaja lindte në shtëpi pa asnjë ndihmë mjekësore nga ana e shtetit dhe foshnja binte në prehrin e ndonjë gjysheje analfabete, e cila edhe kërthizën ia priste me ndonjë gërshtë të ndryshkur. Ç'të bënte e shkreta gjyshe! Ajo, duke mos pasur mundësi të tjera, aq sa dinte, aq edhe bënte. Në ato kushte të prapambitura, për faj të regjimeve antipopullore, të cilave nuk u bëhej aspak vonë se si do të lindnin gratë e popullit, shëndeti i lehonës dhe i fëmijës së saj të shtrenjtë ishte vazhdimisht në rrezik.

Por tani kohët kanë ndryshuar. Partia, duke e quajtur njeriun kapitalin më të çmuar, ka punuar, përveç të tjerave, për të lehtësuar sa më shumë jetën e gruas dhe tani arritëm që deri në çdo fshat të kemi shtëpinë e lindjes. E ku ka më mirë për një grua shtatzënë sesa të shkojë për të lindur gjënë më të dashur të saj, fëmijën, në maternitet? Atje është mamia, jeni ju, vajzat e mia të dashura, që mësuar për këtë qëllim, duke kryer tre vjet shkollë. Por bashkë me detyrën që keni si mami, ju duhet të jeni njëkohësisht edhe agjitatore të zjarrta të Partisë. Me punën tuaj të palodhur ju do t'i mësoni gratë me normat higjiëno-sanitare që duhet të zbatojnë para, gjatë dhe pas lindjes, do t'i udhëzoni ato si të vijnë herë pas here të këshillohen me ju apo në konsultore, si të kujdesen për shëndetin e fëmijës, për ushqimin e regjimin e tij dhe ajo që ka rëndësi është se do të punoni për ta bindur çdo grua shtatzënë që të vijë të lindë në maternitet, pikërisht aty ku shërbeni ju.

Sa shumë më gëzuar me lajmin se ju pritët fëmijët e parë dhe, bashkë me të qarat e tyre, patë edhe buzëqeshjen e nënave! Ju keni të drejtë të ngazëlloheni e të krenoheni për këtë, pasi në shtëpitë e lindjes përtërihet jeta e njeriut. Aty lindin filizat e rinj, të cilët do të rriten e do të lulëzojnë në trungun e gjallë të jetës sonë, lindin ata që nesër do të punojnë e do të drejtojnë në atdheun e tyre të shtrenjtë dhe do ta shpien

përpara revolucionin tonë fitimtar, që udhëheq me lavdi Partia jonë e dashur.

Duke përfunduar, ju uroj shëndet e suksese në detyrën tuaj të re aq shumë fisnike!

Ju përqafoj si vajzat e mia

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 44, f. 155*

## LETËR DREJTUAR SHOKUT HAKI TOSKA

19 shtator 1970

I dashur shoku Haki,

Jam shumë i gëzuar nga lajmet që më japin, se nuk u gjet ndonjë gjë shqetësuese në shëndetin tënd, të gjitha do të kapërcehen me sukses. Çdo gjë bëje deri në fund, që të kthehesh me plot shëndet dhe të bëhet «kyç e liga» siç themi ne andej.

Në familje i ke shumë mirë, kam shkuar i kam bërë vizitë Lirisë. Të gjithë shokët janë mirë.

Mirupafshim së shpejti.

Të përqafoj

*Enver*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR FOTOGRAFIT GEGË MARUBI

29 shtator 1970

I dashur shoku Gegë Marubi,

Me letrën që më dërgove dhe nga shkrimi i Fadil Krajës, botuar në gazetën «Zëri i popullit», mësova se ju i dhuruat shtetit fototekën 85-vjeçare, që pasqyron një histori të tërë të popullit tonë, për të cilën ati juaj, i nderuari Kel Marubi, gjatë tërë jetës së tij, i udhëhequr nga ndjenja patriotizmi, punoi për të me aq kujdes, pasion e durim. Ti, i dashur Gegë, djali i tij, ndoqe me vëmendje, ruajte, zhvillove dhe e pasurove më tej veprën e babait, derisa e bëre fototekën 85-vjeçare, të cilën ia fale më së fundi pushtetit popullor. Ju përgëzoj për këtë gjest patriotik, që e çmon shumë jo vetëm populli i rrethit të Shkodrës, por edhe i gjithë Shqipërisë, dhe që do të frymëzojë edhe patriotë të tjerë që ruajnë vlera të kësaj natyre për të mirën e atdheut e të popullit tonë.

Tani organet e pushtetit dhe të Partisë kanë për detyrë që, në bashkëpunim me ju, ta ruajnë

të paprekur këtë pasuri. Kjo kërkon, në radhë të parë, të bëhet inventari shkencor i të gjitha materialeve, me qëllim që as gjëja më e vogël të mos humbasë, por gjithçka që ekziston në këtë fototekë të vlefshme të shfrytëzohet në interes të popullit në mënyrë rigoroze, të organizuar mirë dhe plot përgjegjësi.

Sigurisht, ju vetë është mirë të vazhdoni të jeni në krye të fototekës, së bashku me vajzën tuaj, e cila, pavarësisht se tani është bërë inxhinieri e kryen edhe funksione të tjera shtetërore, kam bindjen se do të gjejë kohë për t'u interesuar edhe për fototekën. Megjithatë, në qoftë se për kryerjen e kësaj pune do të jetë e nevojshme të shtohet edhe ndonjë ndihmës i kualifikuar, me pëlqimin tuaj, pushteti në rreth mund të vendosë, duke u kujdesur njëkohësisht për të përcaktuar rregulla të plota rreptësisht të zbatueshme ashtu si për çdo arkiv tjetër të rëndësishëm shtetëror.

Unë kam porositur organet e Partisë dhe të pushtetit në rreth që të kujdesen për të marrë të gjitha masat e nevojshme mbrojtëse nga çdo rrezik që mund të dëmtojë fototekën.

Ju uroj shëndet dhe gjithë të mirat juve, vajzës dhe gjithë familjes!

Juaji

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 44, f. 262*

## **TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR SHEFIKE DHE SHERO BAKIRIT**

*Gjirokastrë*

**23 janar 1971**

Shefike e Shero Bakirit,

Vdekja e papritur dhe e parakohshme e shokut tonë të dashur, Subiut<sup>1</sup>, na hidhëroi jashtëzakonisht shumë. Në këtë humbje kaq të dhimbshme për Partinë dhe familjen tuaj me mendje dhe me zemër jemi në këto çaste pranë jush dhe ju shprehim me këtë rast ngushëllimet më të

---

1. Subi Bakiri — një nga komunistët e parë të Gjirokastrës, shtëpia e tij bazë e Luftës Nacionalçlirimtare. Në atë kohë ishte kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Gjirokastrës.

përzemërta, të bëni durim e t'ju rrojnë fëmija.  
Kujtimi i tij do të jetë i paharruar për ne.

*Enver Hoxha  
Nexhmije Hoxha*

Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë

I dashur shoku Jani,

Në fadet e revistës «Studime filologjike» bë-  
rë pas here kam kënduar me interes materialë  
leksiko-frazologjike të mbedhura nga gjuhë  
popullore prej dëmtuesve të pasonuar, në radhë  
e të cilëve bën pjesë edhe ti. Të përgjëzohet për  
këtë punë të vlefshme në shërbim të shkencës  
dhe të gjuhës sonë kombëtare.

Shokët e Institutit të Historisë e të Gjuhës  
sisë, kur u kërkova shpjegime pas letrës që më  
dërgove, më informuan se në arkivin e tyre ka-

I Jani Nushi mbedhës i pasonuar folklori. Në vitin 1953  
në koleksionin «Mbedhës folklori» doli një vëllim me folklor të  
Janit Nushi, mbedhur prej tij.

**LETËR DREJTUAR  
SHOKUT JANI NUSHI (ZEGALI)<sup>1</sup>**

*Lagjja «Kongresi i Lushnjës», Lushnjë*

**28 prill 1971**

I dashur shoku Jani,

Në faqet e revistës «Studime filologjike» herë pas here kam kënduar me interes materiale leksiko-frazeologjike të mbledhura nga goja e popullit prej qemtuesve të pasionuar, në radhët e të cilëve bën pjesë edhe ti. Të përgëzoj për këtë punë të vlefshme në shërbim të shkencës dhe të gjuhës sonë kombëtare.

Shokët e Institutit të Historisë e të Gjuhësisë, kur u kërkova shpjegime pas letrës që më dërgove, më informuan se në arkivin e tyre ru-

---

1. Jani Nushi mbledhës i pasionuar folklori. Në vitin 1982 në kolanën «Mbledhës folklori» doli një vëllim me folklor të zonës së Myzeqesë, mbledhur prej tij.

hen me kujdes, së toku me origjinalin, 8 000 njësi skedaresh dhe, përveç dy botimeve që kanë dalë deri tani, në bazë të mundësive tona, të tjera do të botohen në të ardhmen.

Dëshiroj me këtë rast të uroj shëndet e punë të mbarë për të përpunuar gjithë materialin e grumbulluar, pavarësisht nga mosha që nuk është në gjendje të thyejë vullnetin e njeriut të punës, të lidhur ngushtë me jetën e popullit, siç je ti dhe të brumosur me mësimet e urta të Partisë.

Gjithë të mirat

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR  
SHOKUT SHYQYRI KANAPARI**

*Kavajë*

**21 shtator 1971**

I dashur Shyqyri,

Letra që më dërgove zgjoi në kujtesën time jehonën e atyre ditëve kur zotimi yt i guximshëm u bë i njohur në të gjitha anët e vendit tonë<sup>1</sup>. Partia kishte besim dhe priste që një ditë të

---

1. Në vitin 1955 Heroi i Punës Socialiste Shyqyri Kanapari ishte zotuar që me të njëjtin traktor të bënte 8 000 hektarë unitet hamullor; në vitin 1962 u zotua të bënte 20 000 hektarë unitet hamullor pa riparim të përgjithshëm të traktorit; pas Kongresit të 5-të të PPSH, u zotua që me të njëjtin traktor të bënte 30 000 hektarë unitet hamullor. Edhe këtë zotim ashtu si gjithë zotimet e tjera e tejkaloi duke bërë 30 450 hektarë unitet hamullor dhe duke i kursyer shtetit 216 450 lekë në riparime. Shoku Enver Hoxha i ka dërguar

njoftohej mbi zbatimin e këtij zotimi. Dhe ja, kjo ditë erdhi. Ti na dhe një lajm gazmor, që na e bën zemrën mal: me të njëjtin traktor realizove jo 8 000 hektarë unitet hamullor, sa u zotove në fillim, as aq sa u zotove më vonë, por 30 450 hektarë dhe do të vazhdosh të punosh akoma duke i zgjatur sa më shumë jetën traktorit. Të përqafoj e të përgëzoj nga zemra për këtë sukses të rëndësishëm.

Duke menduar për t'iu përgjigjur letrës tënde, më del përpara figura e dashur e traktoristit, përfaqësuesit të klasës punëtore në fshat, shok pune i kooperativistëve, që lufton pa u lodhur ditën dhe natën, duke çarë e lëvruar fushat tona, duke shpyllëzuar e çelur toka të reja, që mendja dhe duart e arta të punonjësve tanë i bëjnë të gjelbërojnë e të lulëzojnë nga prodhimet bujqësore çdo vit e më të mëdha. I tillë je edhe ti, shoku i dashur Shyqyri, traktoristi ynë i respektuar, Heroi i Punës Socialiste, që fjalët nuk i ndan nga veprat, që ndodhesh gjithmonë mbi timonin e traktorit, të cilin e do aq shumë dhe e ruan si dritën e syve.

Puna jote e lavdërueshme, guximi për të marrë zotime revolucionare, besa për të mbajtur fjalën e dhënë, thjeshtësia dhe urtësia, vendosmëria dhe optimizmi për të ecur përpara e për të korrur kurdoherë suksese të reja — të gjitha

---

shokut Shyqyri Kanapari një letër përgëzuese për sukseset e arritura, më 25 qershor 1965. (Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 30, f. 129.)

këto janë një shembull i lartë frymëzimi për cilindo, por sidomos për traktoristët tanë, të cilët kanë ç'të mësojnë nga ti, nga cilësitë e karakterit tënd e të shokëve si ti, si Budo Isufi, Ibrahim Hidri e të tjerë, nga vrulli juaj revolucionar, nga eksperiencia juaj e pasur.

Të uroj shëndet e suksese të reja në punë ty dhe gjithë traktoristëve të tjerë për të mirën e popullit tonë të mrekullueshëm, për begatinë dhe çelikosjen e atdheut tonë socialist, për t'i pritur duarplot e ballëlart 30-vjetorin e Themelimit të Partisë dhe Kongresin e 6-të të saj.

Shumë të fala

Juaji

*Enver Hoxha*

*Vepra, vëll. 46, f. 493*

## **LETËR NGUSHËLLIMI DREJTUAR FAMILJES SË KOLË KAÇORRIT**

*Mirditë*

**23 shtator 1971**

Të dashur Kolë e Mara Kaçorri dhe ju  
shtatë bijat e tyre,

E dashur Davë,

U preka thellë kur shokët e Partisë më njoftuan për vdekjen e Frrokut<sup>1</sup>, njeriut të shtrenjtë të zemrave tuaja, shokut tonë të dashur komunist, anëtar besnik i Partisë sonë të lavdishme. Më pas këtë lajm që më hidhëroi shumë e mora edhe nëpërmjet letrës suaj, ku ju më shkruani thjesht, çiltër, plot me ndjenja të fuqishme dhe njëkohësisht me dhimbjen aty shprehni edhe for-

---

<sup>1</sup> Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSH i dha atij titullin e lartë «Hero i Punës Socialiste».

cën, kurajën, durimin e krenarinë për Frrokun tuaj dhe të Partisë, që ra me nder si trim në krye të detyrës.

E shkurtër ishte jeta e Frrokut, por vepra dhe akti i tij i fundit për zhblokimin e pusit deri në sakrificën më të lartë do të mbeten një shebull i ndritur jo vetëm për shokët e tij të afërt, por edhe për gjithë njerëzit tanë. Që pesëmbëdhjetëvjeçar ai filloi punën në gjeologji dhe më pas vazhdoi profesionin e nderuar të minatorit, duke u gjendur kurdoherë në krye të detyrës edhe kur i takonte të pushonte. Mbi tokë e nën tokë ai punoi pa u lodhur me një ndërgjegje të lartë socialiste, duke luftuar kurdoherë për realizimin dhe tejkalimin e detyrave që i ngarkohehin. Zemra e re e këtij biri të Mirditës dhe të Shqipërisë gufonte nga gëzimi kur shikonte vagonët plot me bakër, gjë që ia shumëfishonte forcat për të punuar e prodhuar gjithnjë më shumë për popullin. Të tillë e kishte edukuar atë Partia. Por një meritë për rritjen dhe edukimin e Frrokut me cilësi të tilla keni edhe ju, prindërit e tij, që e mbrujtët atë me frymën e Partisë, me mësimet e saj, të cilat ai i bëri flamur dhe i zbatoi më së miri në jetë deri në frymën e fundit. Ai nuk ishte vetëm një minator i dalluar, por dhe aktivist i shquar shoqëror, një komunist i vërtetë. Prandaj hallall e pastë qumështin me të cilin e mëkove ti, motra ime Marë, nënë trimëreshë e Frrokut, që nuk derdhe lot për humbjen e papritur të djalit të vetëm e të shtrenjtë!

Edhe me ty mburret Partia, i dashuri Kolë, që në këto ditë të rënda për familjen tuaj qëndrova i fortë përpara dhimbjes së madhe, nuk u ligështova, por rroka automatikun e Frrokut dhe shkova për ta zëvendësuar atë në stërvitje dhe, si kurdoherë, qëndron i gatshëm për të përmbushur çdo detyrë të Partisë, ashtu siç bënte yt bir, që ti e rrite dhe e mësove të ecte në rrugën e saj.

E fortë dhe zemërçelike qëndrova, o Davë, bashkëshortja e Frrokut, po kështu edhe ju shtatë motrat e tij, krenare për emrin dhe veprën e burrit dhe vëllait tuaj, që lumturinë personale dhe të familjes e gjente vetëm në luftën dhe punën për të siguruar lumturinë e mbarë popullit dhe që kishte vënë të gjitha forcat për t'i pritur duarplot e ballëllart 30-vjetorin e Partisë dhe Kongresin e 6-të të saj.

Ideali më i lartë i Frrokut ishte t'i shërbente me besnikëri deri në fund Partisë së dashur, si anëtar i denjë i së cilës ai luftonte gjithnjë në vijën e parë derisa zemra i pushoi së rrahuri në Minierën e Kurbneshit, që e donte aq shumë. Në mendjen dhe zemrën e birit, bashkëshortit dhe vëllait tuaj ishte skalitur thellë parimi revolucionar i Partisë: Interesi i përgjithshëm mbi gjithçka.

Partia nuk do ta harrojë kurrë anëtarin e saj të vendosur, Frrok Kolë Kaçorri<sup>1</sup>. Komu-

---

1. Për të përjetësuar kujtimin e tij me vendim të Këshillit të Ministrave të RPSSH në korrik 1985 Ndërmarrjes Minerare të Kurbneshit iu dha emri i Heroit të Punës Socialiste «Frrok Kolë Kaçorri».

nistët, brezat e sotëm dhe të nesërm do të frymëzohen nga figura e karakteristikat e tij dhe do të mësojnë shumë nga puna e tij heroike.

Me këtë letër vij aty pranë jush t'ju sjell ngushëllimet më të përzemërta të Partisë dhe të miat.

Juaji

**Enver Hoxha**

*Vepra, vëll. 46, f. 510*

**TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT  
MYSLIM PEZA**

*Paris*

**30 prill 1972**

I dashur shoku Myslim,

Të uroj nga zemra 1 Majin, festën e madhe të të gjithë klasës punëtore të botës dhe tonës. Të uroj njëkohësisht 73-vjetorin e ditëlindjes, të na rrosh sa malet për të mirën e Partisë dhe të popullit dhe të na kthehesh me shëndet të plotë në atdhe, si kurdoherë pranë shokëve dhe familjes që të duan dhe të respektojnë aq shumë. Nga shtëpia i ke shumë mirë.

Të përqafoj

*Enver*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

TELEGRAM DËRGUAR SHOKUJ  
**LETËR DREJTUAR GRUPIT TË KËNGËVE  
KARAKTERISTIKE KORÇARE**

31 tetor 1972

Të dashur shokë,

Ju falënderoj nxehhtësisht për ftesën që më bëtë me rastin e 50-vjetorit të krijimit të grupit tuaj, së cilës nuk iu përgjigja dot në kohë, mbasi isha i zënë në Kongresin e 6-të të BRPSH, ku gjithashtu isha ftuar. Me këtë rast dëshiroj të përgëzoj gjithë pjesëtarët e kolektivit tuaj aktiv për kontributin e çmueshëm që kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin nëpërmjet këngës dhe muzikës popullore në transmetimin e traditave patriotike dhe revolucionare të popullit tonë te brezat pasardhës.

Nëpërmjet këngës dhe muzikës së tij të bukur e plot frymëzim, në ditët e mira dhe të vështira, populli ynë ka shprehur me shumë art ndjenjat e tij të pastra, dashurinë për atdheun e shtrenjtë, shpirtin e heroizmit dhe të sakrificës

dhe urrejtjen për armiqhtë. Kënga jonë patriotike popullore në çdo kohë ka pasqyruar botën reale shqiptare në rrethana të caktuara historike dhe në zhvillimin e saj të pandërprerë, ajo i ka shërbyer kurdoherë edukimit revolucionar të njerëzve tanë. Ja arsytet për të cilat Partia konsideron si shumë të dobishme dhe fisnike ruajtjen, zhvillimin e mëtejshëm dhe përhapjen e traditave të mira të trashëguara nga e kaluara, duke përfshirë edhe këngët e muzikën popullore.

Ju uroj shëndet dhe suksese të reja në veprimtarinë tuaj të palodhur dhe shpreh bindjen se edhe paskëtaj puna juaj do t'u shërbejë argëtimimit dhe edukimit patriotik e revolucionar të masave, veçanërisht të rinisë sonë, që është aq shumë e etshme për të shijuar dhe për të çuar gjithnjë e më përpara artin tonë popullor.

Juaji

*Enver Hoxha*

«Mbi letërsinë dhe artin»,  
f. 323

## LETËR DREJTUAR SHOKUT MITI BOZO

4 nëntor 1972

Shoku Miti Bozo,

E studiova me shumë kujdes raportin që na paraqite «Mbi disa probleme themelore organizativo-ekonomike të ekonomive bujqësore» dhe, me sa e kuptoj unë këtë problem kaq të rëndësishëm, studimin në fjalë e gjej shumë të thelluar dhe me konkluzione të drejta, të arsyetuara shkencërisht dhe në bazë të orientimeve të Komitetit Qendror.

Kur e zura kalimthi në gojë, në mbledhjen e fundit të Byrosë, studimin që po bëhej në kooperativën e Plasës, dija vetëm disa gjëra preliminare që më kishte thënë gojarisht shoku Haki [Toska]. Tash me studimin që i bëra relacionit tuaj, jam i qartë për punën e madhe e të frytshme që keni bërë ju dhe gjithë grupi që ndërmori këtë studim.

Unë jam i mendimit si dhe ju, që Ministria e Bujqësisë duhet ta ketë parasysh si rrugërrëfyes këtë studim dhe të fillojmë në gjerësi nga puna, në radhë të parë në NB, në kooperativat e tipit të lartë, por edhe në kooperativa të bashkuara.

Nuk mund të prononcohem me kompetencë për çështjen e qarkullimit dhe të renditjeve, por si për këto dhe për të tjerat, unë jam me konkluzionet e grupit të studimit.

Ju përshëndes për punën e mirë.

*Enver*

«Për shkencën (Përmbledhje  
veprash)», vëll. 1, f. 495

**LETËR DREJTUAR BAJAME E ISLAM SOPIT,  
PUNËTORË NË FABRIKËN E MIELLIT**

*Durrës*

**13 nëntor 1972**

Të dashur Bajame e Islam,

Lindja e fëmijës suaj të 12-të më gëzoi edhe mua. Ju keni të drejtë të jeni shumë të lumtur për këtë ngjarje jo vetëm si prindër të 12 fëmijëve, por edhe pse jeta e djalit tuaj të porsalindur<sup>1</sup> filloi në ato ditë të zjarrta të Kongresit të

---

1. Prindërit i vunë atij emrin Gazmend. Në Kongresin e 9-të të BGSH, që zhvilloi punimet në qytetin e Durrësit nga data 1-3 qershor 1983, Gazmendi ishte midis pionierëve që përshëndetën kongresin dhe u takua me shokun Enver Hoxha.

6-të të BRPSH, që u zhvillua në Durrës, në vendlindjen e tij.

Fëmijët janë gëzimi ynë, pse na zbukurojnë shtëpitë e na lulëzojnë jetën. Ata janë edhe pasardhësit tanë që do ta ngrenë akoma më lart atdheun tonë socialist. Prandaj, bashkë me kënaqësinë e madhe që ndiejnë për fëmijët që lindin dhe rritin, prindërit kanë edhe detyrime që ata të bëhen të denjë e të vlefshëm për familjen, shoqërinë dhe Shqipërinë tonë të dashur. Dhe kështu edukohen sot fëmijët e vendit tonë, zemra e vogël e të cilëve këndon për Partinë, që kujdeset aq shumë për ta bërë jetën e tyre gjithnjë më të bukur.

Në punën e madhe që zhvillohet te ne për mirërritjen dhe edukimin e drejtë të fëmijëve një rol të veçantë luan familja. Ajo është shkolla e parë e edukimit të fëmijëve dhe prindërit janë mësuesit dhe edukatorët e tyre. Kur të rritet fëmija e 12-të, ju, natyrisht, do t'i tregoni atij gjithçka që s'ka jetuar, që nga traditat e bukura të lashta të popullit tonë, nga ngjarjet e Luftës Nacionalçlirimtare partizane, në radhët e të cilëve ka qenë edhe babai i tij, Islami, e deri në ditët tona. Unë jam i bindur se ju si prindër, do të përpiqeni t'i rritni fëmijët ashtu si dëshiron Partia, sot të zellshëm në mësimet dhe nesër punëtorë të dalluar, siç jeni vetë, qytetarë besnikë të Republikës sonë Popullore.

Me këtë rast, i uroj fëmijës suaj të 12-të shëndet e jetë të gjatë dhe ju, prindërve si dhe vëllezërve e motrave të tij gëzim e lumturi familjare dhe suksese në punë e në mësim.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR  
STILIAN EFTIMIUT**

*Bukuresht*

**Vlorë, 28 nëntor 1972**

Me hidhërim të madh mësuam për vdekjen e vëllait tuaj të dashur, shkrimtarit dhe akademikut të shquar të RS të Rumanisë, Viktor Eftimiut.

Lajmi i vdekjes së Viktor Eftimiut, të këtij biri të ndritur të truallit shqiptar që e ngriti aq shumë me penë dhe e deshi aq shumë me zemër vendlindjen e tij, ka pikëlluar thellë zemrat e gjithë popullit shqiptar.

Me këtë rast, në emër të popullit shqiptar dhe timin personal, ju lutem pranoni ngushëllimet tona më të thella.

Me veprimtarinë e tij, Viktor Eftimiu ka kontribuar fuqimisht në forcimin e lidhjeve miqësore midis popullit rumun dhe popullit shqip-

tar. Kujtimi dhe vepra e Viktorit tonë të dashur do të mbeten përjetë të paharruara dhe do të ndritin si një yll i pashuar në qiellin e patriotizmit shqiptar.

*Enver Hoxha*

«Zëri i popullit», nr. 286 (7578),  
29 nëntor 1972

Bucuresita

Vlorë, 28 nëntor 1972

Me hidhërim të madh mësuam për vdekjen e shokut tuaj të dashur, shkrimtarit dhe akademikut të shquar të RS të Rumanisë, Viktor Eftimit. Kujtimi i vdekjes së Viktor Eftimit, të këtij dritë ndritur të trusllit shqiptar që e rregullisht shpreh me penë dhe e dëshoi sa shumë me zemër vërtetshjen e tij, ka përkthyer thellë zemrat e gjithë popullit shqiptar. Në këtë rast, në emër të popullit shqiptar dhe të personit të jetës së tij, ju lutem pranoni ngushëllimet tona më të thella. Me veprimtarinë e tij, Viktor Eftimit ka kontribuar fuqimisht në forcimin e lidhjeve miqësore midis popullit rumun dhe popullit shqiptar.

## LETËR DREJTUAR SHOKUT SPIRO LERA

Korçë

5 janar 1973

I dashur Spiro,

Në mes letrave e telegrameve të shumta që më erdhën nga një numër i madh kolektivash e punonjësish me rastin e Vitit të Ri 1973, ishte edhe letra jote, me të cilën më njoftoje për realizimin e planit të pestë pesëvjeçar, tre vjet e njëmbëdhjetë ditë para afatit. Ky lajm, që ishte një dhuratë e bukur në prag të Vitit të Ri, të gjithëve na i mbushi zemrat plot gëzim.

Me zotimin e guximshëm, sipas të cilit «planin pesëvjeçar do ta realizoje në dy vjet e gjysmë», ti u bërë iniciator në radhët e shoferëve të vendit tonë, të cilët po punojnë tani për të rea-

lizuar para afatit planin e pestë pesëvjeçar. Por kur ti, shoku Spiro, diskutove në Kongresin e 7-të të Bashkimeve Profesionale, e shpure më përpara zotimin që more. Ti fole shkurt, me fjalë të thjeshta, siç e kanë zakon punëtorët, por ato që the buronin nga zemra e një revolucionari me «fjalë pak e punë shumë». Dhe këtë e provoi koha. Duke vënë në jetë me këmbëngulje mësimet e Partisë, me luftë e përpjekje të vazhdueshme, me ndërgjegje të lartë socialiste, ti je kujdesur për të shfrytëzuar plotësisht kohën e punës dhe për të ruajtur si dritën e syve automjetin dhe rimorkion, gjë që të dha mundësinë për të realizuar me nder zotimin që more para delegatëve të klasës punëtoare.

Të lumtë, shoku ynë i vlefshëm Spiro, që mbajte fjalën e dhënë, duke mbyllur me sukses pesëvjeçarin e pestë dhe tani po punon për llogari të planit të ardhshëm pesëvjeçar. Shembulli yt dhe rezultatet që arrite në punë janë një burim i ri frymëzimi jo vetëm për shoferët, por për gjithë punonjësit e tjerë të vendit tonë. Populli dhe Partia mburren me njerëzit e pararojës si ti, që punojnë me të gjitha forcat e trupit dhe të mendjes për lulëzimin dhe fuqizimin e atdheut tonë socialist.

Duke të përshëndetur nga zemra për suksesin e arritur, të uroj me këtë rast Vitin e Ri gëzuar, shëndet e gjithnjë suksese në punë, për të

mirën e popullit, të Partisë e të Republikës sonë Popullore.

Shumë të fala familjes dhe shokëve e shoqëve të punës.

Yti

*Enver Hoxha*

LËTR DRETTAR NËNËSVE, MËSUES  
DHE KOMUNISTËVE TË SHKOLLËS  
ANARI-

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

1971

Të dashur shokë, mësues dhe nxënës,  
Ju falënderoj për letrën që më dërguat me  
rastin e 25-vjetorit të shkollës. Kjo letër më kë-  
son edhe mua, sepse jam jo vetëm banor i kë-  
njëtës lagje, por me shkollën tuaj më lidhin  
edhe shumë kujtime familjare.  
Shpesh ime Nexhmija dhe unë, si prindërit  
gjenerimorë të shkollës - 11 Janar-  
it - de kanë mësuar tre fëmijët tanë. I lindu  
tin dhe Pranverën dhe i kanë edukuar të jenë  
njëzë të thjeshtë e të dashur me popullin, sh-  
tarë besnikë të Partisë. Edukata që kanë marrë  
në bankat e shkollës suaj nga mësues e mësues

Yti

Enver Hoxha

**LETËR DREJTUAR NXËNËSVE, MËSUESVE  
DHE KOMUNISTËVE TË SHKOLLËS  
«11 JANARI»**

Tiranë

7 maj 1973

Të dashur shokë, mësues dhe nxënës,

Ju falemnderit për letrën që më dërguat me rastin e 25-vjetorit të shkollës. Kjo festë më gëzon edhe mua, sepse jam jo vetëm banor i së njëjtës lagje, por me shkollën tuaj më lidhin edhe shumë kujtime familjare.

Shoqja ime Nexhmija dhe unë, si prindër, u jemi mirënjohës mësuesve të shkollës «11 Janari» që kanë mësuar tre fëmijët tanë, Ilirin, Sokolin dhe Pranverën dhe i kanë edukuar të jenë njerëz të thjeshtë e të dashur me popullin, ushtarë besnikë të Partisë. Edukata që kanë marrë në bankat e shkollës suaj nga mësuese e mësues

komunistë e patriotë, si Silla Gjika, Andromaqi Harito, Ollga Afezulli e të tjerë, do t'u shërbejnë fëmijëve tanë, ish-nxënës të asaj shkolle, për të qenë kurdoherë kokulur në punë e në jetë dhe të japin çdo gjë për atdheun, ashtu si qindra e mijëra nxënës të tjerë, që kanë kryer ose që do të mbarojnë në të ardhmen mësimet në atë vatrë edukimi me tradita revolucionare.

Sukseset e shkollës suaj janë një pjesë e sukseseve të shumta të arritura nën udhëheqjen e Partisë në frontin e arsimit e të kulturës që po lulëzon në vendin tonë. Unë ju përgëzoj për punën e palodhur që keni bërë dhe, me rastin e 25-vjetorit, ju uroj gjithë juve, nxënësve, mësuesve dhe komunistëve të shkollës, suksese të reja e më të mëdha në mësimet, në punën prodhuese, në kalitjen fizike dhe ushtarake, në edukimin tuaj revolucionar.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR  
FAMILJES SË MEHMET HALIL GASHIT**

*Hasan, Fushë-Krujë*

**22 maj 1973**

Më preku thellë vdekja e xha Mehmetit, vëllait të heroinës Qerime Galica (Shota), patriotit të vjetër, luftëtarit trim dhe miku im që s'u përkul asnjëherë por luftoi me trimëri kundër shumë armiqve të popullit shqiptar dhe sot me gjithë moshën e kaluar kontribuonte për lulëzimin e fshatit tonë socialist. Kujtimi i tij do të mbetet i paharruar.

Me këtë rast, ju dërgoj ngushëllimet e mia të përzemërta.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR  
USHTARËVE DHE OFICERËVE ME RASTIN  
E 30-VJETORIT TË THEMELIMIT  
TË USHTRISË POPULLORE**

9 korrik 1973

Të dashur shokë ushtarë e oficerë,

Në këtë ditë të shënuar të 30-vjetorit të themelimit të Ushtrisë sonë Popullore, në emër të Komitetit Qendror të Partisë e të Këshillit të Ministrave, përshëndes efektivin e ushtrisë, punëtorët, fshatarët, inteligjencien popullore dhe gjithë rininë tonë heroike, që, duke punuar në frontet e ndërtimit socialist të vendit dhe duke mësuar në bankat e shkollës, qëndrojnë vigjilentë e të gatshëm për të mbrojtur atdheun me pushkë në dorë.

Duke festuar 10 Korrikun, të gjithë ne së

bashku kujtojmë ato ditë heroike dhe legjendare kur lindi ushtria jonë e lavdishme, në flamujt e së cilës janë shkruar me gjak fitorja mbi armiqtë barbarë nazifashistë dhe çlirimi i Shqipërisë. Ne kujtojmë plot krenari Luftën vigane Nacionalçlirimtare të popullit tonë, veprën e pavdekshme të partizanëve trima, që hodhën themelet e patundshme të Republikës Popullore të Shqipërisë, të pushtetit popullor, të jetës së re që gëzojmë sot.

Mendjet dhe zemrat tona u drejtohen sot me nderim dhe me mirënjohje të thellë heronjve dhe heroinave që dhanë jetën e tyre të re për lirinë dhe për pavarësinë e atdheut, që Shqipëria të shpëtonte një herë e mirë nga të huajt, nga tregtarët e bejlerët, që të zhdukeshin përgjithmonë uria dhe skamja.

Lindja dhe forcimi i Ushtrisë Popullore, gjithë rruga e saj 30-vjeçare, që nga njësitet e para guerile deri tek armatosja e gjithë popullit, janë vepër e Partisë sonë të lavdishme. Asaj i përket merita e madhe historike në hartimin e programit të revolucionit popullor, në përpunimin e bazave teorike dhe të parimeve themelore të ndërtimit, të edukimit e të përgatitjes së ushtrisë, në përcaktimin e rrugëve për forcimin e fuqisë mbrojtëse të vendit, në hedhjen e themeleve dhe në zhvillimin e shkencës sonë ushtarake popullore.

Ushtria Popullore u krijua në bazë të mësimëve të marksizëm-leninizmit dhe, mbi traditat shumë të pasura të luftërave të gjata të popullit

tonë për liri e pavarësi, u krijua si armë në duart e popullit për çlirimin e atdheut, për vendosjen e pushtetit popullor dhe për ruajtjen e fitoreve të revolucionit.

Këto qëllime të mëdha e fisnike përcaktuan edhe karakterin e saj thellësisht popullor, klasor e revolucionar. Në luftë me armiqtë dhe me vështirësitë e panumërta, e frymëzuar nga ideallet e mëdha të Partisë sonë dhe nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë të saj, ajo u formua e u kalit si një ushtri e fortë revolucionare. Me heroizmin e pashoq të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, me gjakun e bijave dhe të bijve më të mirë të Shqipërisë u shkrua epopeja e Luftës legjendare Nacionalçlirimtare, luftës më të përgjakshme e më të madhe që ka bërë populli ynë gjatë gjithë historisë së tij, por që i solli edhe fitoren e lavdishme më të madhe në historinë e tij shumëshekullore.

Forcimi dhe modernizimi i vazhdueshëm i Ushtrisë sonë Popullore kanë qenë dhe mbeten në qendër të vëmendjes së Partisë dhe të pushtetit popullor. Ata e kanë parë këtë detyrë kurdoherë si një faktor vendimtar për mbrojtjen e atdheut dhe të revolucionit, si pjesë përbërëse të ndërtimit socialist të vendit.

Në kushtet e reja të pasluftës ushtria jonë duhej të organizohej dhe të armatosej sa më mirë, të përgatitej politikisht dhe ushtarakisht, të bëhej plotësisht e ndërgjegjshme dhe e gatshme për të përballuar e për të thyer me sukses çdo agresion ngado që të vinte.

Partisë iu desh që në fillim të hidhte poshtë jo vetëm pikëpamjet borgjeze mbi ndërtimin e ushtrisë, por të luftonte me vendosmëri edhe kundër teorizimeve oportuniste të revizionistëve modernë e ndërhyrjeve të tyre si në të gjitha çështjet e tjera, edhe në fushën e ushtrisë. Në kundërshtim me tezat e tyre që e bënin gati të panevojshme ekzistencën e ushtrisë sonë dhe që pretendonin se ajo duhej të ndërtohej vetëm sipas modeleve të huaja dhe jo në përshtatje me detyrat dhe me kushtet e vendit tonë, Partia, me urtësinë dhe me largpamësinë e saj, zbatoi një politikë konsekuente dhe mori një varg masash konkrete për forcimin e gjithanshëm të ushtrisë, për pajisjen e saj me armë moderne, për përsosjen e ndërtimit të saj strukturor, për përgatitjen e saj luftarake e teknike, për forcimin e drejtimit të Partisë në të dhe të edukimit ideopolitik, duke u mbështetur si në artin modern të luftës ashtu edhe në eksperiencën e pasur të Luftës Nacionalçlirimtare. Në këtë rrugë u hodhën bazat dhe u përpunuan në mënyrë shkencore parimet e Artit tonë Usharak Popullor — bazë e patundur për organizimin e mbrojtjes së pathyeshme të vendit tonë.

Eksperienca e gjithë këtyre viteve vërtetoi plotësisht drejtësinë e kësaj vije marksiste-leniniste të Partisë. Shqipëria socialiste u ka qëndruar dhe u qëndron si shkëmb graniti të gjitha rrebesheve që janë vërsulur mbi të gjatë kësaj periudhe, ajo u ka rezistuar me guxim pre-

sioneve, kërcënimeve dhe shantazheve të ujqve imperialistë e revizionistë, ka mbrojtur ballëhapur lirinë dhe pavarësinë, punën e vet paqësore.

Ushtria jonë është e fortë dhe e pathyeshme pasi ajo, duke ndjekur mësimet e Partisë, ka qenë e ndërgjegjshme se fuqia e saj nuk qëndron vetëm tek armët dhe organizimi i saj, por edhe te sigurimi i përhershëm i udhëheqjes së Partisë, te lidhjet e çeliktat të saj me masat, te bindjet e ndërgjegjshme të të gjithë efektivit për detyrat e larta që i janë ngarkuar, qëndron, më në fund, në potencialin ekonomik e kulturor të vendit tonë.

Me këtë shpjegohen shkrirja e interesave të ushtrisë me interesat e gjithë popullit, puna e përbashkët për mbrojtjen dhe për ndërtimin e socializmit, fakti që populli është i gjithë ushtar dhe ushtria është me të vërtetë e popullit.

I madh e i vogël te ne e kanë bërë të tyre parullën luftarake të Partisë «Të ndërtojmë socializmin duke mbajtur në një rën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën». Problemi i mbrojtjes së atdheut është bërë çështje e masave të gjera të popullit, ashtu si përgatitja e tyre ushtarake është bërë pjesë e pandarë e ndërtimit të socializmit. Sot ushtria jonë heroike, kjo armë e dashur dhe besnike e popullit, mbrojtëse e fuqishme e diktaturës së proletariatit, përfshin në radhët e veta gjithë popullin tonë trim, punëtor e patriot.

Përvjetori i tridhjetë i gjen efektivin e for-

cave tona të armatosura, mbarë popullin shqiptar, të përfshirë në një atmosferë entuziazmi, mobilizimi e vrulli revolucionar për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit të 6-të të Partisë, për të realizuar me sukses detyrat e mëdha të vitit të tretë të planit të pestë pesëvjeçar. Populli ynë e feston këtë datë të shënuar i angazhuar në luftën e madhe për revolucionarizimin e mëtejshëm të të gjithë jetës së vendit, për forcimin gjithnjë e më shumë të vigjilencës revolucionare, për përgatitjen dhe për gatishmërinë luftarake.

Situata e vendit tonë është sot më e shëndoshë se kurrë. Pozita ndërkombëtare e Shqipërisë socialiste është forcuar shumë. Atdheu ynë ka një autoritet të merituar dhe gëzon respekt të madh kudo në botë. Kanë kaluar një herë e përgjithmonë ato kohë kur Shqipërinë e merrnin nëpër këmbë dhe flitnin me të nga pozitrat e forcës. Vendi ynë sot ka miq të shumtë, besnikë e të fortë në të gjithë botën.

Me ne janë gjithë popujt revolucionarë të botës.

Por në të njëjtën kohë Partia, populli dhe ushtria jonë janë të ndërgjegjshëm për kërcënimin dhe për rrezikun e madh e të vazhdueshëm që i vjen vendit tonë nga rrethimi imperialist e revizionist. Pavarësisht nga disfatat e shumta, nga krizat e thella dhe nga kontradiktat që i brejnë nga brenda fuqitë imperialisto-revizioniste, politika agresive, synimet dhe veprimet e ty-

re armiqësore mbeten të pandryshueshme. Të dyja superfuqitë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, thurin plane për vatra të reja luftime, kombinojnë komplete politike e prapaskena të pabesa, përgatitin tradhti dhe provokacione të reja, nënshkruajnë marrëveshje për ndërhyrje në punët e brendshme të popujve, për agresione të armatosura. Ato zgjerojnë bashkëpunimin e tyre në dëm të vendeve të tjera dhe kërkojnë hapësira të reja për të shtrirë ndikimin dhe hegjemoninë e tyre.

Rrethimi imperialisto-revizionist i vendit tonë, si i vetmi vend në Evropë që mban lart e mbron me besnikëri flamurin ngadhënjimtar të marksizëm-leninizmit, nuk sjell vetëm rrezikun e agresionit të hapët të armatosur. Ai ushtron ndaj nesh edhe një presion të vazhdueshëm, një diversion ideologjik, kulturor e psikologjik të pandërprerë. Në këtë rrugë armiqët kërkojnë të helmatisin dhe të atrofizojnë jetën dhe mendjen e popullit, të çoroditin dhe të neutralizojnë aktivitetin dhe frymën revolucionare të masave, të liberalizojnë e të dobësojnë diktaturën e proletariatit. Në llogaritë e imperialistëve dhe të revizionistëve agresioni ideologjik e kulturor paraprind e parapërgatit agresionin e armatosur, ai spastron rrugën dhe u hap shtigje topave, tankeve dhe avionëve të tyre.

Prandaj Partia i ka mësuar dhe i mëson vazhdimisht popullin dhe ushtrinë që ta kuptojnë politikisht dhe ideologjikisht këtë rrethim të

vendit tonë, ta vlerësojnë drejt e realisht, për t'i parë dhe për t'i njohur rreziqet imediate e ato të ardhshme, me qëllim që të merren të gjitha masat e nevojshme politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake për të luftuar e për të fituar mbi të.

Vendimet e Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror të Partisë, që iu kushtua thellimit të luftës ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre, janë një armë e fuqishme në duart e Partisë dhe të mbarë masave punonjëse për ngritjen e mëtejshme të nivelit ideologjik e politik të njerëzve tanë, për forcimin e vigjilencës revolucionare dhe të luftës kundër presioneve dhe ndikimeve të huaja, ngado që të vijnë. Ato do ta ndihmojnë për ta çuar edhe më përpara jetën e vendit, ndërtimin e socializmit, për të forcuar figurën morale dhe frymën luftarake të masave punonjëse, për të forcuar disiplinën proletare dhe përgatitjen luftarake të ushtrisë dhe të popullit, për të fuqizuar edhe më shumë mbrojtjen e atdheut. Garanci e forcës së pathyeshme të ushtrisë sonë, e besnikërisë së saj të patundur ndaj popullit dhe çështjes së socializmit, e fitoreve të saj, sot e në të ardhmen ka qenë dhe mbetet udhëheqja e Partisë.

Masat e rëndësishme që ka marrë Partia vitet e fundit për revolucionarizimin e mëtejshëm të forcave të armatosura, kanë vërtetuar plotësisht në praktikë drejtësinë e tyre, kanë pasur një efekt të madh në fuqizimin e mbrojtjes së

atdheut. Por në këtë rrugë ne duhet të ecim përpara pa u ndalur. Duhet punuar pa u lodhur për edukimin revolucionar të të gjithë efektivit të forcave të armatosura me veti të larta morale dhe disiplinë të hekurt proletare. Është e nevojshme të ngrihet në një shkallë më të lartë gjithë puna që bëhet për stërvitjen luftarake të ushtrisë dhe të mbarë popullit, duke ngulur këmbë që ajo të arrijë plotësisht objektivat e caktuar. Më shumë se kudo në stërvitjen ushtarake nuk mund të lejohen formalizmi, liberalizmi dhe konformizmi.

Ashtu si dhe deri më sot, respektimi i disiplinës së çeliktë proletare, zbatimi me rreptësi nga të gjithë, që nga oficeri më i lartë e deri tek ushtari i thjeshtë, i rregulloreve ushtarake dhe i urdhrave të komandave, ruajtja gjithnjë e pastër e figurës morale të ushtarit të popullit, janë ligje të shenjta për ushtrinë tonë dhe, si të tilla, duhen vënë në jetë me fanatizmin më të madh.

Partia ka besim se ushtarët e oficerët, vullnetarët e vullnetaret, nxënësit e studentët, të bashkuar rreth Partisë dhe Komitetit të saj Qendror, do t'i karakterizojnë si kurdoherë lufta dhe përpjekjet për t'i kryer sa më mirë detyrat e shërbimit, gatishmëria e përhershme luftarake, puna e palodhur krijuese, lufta këmbëngulëse dhe guximi për kapërcimin e vështirësive, bindja e thellë në drejtësinë e vijës së Partisë dhe besimi në fitore.

Shokë ushtarë dhe oficerë,  
Mbani kurdoherë lart flamujt tuaj luftarakë, flamujt e betejave legjendare të luftës së lavdishme për çlirimin e Shqipërisë, qëndroni kurdoherë vigjilentë e të disiplinuar, përvetësoni me ngulm artin ushtarak dhe bëhuni mjeshtër të luftimit, jini kurdoherë të gatshëm, të vendosur e të bashkuar për të mbrojtur punën ndërtimore të njerëzve tanë, për të luftuar me trimëri dhe për të fituar kundër çdo armiku që do të guxonte të prekte atdheun tonë socialist!

Rroftë populli ynë besnik!

Rroftë Partia trime e Punës, krijuesja dhe udhëheqësja e forcave tona të armatosura!

Rroftë Ushtria jonë Popullore!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Sekretari i Parë i KQ të PPSH  
dhe Komandant Suprem i Forcave të Armatosura  
të RPSH

*Enver Hoxha*

«Për Ushtrinë Popullore (Përmbledhje veprash)», vëll. I,  
f. 608

## **LETËR DREJTUAR FAMILJES SË SHOQES ZELIHA ALLMETA**

*Elbasan*

**17 gusht 1973**

Mësova me hidhërim për vdekjen e parakohshme të Zelihasë, kësaj nëne trimëreshë, e cila për të shpëtuar nga mbytja në lumë dy fëmijë, bëri fli jetën e saj të re.

Ky akt i lartë heroizmi i Zelihasë nuk është i rastit. Nga letra që më dërgoi brigada e pestë e kooperativës bujqësore të Bradasheshit, ku ajo punonte, u njoha me jetën e gjallë dhe me cilësitë e saj të rralla. Zelihaja ishte një grua e ndershme, punëtore e palodhur me ndërgjegje të lartë, patriote, e thjeshtë, trime dhe besnike deri në fund e Partisë. Në shembullin e saj të lartë shkëlqeu dashuria e çiltër e nënës për fëmijët. Lumi nuk e trembi zemrën e saj të futej në ujë e të shpëtonte nga vdekja dy fëmijë, që i donte si fëmijët e vet. Kjo është shprehje e asaj dashurie të madhe që kanë nënat tona për fëmijët; ky është ai solidaritet i lartë socialist me të cilin i ka edukuar dhe i edukon ato nëna jonë e madhe — Partia.

Emri i Zelihasë do të mbetet përgjithmonë i paharruar jo vetëm në kujtesën e gjithë njerëzve të saj të dashur të familjes, por dhe të të gjitha shoqeve e shokëve të kooperativës bujqësore, si dhe të atyre që dëgjuan për aktin e saj prej nëne e gruaje trime.

Vetëmohimi i guximshëm i Zelihasë do t'i frymëzojë njerëzit tanë në punë për ndërtimin e një jete gjithnjë e më të bukur e të begatshme, për të ardhmen e lumtur të fëmijëve tanë, për atë të ardhme që ëndërronte e punonte Zelihaja.

Jam i bindur se tre djemtë që lindi kjo nënë trime dhe dy vajzat që shpëtoi, kur të rriten, në shkollë e në jetë, do të nderojnë kurdoherë emrin e kujtimin e Zelihasë dhe do t'u shërbejnë me vetëmohim popullit, atdheut, Partisë.

Në gjirin e dy familjeve tuaja patriotë, ku u rrit, jetoi dhe u edukua Zelihaja, do të rriten e kaliten edhe djemtë e saj me vetitë e larta të popullit tonë dhe me idealet revolucionare të Partisë së Punës.

Me këtë rast, ju dërgoj ngushëllimet e mia të përzemërta duke përçafuar gjithë familjarët e Zelihasë, veçanërisht tre djemtë e saj të vegjël.

Juaji

*Enver Hoxha*

«Zëri i popullit», nr. 197 (7803),

18 gusht 1973

## LETËR DREJTUAR SHOKUT MIHAL DHIMA

1 shtator 1973

I dashuri im Mihal,

Letrën që më dërgove e mora dhe e këndova me gëzim. Të falënderoj nga zemra ty dhe gruan për urimet që më bënit me rastin e fejesës së djemve. Edhe unë ju uroj për martesën e nipit, Aleksandrit: Të trashëgohen, jetë të gjatë e të lumtur!

Haxhoja më tha se kishe shkuar tek ajo, por siç duket në kohën kur unë ndodhesha në Durrës. Më erdhi keq që s'u takuam, se edhe mua më ka marrë malli për ty, prandaj, kur të vish herë tjetër në Tiranë, të pres në shtëpi jo vetëm për urime, por të më qëndrosh edhe për drekë.

U gëzova shumë që nipi yt i madh mbaroi shkëlqyeshëm dhe doli mjek. Dhimoja nuk rrojti që ta gëzonte, pse kaq e kishte jetën. Por ti,

i dashur Mihal, duhet të mbahesh i fortë, se dje-  
mtë e Dhimos tani jo vetëm u rritën, por ata  
kanë Partinë, të kanë edhe ty. Prandaj bëj kuj-  
des për shëndetin. Të uroj gjithë të mirat.

Haxhoja, Sanoja dhe Nexhmija ju bëjnë  
shumë të fala. Fëmijët gjithashtu ju përshënde-  
tin me respekt.

Të përqafoj ty dhe gruan

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## **PËRSHËNDETJE ME RASTIN E 50-VJETORIT TË SHKOLLËS SË MESME «ASIM ZENELI»**

**9 nëntor 1973**

I dashur popull i Gjirokastrës,

Të dashur nxënës e pedagogë të shkollës së mesme «Asim Zeneli»,

Të dashur ish-nxënës e mësues të liceut,

Kërkoj falje që nuk iu përgjigja dot ftesës e të ndodhësja edhe unë aty, në gjirin tuaj të ngrohtë, në gjirin e popullit të dashur të qytetit tim që më rriti, më edukoi e më dha mësimet e para. Në këto çaste mirënjohja e pafund e të gjithë neve, bijve të Gjirokastrës, i drejtohet popullit të vendlindjes, që bëri tërë ato përpjekje të mëdha e sakrificat të panumërta për të na mësuar si t'i shërbejmë deri në vdekje popullit heroik të vendit tonë, atdheut të shtrenjtë, Shqipërisë socialiste.

Sot, kur Gjirokastra jehon akoma nga Festivali i mrekullueshëm Folkloristik Kombëtar, ju jeni mbledhur në një gëzim tjetër të madh: në festën e 50-vjetorit të liceut, shkollës së mesme të përgjithshme «Asim Zeneli».

Edhe unë, një nga ish-nxënësit e fillimit të asaj shkolle, kisha, si të gjithë, dëshirë të zjarrtë të isha me këtë rast të gëzueshëm midis jush, por detyrat e Partisë e të popullit nuk më dhanë mundësi të vija në atë festë aq të ngrohtë e tërë emocione, të çmallesha me qytetin e dashur ku kam lindur, me shkollën e paharruar ku kam mësuar, të takohesha me ju, bashkëqytetarët, me bashkënxënësit dhe edukatorët e nderuar, të bisedoja nga afër me shokët e vegjëlisë e të rinisë. Por të jeni të sigurt, të dashur shokë, motra e vëllezër, se gëzimin e madh që ndieni sot ju në atë festë jubilarë, e kam edhe unë, po aq të fortë e të ndjeshëm sepse me mendje e me zemër jam aty, së bashku me ju. Me këtë rast ju dërgoj përshëndetjet e mia shoqërore më të nxehta dhe ju uroj «gëzuar e për shumë vjet festën e shkollës sonë!».

Gjysmë shekulli më parë çeli dyert i pari Lice në Gjirokastër, i cili priti krahëhapur kontingjentin e parë të nxënësve, midis tyre edhe vajzat e para të popullit. E kush nuk gëzoi në ato ditë! Edhe gurët e udhës gëzuan. Rinia manifestoi me gjithë dufin dhe gëzimin e shpirtit në she-shin që më vonë mori emrin e luftëtarit të shquar të Rilindjes, patriotit Çerçiz Topulli. Njerëzit

e thjeshtë, me fytyrë të qeshur e gjithë ngazëllim, se po hapej një dritare e re drite në errësirën e kohës, bisedonin grupe-grupe te Qafa e Pazarit, te Sheshi i Kokonës, te Shtatë Kronjëret e Meçites, te Zalli i Çetemelit, te sufatë e portave të shtëpive e kudo që ndodheshin. Kjo atmosferë gazmore u ndie edhe nga ai rapsodi i verbër popullor, Vehip Qorri, i cili, megjithëse pa sy, shih-te me sytë e mendjes e të zemrës dhe thuri këngën: «Shihni djemtë e Licesë/ dalin poshtë xhadesë/ togje-togje katër a pesë!». Vetëm gjakpirësit e popullit, armiqtë e klasës e xhahilët anadollakë nuk gëzuan, sepse ata përpiqeshin t'i mbanin masat punonjëse në errësirë, në një kohë që fëmijët e tyre i dërgonin deri edhe në shkollat e Italisë, të Korfuzit etj.

Hapja e Liceut të parë Francez në Gjirokastrër u bë jashtë dëshirës së Zogut e klikës së tij. Atë e çeli populli, i cili donte që bijtë e tij të merrnin kulturë përparimtare për vendin e tyre të vuajtur e në errësirë, të mësonin edhe historinë e një populli dhe revolucionit, që u preu kokën mbretërve. Kjo, doemos, e trembte regjimin në fuqi, sepse frymëzonte bijtë e popullit tonë të ngriheshin kundër tiranisë së mbretit Zog.

Ky Lice nuk lindi rastësisht, në një truall bosh e nga hiçgjë. Në Gjirokastrër, si në tërë Shqipërinë, zienin prej kohësh mendimi dhe veprimi patriotik i të parëve tanë. Populli ynë nuk e ka ndarë kurrë «dyfekun me gjalmë» nga libri, shpatën nga pena, trimërinë nga dituria, luftën

nga puna. Pushka dhe abetarja kanë qenë kurdoherë dy binjake në duart e popullit shqiptar, në të njëjtat llogore të luftës së tij për liri, pavarësi, tokë, të drejta e përparim.

Lëvizjen për arsimin shqip në Gjirokastrë e patën filluar pionierët e parë të saj, Koto Hoxhi, Pandeli Sotiri, Avni Rustemi e sa e sa të tjerë, që s'kursyen as jetën për shkollën tonë, për gjuhën tonë të bukur amtare, për dritën e përparimit.

Këta luftëtarë të pushkës e të penës nuk mund të duronin më që në shkollat e Shqipërisë të mësohej gjuha e pushtuesve turq e grekë dhe të mos lejohej mësimi i gjuhës së nënës së tyre, që u ka kënduar aq ëmbël në shqip bijave e bijve të saj, duke i përkundur në djep me aq bukuri e trimëri me ato ninulla që kishte kënduar e qarë shqip aq thellë në gëzime e hidhërime, që i kishte goditur pushtuesit e huaj me plumb e me gjuhën shqipe «Shporruni nga vendi ynë!». Ja, në këtë truall të lagur me gjak e djersë nga stërgjyshërit e gjyshërit tanë, çelën edhe «trëndafilët» e parë. Më 1908 u hap në qytetin e Gjirokastrës shkolla e parë shqipe, së cilës populli i dha emrin plot domethënie politike: «Liria». Pas dy vjetësh u çelën shkollat shqipe edhe në Libohovë, në Labovën e Madhe e pastaj me radhë në krahina të tjera të qarkut.

I paharruari Bajo Topulli ishte një nga kryesorët që na mësonte abëcënë e Manastirit. Mësuesit tanë të nderuar Thoma Papapano, Iljaz

Hoxha, Xhafo Poshi, Rexho Muçi, Sadik Çelo, Asaf Çipi, Jani Minga, Andrea Konomi, Arshi Çabeu e të tjerë, janë nga pishtarët e parë që na mësuan me aq pasion gjuhën shqipe, historinë dhe gjeografinë e vendit tonë të dashur.

Lufta për shkollën, për kulturën kombëtare në Gjirokastrë, u ngrit në një shkallë më të lartë me krijimin e Liceut, hapja e të cilit ishte një kërkesë e zjarrtë e patriotëve tanë, e rilindasve, e arsimdashësve të palodhur e të nderuar, që u digjej zemra për dritë, për gjuhën shqipe, për arsim e kulturë. Me këtë rast dëshiroj të kujtoj me respekt profesorët shqiptarë të këtij Liceu — Thoma Papapanon, një nga mësuesit më të shquar të gjuhës shqipe, ndaj të cilit ruaj shumë kujtime dhe një nderim të veçantë, Hysni Babame-ton, Elmaz Çanin, Ilia Dilo Sheperin, Pano Hidon, si dhe drejtorin francez Viktor Kutanë e kolegët e tij profesorë.

Vajtja për herë të parë e vajzave në Lice ishte, gjithashtu, një gëzim i madh. Për këtë kishin punuar pa u lodhur mësueset Urani Rumbo, kjo organizatore e shquar e arsimit dhe e emancipimit të vajzës gjirokastrite, si dhe Hasibe Hashorva, Naxhije Hoxha, Xhemile Bilali e Nebahet Bakiri, të cilat, në kohë të vështira, mësonin motrat e tyre, që, aktualisht, janë gjyshet ose nënat e të rinjve të sotëm të Gjirokastrës.

Puna e këtyre mësueseve guximtare kishte një rëndësi shumë të madhe për përparimin e guas së vendit tonë. e cila në atë kohë ishte e

shtypur e skllave. Anetë dhe nanatë tona u kanë kënduar qysh në djep bijve të vet për mjerimin dhe shtypjen e madhe të gruas me vargje si:

*Mu te Ur' e Zerzebilit,  
Hanushe, bilë e Bakirit,  
të vrau plumb' i qafirit,  
pse ngrite perçen e sirit.*

Këngët e ngjethshme të nënave tona të shumëvuajtura ne i kujtonim edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Këto i mbajtëm e i mbajmë parasysh, gjithashtu, sot në luftën e madhe që zhvillon Partia për emancipimin e plotë të gruas. Prandaj, shoqe dhe shokë, të mos e harrojmë punën heroike të mësuesve dhe mësueseve të para.

Liceu i Gjirokastrës ka një histori të shkëlqyer. Hapja e tij ishte jo vetëm një ngjarje e shënuar në jetën arsimore, por edhe në jetën politike e shoqërore të krahinës së Gjirokastrës. Prandaj klika e Zogut urdhëroi mbylljen e tij që në vitin e parë shkollor. Por populli u ngrit në këmbë dhe Bajo Topulli protestoi në prefekturë. Liceu filloi kështu përsëri mësimet. Oborri i tij gumëzhiti prapë i hareshëm nga gëzimi i bijve të popullit që mundën të futeshin në shkollë.

Sa tipare përparimtare e revolucionare dallohen në Liceun e Gjirokastrës! Ai ruajti që në fillim një frymë të theksuar laike, gjë që ishte karakteristike për arsimin tonë kombëtar. Që në shkollën fillore mësuesit tanë na edukonin të mos

i besonim fesë. Kur dilnim shëtitje në ajër të pastër, duke u kënaqur me aromën e luleve, me erën që fishkëllinte në qiparisa, me zhurmën e bletës, që bridhte nëpër cfakat luleverdha, shkoni nganjëherë edhe te teqeja e baba Manes. Mësuesi ynë, zoti Rexho, na thoshte se «Dervishët s'kanë ç'bëjnë, mbliidhen nën qiparisa, janë dembelhanët më të mëdhenj, hanë, pinë e luajnë filxhane, nuk lahen kurrë, bien erë përç, por ç'të bësh...». Dhe ne me njëri-tjetrin bisedonim: «Të ketë vallë perëndi?». Pas debatesh arrinim në përfundimin: «I duhet besuar fjalës së mësuesit, ai lexon shumë libra — nuk ka perëndi».

Shpeshherë historinë, gjeografinë, shkencat e tjera shoqërore dhe ekzakte, që mësonim nga libri në bankën e shkollës e në shtëpi, i mësonim edhe në natyrë, në këtë libër të madh kurdoherë të hapur të jetës, faqet e të cilit nuk mbarohen kurrë. Kur dilnim shëtitje me shkollën te bregu i teqesë, zoti Xhafo na shpinte drejt jugperëndimit të kodrës dhe na thoshte:

— Djema, këtu, në këtë vend ku jemi tash, ka qëndruar edhe Çerçiz Topulli me shokët e tij të çetës. Ai priste të ktheheshin të dy shokët, që kishte dërguar brenda në Gjirokastër për të vrarë bimbashin turk. Këtu Çerçizi dëgjonte me kujdes kur matanë të kërcitnin pushkët dhe vërente me sy shqiponjë atje tej.

Dhe zoti Xhafo na tregonte me gisht matanë bregut teqenë tjetër të baba Hasanit dhe qersat

e Embro Totos, nga do të dilnin të dy shokët e Çerçizit, pasi të kryenin vrasjen.

— Bimbashi do të vritej, — vazhdonte zoti Xhafo, — dhe kështu ngjau aty në rrugën që zbret nga pazari në Hazmurat, pse në atë lagje jetonte ai jezit. Kështu që atje, afër shtëpisë së Jupit, krisi pushka dhe bimbashi turkoman ra si viç i ngordhur mbi kadërdhëm. Të dy trimat e Çerçizit zbritën me shpejtësi sokakun dhe, në vend që të dilnin poshtë në teqenë e baba Hasanit, kaluan Sokakun e Lulës dhe dolën para kishës.

Çerçizi, i dëgjoji pushkët, u ngrit në këmbë dhe thirri i gëzuar: «U vra halldupi! Rroftë Shqipëria e lirë!». E gjithë çeta rrinte në këmbë dhe Çerçizi përpara saj, me atë trup të bukur, me gjerdanin plot fishekë në mes e me flokët e tij të lëshuar që ia merrte era. «Ja, dolën shokët te kisha», — tha Çerçizi dhe për t'i përshëndetur e nderuar ata për veprën e guximshme patriotike u dha urdhër shokëve:

«Pushkët gati për qitje, drejt huqumetit të Gjirokastrës, zjarr!». Dhe filloi batareja, për t'i thënë kështu Turqisë: «Edhe huqumetin ta godita, edhe bimbashin ta vrava».

Këtu u mbledh e gjithë çeta që luftonte për Shqipërinë e për lirinë, siç jemi mbledhur edhe ne sot, nxënës e mësues, që mësojmë dituri për të mirën e Shqipërisë.

Pasi Çerçizi i puthi dhe i përqafoi të dy shokët që vranë bimbashin, atëherë çeta mori

rrugën për në Mashkullorë, dhe zoti Xhafo na tregonte me gisht Mashkullorën, atje tej në mal. Këtej Çerçizi zbriti si levend me çetën, me dyfek në sup, kapërcyen atë zall atje dhe dolën në fshat, te miqtë e tyre besnikë mashkulloritë. U ulën nën rrapin e madh historik dhe i treguan popullit ngjarjen e shënuar. Rrapi mbeti dhe do të mbetet në histori, sepse atje luftoi si asllan Çerçizi me shokë. Ju e dini këngën, vazhdonte zoti Xhafo:

*«Në Mashkullorë te Rrapi  
Ergjeri (Gjirokastër), ç'u vra bimbashi.*

*Te Rrapi në Mashkullorë  
Foli Çeçua me gojë».*

Këto tregime historike na ndiznin zjarr ndjenjat e atdhedashurisë e na i bënë shëtitjet tona akoma më të gëzueshme.

Nga kodra bënim sehir fushën, lumin e Drinos, malet e Lunxhërisë, kalanë e Shëntriadhës. Ç'mrekulli! Ne e donim vendin tonë me mall të madh. Mësuesi i gjeografisë, zoti Arshi, na tregonte një nga një të gjitha fshatrat e Lunxhërisë, që nga Erindi, Kariani e Kakozi e deri në Stegopul. «Ja Qestorati, — thoshte ai, — fshati i Koto Hoxhit, mësuesit tonë të madh të gjuhës shqipe! Djema, mos e harroni kurrë këtë burrë patriot të ndritur!». Dhe vazhdonte: «S'ka fshat-

ra më të bukura në botë se fshatrat e Lunxhërisë, me ato shtëpitë në mes të pemëve frutore. Atje rriten për bukuri dardha, gorica, kumbulla, mani, thana, ftoi, fiku, qershia, pjergulla. . . Atje ka ato goxha burime, çezma me ujë të freskët e të kulluar, që del si me këngë nga mali. . . , ndërsa atje tej ka trëndelinë, — dhe zoti Arshi, me gishtin e tij të hollë, tregonte një qafë mbi Erind. — Ja, ajo qafa quhet Serpen dhe pas saj është një xhenet që quhet Çajup. S'ka në botë si Çajupi!».

Që në hapat e parë të Liceut veprimtaria arsimore aty u gërshetua me veprimtarinë kulturoro-artistike, sportive. E kujt nga ne, ish-nxënësve të asaj kohe, nuk i kujtohen ato shfaqje teatrale, për përgatitjen e të cilave nxënësit punonin plot pasion dhe natën? Regjisor atëherë nuk kishte, por këtë rol e luajti aq bukur fotografi Dine Qadhimi, një njeri i varfër e shëndetlig, por me ndjenja të pastra, që dinte s'dinte, me aq sa i jepej, u bë regjisor i shoqërisë «Studenti». Kujt nuk i kujtohet mandolinata, nën tingujt e ëmbël të së cilës liceistët këndonin me dashuri Himnin e Flamurit? Pjesëmarrës i mandolinatës u bë edhe Kamber Bilali, që s'ishte fare nxënës, ndihmuan edhe Samuel Kofina e të tjerë.

Kështu, të dashur nxënës e mësues të shkollës së mesme «Asim Zeneli», veprohej në moshën tonë të vegjëlisë. Natyrisht, aktivitetet brenda dhe jashtë Liceut erdhën duke u rritur. Dhe këto nuk kishin thjesht karakter të mbyllur kul-

turor. Ato ishin, në radhë të parë, aktivitete politike, ku mbahej ndezur, sidomos, prushi i patriotizmit, i urrejtjes dhe i luftës kundër regjimit. Boshti i tërë kësaj pune u bë shoqëria «Studenti», që krijoi aleancë me shoqërinë «Lidhja e punëtorëve» të Gjirokastrës. Liceu u bë kështu një qendër e rëndësishme patriotike, përparimtare, antizogiste. Pikërisht për këtë qeveria e Zogut më 1925 e mbylli shoqërinë «Studenti», dhe, pas tre vjetësh, më 1928 mbylli me forcën e bajonetës edhe vetë Liceun. Regjimi obskurantist zogollian po tregonte me vepra fytyrën e tij antipopullore e antikombëtare. Prandaj zemërimi dhe protesta e popullit arritën kulmin. Qeveria përdori makinacione të ndryshme për të penguar kundërshtimet e masave. Kështu, për të dobësuar valën e zemërimit, më 1929 ajo hapi një shkollë të ulët profesionale dhe një vit më vonë një shkollë normale gjysmake. Por populli gjirokastrit nuk u pajtua kurrë me këto «zgjdhje» gjysmake e demagogjike. Ai vazhdoi kërkesat e tij këmbëngulëse dhe, si rrjedhim, në vitin arsimor 1935-1936 normalja u kthye në gjimnaz.

Liceu im i dashur, ty të ngriti në këmbë dhe të përtëriti populli fukara me këmbënguljen e tij, me duart e fuqishme të tij, me djersën e tij të ballit, me ngrohtësinë e shpirtit të tij të pashuar për dritë. Ty të mbrojti populli sy-patrembur me guximin e vet, me gjakun e zemrës së vet. Sa herë të rrethuan xhandarët e Zogut, por ti kurrë s'u trondite, qëndrove kre-

nar si malet që të rrinë rrotull, si Këculla që ke pranë. Dyert e tua u mbyllën përkohësisht, por populli i çeli ato përsëri. Ti u bërë një vatër që ndeze ndërgjegjen kombëtare, dashurinë e flaktë për mëmëdheun, krenarinë shqiptare, traditat luftarake; ti u ktheve në një çerdhe të shqiptarizmsë, të ideve përparimtare. Ti u bërë një fole antizogiste e antifashiste, një vatër e zjarrtë e ideve komuniste.

Ti, nën fhirrjen e Partisë, u gjende në radhët e para të Luftës Nacionalçlirimtare. U gjakose me armiq e tradhtarë, me fashistë e nazistë, por asnjëherë nuk u theve. Shumë nxënës e mësues nga gjiri yt rrëmbyen armët dhe dolën malit për liri. Ti i dhe luftës për çlirimin e atdheut 45 heronj e dëshmorë, si Muzafer Asqerini, Themo Vasin, Ali Demin, Nuri Luçin e shumë të tjerë. Në gjirin tënd ti edukove shumë komunistë e udhëheqës të shquar si Haki Toska, Adil Çarçani, Sadik Bocaj, Pirro Kondi, Foto Çami, Veiz Gjebero e të tjerë. Nga radhët e tua dolën shumë komandantë, komisarë e partizanë trima. Mësuesit patriotë e revolucionarë, si Siri Shaplo, Aqif Selfo, Qibrie Ciu, Zihni Sako, Kadri Baboçi e të tjerë, tok me nxënësit e tyre dhe me popullin liridashës, dolën në demonstrata dhe luftuan kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve të vendit. Në këto pesë dekada ti ke qenë si një «fidanishte» e vërtetë, që nxjerr kurdoherë «filizë» të rinj, të cilët janë shpërndarë e japin kontributin e tyre në të

katër anët e atdheut, si inxhinierë e agronomë, oficerë e mjekë, shkencëtarë e mësues, shkrimtarë të talentuar si Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Agim Shehu e të tjerë.

Të dashur shokë dhe shoqe,

Festa si kjo e 50-vjetorit të Liceut të Gjirokastrës janë festa të mbarë arsimit tonë kombëtar e popullor, të kulturës sonë socialiste, të traditave tona përparimtare, demokratike e revolucionare.

Partia, trashëgimtarja më e denjë e traditave revolucionare të popullit tonë, e ka ngritur lart, si asnjëherë, arsimin tonë popullor. Pas Çlirimit, si kudo në Shqipëri, Gjirokastra njohu atë zhvillim masiv e dinamik të arsimit, që ndryshon me të kaluarën si dita me natën. Po të mos ishte Partia, sot në Gjirokastër nuk do të ishte e mundur të kishte 8 shkolla të mesme me shkëputje nga puna, 9 pa shkëputje nga puna, si dhe një shkollë të lartë, të cilat ndiqen nga 3 300 nxënës dhe mbi 1 100 studentë. Kjo është një armatë e tërë, kur kujton që gjatë 16 vjetëve të ekzistencës së Liceut të Gjirokastrës u diplomuan vetëm 9 maturantë. Vetëm në këtë vit shkollor shkolla e mesme e arsimit të përgjithshëm «Asim Zeneli» diplomoi 454 veta, ose 50 herë më shumë. Ja me ç'ritme të larta zhvillohet sot arsimi në atdheun tonë socialist!

Ju, të dashur nxënës e pedagogë asimznelas, jeni të lumtur që mësoni dhe edukoheni në atë shkollë. Unë kam bindjen se ju do t'i çoni gjithnjë e më përpara traditat e saj luftarake, do t'i pasuroni ato nga viti në vit me tradita të reja revolucionare, do të mbani si kurdoherë lart emrin e Heroit të Popullit, Asim Zenelit, për të mirën e popullit dhe të atdheut tonë socialist, për ato ideale të larta për të cilat dhanë jetën e tyre të re paraardhësit tuaj.

Ju, të rinj e të reja, po rriteni në kohë të tjera, që s'kanë të krahasuar me ato të ish-nxënësve të parë të shkollës suaj. Në kushtet e vështira, të shkaktuara nga okupacioni turk, grek, italian e gjerman, duke na ushqyer shpeshherë me bukë të përgatitur përzier me miell druri, njerëzit patriotë të këtij vendi bënë çmos për të na mësuar fshehurazi gjuhën e mëmës, për të marrë kulturë e dije. Mblidheshim atëherë, ne, nxënësit, në hajatet e xhamive, duke ndenjtur në dërrasa. Gjë për të shkruar nuk kishim, prandaj vinim e u luteshim xha Bido Tushës dhe xha Banush Mezinut të na jepnin ndonjë copë kartë shtupellë dhe ajo ishte defteri ynë. Më vonë dolën disa pllaka me kalem prej guri dhe kush arrinte t'i kishte ato në dorë, sikur kishte ndonjë gjë të madhe. Në ato kohë ne mezi gjenim, gjithashtu, ndonjë libër të Samiut ose të Naimit, shtypur në Stamboll a në Bukuresht, si «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë», e «Bagëti e bujqësi» dhe me ndihmën e tyre, nën

pushtimin e armiqve e në kushtet më të rënda të asaj kohe, ne mësonim gjuhën tonë amtare. Kurse për ju janë ngritur sot ndërtesa të mrekullueshme shkollore, të pajisura për bukuri, janë botuar e botohen përditë libra e tekste për të gjitha lëndët.

Populli dhe Partia, prindërit dhe familjet tuaja nuk kanë kursyer e nuk do të kursejnë asgjë për ju, të rinj e të reja, që sot jeni në bankat e shkollës e nesër do të shërbeni në frontet e ndërtimit të socializmit. Prandaj mësoni me pasion e këmbëngulje dhe përpiquni të jeni në çdo drejtim shembullorë. Përvetësoni pa u lodhur politikën e Partisë, ideologjinë e saj, që janë busulla jonë e pagabuar, flamuri ynë. Mësoni me zell shkencën dhe teknikën. Mbani fort në një dorë kazmën, në dorën tjetër pushkën dhe librat e Partisë në gji. Mos harroni për asnjë çast se imperialistët, revizionistët e sotëm dhe armiq të tjerë synojnë të na prishin lumturinë, ata komplotojnë kundër revolucionit e socializmit, kundër lirisë e pavarësisë së popujve, ashtu siç kanë bërë e po bëjnë këto ditë kundër popujve arabë. Prandaj të jeni kurdoherë vigjilentë e në gatishmëri të plotë për t'i dhënë, tok me gjithë popullin, përgjigjen e merituar kujtdo që do të guxojë të na prekë.

U zgjata ca, motra e vëllezër të Gjirokastres, por doja të nxirrja mallin e madh që më zgjuan kujtimet e mia si ish-nxënës i asaj shkolle.

Më në fund, do të dëshiroja t'i propozoj popullit të Gjirokastrës që, po ta gjejë të arsyeshme, për të gjithë mësuesit dhe mësueset, pionierë të shkollës e të gjuhës shqipe, të ngrihej një obelisk dhe një muze përkujtimor, mu në vendin ku u themelua shoqëria «Drita» dhe u vazhdua puna për të mësuar djemtë e Gjirokastrës në shkollën «Drita», në të cilët të pasqyrohen sa më mirë lufta dhe përpjekjet e bëra prej tyre në fushën e arsimit. Në qoftë se ky propozim do të pranohet nga ana juaj, do të jem i lumtur të vij edhe unë aty për të vënë një gur dhe të laj kështu borxhin e mosardhjes në këtë festë të përbashkët jubilarë të shkollës, për arsye që janë jashtë vullnetit dhe dëshirës sime të zjarrtë.

Edhe një herë ju uroj me gjithë zemër:

Gëzuar festën e shkollës sonë!

Dalshi kurdoherë faqebardhë, duke e mbajtur gjithmonë lart flamurin e shkollës suaj me tradita të shumta patriotike e revolucionare!

Përqafime

Juaji

Enver Hoxha

«Për arsimin dhe edukatën»,  
bot. i dytë, Tiranë, 1982, f. 587

**LETËR DREJTUAR SHOKUT  
ODISE PASKALI, «SKULPTOR I POPULLIT»**

*Tiranë*

**27 dhjetor 1973**

I dashur shoku Odise,

Në këtë ditë të përvjetorit të 70-të të lindjes suaj, dëshiroj t'ju dërgoj përshëndetjet e mia dhe t'ju uroj nga zemra shëndet të mirë, të rroni edhe shumë e shumë vjet për të mirën e artit tonë përparimtar revolucionar e gëzimin e familjes suaj.

Ju keni një kohë të gjatë që merreni me punën e nderuar të skulptorit. Veprimtaria juaj artistike është frymëzuar kurdoherë nga motive patriotike e përparimtare. Në veprat skulpturale që ju keni krijuar me aq mjeshtëri, spikat me tërë madhësinë e vet patriotizmi i zjarrtë i popullit tonë në shekuj, lufta e tij heroike për çlirimin kombëtar e shoqëror.

Krahas figurave të shquara patriotike të luftëtarëve të lirisë me pushkë e penë, që nga Skënderbeu, Naimi e të tjerë, ju përjetësuat në

bronz figurën e partizanëve dhe të luftëtarëve të rinj, që, me Luftën legjendare Nacionalçlirimtare të udhëhequr nga Partia jonë, çliruan atdheun nga pushtuesit fashistë, vendosën pushtetin e popullit dhe sot punojnë për forcimin e mbrojtjes së atdheut dhe të fitoreve të socializmit.

Krijimtaria juaj pas Çlirimit përbën një kontribut të shquar në formimin dhe zhvillimin e skulpturës shqiptare të realizmit socialist. Bashkë me bronzin e derdhur në veprat tuaja bie menjëherë në sy puna e pasioni prej artisti të talentuar, formimi e pjekuria e një artisti patriot e përparimtar, që gjithë aftësinë e tij krijuese e ka vënë në shërbim të popullit dhe edukimit të brezave të rinj. Veprat tuaja, përkrah veprave më të shquara të artistëve të tjerë të vendit tonë, do të jenë shembull frymëzimi në krijimtarinë e artistëve tanë të rinj.

Ju uroj suksese të mëtejshme në punën fisnike të skulptorit. Jam i bindur se mosha nuk do t'ju pengojë që të vazhdoni dhe për shumë vite të krijoni vepra të reja artistike, që do të gëzojnë Partinë tonë të Punës dhe popullin.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR SHOKUT  
DURRO ALUSHANI**

*Selenicë-Vlorë*

**9 korrik 1974**

I dashur shoku Durro,

E lexova me kënaqësi të madhe letrën që më dërgove. Fjalët e tua të ngrohta, të sinqerta e plot frymëzim optimist, më prekën së tepërmi. M'u duk sikur kuvendova një copë herë me ty dhe të njoha nga afër, mësova për jetën tënde 84-vjeçare, për rrugën e gjatë, për vuajtjet e vështirësitë që ke kaluar, si dhe për ditët e bardha që gëzon sot. Më mbetën në mendje ato që u thoshe shokëve, kur të lindnin fëmijët: «Mos më uroni mua, uroni beun, se djemtë e mi viçat e tij do të ruajnë».

Dhe me të vërtetë ashtu, e varfër dhe e mjeruar, e prapambetur dhe e cfilitur, ishte di-

kur Shqipëria. Po sa bukur e me ç'gëzim i shpreh ti ndryshimet e mëdha që janë bërë sot nga ato kohë të zymta e të trishtuara, që duken jo vetëm në përparimet, në zhvillimin e pakrahasueshëm të ekonomisë e të kulturës, po në radhë të parë në edukimin e njeriut të ri të mrekullueshëm që ka edukuar Partia. Ky ndryshim duket në çdo familje shqiptare, ashtu si edhe në familjen tënde të gëzuar.

Të mirat e mëdha që gëzojmë na i solli Partia, ndaj së cilës ti ushqen një dashuri e besim të madh, pse ajo mendon e punon ditë e natë për popullin. Këtë jetë të re e të lumtur në mbarrë vendin tonë, këtë besim për Partinë ti e shpreh me zemër të bardhë, me ngrohtësi e dashamirësi prej patrioti revolucionar që të gjithë duhet vazhdimisht ta shtojmë e ta forcojmë, pse ajo është shpëtimtarja jonë, udhëheqësja jonë, garancia e lumturisë sonë.

Ti ke plotësisht të drejtë, kur thua se rinia duhet ta njohë gjithnjë e më mirë të shkuarën e vendit dhe më pëlqeu shumë e më gëzoi puna që bën vetë në këtë drejtim që, megjithëse në moshë të madhe, nuk je mbyllur në guaskën e viteve dhe nuk qëndron me tespi në duar apo duke dredhur zinxhirin për të vrarë kohën e për të kaluar një pleqëri «pa andrralla». Ti vazhdon të punosh edhe sot, i flet rinisë për të djeshmen e hidhur, për traditat luftarake, këshillon dhe frymëzon ata që nuk mësojnë e nuk punojnë sa duhet, duke u treguar rrugën e Partisë, suk-

seset e arritura me gjak e me punë të palodhur, të ardhmen e bukur që kemi ndërtuar e do të ndërtojmë vetë, me djersën tonë, akoma më të mirë. Kështu duhet të veprojnë gjithë veteranët, gjithë të moshuarit, tërë pensionistët. Ata janë mësuesit e jetës, sepse kanë një përvojë të gjatë, me të cilën brezi i ri, që të mos gabojë ose të gabojë sa më pak, ka nevojë të armatoset me përvojën e të parëve, e të brezit që po i lë stafetën, që të çajë kurdoherë më shpejt e më me guxim përpara, për ta bërë Shqipërinë socialiste gjithnjë më të bukur, më të lulëzuar e më të fuqishme, një kala të çeliktë revolucionare, ku të thyejnë kokën të gjithë armiqtë që do të guxojnë ta prekin.

Me këtë rast, duke e mbyllur këtë letër, dëshiroj të të falënderoj nga zemra për besimin e madh që shpreh në letër për Partinë, për të cilën s'ka gëzim e lumturi më të madhe sesa besimi që ushqen populli për të. Të uroj i dashur Durro, jetë të gjatë e shëndet, suksese në punën e vlefshme shoqërore, gëzim e lumturi familjare.

Juaji

Enver Hoxha

«Zëri i Vlorës», nr. 56 (708),

14 korrik 1974

**LETËR NGUSHËLLIMI DREJTUAR  
FAMILJES SË ILIA QIQIT  
NË FSHATIN ZERVAT**

*Gjirokastrë*

**30 tetor 1974**

Të dashur prindër, motra dhe vëllezër të Ilias,

Ju shpreh hidhërimin tim të thellë dhe ju dërgoj ngushëllimet më të përzemërta për vdekjen e djalit e vëllait tuaj të dashur, birit besnik të popullit tonë<sup>1</sup>.

Vdekja e Ilias është e rëndë, sepse e shkëputi atë papritur nga familja dhe nga gjiri i shoqërisë në moshën më të bukur, kur ai po hidhte hapat e parë në jetë për t'u shërbyer me devotshmëri Partisë, popullit dhe atdheut, Shqipërisë së tij socialiste. Megjithatë kjo ngjarje kaq

---

1. Ilija Qiqi ra në krye të detyrës më 14 tetor 1974. Presidiumi i Kuvendit Popullor i dha atij titullin e lartë Hero i Punës Socialiste.

e hidhur të ngjall edhe krenari, sepse vendimi që ai mori për t'u kthyer pa humbur kohë në krye të detyrës, nga Burreli në fshatin Lis, për t'u dhënë mësim nxënësve që i donte dhe e donin aq shumë, flet për një shembull të lartë të ndërgjegjes socialiste në punë.

Jam i informuar se Ilia ishte i zellshëm dhe i lidhur ngushtë me punën. Edhe pse kishte pak kohë në Lis të Matit, ku qe duke shërbyer si mësues, me qëndrimet dhe sjelljet e tij të mira ai shpejt meritoi besimin, dashurinë dhe respektin e shokëve, të cilët e kishin zgjedhur sekretar të organizatës së rinisë të shkollës.

Duke shndërruar në bindje të thellë ideologjinë marksiste-leniniste të Partisë, ky komisar i ri i dritës, siç i quan populli ynë arsimtarët e vet, vdiq për të mos u harruar kurrë nga nxënësit e tij të vegjël, nga shokët, nga familja dhe nga mbarë atdheu, që ai e kishte aq shumë në zemër.

Më kanë prekur shumë si qëndrimi burrëror i mbajtur nga ju pas marrjes së lajmit të hidhur dhe fjalët aq të ngrohta që shprehni për Partinë tonë të dashur në letrën që më dërguat, ashtu edhe marrja me shpejtësi e vendimit për të dërguar djalin dhe vëllanë tjetër, Stefanin, që të vazhdojë detyrën e Ilias, duke e zëvendësuar atë menjëherë në vendin ku shërbente.

Ky është një gjest i lartë kuptimplotë. Vajtja nga Dropulli e pjesëtarit tjetër të familjes suaj për të punuar në Burrel, shpreh me qartësinë e

dritës atë patriotizëm të zjarrtë dhe ndjenjë të pastër të vëllazërimit socialist që ka kalitur e kalit çdo ditë te njerëzit tanë Partia. Është kënaqësi e madhe që bij minoritarë shkojnë vullnetarisht e me gëzim në çdo cep të vendit, sepse janë të ndërgjegjshëm që sot atdheu i tyre është tërë Shqipëria, se socializmi ndërtohet kudo, në Jug e në Veri, dhe çdo qytetar e gjen lumturinë jo vetëm atje ku ka lindur, por në gjithë territorin e Republikës sonë Popullore.

Duke qëndruar shpirtërisht pranë jush, bashkë me ngushëllimet, ju dërgoj edhe përshëndetjet e mia të nxehta dhe shpreh dëshirën që paskëtaj të keni kurdoherë gëzime, lumturi dhe suksese në punë. Stefanin e përgëzoj nga zemra për gatishmërinë që tregoi dhe i uroj shëndet e rezultate të mira në detyrën aq të bukur të mësuesit për edukimin komunist të brezit të ri.

Juaji

*Enver Hoxha*

«Dy popuj miq», f. 214

## TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË SHOKUT REXHEP DURAKU

*Gjakovë-Kosovë*

**21 janar 1975**

Bashkëshortes dhe fëmijëve të të ndjerit  
Rexhep Duraku

Me hidhërim të thellë mësova për vdekjen e mikut tim të respektuar, patriotit Rexhep Duraku, bashkëshortit dhe babait tuaj të dashur, që rriti dhe edukoi shokun tonë të luftës, komunistin veteran, birin revolucionar të Kosovës heroike dhe të të gjithë popullit shqiptar, të pahiruarin Emin Duraku.

Duke marrë pjesë në këtë hidhërim, ju shpreh juve dhe gjithë të afërmve të familjes suaj ngushëllimet e mia më të sinqerta.

*Enver Hoxha*

«Zëri i popullit», nr. 18 (8249),  
22 janar 1975

**TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR  
FAMILJES SË NAIM FRASHËRIT**

*Tiranë*

**18 shkurt 1975**

**Bashkëshortes, vajzës dhe djemve**

Mësova me hidhërim të thellë për vdekjen e papritur të bashkëshortit dhe babait tuaj të dashur Naimit, shokut tonë komunist, Hero i Punës Socialiste dhe Artist i Popullit. Humbja e tij e parakohshme po lë një boshllëk të ndjeshëm në radhët e punonjësve të artit dhe të kulturës së vendit tonë midis të cilëve ai zinte një vend nderi. Tërë jetën e tij me një ndërgjegje të lartë socialiste Naimi shkriu të gjitha energjitë për ta

çuar përpara artin tonë skenik në rrugën e Partisë.

Ju dërgoj në këto çaste të rënda për familjen tuaj ngushëllime të përzemërta.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR KOLEKTIVIT PUNONJËS  
TË SHARRAVE TË PUKËS**

*Fushë-Arrëz*

**2 shtator 1975**

Të dashur shokë punëtorë të sharrave,

Ju falemnderit shumë për ftesën që më dërguat për të marrë pjesë në festën e 30-vjetorit të themelimit të ndërmarrjes suaj. Edhe vetë kisha dëshirë të madhe të isha midis jush me këtë rast, por duke qenë i zënë me punët e Partisë, nuk vij dot të kuvendoj sy për sy me ju, punëtorë heroikë e të palodhur të sharrave. Megjithëkëtë, të jeni të sigurt se gëzimin e festës suaj e ndiej edhe unë, prandaj me mendje e me zemër jam sot aty, midis jush. Me këtë rast kaq të gëzueshëm ju dërgoj përshëndetjet më të ngrohta të Komitetit Qendror të Partisë e të miat dhe ju uroj shëndet e rezultate akoma më të larta në luftën që po bëni, si tërë klasa jonë heroike punëtoresh, për ndërtimin e socializmit.

Ju më vutë në dijëni për sukseset që keni arritur nën udhëheqjen e organizatës-bazë të Partisë, për rezultatet e punës suaj krijuese, për rritjen e shkallës së mekanizimeve në një sërë procesesh pune dhe për aksionet e njëpasnjëshme, që tani janë bërë metodë e punës së klasës punëtore dhe të masave punonjëse të vendit tonë. Këto flasin qartë për dashurinë e pakufishme që ushqeni për Partinë, për atdheun, për popullin tonë të mrekullueshëm dhe për punën që ju jep krahë për të ecur kurdoherë përpara. Ju, pa përfillur asnjë vështirësi, i keni realizuar vazhdimisht me nder detyrat e caktuara, keni dhënë prodhime me cilësi të lartë, gjë që tregon se i keni përvetësuar drejt mësimet e Partisë.

Mbarë populli shqiptar krenohet me të drejtë për industrinë e fuqishme, për kombinatet, për uzinat e hidrocentralet, për rrugët, hekurdhat, shkollat, shtëpitë e kulturës, shtëpitë e banimit etj., etj., të ngritura me duart e arta të klasës sonë punëtore, e udhëhequr nga Partia. Ai di gjithashtu se edhe sharrëxhinjtë e druvarët e palodhur pukjanë, duke punuar në kushte të vështira, në shi e në dëborë, i kanë siguruar vazhdimisht ndërtimit socialist të vendit lëndën aq të domosdoshme të drurit, duke dhënë kështu një kontribut të paçmuar në përparimin dhe në mbrojtjen e atdheut, prandaj ushqen një dashuri e respekt të veçantë për ta.

Ju përgëzoj për punën e mirë që po bëni gjithashtu në ndihmë të fshatit. Ditët e punës që

keni realizuar atje, kontributi i dhënë për mekani-  
nizimin e mëtejshëm të punimeve bujqësore, vaj-  
tja e shumë shokëve punëtorë nga kolektivi i  
ndërmarrjes për të punuar e jetuar pranë famil-  
jeve të tyre në kooperativa, — të gjitha këto ka-  
në ndikuar që fshati të përparojë e të zhvillohet  
më tej, që jeta e tij të bëhet sa më e bukur, që ajo  
t'i afrohet sa më shumë asaj të qytetit, që alean-  
ca e klasës sonë punëtoresh me fshatarësinë koo-  
perativiste të forcohet pandërprerë. Puna juaj  
në këtë drejtim, si dhe e shumë ndërmarrjeve,  
institucioneve e organizatave të tjera shtetërore,  
kooperativiste e shoqërore të vendit tonë, është  
një shembull i lavdërueshëm që duhet përkrahur  
e ndjekur nga të gjithë.

Duke u mbështetur në traditat burrërore dhe  
në patriotizmin e malësorëve trima pukjanë dhe  
të kolektivit tuaj revolucionar, kam besim se  
sukseset e arritura do t'ju shtyjnë gjithmonë për-  
para dhe se zotimet e marra me rastin e festës  
do t'i vini në jetë deri në fund.

Edhe një herë ju uroj: Gëzuar festën, shën-  
det e lumturi në familje dhe suksese gjithnjë  
më të mëdha në punë për të mirën e atdheut dhe  
të të gjithë popullit tonë!

Juaji

*Enver Hoxha*

«Zëri i popullit», nr. 213 (8444),  
6 shtator 1975

**TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR  
FAMILJES SË SHOKUT KAHREMAN YLLI**

*Tiranë*

**4 shtator 1975**

E dashur motër Parashqevi, të dashur djem:  
Fatos, Artan dhe Agron,

Vdekja e papritur dhe e parakohshme e shokut Kahreman, bashkëshortit dhe prindit tuaj të dashur, njëkohësisht shokut të kohëve të vështira të Luftës Nacionalçlirimtare dhe bashkëpunëtorit tonë të afërt, birit besnik të Partisë dhe të popullit, anëtarit të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Presidiumit të Kuvendit Popullor më ka hidhëruar thellë.

Shoku Kahreman u nda nga ne në një kohë kur ndihej shumë kontributi i tij në punët e Partisë dhe të pushtetit tonë popullor, çështjes të të cilëve ai u kushtoi gjithë jetën si militant

dhe luftëtar i vendosur. Të gjithë shokët e tij dhe unë personalisht e ndiejmë boshllëkun që la ai midis nesh. Por këtë humbje të rëndë për ne dhe për familjen tuaj jam i bindur që ju, duke pasur si kurdoherë pranë Partinë dhe ne shokët e tij, do ta ktheni në forcë për të kryer me nder detyrat që keni përpara si arsimtare, studentë dhe nxënës, ashtu siç ju ka frymëzuar vazhdimisht bashkëshorti dhe babai juaj i nderuar, që gjithë jetën vetë punoi me devocion e vendosmëri për t'u shërbyer deri në fund me të gjitha forcat Partisë, atdheut, popullit dhe çështjes së socializmit. Prandaj vepra dhe kujtimi i tij do të jenë të paharruar për ne.

Në këto çaste të rënda për familjen tuaj ju dërgoj ngushëllimet më të përzemërta.

Juaji

*Enver*

**Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë**

**LETËR DREJTUAR KOOPERATIVISTEVE  
TË KËMISHTAJT DHE KOOPERATIVISTEVE  
TË DALLUARA TË RRETHIT TË LUSHNJËS**

22 shtator 1975

Të dashura shoqe të Kooperativës së Tipit të  
Lartë të Këmishtajt,

Të dashura shoqe kooperativiste të dallua-  
ra të rrethit të Lushnjës,

Lexova me interesim e me kënaqësi të ve-  
çantë letrën që më dërguan 250 kooperativistet  
e dalluara të rrethit të Lushnjës, si dhe raportin  
shumë të qartë, instruktiv e frymëzues të krye-  
tares së kooperativës së Këmishtajt, Heroinës së  
Punës Socialiste, shoqes Themie Thomai. U gë-  
zova pa masë për përfundimet shumë të mira që  
ka arritur rrethi i Lushnjës në korrjet e sivjet-  
me të grurit, dhe veçanërisht për rezultatet e  
shkëlqyera që kanë arritur anëtarët e Koopera-  
tivës së Tipit të Lartë të Këmishtajt. Në emër të

Komitetit Qendror të Partisë i përgëzoj dhe u shtrëngoj duart atyre për faktin që morën rendimentin më të lartë në grurë nga të gjitha ekonomitë bujqësore të rrethit dhe që prej disa vjetësh me radhë i plotësojnë e i tejkalojnë detyrat e planit edhe në prodhimet e tjera bujqësore e blegtorale.

Ju, të dashura shoqe, u mblodhët në Këmishtaj jo për të bërë paradë suksesesh, por për të diskutuar me frymë të lartë luftarake, siç na mëson Partia, dhe për të treguar e për të argumentuar në mënyrë shkencore bazat e sukseseve tuaja, duke goditur konceptet e praktikat e prapambetura, që të gozhdojnë në vend ose të tërheqin prapa, dhe duke i lidhur detyrat tuaja me kërkesat e ndërtimit të socializmit e të mbrojtjes së atdheut. Kjo është një praktikë me të vërtetë revolucionare, që nxit dhe inkurajon ecjen përpara, drejt sukseseve gjithnjë e më të mëdha.

Rezultatet e kooperativës së Këmishtajt në të gjitha prodhimet bujqësore e blegtorale të entuziazmojnë: brenda 4 vjetëve të fundit u rrit afro dyfish rendimenti i grurit dhe i misrit, duke arritur përkatësisht 43,6 dhe mbi 50 kuintalë për hektar, afro dyfish ai i pambukut, mbi trefish i fasules dhe 1,7 herë i qumështit të lopëve. Është fare e qartë se këtyre përfundimeve u hap rrugë më të gjerë edhe forma e re e organizimit në kooperativë të tipit të lartë, e cila harmonizoi më mirë interesat e të gjithë shoqërisë me ata të kooperativistëve, përsosi më tej or-

ganizimin shkencor të prodhimit, duke vendosur mbi baza të shëndosha drejtimin ekonomik kryesor të kooperativës, bashkërendimin racional të degëve të ndryshme të prodhimit, sidomos të bujqësisë e të blegtorisë, dhe duke përcaktuar radhën e mbjelljeve dhe të ndërrimit të kulturave bujqësore në mënyrë të organizuar. Të gjitha këto vërtetojnë në jetë drejtësinë e vijës së Partisë, të politikës së saj largpamëse ekonomike për zhvillimin e fshatit tonë socialist, me pikësynimin e madh për të ngushtuar e për të zhdukur dallimet esenciale midis qytetit e fshatit.

Shembulli i kooperativës së Këmishtajt, sukseset e saj të mëdha të gëzojnë e të frymëzojnë shumë edhe për faktin se atje në drejtim të punëve ka shumë gra, siç janë kryetarja e talentuar Themie Thomai, brigadieret e palodhura Athina Andoni, Prenda Liço, Ana Qorri, komunistet, këshilltaret dhe kooperativistet e dalluara Themie Pjetri, Donika Prifti, Sila Allkanjari, Konxhe Dhima, Marie Lena e të tjera. Partia jonë e dashur ka edukuar e ka përgatitur gra të tilla revolucionare, punëtore të palodhura edhe në të gjitha kooperativat e tjera, siç janë Vangjeli Shani, Pavlina Prendi, Nazmie Ibrahimllari, Anthulla Akulli e shumë të tjera si këto, që me vullnet të madh e me këmbëngulje mësojnë dhe luftojnë për të përvetësuar e për të vënë në jetë eksperiencën e përparuar e të rejtat e shkencës, për revolucionarizimin dhe për të çuar përpara prodhimin bujqësor. Kjo dëshmon edhe një herë

se porosia e Partisë, për ta ngritur sa më lart rolin e grave në ndërtimin socialist, për t'u besuar atyre pa druajtje dhe në çdo fushë vende me përgjegjësi, ka qenë plotësisht e drejtë.

Siç thoni edhe ju, të dashura shoqe, faktorë me rëndësi shumë të madhe në marrjen e rendimenteve të larta janë bërë pasioni dhe kujdesi për të mësuar me këmbëngulje, për të zotëruar shkencën dhe për ta zbatuar atë në mënyrë krijuese, në bazë të kushteve konkrete, në përputhje me kërkesat e tokës, të bimëve dhe të kafshëve. Dhe këto rrjedhin nga kuptimi juaj i drejtë se nuk mund të ketë bujqësi moderne të prodhimit të zgjeruar socialist pa dituri dhe pa shkencë, pa i bërë këto pronë të masave të gjera punonjëse. Duke e kombinuar drejt eksperimentimin shkencor me përvojën e përparuar në të gjitha kulturat bujqësore, ju u keni kushtuar një vëmendje të veçantë sistemimit dhe nivelimit të tokës, kullimit dhe ujitjes, plehërimit racional mbi bazën e të dhënave agrokimike, zgjedhjes e përdorimit të farërave më të mira dhe kryerjes së rregullt të shërbimeve, gjer në mbledhjen e shpejtë e pa humbje të prodhimit.

Kooperativa e Këmishtajt zbatoi një agroteknikë të lartë në kultivimin e grurit. Të tërë e mbolli pas bimëve prashitëse e bishtajore, zgjidhi drejt strukturën e llojeve të farërave në përshatje me kushtet konkrete të tokës e ato atmosferike, siguroi një kullim shumë të mirë të tokave, duke kombinuar drenazhimin me vijat

kulluese, përdori gjerësisht lesimin. Gruri u plehërua sipas normave dhe i kombinuar me plehërim të lëngshëm, duke u mbështetur në hartat agrokimike. Dhe, më në fund, ujtja gati në tërë sipërfaqen tregoi se kooperativistët, në kushtet e thatësisë së këtij viti, nuk qëndruan duarlidhur, por i mposhtën vështirësitë e natyrës.

Si revolucionarë të vërtetë kanë punuar e kanë drejtuar në këtë kooperativë komunistët, me sekretarin e palodhur të byrosë së Partisë, shokun Llazi Liko në krye, si dhe brigadierët e dalluar, mjeshtrit e vërtetë të prodhimit bujqësor e blegtoral Hilli Mile, Llazi Cauli, Koli Llupo, Lili Maka, Kadri Pirra, Nasi Saveta, Josif Maka e të tjerë.

A nuk përbëjnë të gjitha këto një shembull shumë të mirë që tregon se çfarë rezultatesh të mrekullueshme arrihen kur bujqësia organizohet e drejtohet mbi baza shkencore, kur njerëzit, të udhëhequr e të edukuar nga Partia, shkrijnë në punë të gjitha energjitë, mendjen dhe zemrën e tyre, kur parashikohen dhe planifikohen të gjithë treguesit e faktorët që përbëjnë kompleksin e prodhimit bujqësor, duke përfshirë edhe kushtet atmosferike? Ja pse eksperiencia e kooperativës së Këmishtajt duhet të shërbejë si shkollë e madhe dhe të bëhet flamur për të gjitha ekonomitë bujqësore të vendit, burim i madh frymëzimi, për t'i dhënë një hov të ri zhvillimit të bujqësisë sonë socialiste.

Çfarë begatie do të krijohet dhe sa do të fuqizohet atdheu ynë kur të arrihen treguesit e Këmishtajt dhe të ekonomive të tjera të përparuara në zona të ndryshme të vendit! Kjo nuk është thjesht një dëshirë, por një mundësi reale, e bazuar shkencërisht, e vërtetuar në praktikë. Këto mundësi i kanë të gjitha kooperativat e tjera të rrethit tuaj, si dhe ndërmarrja bujqësore «29 Nëntori», me një bazë më të fuqishme materialo-teknike dhe me kushte të tjera të favorshme, por që kanë marrë 7 deri 12 quintalë grurë për hektar më pak se ajo e Këmishtajt. Këto mundësi i kanë edhe kooperativat e ndërmarrjet bujqësore të rretheve të tjera, të cilat kanë pranë tyre ekonomi të tilla të dalluara, si kooperativa «Agimi» në rrethin e Fierit, e Pojanit në rrethin e Korçës, e Çërravës në rrethin e Pogradecit, e Dropullit të Poshtëm në rrethin e Gjirokastrës, e Llugajt në rrethin e Tropojës, që në grurë e në prodhime të tjera kanë marrë rendimente të larta.

Për këtë duhet të mendojmë thellë të gjithë e të luftojmë që, duke shfrytëzuar në maksimum rezervat e mëdha që ekzistojnë kudo, të arrihet Këmishtaj, të konkurrohen kjo dhe ekonomitë e tjera të përparuara, ndërsa të dalluarit, pa u dehur nga sukseset, të gjejnë rrugë e mundësi të reja për të konsoliduar fitoret e arritura e për të ecur edhe më përpara.

Zhvillimi është një proces i pandërprerë.

Mundësitë dhe rezervat në bujqësi për të ecur me ritme të shpejta përpara janë të pakufishme. Prandaj lufta dhe përpjekjet duhen ngritur në një shkallë më të lartë për të arritur rezultate më të mëdha. Ndërtimi socialist dhe mbrojtja e atdheut kërkojnë që të prodhojmë sa më shumë drithëra buke, ta sigurojmë bukën në vend, jo vetëm për sot, por të krijojmë edhe rezerva. Ta shtojmë në maksimum prodhimin dhe përdorimin e patateve, të perimeve, të fasuleve e të thjerrëzave, që janë aq të domosdoshme dhe me vlera shumë të mëdha për ushqimin e popullsisë në qytet e në fshat. T'i sigurojmë gjithmonë e më mirë nevojat e vendit me yndyrna, sheqer, oriz, pambuk etj. Të hapim toka të reja. Të zhvillojmë blegtorinë, duke treguar kujdes të veçantë për shtimin dhe për përmirësimin e lopëve me racat më të mira, duke shtuar e duke përmirësuar dhentë e dhitë, për të cilat ka kudo mundësi në vendin tonë, duke shtuar kafshët e punës e pendët e qeve, dhe duke bërë një kthesë rrënjësore në sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë. Të zgjerojmë mbjelljen e ullinjve, të pemëve e të vreshtave. Të vëmë në jetë porositë e Partisë që kodrat e malet t'i bëjmë pjellore e të begatshme si edhe fushat.

Realizimi i këtyre detyrave duhet të jetë objekt i një studimi të thellë nga çdo ekonomi dhe institucion kërkimor-shkencor, nga të gjithë punonjësit dhe specialistët e bujqësisë, të cilët,

duke u mbështetur në treguesit e ekonomive të përparuara, përmes një analize të hollësishtme, të nxjerrin në dritë çfarë është bërë, çfarë nuk është bërë dhe çfarë duhet bërë, me synim që të parashikojnë dhe të arrijnë detyra mobilizuese e revolucionare për vitin 1976 dhe për krejt pesëvjeçarin e ardhshëm.

Për të siguruar rendimente të larta në bujqësi janë të nevojshme njohja e zbatimi i shkencës bujqësore dhe i eksperiencës së përparuar në prodhimin e gjerë. Kjo kërkon njerëz të arsimuar, sepse edhe kooperativisti i thjeshtë duhet të jetë në gjendje të vërë në zbatim të dhënat e shkencës bujqësore. Traktoristët, kombajnerët dhe gjithë mekanizatorët e bujqësisë, gjithashtu, të thellojnë dijet e tyre dhe të bëhen mjeshtër të vërtetë të prodhimit bujqësor. Përpjekje të mëdha e të vazhdueshme duhet të bëjnë posaçërisht specialistët e bujqësisë, për të rritur njohuritë e tyre teknike, për t'i pasuruar përditë ato me të dhënat praktike të zhvillimit të ekonomisë bujqësore. Studimet agrokimike e pedologjike, të bonifikimit e të sistemimit të tokave, të strukturës e të llojeve të farërave, të fidaneve e të gjësë së gjallë, studimet për organizimin dhe për forcimin e brendshëm ekonomik-organizativ të ekonomisë bujqësore të përdoren më mirë nga të gjithë dhe të përsosen e të thellohen më tej.

Nga zhvillimi dhe nga modernizimi i bujqësisë varet shumë rritja e vazhdueshme e mirë-

qenies së mbarë popullit tonë. Prandaj, shoqe e shokë kooperativistë, të shtoni mobilizimin dhe të luftoni me të gjitha forcat për t'i dhënë një hov të fuqishëm rritjes së prodhimit bujqësor, duke filluar qysh tani me vjeljen e të vonave dhe me mbjelljet e vjeshtës. Punonjësit e qytetit të përfshihen gjithmonë e më shumë në këtë mobilizim për të ndihmuar fshatin me aksione masive, të vazhdueshme e të organizuara mirë. Në ballë të kësaj pune të qëndrojnë, si kurdoherë, klasa punëtore. Rinia jonë, që i është përgjigjur me gatishmëri çdo thirrjeje të Partisë, të shkojë me dëshirë për të punuar e për të jetuar në fshat, të ndër marrë aksione të rëndësishme, që do ta bëjnë fshatin më të begatshëm dhe jetën më të bukur.

Organizatrat e Partisë dhe komunistët të bëhen promotorë të fuqishëm për t'i ngritur të gjithë njerëzit në këmbë, për të rritur tek ata sedrën, besimin dhe optimizmin revolucionar se s'ka detyrë që nuk përmbushin, s'ka kala që s'marrin njerëzit e rinj të Shqipërisë socialiste, të edukuar dhe të udhëhequr nga Partia jonë e lavdishme.

Edhe një herë ju përgëzoj, të dashura shoqe, dhe ju uroj t'i vini sa më parë në jetë ato që mësuat në takimin tuaj, duke punuar e duke luftuar me trimëri e dituri, ashtu siç dinë të punojnë e të luftojnë gratë tona heroike. Le të bëhet shembulli i Këmishtajt një shkëndijë që të

nde të një zjarr të madh të ri, për t'i ngrohur  
akoma më shumë zemrat e mbarë popullit shqip-  
tar me prodhime bujqësore e blegtorale gjithnjë  
e më të bollshme!

Juaji

*Enver Hoxha*

«Raporte e fjalime 1974-1975»,  
f. 364

**LETËR DREJTUAR POPULLIT  
TË FSHATRAVE DHIVËR, CERKOVICË,  
SHËNDRE, MEMORAQ E TË TJERË**

*Sarandë*

**25 nëntor 1975**

Të dashur vëllezër dhe motra,

Në këto ditë kur mbarë populli ynë, si një trup i vetëm, i është përveshur punës për t'i pritur me gëzim festat e tij të mëdha të Nëntorit me realizimin e detyrave të vitit të fundit të pesëvjeçarit të pestë, na erdhi papritur lajmi i hidhur mbi tërmetin që preku fshatrat dhe familjet tuaja<sup>1</sup>. Dëmet dhe dhimbja që ju shkaktoi kjo fatkeqësi e natyrës tani, në prag të dimrit,

---

1. Më 22 nëntor 1975, në orën 11,06 minuta u vërtetuan lëkundjet e një tërmeti të fortë me një fuqi prej 7 ballësh në 15 fshatra të rrethit të Sarandës.

ka prekur thellë kudo, gjithë Partinë dhe popullin shqiptar, anekënd atdheut.

Gjithë populli ynë, Partia dhe Komiteti i saj Qendror, në këto momente të vështira, e ndiejnë veten pranë jush dhe, ashtu sikurse në gëzime e në të mira, marrin pjesë dhe ndajnë me ju shqetësimet që ju shkaktoi tërmeti.

Porsa mora lajmin e hidhur për sa ju ndodhi, i dhashë urdhër Qeverisë që t'ju dërgohehin menjëherë ndihmat e para dhe njëkohësisht të merren masat që brenda muajit dhjetor të gjitha shtëpitë e rrënuara të pabanueshme të ndërtohen të reja, ndërsa të dëmtuarat të riparohen gjithashtu brenda këtij afati.

Tanimë në Shqipërinë socialiste është bërë traditë që fatkeqësitë kapërcehen së bashku, vuajtjet lehtësohen e zhduken shpejt. Kështu ndodhi në vitin 1967 në rrethet e Dibrës e të Librazhdit, kështu ndodhi edhe dy vjet më vonë, më 1969, në disa rrethe të Jugut, kështu po ndodh edhe me ju. Atdheu socialist dhe populli vuajnë kur një pjesë e tyre është në vështirësi, zemrat e të gjithëve rrahin dhe ndiejnë njëlloj, prandaj jam i bindur se ju nuk ju ligështon aspak kjo që ju ndodhi. Te ne, që udhëheq Partia, punohet e jetohet me moton «Të gjithë për një dhe një për të gjithë», prandaj njerëzit punojnë me plot besim dhe me të gjitha forcat për t'i çuar gjithnjë më përpara ndërtimin socialist dhe çështjen e mbrojtjes nga çdo armik të fitoreve të arritura.

Kanë perënduar një herë e përgjithmonë ato kohë të zymta për popullin, kur në raste të tilla njerëzit e prekur nga një fatkeqësi e rëndë mbeteshin gjithë jetën në mjerim e varfëri. Rëndin feudo-borgjez populli shqiptar e përmbysi një herë e përgjithmonë dhe vendosi pushtetin e vet, që e forcon dita-ditës dhe e mbron nga çdo armik.

Me këtë rast ju dërgoj të gjithë juve, të dashur vëllezër e motra, të rinj, të reja e fëmijë të familjeve të prekura nga tërmeti, përshëndetjet më të ngrohta të Komitetit Qendror të Partisë e personalisht të miat dhe ju siguroj se deri në përfundimin e ndërtimit të plotë të shtëpive të rrënuara e të dëmtuara, do të jemi me mendje e me zemër aty, pranë jush.

Unë shpreh bindjen se komunistët e rrethit tuaj, si dhe vullnetarët e ardhur nga gjithë Shqipëria, tok me ju, ashtu sikurse i ka edukuar Partia, do të jenë në ballë të fronteve më të vështira për eliminimin brenda kohës më të shkurtër të pasojave të tërmetit.

Edhe një herë ju uroj suksese në përballimin e kësaj fatkeqësie dhe në zhdukjen sa më parë të pasojave që solli ajo.

Juaji

*Enver Hoxha*

«*Dy popuj miq*», f. 224.

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR SHKOLLËS  
SË MESME TË PËRGJITHSHME  
«QEMAL STAFA» ME RASTIN  
E 50-VJETORIT TË SAJ**

**12 dhjetor 1975**

Të dashur nxënës e pedagogë të shkollës së mesme të përgjithshme «Qemal Stafa»,

Pak ditë më parë, të gjithë së bashku, popull e Parti, kremtuam me madhështi e entuziazëm festat e mëdha të Nëntorit. Ju tani keni një tjetër gëzim, kremtimin e një ngjarjeje të rëndësishme në historinë e arsimit tonë kombëtar, çeljen 50 vjet më parë të gjimnazit «Qemal Stafa». Si ish-mësues i kësaj shkolle, ju falënderoj nga zemra për ftesën që më dërguat dhe me gjithë dëshirën time të zjarrtë, për shkak të punëve nuk kam mundësi të marr pjesë në këtë gëzim të përbashkët. Sidoqoftë, në këto çaste kaq të gëzueshme unë e ndiej veten sikur të isha aty, midis jush.

Shkolla juaj, kjo vatër e zjarrtë patriotike

dhe revolucionare, burim i fuqishëm drite në zemër të kryeqytetit të atdheut tonë socialist, ishte vepër e këmbënguljes së shtresave më të varfra të popullit patriot e arsimdashës të Tiranës dhe e përpjekjeve të pandërprera të revolucionarëve demokratë, si Avni Rustemi, Sali Ceka e të tjerë. Qeveria reaksionare e Zogut, me gjithë synimet e saj të errëta, nuk i mposhti dot ndjenjat e fuqishme të popullit, i cili kurdoherë pranë pushkës e parmendës ka mbajtur në gji librin dhe në shekuj ka qenë i prirë drejt dritës, kulturës dhe përparimit shoqëror. Regjimi i urryer i errësirës përdori të gjitha mjetet e mënyrat për ta shuar këtë shkëndijë, por populli e mbajti atë kurdoherë ndezur, e mbrojti me të gjitha forcat dhe dërgoi në të djemtë dhe vajzat e tij që ishin shpresa e së ardhmes së vendit.

Shkolla juaj, të dashur nxënës dhe mësues, ka një histori të ndritur. Ajo i ushqeu të rinjtë e të rejat që e ndoqën me frymë të lartë atdeshdashurie e kryengritëse kundër regjimit të Zogut e pushtimit fashist dhe u bë një qendër e rëndësishme e përhapjes së ideve komuniste. Aty mësuan bijtë e shquar të popullit e të Partisë, si Qemal Stafa, Vasil Shantoja, Ali Demi, Themo Vasi, Asim Zeneli, Margarita Tutulani, Nazmi Rushiti, Shyqyri Ishmi, Skënder Çaçi, Shejnaze Juka, Manush Alimani, Myslim Keta, Alqi Kondi e të tjerë. Shkolla juaj dha në luftën për lirinë e atdheut më tepër se 70 dëshmorë. Prej saj dolën qindra partizanë e kuadro që sot drej-

tojnë dhe punojnë me besnikëri në sektorë të rëndësishëm të jetës sonë, si Ramiz Alia, Xhafer Spahiu, Heroi i Punës Socialiste që nuk është më midis nesh Naim Frashëri, Artisti i Merituar Sandër Prosi e të tjerë. Në shkollën tuaj kanë punuar arsimtarë të shquar e patriotë, që njihen për kontributin e dhënë në zhvillimin e arsimit, të shkencës e të kulturës sonë, si Nonda Bulka, Sotir Angjeli, Aleko Tashko, Aleks Buda, Eqrem Çabej, Ahmet Gashi, Vangjel Gjikondi, Abdurrahim Buza e të tjerë. Jam i bindur se ju do ta mbani e do ta çoni edhe më lart, ashtu si gjithmonë, veprën e pavdekshme të ish-nxënësit, Heroit të Popullit, shokut tim të paharruar të luftës Qemal Stafa, emrin e të cilit e mban shkolla juaj.

Shkolla jonë e re, duke iu përgjigjur kërkesave të shoqërisë sonë socialiste, mishëron në një unitet dialektik mësimin me punën dhe edukimin fizik e ushtarak. Mësimet e çmuara të Partisë, orientimet e saj të njëpasnjëshme, e sidomos vendimet e Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror, janë busull për ta çuar më përpara e për ta revolucionarizuar vazhdimisht, si kudo, edhe veprimtarinë e shkollës suaj.

Në etapën që po kalojmë roli i shkollës është bërë edhe më i ndjeshëm. Pa studimin e teorisë fitimtare, marksizëm-leninizmit, pa mësimet dhe eksperiencën e Partisë sonë të dashur, pa shkollë, pa dituri të thella, nuk mund të ecim dot përpara me ato ritme që kërkohen. Populli

dhe Partia nuk kursejnë për arsimin dhe shpreh besimin se edhe ju, mësues e nxënës, si një trup i vetëm, do të punoni e do të mësoni pa u lodhur e me zell të madh, do të përvetësoni me etje ideologjinë e Partisë sonë, marksizëm-leninizmin, do të mësoni thellë e me pasion komunizmin, do të ngrini nivelin shkencor të dijeve tuaja dhe do ta bëni shkollën vatër të edukimit revolucionar e klasor të rinisë.

Ashtu si deri më sot, nxënësit që do të dalin paskëtaj nga bankat e shkollës suaj do të jenë me siguri punëtorë, kooperativistë e intelektualë të ndërgjegjshëm e të palodhur, patriotë të flaktë e luftëtarë të vijës së parë për ta zbatuar vijën e Partisë, ndërtimin socialist dhe mbrojtjen me heroizëm të atdheut tonë të lumtur.

Gëzuar festën! Faqebardhë dalshi kurdoherë, për ta ngritur lart e më lart flamurin e traditave luftarake të shkollës suaj, të arsimit tonë popullor dhe për të arritur suksese edhe më të mëdha në të ardhmen!

Juaji

Enver Hoxha

«Zëri i popullit», nr. 298 (8529),

14 dhjetor 1975

## **LETËR DREJTUAR SHOQES FILE HABILI NË FSHATIN OKSHTUN**

*Durrës*

**29 dhjetor 1975**

E dashur dhe e nderuar nënë File,

E mora letrën e dashur që më dërgove me rastin e kthimit në atdhe të eshtrave të luftëtarëve trima që dhanë jetën jashtë kufijve, një nga të cilët ishte edhe Ramazani, djali yt i shtrenjtë dhe shoku ynë besnik i Luftës Nacionalçlirimtare.

Partia dhe populli do t'u jenë në shekuj mirënjohës bijave dhe bijve partizanë si Ramazani që, pasi dëbuan okupatorët që na kishin zaptuar vendin, vazhduan luftën edhe për çlirimin e vëllezërve tanë të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit, Maqedonisë e Malit të Zi, si dhe të popujve fqinj të Jugosllavisë që ishin gjithashtu të

okupuar si ne. Prandaj, në ditët kur eshtrat e tyre u kthyen në truallin amtar<sup>1</sup>, u ngrit në këmbë gjithë populli dhe u bëri atyre nderimet më të larta. Partia dhe populli plotësuan kështu një detyrë fisnike ndaj gjithë atyre partizanëve trima që me kontributin e gjakut të tyre të pastër ngritën lart emrin e Shqipërisë.

Të uroj shëndet që të rrosh sa më shumë, e dashur nënë, për ta parë edhe më Republikën Popullore të Shqipërisë që, nën udhëheqjen e Partisë, lulëzon e forcohet dita-ditës, ashtu siç e deshi Ramazani, biri yt dhe shoku besnik i Luftës Nacionalçlirimtare.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

---

1. Eshtrat e dëshmorëve tanë u sollën në Shqipëri më 6 dhjetor 1975.

**TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR  
FAMILJES SË QERIM UKË MUKËS**

*Rrashbull-Durrës*

**8 janar 1976**

E dashur motër Rape,  
Të dashur Mustafa, Avdi e Skënder,

Jam prekur thellë nga vdekja e patriotit të vjetër dhe shokut tonë besnik të Luftës Nacionalçlirimtare dhe të ndërtimit socialist Qerim Ukë Muka. Humbja e tij pikëlloi jo vetëm ju, bashkëshorten, djemtë dhe vëllanë e tij, nuset, nipërit e mbesat, por edhe gjithë miqtë e shokët e tij që e kanë njohur, e kanë dashur dhe e kanë respektuar për meritat e tij të shumta.

Qerimi ishte një bir besnik i Kosovës trimë dhe të palëkundur asnjëherë përpara furtunave që, ashtu si tek të gjithë bijat dhe bijtë e saj të mençur e patriotë të vendosur, edhe tek

ai pati mburjtur dashurinë e pakufishme për Shqipërinë, vendosmërinë e patundur për mbrojtjen e saj, si dhe për ruajtjen me nder e krenari të ligjshme të emrit të nderuar dhe të qenies shqiptar.

Si një patriot revolucionar ai e donte me të gjitha forcat e shpirtit të vet Shqipërinë socialiste, së cilës i shërbeu me besnikëri e konsekuencë në rrugën e drejtë të Partisë deri në fund të jetës, prandaj kujtimi i shokut dhe vëllait tonë, Qerim Ukë Mukës, do të mbetet i paharruar për ne, emri i tij do të përmendet kurdoherë me respekt.

Me këtë rast kaq të hidhur për të gjithë ne, ju shpreh juve, familjes suaj dhe gjithë miqve e shokëve kosovarë që jetojnë në vendin tonë, ngushëllimet e mia më të ngrohta vëllazërore.

Juaji

*Enver Hoxha*

«Zëri i popullit», nr. 7 (8550),  
9 janar 1976

## **LETËR DREJTUAR TIPOGRAFËVE VETERANË**

*Tiranë*

**15 prill 1976**

Të dashur shokë,

Më mbushën zemrën plot gëzim fjalët tuaja aq të ngrohta, plot mirënjohje e dashuri të thellë për Partinë, entuziazmi juaj në punë, në mënyrë të veçantë në ato ditë kur punuat pa u lodhur për shumëfishimin e Projektkushtetutës së re, si dhe optimizmi që shprehni në letrën që më dërguat për të ardhmen e lumtur të popullit tonë.

Ju, të dashur shokë, tipografë veteranë, me besnikërinë që ju karakterizon dhe me punën tuaj të palodhur për çështjen e madhe të popullit, e keni ndjekur hap pas hapi Partinë, si dje

në luftë, edhe sot, gjatë ndërtimit të socializmit. Ju kurdoherë keni punuar dhe vazhdoni të punoni në rrugën e çelur nga shokët tanë të pahiruar, heronjtë e popullit Mihal Duri, Misto Mame e të tjerë tipografë revolucionarë komunistë që, qysh në orët e para të themelimit të Partisë, iu ndodhën asaj pranë dhe i shërbyen me vetëmohim, derisa dhanë jetën për çështjen e saj të madhe.

Ju vetë në vitet e stuhishme të Luftës Nacionalçlirimtare, pa u trembur aspak nga rreziqet që mund t'ju kushtonin kokën, punuat nën hundën e armikut në kushtet shumë të vështira të ilegalitetit, të rraskapitur dhe shpesh bile me barkun bosh, por gjithnjë me shpirt të lartë luftarak, sepse ishit të ndërgjegjshëm për detyrën me përgjegjësi të lartë që kryenit. Me gjithë vështirësitë dhe ndjekjet e egra të armiqve fashistë, ju asnjëherë s'e ndalët hovin për shtypjen e materialeve propagandistike dhe trakteve të Partisë që ushqenin përditë popullin me ndjenjat e revoltës dhe e mobilizonin atë në luftën çlirimtare kundër okupatorëve dhe tradhtarëve. Armiqtë tërboheshin kur shikonin se fjala e Partisë botohej dhe përhapej me shpejtësi anembanë atdheut dhe, me gjithë raprezaljet barbare të tij, me disiplinën e përpikërinë shembullore që ju karakterizon, ju i përgjigjeshit me entuziazëm kërkesës së Partisë që shtypi të dilte vazhdimisht, me çdo kusht dhe në kohën e duhur. Shumë nga ju jo vetëm radhitët e shtypët materialet e

Partisë, por morët pjesë aktive edhe në luftë. Në traditën e grevave të tipografëve të Gjirokastrës dhe më vonë të shokëve të tjerë të shtypshkronjës «Dielli», të udhëhequr nga militantët e shquar, heronjtë e popullit, Qemal Stafa e Vasil Shantoja, gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhanë jetën për çlirimin e vendit edhe shumë dëshmorë tipografë, ndër të cilët edhe Mihal Duri.

Sot, së bashku me ata që po vazhdojnë punën tuaj fisnike, tipografët e rinj, të cilët po përvetësojnë me zell eksperiencën tuaj të madhe, të gjithë të lumtur e plot optimizëm revolucionar, në kushtet aq të mira të krijuara nga Partia e pushteti popullor, po punoni me makineri moderne, për të cilat tregoni aq kujdes t'i ruani si sytë e ballit. Jam i bindur se ju e ndieni veten shumë të gëzuar që një pjesë e mundit dhe e djersës suaj ndriçon çdo ditë mendjen e punëtorëve, të kooperativistëve dhe të ushtarëve, të nxënësve, të studentëve dhe të inteligjencies sonë që presin të mësojnë me etje materialet e Partisë, të rejat e shkencës dhe të teknikës, me qëllim që të gjithë së bashku t'i shërbejnë sa më mirë ndërtimit socialist të vendit. Librat, gazetatat, broshurat e revistat e shtypura me cilësi gjithnjë e më të lartë e në kohë dëshmojnë për ndërgjegjen tuaj të lartë socialiste në punë. Prandaj me të drejtë Komiteti Qendror dhe unë ju kemi konsideruar dhe ju konsiderojmë ju si proletarë nga më të vendosurit e Partisë, që gjithmo-

në keni qëndruar dhe qëndroni në ballë të punës për përhapjen e mësimeve të saj të çmueshme.

Duke përfunduar, ju uroj nga zemra juve dhe nëpërmjet jush gjithë tipografëve të vendit shëndet e suksese të reja në punë.

Juaji

*Enver*

*Botohet për herë të parë sipas originalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

LETËR DREJTUAR GRAVE DHE VAJZAVE  
PUNËTORE TË NDËRMARRJES SË  
PRODHIMEVE ARTISTIKE

*Krujë*

**17 nëntor 1976**

Të dashura shoqe,

Midis letrave të shumta që kam marrë këto ditë nga punonjës të profesioneve të ndryshme, të cilët, të entuziazmuar nga përfundimi me shumë sukses i punimeve të Kongresit të 7-të historik të Partisë, zotohen për plotësimin dhe tejkalimin e detyrave që shtrohen, mora dhe letrën tuaj. Fjalët aq shumë të ngrohta që shprehni për Partinë, besimi juaj i patundur në vijën e drejtë të saj dhe optimizmi revolucionar që ju karak-

terizon për ato që janë kryer deri më sot dhe për të ardhmen akoma më të bukur të atdheut tonë socialist, më gëzuan shumë.

Qyteti i lashtë hero i Krujës, ku jetoni dhe punoni ju, të dashura shoqe punëtore, është zbuluar dhe përtëritur në epokën e lavdishme të Partisë. Si gjithë populli ynë edhe populli patriot e punëtor i rrethit tuaj, nën udhëheqjen e urtë të Partisë, e ka ngritur në një shkallë më të lartë zhvillimin ekonomik e kulturor të tij. Ai gjithashtu punon pa u lodhur për të forcuar gjithnjë e më mirë aftësinë mbrojtëse, këtë traditë patriotike të rrënjosur thellë te ju që në kohën e heroit tonë të madh Skënderbeut, si dhe dashurinë për atdheun e shtrenjtë socialist dhe besnikërinë e pakufishme për Partinë e Punës, që me aq frymëzim, me shpirt dhe energji rinore i këndojnë pleqtë gazmorë krutanë.

Në realizimet e shumta madhështore që ka arritur mbarë vendi ynë, kanë meritat e tyre të shquara edhe gratë, pra edhe ju, shoqe dhe motra krutane, endëse me duar të shkathëta të Ndërmarrjes së Prodhimeve Artistike të Krujës, që punoni me ndërgjegje të lartë e me të gjitha fuqitë për lulëzimin dhe begatinë e vendit. Me prodhimet e realizuara nga duart tuaja, ju, vazhdimisht, nderoni atdheun dhe veten, derisa prodhimet që nxirrni u përgjigjen kërkesave të standardeve të tregut të brendshëm dhe të jashtëm dhe ruajnë karakteristikat artistike artiza-

nale me motive popullore, që ju po i përpunoni dhe i pasuroni më tej.

Jam gëzuar shumë për çka më shkruani lidhur edhe me sukseset që keni shënuar në rrugën e emancipimit tuaj. Juve, motra dhe shoqe, deri dje të shtypura, të skllavëruara e të përbuzura nga sundimtarët, feja dhe kanunet e botës së vjetër, Partia ju dha vendin e merituar në punë e në shoqëri, prandaj keni marrë krahë dhe jeni bërë endëse të kualifikuara, amvisa të mira dhe ushtarë trime për mbrojtjen e atdheut dhe të socializmit.

Duke i matur me kohën, këto arritje janë me të vërtetë madhështore, por, të dashura motra dhe bija, besoj se edhe ju jeni dakord me mua që Partisë dhe Organizatës së Bashkimit të Grave u duhen akoma shumë përpjekje që, krahas emancipimit të gruas në punë e në shoqëri, të arrihet emancipimi i saj i mëtejshëm edhe në familje. Trashëgimi i së kaluarës në këtë drejtim është mjaft i hidhur, prandaj jam i bindur se ju do të punoni ashtu siç dëshiron Partia që të mos ndërpritet puna e filluar për thyerjen me guxim të atyre mbeturinave të normave të vjetra patriarkale e feudale që janë qepur akoma si rrodhja në marrëdhëniet familjare. Në këtë drejtim ju do të keni me siguri edhe përkrahjen e burrave, vëllezërve dhe djemve tuaj, që, siç e ka provuar jeta, nuk e bëjnë kurrë dysh fjalën e Partisë, e cila i trajtoi edhe një herë këto probleme edhe në Kongresin e saj të 7-të, në mënyrë që të

rritet me hapa edhe më të shpejtë roli i gruas si në çdo drejtim edhe në jetën familjare.

Duke ju dëshiruar gjithë të mirat, ju uroj të gjithave suksese në punë dhe lumturi në familje.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Kastrioti», nr. 46 (292),  
19 nëntor 1976*

24 maj 1977

**PËRSHËNDETJE POPULLIT TË  
GJIROKASTRËS ME RASTIN E INAUGURIMIT  
TË QENDRËS MUZEALE DHE TË OBELISKUT**

**24 maj 1977**

Motra dhe vëllezër të dashur gjirokastritë,  
Të dashur nxënës dhe nxënëse, mësues dhe  
mësuese,

Ju flas<sup>1</sup> nga Tirana në pamundësi të gjndem  
me ju në këtë ditë të shënuar, me një kuptim të  
lartë dhe frymëzim patriotik, për të kujtuar së  
bashku ato kohë plot histori të lavdishme, plot  
luftëra, sakrificë dhe heroizma që kanë bërë pri-  
ndërit dhe gjyshërit tanë, mësuesit dhe mësueset  
tona të nderuara, i gjithë populli i krahinës dhe  
i qytetit të Gjirokastrës. Por pavarësisht se ju  
flas nga Tirana, me zemër, me mend e me kuj-  
tesë jam atje, tok me ju, në mes të popullit tim,

---

1. Përshëndetja u dërgua e incizuar në magnetofon.

në sheshin e vogël ku, 60 vjet më parë, së bashku me shokët e mi të shkollës «Drita», vinim rrotull në oborrin e saj të vogël me abetare në duar, duke përsëritur mësimin. Pikërisht në atë shesh, njëra pas tjetrës, u themeluan e zhvilluan veprimtarinë e tyre patriotike e kulturore një varg lidhjesh, shoqërih demokratike e klubesh patriotike, të cilat, së bashku me këngët dhe tregimet e nënës, qenë shkolla ime e parë e fëmijërisë dhe e rinisë së hershme, ku mësova të dua e të nderoj me gjithë shpirt këtë atdhe të shtrenjtë, këtë popull të lavdishëm, gjuhën tonë të bukur, traditat tona të shkëlqyera, kulturën tonë të lashtë e përparimtare dhe t'u kushtoja, si gjithë njerëzit tanë të ndershëm e patriotë, jetën time. Sot ai shesh i vogël, me pionierët e pionieret, më ngjet si fusha e Çajupit me trëndelinë, në mes të të cilit ngrihet një obelisk i madh, i madhërisëm, siç kanë qenë të gjithë ata trima të pushkës e të penës, që luftuan në kohë shumë të vështira kundër errësirës, okupimit, tiranisë, që ndoqën traditat heroike luftarake e lirisdashëse të të parëve tanë, që i mbajtën gjallë këto tradita, i çuan më tej dhe na i lanë trashëgim, na hapën neve rrugën, na kalitën me patriotizëm, na mësuam të mbanim kurdoherë në dorë hutën, të mësonim diturinë dhe të forconim dashurinë në mes nesh.

Sot ne, të moshuarit, kalamanët e atyre kohëve heroike, kur na mungonin edhe letra e lapsi dhe mezi gjenim abetaret me shkronjat e

vjetra të alfabetit të Stambollit, të sjella fshehtazi në trasta nën pushkë dhe guna të dhirta të Çerçizit, të Bajos, të Mihalit etj., kujtojmë me nderim të madh ata burra trima e patriotë të flaktë, që zbritnin dhe ngjitnin rrugët e pazarit të Gjirokastrës. Kaq fort janë skalitur ata në mendjen dhe në zemrat tona, sa edhe tash na duket sikur i shikojmë ashtu siç ishin, të thjesh-të, të thinjur nga mosha dhe nga hallet, por me sy që u ndritnin kur ne, të rinjtë dhe të vegjlit, i përshëndetnim me respekt.

Ne që përuleshim përpara xha Bajo Topullit, Idriz Gurit, Hasan Xhikut, Hysen Hoxhës, Hasan Sinos, Polo Meksit, Papapanos (plakut, priftit), Veli Hashorvës e të tjerëve, që u revoltuam kur katili Zog na vrau Avniun tonë, udhëheqësin e djalërisë, kur shokët tanë më të moshuar u nisën për të sulmuar Tiranën, ndiejmë një krenari të madhe për ata burra patriotë që na ndritën rrugën me armë dhe me penë, ndiejmë një krenari të veçantë, sepse kemi pasur privilegjin e madh t'i njihnim nga afër, t'u kemi folur dhe të na kenë përkëdhelur kokën me ato duart e hekurta që kanë mbajtur dhe shkrepur «mauzerët» dhe «malisherët».

Sa shumë thesare të vyera ruan kjo kodër historike në mes të Gjirokastrës, vëllezër e motra! Aty është folur me pushkë e me penë për Shqipërinë, aty qëndronin krah për krah me luftëtarët e çetave patriotike mësuesit dhe nxënësit, në vatra si këto janë vënë themelet e para

të shkollave që sot mbushin anembanë Shqipërinë; aty lindën skenat e para të teatrove amatore dhe profesionistë; aty për herë të parë nënat dhe motrat tona u organizuan në shoqërinë «kundër Bastiljes» (burgut) më 1919 dhe shpallën hapur se do të luftonin kundër errësirës, prapambetjes, skllavërisë, në të cilat i kishin zhytur pushtuesit, regjimet antipopullore, kishat e xhamitë.

Shoqëritë dhe klubet patriotike, që u themeluan në këtë kodër, nuk lindën rastësisht dhe në një truall bosh. Ato ishin rrjedhim dhe vazhdim i drejtpërdrejtë i asaj veprimtarie të shquar e të gjithanshme, që kishin zhvilluar për vite të tëra me pushkë e me penë shoqëritë, klubet dhe çetat patriotike të Rilindjes sonë Kombëtare, qenë, në të njëjtën kohë, pasurim dhe zhvillim i mëtejshëm sasior e cilësor i gjithë veprimtarisë mëparshme të të parëve tanë të lavdishëm. Këto klube e shoqëri patriotike, që u hapën anembanë vendit, u bënë boshti i gjithë asaj lëvizjeje të fuqishme që i kishte vënë vetes si qëllim të fitonte pavarësinë e lirinë e atdheut, të luftonte për gjuhën e shkollën shqipe, për zhvillimin e përparimin e kulturës kombëtare, të muzikës, të teatrit e të folklorit tonë të mrekullueshëm, për demokraci, zhvillim e përparim shoqëror.

Armiqtë e brendshëm e të jashtëm i ndiqnin e i persekutonin patriotët tanë të nderuar, por, më tepër se kaq, ata nuk kishin ç't'u bënin. Patriotizmit tonë popullor, shpirtit liridashës,

luftarak e përparimtar të njerëzve tanë, trimërisë dhe besnikërisë shqiptare armiqtë kurrë nuk ia ndalnin dot shpërthimin e nuk ua rrëzonin dot tiparet, sepse këto virtyte të larta kishin rrënjë shekullore dhe qenë shtrirë në mendjet dhe në zemrat e gjithë popullit.

Në emër të këtij patriotizmi buçiti kënga e mëmëdheut, e Andon Zako Çajupit, për truallin tonë të shtrenjtë e derdhën gjakun rrëke trimat e Selam Musa Salarisë në epopenë e Vlorës më 1920, për çështjen e madhe kombëtare shpërtheu në Paris koburja e revolucionarit demokrat Avni Rustemi, mu në zemër të tradhtarit Esat Pashë Toptanit.

Kemi qenë në moshë të re në atë kohë, të dashur motra dhe vëllezër gjirokastritë, por do t'ju them një ndodhi trimash. Nuk e mbaj mend vitin, por ishte Dita e Flamurit, në kohën e regjimit të Zogut. Me shkollën vajtëm në atë copë vend para prefekturës së vjetër, që të moshuarit e mbajnë mend, atje ku sot është kinemaja. Te porta e madhe e prefekturës, në mes të kolonave, dolën prefekti, komandanti i xhandarmërisë dhe zyrtarë të tjerë të lartë. Dhe prefekti, sa për të shkuar radhën, filloi të thoshte pak fjalë për Ditën e Flamurit, pastaj nisi të mburrte Zogun dhe regjimin e tij. Heshtje e madhe në të katër anët, s'kishte asnjë duartrokitje, por në këtë çast një zë i fortë u dëgjua nga turma: «Poshtë kusarët!». U bë katrahura, xhandarët vinin rrotull, prefekti dhe autoritetet u futën brenda. Ne, djemtë e

shkollave, prishëm radhën dhe dëgjonim mësuesit të flitnin kokë më kokë: «Oh, më ju lumtë!». Turma jonë u hap përnjëherë dhe ne pamë të çante përpara, me kokën lart, me dorën në shpatë dhe me sharpën kuqezi hedhur në sup e kra-hëror, kapiten Idriz Gurin. Ishte ai, luftëtar i vjetër dhe shok i Çerçizit e i të tjerëve, që bërtiti: «Poshtë kusarët!». Idriz Guri zbriti rrugës, qëndroi në një tryezë këmbë mbi këmbë në kafenenë e «huqumetit» dhe porositi një gotë raki. Rreth e rrotull tij u mblodhën burra. Ne, djalëria, kishim zënë rrugën që çonte në klubin e rilindësve, që po inaugurohet sot, dhe qëndronim te shkallët e kovaçit armëndreqës, Aziz Budukut, përpara dyqanit të Zigurit, të xha Banushit dhe pritnim ç'do të ngjiste.

Nuk kaloi shumë kur u dëgjuan këpucët me proka të xhandarëve me një major në krye të tyre. Majori i Zogut çau me zor turmën, qëndroi përpara xha Idrizit dhe iu drejtua me zë të lartë: «Kapiten Idriz Guri, kam urdhër të të arrestoj. Dorëzo shpatën!». Xha Idrizi, me mustaqe të thinjura dhe të dredhura në maja, u çua në këmbë, nxori shpatën dhe bërtiti: «S'e dorëzon kollaj shpatën Idriz Guri. Sprapsu, zoti major!». Ne filluam të thoshim: «Mbahu, xha Idriz!». Gjirokastritët, shokë të moshuar të xha Idrizit, rrethuan majorin e xhandarmërisë dhe njëri prej tyre i tha me zë të fortë: «Ikë u thuaj atyre që të kanë dërguar se nuk arrestohet Idriz Guri. Ne po shkojmë të pimë te kafeja e Kuçukut, se ke-

mi festë dhe, po të doni, ejani, por duhet të vini me një tabor xhandarësh». Majori i xhandarmërisë u shtang, u tremb, u zbraps dhe u largua, kurse turma me xha Idrizin në krye, mori rrugën e pazarit dhe ne të rinjtë u shkuam nga pas, duke kënduar këngën e Flamurit. Ahmet Zogu ia zhveshi xha Idriz Gurit rrobat e oficerit, por ai vazhdoi luftën e tij patriotike, me «bastunet» që ju i keni në muzeun e qytetit.

Të tillë ishin ata trima të pushkës e të penës që ne përkujtojmë dhe e bëjmë veprën e tyre të pavdekshme. Populli ruan si gjënë më të shtrenjtë kujtimin e përpjekjeve të tyre patriotike dhe Partia jonë e lavdishme e Punës i vuri ata në pedestal.

Në këtë truall të lavdishëm, në këtë lumë të pashtershëm patriotizmi e trimërie, në këtë shkollë të madhe të jetës u mësuan e u edukuan ata djem dhe ato vajza të popullit, që më pas, në vitet e vështira të okupacionit fashist, u bashkuan rreth Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe u bënë mish e gjak i saj, u bënë heronj të lavdishëm të saj dhe të popullit.

Monumenti i bukur e kuptimplotë, që ju inauguroni sot, ngrihet mbi gjithë Gjirokastrën si një pishtar drite i pashuar kurrë. Atë e shikon kalaja krenare, e shikojnë lagjet, rrugicat, fusha dhe mali, e shikojnë Mashkullora dhe Qestorati me Libohovën, e shikojnë shkolla dhe shkollarët, mësuesit dhe mësueset e tyre, e shikon gjithë populli dhe lapidari i heronjve të Luftës Nacional-

çlirimtare sikur u thotë nga bregu mbi urën e lumit: «Ja, edhe ne këtu jemi. Luftuam trimërisht me Partinë e komunistëve në krye dhe ramë në fushën e nderit me pushkë në dorë, sepse ashtu na kishit mësuar ju, nënat, baballarët, gjithë populli». Dhe tani djemtë e vajzat e tyre falënderojnë Partinë e Punës që e nxori Shqipërinë në dritë, se e çliroi përgjithmonë dhe e zbukuroi atdheun socialist, duke zbatuar në jetë moton e rilindësve: «Dituri, dashuri dhe hutë» dhe që në kohën e Partisë u bë: «Në njërën dorë kazmën, në tjetrën pushkën».

Në emër të Partisë, ju falënderoj dhe ju përgëzoj që vutë në vend fjalën e saj për ngritjen e një obelisku në kujtim të përjetshëm të mësuesve dhe të pedagogëve që punuan me guxim e me trimëri, që u burgosën, u torturuan dhe u vranë për të çelur shkollat shqipe, si në shumë anë të Shqipërisë, edhe në Gjirokastrë. Me respekt e mirënjohje të thellë dëshiroj të kujtoj me këtë rast mësuesit tanë të parë, patriotë të nderuar, si Thoma Papapano, Andrea Konomi, Ilia Dilo Sheperi, Asaf Çipi e më vonë një plejadë e tërë me Iljaz Hoxhën, Xhafo Poshin, Urani Rumbon, Rexho Muçin e të tjerë, të cilët, duke ndjekur rrugën e Koto Hoxhit e të Pandeli Sotirit, çelën, në truallin rreth kësaj kodre, me përpjekje të mëdha, shkollën shqipe «Liria» e më pas shkollën «Drita».

Prej punës dhe luftës së tyre, prej pasionit

dhe zellit të madh të nxënësve të këtyre mësuesve patriotë, gjithmonë kanë mësuar e akoma më shumë duhet të mësojnë mësuesit, nxënësit dhe studentët tanë. Kurrë të mos harrojnë këta se pionierëve të parë të shkollës sonë u është dashur ta mbronin e ta përhapnin me vështirësi të panumërta e shpesh, edhe me gjakun e tyre, çdo germë të alfabetit shqip. Kurrë të mos harrojnë mësuesit e gjithë shkollarët tanë, që tani punojnë, përgatiten dhe edukohen në ndërtesa kaq të bukura e të pajisura me të gjitha kushtet, se mësuesve dhe nxënësve të shkollave të para shqipe, si «Liria» e «Drita», u mungonin edhe librat e kalemrat, pale mjetet e pajisjet e tjera mësimore, me të cilat janë të mbushura shkollat e sotme, tonat. Ata kuptuan rëndësinë e shkollës amtare, rëndësinë e alfabetit, rëndësinë e librit, rëndësinë e diturisë. Pikërisht në ato kushte, në ato shkolla, që ngjanin si haure, nga radhët e atyre nxënësve që shkonin të mësonin, të shkruanin e të këndonin gjuhën e nënës, u edukuan e më pas u bënë mësues të nderuar djem të tillë të popullit, si Siri Shaploja, Aqif Selfoja, Emin Shtinoja, Sokrat Kutra e shumë e shumë të tjerë. Lufta e armatosur për t'u çliruar nga robëria e imperialistëve dhe e shkelësve barbarë nuk mund të ndahej nga lufta për alfabetin dhe për shkollën shqipe.

Krah për krah me këto përpjekje ecnin edhe këngët e popullit:

*Mu te qaf' e Peshkëpisë  
Lufton i bir'i xhixhisë  
Me taborret e Turqisë,  
Balil-o, Balil nuri!*

*Sot është dita, shqipëtarë  
Alfabetin ton' ta mbrojmë,  
Shpejt, o burrani!  
Shkronjat tona jan' të arta,  
Këto duamë.*

Dy këngë popullore, një refren i vetëm, i shenjtë:

*Shqipëri, Atdhe i dashur,  
Ne s'të lëmë ty të varfër!...*

Jo rastësisht rreth e rrotull shkollës dhe klubit «Drita» janë grumbulluar klubet patriotike, jo rastësisht kërcenin valle rreth kolonës së klubit «Drita» Çerçiz Topulli, Hysen Hoxha, Thoma Papapano Çuçi, Elmaz Boceja, Idriz Angoni me shokët e tyre. Jo rastësisht ne, të rinjtë, i këndonim atëherë së toku ato vjersha që përmenda më lart e shumë e shumë të tjera si ato me aq frymëzim luftarak e patriotik.

Çlirimi i atdheut nga okupatorët ishte i lidhur me fitoren e diturisë. Rilindasit tanë e konsideronin diturinë dritë, sepse me anë të saj do të shpërndahej errësira që kishte pllakosur popullin tonë gjatë shekujve, sepse ajo do t'i çonte lart ndërgjegjen dhe patriotizmin e shqiptarit,

sepse ajo, e bashkuar me pushkën, do të konsolidonte pavarësinë e fituar dhe do të sillte përparimin dhe begatinë e atdheut.

Këtë rrugë e çoi me Luftën heroike Nacionalçlirimtare dhe me lavdi përpara Partia heroike e komunistëve shqiptarë, që diti aq mirë, aq drejt dhe me aq guxim e heroizëm të zbatonte marksizëm-leninizmin, këtë shkencë universale e të pagabueshme, në lidhje të ngushtë me traditat heroike, liridashëse dhe përparimdashëse të popullit shqiptar. Ja, pra, ç'vlera të mëdha ruan në vetvete veprimtaria e këtyre shoqërive, klubeve dhe lidhjeve patriotike e kulturore! Ja ç'punë të lavdërueshme keni bërë ju, vëllezër dhe motra, duke ngritur këtë qendër të re muzeale, e cila, krahas të tjerave, dëshmon më së miri se Gjirokastra jonë është qytet-muze, në radhë të parë, për historinë e saj të lavdishme patriotike e revolucionare, për luftërat dhe përpjekjet e pareshtura të bijve dhe të bijave të saj për liri e pavarësi, për gjuhën dhe për shkollën shqipe, për demokraci, zhvillim e përparim të gjithanshëm ekonomik e shoqëror!

Krahas muzeve dhe qendrave të tjera kulturore, kjo qendër e re do të jetë për brezat e sotshëm e të ardhshëm një shkollë e vërtetë e edukimit të patriotizmit e të trimërisë, të dashurisë për gjuhën dhe për kulturën tonë kombëtare, të respektit dhe të mirënjohjes së thellë për gjithë traditat e shquara dhe veprimtarinë patriotike revolucionare të të parëve tanë.

Duke u njohur me këto tradita të shquara të së kaluarës, brezat e sotshëm e të ardhshëm do të kuptojnë më mirë edhe vijën politike e ideologjike të Partisë, do të kuptojnë më mirë filozofinë e saj, sepse në mënyrë konkrete do të shohin që fjala dhe vepra e Partisë nuk janë diçka e shkëputur nga e kaluara e lavdishme e popullit tonë; përkundrazi, ato janë vazhdim i mëtejshëm dhe pasurim i gjithanshëm i saj në brendi e në formë me ideologjinë marksiste-leniniste.

Përsëri ju kërkoj ndjesë që, jashtë dëshirës sime, nuk munda të vij sot aty për të festuar edhe unë bashkë me ju këtë ditë të shënuar, sikurse u zotova në përsëritjen time me rastin e 50-vjetorit të shkollës «Asim Zeneli», por do të kem rast të vij të shikoj Gjirokastrën tonë të dashur, për të cilën më ka marrë aq shumë malli, të bisedojmë edhe për qendrën e re muzeale që po inauguroni, për të cilën ruaj aq shumë kujtime të fëmijërisë dhe të rinisë, veçanërisht për shoqërinë «Studenti», anëtar i së cilës kam pasur fatin të isha edhe vetë.

Përfitoj nga rasti, vëllezër e motra, t'ju uroj nga zemra për titullin e lartë «Hero i Punës Socialiste», akorduar rrethit të Gjirokastrës pak kohë më parë. Populli i rrethit të Gjirokastrës e meriton plotësisht këtë titull dhe shpreh bindjen se me punë dhe me përpjekje të gjithanshme të gjithë, si një grusht rreth Partisë, do të punoni akoma më të vendosur, si mbarë populli ynë heroik,

për ta bërë gjithnjë e më të bukur, gjithnjë e më të paprekshme Shqipërinë tonë socialiste, atdheun tonë të lavdishëm, për të cilin është derdhur aq shumë gjak nëpër shekuj.

Lavdi heronjve të popullit, të vjetër dhe të rinj!

Lavdi heronjve të pushkës, të punës dhe të penës!

Lavdi Partisë sonë të dashur!

Lavdi popullit tonë heroik!

Dalshi gjithmonë faqebardhë, vëllezër dhe motra të mia të Gjirokastrës!

Ju përqafoj

Juaji

*Enver Hoxha*

«Për arsimin dhe edukatën»  
bot. i dytë, Tiranë, 1982,  
f. 624

**TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT  
KRISTO KONO**

**Korçë**

**22 shtator 1977**

I dashur shoku Kristo,

Me rastin e 70-vjetorit të lindjes të uroj shëndet dhe një jetë plot veprimtari si aktivist shoqëror dhe në fushën e krijimtarisë muzikore. Partia e ka vlerësuar kurdoherë qëndrimin tënd konsekuent të një mësuesi patriot dhe kompozitori të talentuar e të palodhur që gjithë jetën ia ke kushtuar çështjes së popullit dhe përparimit të atdheut. Jam i bindur se edhe në të ardhmen do të vazhdosh të punosh me pasionin që të karakterizon për të dhënë kontributin tënd, sidomos në lëmin e muzikës, duke krijuar akoma

për popullin pjesë me vlerë dhe dinjitoze për kohën plot vrull revolucionar që jetojmë.

Edhe një herë të uroj nga zemra jetë të gjatë, punë të mbarë dhe lumturi familjare.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas originalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR KOLEKTIVIT  
TË SHKOLLËS SË MESME  
TË PËRGJITHSHME «RAQI QIRINXHI»**

*Korçë*

**1 dhjetor 1977**

Të dashur pedagogë dhe nxënës,

Këto ditë ju festoni një nga ngjarjet e shënuara në vargun e gjithë ngjarjeve të tilla me karakter të theksuar patriotik e përparimtar që kanë ndodhur në historinë e lavdishme të popullit tonë patriot, të papërkulur, përparimtar, të etur e luftëtar në shekuj për dritë, dituri, arsim e kulturë — 60-vjetorin e themelimit të Liceut të Korçës, sot shkolla e mesme e përgjithshme «Raqi Qirinxhi».

Ju falënderoj me gjithë zemër për ftesën që në këtë gëzim të përbashkët të merrja pjesë edhe unë, ish-nxënës dhe ish-mësues në atë Lice dhe, së bashku, të vjetër e të rinj, të rikujtonim

e të rijetonim ngjarjet e paharruara të atyre viteve, kur, tok me klasën punëtore korçare dhe të edukuar prej saj, luftonim kundër shtypjes, shfrytëzimit, obskurantizmit e paditurisë së regjimeve antipopullore, luftonim për liri, përparim shoqëror e dituri.

Të më falni që, me gjithë dëshirën e zjarrtë tuajën dhe timen, punët nuk më lejuan të ndodhem midis jush në këtë ditë të shënuar. Por unë kurdoherë ndjek me interes të veçantë dhe në çdo hap përparimet tuaja, punën e përpjekjet që bëni për të realizuar me ndërgjegje të lartë e vetëmohim detyrat që ju ka ngarkuar Partia.

Unë ruaj për shkollën tuaj dhe timen, ashtu si për tërë popullin patriot, punëtor e përparimtar të Korçës, dashuri e respekt të thellë. Shpesh kujtoj shokët e shkollës e të luftës, mësuesit e nxënësit e mi, kujtoj gjithmonë ato ditë kur rinia hidhej në demonstrata dhe vërsulej me trimëri mbi bajonetat e xhandarëve.

Liceu i Korçës është i njohur në gjithë vendin si një vatër e rëndësishme drite e përparimi. Shumë të rinj që ndiqnin atë shkollë, krahas historisë së lavdishme të popullit tonë, krahas asaj pune edukative që është bërë për edukimin e tyre me ndjenja patriotike dhe me urrejtje për shkaktarët e mjerimit e të paditurisë së masave popullore, janë njohur edhe me kulturën përparimtare frënge dhe me historinë e Revolucionit Francez që kanë ndikuar në edukimin revolucionar të të rinjve tanë. Por rrugën e sigurt të

revolucionit, të dritës e të përparimit, na e treguan vetëm idetë marksiste-leniniste që depërtuan në vendin tonë pas Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit dhe që u përhapën te ne nga komunistët shqiptarë. Veçanërisht Grupi Komunist i Korçës, duke ushqyer me këto ide punëtorinë korçare, i futi ato edhe në mendjen e zemrat e të rinjve liceistë. Bindjet e mia si revolucionar komunist u formuan dhe u kristalizuan pikërisht në masën e klasës punëtore e të komunistëve korçarë. Në rrugët e Korçës, në ndeshje me forcat e errëta të regjimit zogist, ne, të rinjtë e Liceut, në shembullin e klasës punëtore, vumë për herë të parë në provën e zjarrit aspiratat dhe idetë tona revolucionare, të cilat do të merrnin flakë, që nuk shuhen kurrë, me themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Themelimi i Liceut të Korçës 60 vjet më parë ishte rezultat i drejtpërdrejtë i dëshirës së madhe dhe i përpjekjeve të gjithanshme të popullit tonë për arsim e dije, ishte vazhdim i luftës prej shumë dekadash të popullit patriot e përparimtar të Korçës për gjuhën e shkollën shqipe, që poeti i madh i Rilindjes Kombëtare, Naim Frashëri, e pati përsëndetur në vargje me ndjenjat më të pastra të mirënjohjes:

*Lumja ti, moj Korçë, o lule,*

*Q'i le pas shoqet e tua,*

*Si trimi në ballë u sule,*

*Ta paçim për jetë hua!*

Për të realizuar këto dëshira dhe aspirata në krahinën e Korçës punuan e luftuan, me pushkë e me penë, patriotët e shquar të çështjes kombëtare si Naum Veqilharxhi, Petro Nini Lularasi, Papakristo Negovani, Thimi Mitko, Pandeli Sotiri, Themistokli Gërmenji, Spiro Bellkameni, Mihal Grameno, Asdreni dhe shumë të tjerë. Për arsimin e kulturën kombëtare shkruanë forcat e tyre fizike e mendore mësuesit e vjetër të Liceut si Sotir Paparisto, Kostaq Cipo, Vangjush Mio e të tjerë, për veprën kulturore e patriotike të të cilëve kam një respekt të thellë.

Më vonë, me formimin e Partisë Komuniste këto përpjekje do të merrnin një zhvillim të paparë. Veprimtaria revolucionare e Partisë me nxënësit e me mësuesit e Liceut e shndërruan këtë shkollë në një vatër të zjarrit të lëvizjes patriotike, përparimtare, punëtore e komuniste, në një kështjellë të pamposhtur të Partisë, ku iu bë jehonë e fuqishme ideve e thirrjes së saj për luftë të armatosur kundër pushtuesve e tradhtarëve për çlirim e përparim kombëtar e shoqëror.

Në ditët e errëta të agresionit e të pushtimit fashist rinia e Liceut të Korçës, me një frymë të lartë atdhedashurie e guximi revolucionar, mori pjesë aktive në protestat, demonstratat dhe ndeshjet me armikun. Një shumicë ish-nxënës të kësaj shkolle, bashkë me punëtorë e patriotë të tjerë antifashistë, u përleshën ditën e 8 Nëntorit në rrugët e Korçës, përleshje në të cilën dha jetën komunisti sypatrembur Koci Bako, vepra hero-

ke e të cilit u bë shembull i lartë frymëzimi për rininë e Liceut si për gjithë rininë e vendit tonë.

Nga gjiri i të rinjve të Liceut dolën shumë komunistë të orëve të para, propagandues të flaktë të ideve komuniste dhe luftëtarë shembullorë. Me qindra nxënës të Liceut, duke iu përgjigjur thirrjes së Partisë, i dolën zot atdheut me armë në dorë. Shumë prej tyre u vunë në krye të reparteve partizane dhe i udhëhoqën ato në luftëra e beteja të lavdishme. Dashuria e lidhjet e çelikta të rinisë së Liceut të Korçës me atdheun, popullin e Partinë u çimentuan me gjak. Me dhjetëra e dhjetëra ish-nxënës e mësues të tij dhanë jetën për lirinë e atdheut, për realizimin e aspiratave të popullit, të klasës punëtore, për idealet e komunizmit, si heronjtë e popullit Musa Fratari, Fuat Babani e Dino Kalenja, komunistët e dëshmorët Raqi Qirinxhi, Vaskë Dushku, Xhafer Cenko Lubonja, Ptoleme Xhuvani, Floresha Myteveli, Sedat Babani e shumë të tjerë. Në Liceun e Korçës mësuan gjatë këtyre dekadave shumë kuadro që sot punojnë në organet e Partisë e të pushtetit popullor, shumë të tjerë të talentuar e të devotshëm në sektorët e shkencës, të ekonomisë, të ushtrisë, të arsimit e të kulturës sonë socialiste, ku punojnë me patriotizëm e partishmëri të lartë për zhvillimin e mbrojtjen e atdheut, për begatinë e lumturinë e popullit.

Korça është bërë sot një qendër e madhe dhe e rëndësishme ekonomike, industriale, bujqësore dhe me një kulturë të zhvilluar e të për-

paruar, që zë një vend nderi në atdheun tonë socialist. Krahas këtij zhvillimi ka ecur edhe shkolla e mesme «Raqi Qirinxhi», në bazë të orientimeve e të direktivave të Partisë dhe në luftë për vënien e tyre në jetë. Në këtë rrugë të shkëlqyer ajo ka arritur suksese të mëdha në tërë punën që bëjnë edhe tani nxënës e mësues për zbatimin e vendimeve të Kongresit të 7-të të Partisë dhe të Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror të saj të vitit 1969.

Por stadi i zhvillimit në të cilin kalojmë dhe ai perspektiv kanë nxjerrë përpara shkollës sonë detyra të reja më të mëdha, për të përgatitur nxënës të zotë e punonjës të nesërm sa më të formuar politikisht e ideologjikisht, të edukuar e të kalitur me mësimet e marksizëm-leninizmit e të Partisë sonë, të pajisur me horizont sa më të gjerë kulturor e me dije të thella shkencore, të edukuar nëpërmjet mësimet, punës e në zjarrin e luftës klasore me frymën, moralin e disiplinën e klasës punëtore, të përgatitur për jetën e të ndërgjegjshëm për të vënë të gjitha forcat fizike e mendore në shërbim të popullit, të atdheut e të revolucionit, të gatshëm për të punuar atje ku ka nevojë atdheu dhe të aftë për të mbajtur mbi shpatulla e për të realizuar detyra të mëdha në frontet e ndryshme të ndërtimit socialist e të mbrojtjes.

Partia dhe populli kanë besim se, ashtu si deri më sot, edhe në të ardhmen, ju, nxënës e mësues të shkollës së mesme «Raqi Qirinxhi»,

do t'i shtoni përpjekjet e përbashkëta dhe, duke realizuar si duhet tre komponentët: mësim, punë prodhuese, kalitje fizike e përgatitje ushtarake, do t'u përgjigjeni këtyre kërkesave të kohës. Ata kanë besim se ju, duke zbatuar vijën e orientimet e Partisë, duke jetuar aktivisht me situatat që kalojmë e me problemet që nxjerr jeta, duke punuar, luftuar e jetuar me frymë të lartë revolucionare si në rrethim, duke mësuar kurdoherë nga klasa punëtore e nga populli, duke marrë pjesë gjallërisht në luftën klasore, në luftën kundër imperializmit e socialimperializmit, revizionizmit e oportunitizmit të çdo ngjyre, kundër çdo ndikimi e shfaqjeje të huaj dhe qëndrimi liberal ndaj tyre, do të realizoni gjithnjë e më mirë detyrat e rëndësishme e me shumë përgjegjësi që keni përpara.

Përshëndetje të përzemërta

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Përpara», 7 dhjetor  
1977*

## **LETËR DREJTUAR SHOQES SADAKATE DESHA**

**30 dhjetor 1977**

**E dashur si motër Sadakate,**

Letra juaj, me anë të së cilës ju falënderoni Partinë që u kujdes për të sjellë në atdhe eshtrat e patriotit të shquar dhe babait tuaj të nderuar Hasan Prishtina<sup>1</sup>, më ka prekur shumë. Ju fale-minderit për fjalët e ngrohta të respektit, të dashurisë e të mirënjohjes për Partinë tonë të Punnës, e cila, siç thoni edhe ju, ka lartësuar lavdinë e luftërave patriotike e liridashëse të kombit tonë të lashtë, ka vënë në vendin e merituar dhe ka përjetësuar të gjithë ata që kanë luftuar e dha-

1. Me kujdesin e Partisë e të shokut Enver Hoxha, Qeveria jonë solli nga Greqia eshtrat e patriotit dhe luftëtarit të shquar demokrat, Hasan Prishtina, më 3 dhjetor 1977, të cilat u vendosën në varrezat e dëshmorëve të periudhës para Luftës Nacionalçlirimtare në qytetin e Kukësit.

në jetën e tyre për lirinë e pavarësinë e atdheut.

Hasan Prishtina ka qenë një nga patriotët më të shquar që ka nxjerrë trualli shqiptar, luftëtar i flaktë e i pamposhtur i çështjes së pavarësisë, bashkimit e përparimit të kombit tonë. Jeta e veprimtaria e tij janë shembull i dashurisë e i devotshmërisë së pafund ndaj atdheut, i guximit e i trimërisë së rrallë, i luftës deri në vdekje për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve, për çlirimin e tyre nga zgjedha e huaj, për ruajtjen e gjuhës e të traditave të tyre.

Hasan Prishtina bën pjesë në atë plejadë të ndritur patriotësh e luftëtarësh heroikë, që, së bashku me Ismail Qemalin, Luigj Gurakuqin, Isa Boletinin e shumë të tjerë, ngritën flamurin kombëtar në Vlorë më 1912 dhe i treguan botës se popullin shqiptar askush nuk mund ta mbante nën zgjedhë, se ai kishte vendosur të rronte i lirë e i bashkuar në trojet e tij të lashta që për shekuj me radhë i kishte vaditur me gjak e me djersë.

Si bir besnik e i denjë i Kosovës kreshnike Hasan Prishtina luftoi me pushkë e me penë kundër copëtimit të Shqipërisë, kundër shovinizmit të monarkive fqinje, kundër pazarllëqeve të ulëta të fuqive të mëdha imperialiste në kurriz të popullit shqiptar. Diplomat e orator, publicist e politikan i zoti, ai luftoi me tërë zjarrin e shpirtit që zëri i popullit shqiptar të dëgjohej në të gjithë botën, që miqtë e armiqtë të ishin të qartë se kushdo që do të përpiquej të pengonte afirmimin e kombit shqiptar, të mohonte të drejtat e tij, të

grabiste trojet e tij shekullore, do të ndeshej me një popull, i cili ishte i vendosur të bënte çdo sakrificë, por që nuk do të pranonte më kurrë të rronte i shtypur, i përçarë e i përbuzur.

Ju shkruani se jeni në moshën 70-vjeçare. Kur lindët ju Shqipëria ishte në furtunë. Fatet e kombit tonë në atë kohë ishin vënë në peshore, shtrohej çështja e jetës ose e vdekjes së tij. I vetëm në mes të Evropës e të botës populli shqiptar luftonte jo vetëm për lirinë e pavarësinë, por edhe për vetë ekzistencën e tij. Shovinistët fqinj dhe miqtë e tyre imperialistë truallin shqiptar kërkonin ta copëtonin e ta ndanin pjesë-pjesë. Gjyshërit e baballarët tanë luftuan me trimëri e vetëmohim për të fituar lirinë e pavarësinë e kombit, për të mbrojtur tërësinë tokësore të Shqipërisë mëmë, traditat, gjuhën dhe virtytet e larta të popullit tonë.

Të parët tanë, patriotët e luftëtarët e lirisë, kanë ushqyer në zemrat tona një dashuri të zjarrtë për lirinë e sovranitetin e atdheut. Partia jonë e Punës këto ndjenja të pastra na i ka zhvilluar akoma më shumë. Ajo ka rrënjësuar në tërë popullin tonë një frymë të lartë patriotike, një respekt të veçantë për traditat më të mira të kombit, një guxim për të luftuar pa u epur për lulëzimin e përparimin e tij. Ajo na ka mësuar që trashëgiminë patriotike, liridashëse e përparimtare, e cila është pjesë e pandarë e karakterit dhe e tipareve të njerëzve tanë, ta ruajmë fort, ta mbrojmë dhe ta çojmë kurdoherë përpara.

Ne shqiptarët, kudo që jemi, jemi lidhur me truallin kombëtar si mishi me kockën dhe s'ka forcë që të na shkulë. Tokat e mallin e të tjerëve nuk e kemi lakmuar kurrë, por dhe tonat i kemi mbrojtur deri në fund. Duke mos qenë aspak shovinistë për vete, ne nuk jemi pajtuar e nuk i jemi nënshtruar kurrë shovinizmit të huaj.

Populli ynë kurdoherë ka dashur dhe do miqësi e drejtësi me popujt fqinj, ai ka qenë dhe është për mosndërhyrje në punët e njëri-tjetrit. Gjithnjë kemi kërkuar e kërkojmë që, për të mirën e përbashkët, të mos shkohet nga rruga e së kaluarës.

Ne jemi një popull që në shekuj kemi luftuar e luftojmë me këmbëngulje, me durim e vendosmëri për të drejtat tona, për lirinë e pavarësinë e atdheut, për tërësinë e unitetin e kombit, për ruajtjen e pastërtinë e gjuhës amtare, të kulturës e të traditave, të dokeve e zakoneve tona të mira e burrërore. Bijtë e bijat e Shqipërisë kurdoherë kanë luftuar me besim në të ardhmen, ata kurrë, edhe në momentet më të rënda, më të vështira e më të rrezikshme nuk janë ligështuar dhe nuk e kanë humbur shpresën. Pse kanë qenë të tillë ata i rezistuan dhe fituan mbi robërinë pesëshekullore otomane, përballuan e përballojnë rrebeshet e rënda të historisë që përplasen mbi ta.

Shqiptarët janë të njohur për trimëri e urrejtësi. Të tillë i kanë bërë lufta, jeta, përpjekjet për të rrojtur të lirë e të pavarur. Ne nuk jemi kokëshkretë e aventurierë, por një popull i zgjuar e

gjakftohtë. Kur e lypin nevojat dhe interesat e atdheut ne dimë shumë mirë të luftojmë me armë, por dimë të luftojmë edhe me politikë. Babai juaj, Hasan Prishtina, si gjithë patriotët e mëdhenj të vendit tonë, ka qenë luftëtar trim e politikan i urtë. Për t'i dalë zot atdheut, lirisë së tij, çështjes së kombit shqiptar, simbas rastit, ata kanë përdorur me mjeshtëri edhe pushkën, edhe penën, edhe fjalën.

Shqipëria socialiste, duke u bazuar në mësimet e marksizëm-leninizmit, duke luftuar për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e interesave të lartë të atdheut, duke mbajtur gjallë e duke zhvilluar më tej traditat e mira të popullit tonë, nuk i bën dëm askujt. Por shqiptarët kanë të drejtë të përpiqen për forcimin e krenarisë së tyre kombëtare, për të rritur dashurinë e lidhjen me tokën e gjuhën amtare, për të çelikosur bashkimin e tyre në shërbim të qëllimit të madh, përparimit e lulëzimit të kombit shqiptar.

Lufta dhe përpjekjet e patriotëve shqiptarë nderohen nga Partia dhe të gjithë njerëzit tanë. Populli shqiptar përulet kurdoherë me respekt përpara burrave të Shqipërisë mëmë që nuk kurrë as jetën për lirinë e pavarësinë e kombit, për tërësinë territoriale, për demokracinë dhe unitetin e popullit shqiptar, si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, Azem e Shote Galica, Asim Vokshi e Xhemal Kada, Emin Duraku, Hajdar Dushi, Xhevdet Doda, si Josif Bageri, Mustafa

Tetova e Iljaz Dibra, si Ismail Nikoçi, Mehmet Beci, Jusuf Uruci e shumë e shumë të tjerë.

Vitin që vjen do të festohet 100-vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Duke përkujtuar këtë ngjarje të shënuar të historisë sonë kombëtare, shqiptarët kudo që janë do të kenë rast të njihen edhe më mirë me të kaluarën e tyre të lavdishme, me luftën që kanë bërë të parët e tyre për mbrojtjen e tokave dhe të të drejtave të pamohueshme të Shqipërisë, t'u sjellin nderimet dhe respektin e madh të gjithë atyre që kanë luftuar me pushkë e me penë për lirinë, pavarësinë e përparimin e atdheut tonë.

Duke përfunduar këtë letër, ju uroj shëndet e jetë të gjatë, gëzim e lumturi familjes suaj.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR SHOKUT  
KRISTAQ ANTONIU**

**23 janar 1978**

I dashur shoku Kristaq Antoniu,

Letra që më dërgove, të cilën sapo e lexova, më ka prekur dhe emocionuar thellë, sepse atje shoh të rrahë me forcë zemra jote prej patrioti dhe artisti popullor. As mosha, as gjendja jo e mirë shëndetësore e kohëve të fundit, nuk t'i kanë prekur ndjenjat e pastra dhe gjendjen shpirtërore. Ti më shkruan se je «i gëzuar për tërë këto fitore të mëdha që kanë korrur Partia jonë dhe populli ynë», se je i lumtur për kujdesjet dhe përkrahjen e gjithanshme që ka treguar e tregon Partia për ty e familjen tënde, se je bërë me krahë që po e sheh Shqipërinë të lulëzuar në çdo drejtim, veçanërisht atje ku ke pasur pasionin tënd, «në artin e kulluar socialist me kualitet të lartë».

Për të gjitha këto fjalë të ngrohta që drej-

ton në adresë të Partisë e timen, unë të falënderoj nga zemra, shoku Kristaq, dhe uroj që të shërohesh sa më shpejt. Për popullin e Partinë tonë është e shtrenjtë jeta e çdo artisti, ashtu siç është i shtrenjtë e i vyer arti ynë socialist, siç janë të shtrenjta dhe të vyera jeta dhe veprat e gjithë njerëzve tanë.

Prindërit e tu u detyruan të shkonin jashtë atdheut për të siguruar krodhën e bukës, por mërgimi kurrë s'u bë atdhe për shqiptarët e vërtetë. Prindërit patriotë të mëkuan me ndjenjën e flaktë të shqiptarizmit, të dashuruan me këngët e mrekullueshme shqiptare. Këto këngë, që i këndove plot pasion, të bënë të njohur në skenat e huaja. Ti krenoheshe që ishe bir i një populli trim, punëtor e artist, e kishe për nder që ishe shqiptar.

Dheu i huaj nuk të mbante dot, sepse kënga dhe malli të shtynin të ktheheshe atje ku ato e kishin burimin — në Shqipëri. Zëri yt u bë i dashur që nga skenat e thjeshta të kantierëve e fshatrave e gjer në skenën e operës shqiptare, kësaj veprë të madhe të viteve të Partisë.

Rruga që ndoqe ti në jetë e në art, si rruga e gjithë artistëve dhe shkrimtarëve tanë të shquar, është një shembull i mirë edukativ për brezat tanë të rinj, veçanërisht për talentet e reja të letërsisë e të arteve.

Punën dhe përpjekjet e palodhura si qytetar, patriot e artist, devotshmërinë dhe kontributin tënd në shërbim të artit tonë socialist, po-

pulli e Partia, kurdoherë t'i kanë çmuar, prandaj të kanë nderuar me titullin e lartë «Artist i Popullit».

Gëzohem shumë që fëmijët e tu po ndjekin me sukses rrugën e artit. I këshilloj ata që ashtu si gjithë djemtë dhe vajzat e Shqipërisë, të mësojnë e të punojnë pa u lodhur, për ta çuar më tej veprën e prindërve të tyre si dhe veprën e madhe të popullit e të Partisë.

Duke përfunduar, edhe një herë të uroj shërim të shpejtë e të plotë. Shëndet e jetë të gjatë ty dhe bashkëshortes tënde, piktores Androniqi Zengo.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë.*

**LETËR DREJTUAR SHOKUT  
LAVER NURKA (BARIU)**

*Përmet*

**27 janar 1978**

I dashur Laver,

Letra jote e thjeshtë më gëzoi kur e lexova. Ka arsye të forta të këndojë zemra juaj, se përmetari i varfër s'kishte parë t'i qeshte buza një herë në të kaluarën kur fëmija i kërkonte bukë e ai bukë nuk kishte. Kurse sot ti i shkruan Partisë se jeton i lumtur me djem e vajza, me dhëndurë, me nipër e mbesa plot, i shkruan se djali mbaroi universitetin dhe doli inxhinier. Këto fjalë e gëzojnë Partinë, sepse ajo punon e lufton që ta shohë popullin kurdoherë të lumtur e të gëzuar.

Meloditë e bukura të këngëve patriotike që këndonin ju për vëllezërit Frashëri, për Çerçizin etj., këngët «A kanë ujë ato burime», «Trëndafilin fletë-fletë», «Moj kunadhja leshverdhë», «Filloi gjyshi dasmën», «A më qas të vi në bahçe», si edhe shumë këngë popullore dhe kabatë e tua të dëgjuara, i kam të regjistruara në magnetofon dhe i dëgjoj herë pas here për t'u çlodhur e për t'u frymëzuar në punë. Njëpërmjet këtyre këngëve është ngritur në art me mjeshtëri të rrallë vetë jeta e popullit me luftërat dhe përpjekjet e pareshtura për liri, me vuajtjet dhe mjerimin që ka hequr, me heroizmin e pashembullt të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe me punën e luftën gjithmonë fitimtare për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut. Populli edhe njëpërmjet këngëve e ka shkruar historinë e tij.

Partia na porosit që këngët e popullit t'i ruajmë, t'i këndojmë e t'i përhapim te brezi i ri. Ti, Laver, së bashku me Lefterin, me Sulejmanin, me Xhelalin, me Taren, me Krenarin e të tjerë, keni bërë një punë të lavdërueshme, me një nivel të mirë artistik për ta përhapur këngën popullore përmetare. Ju përgëzoj të gjithë nga zemra.

Ti më shkruan se je në prag të daljes në pension, e megjithatë kabaja jote do të dëgjohet kudo. Të lumtë! Sa të rrojnë këngëtarët dhe instrumentistët virtuozë, sikurse jeni edhe ju, do

t'i këndojnë me gjithë shpirt popullit, atdheut e Partisë.

Ju uroj të gjithëve shëndet e lumturi në familje dhe suksese.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR SHOKUT  
NAMIK HASAN BILVAR<sup>1</sup>**

*Izmir-Turqi*

**24 maj 1978**

I dashur bashkatdhetar,

Ju falënderoj nga zemra, ty dhe bashkëshorten, për letrën që më dërguat para se të largoheshit nga mëmëdheu për të cilin ju ushqeni një dashuri të madhe. Gjithë patriotët shqiptarë që janë larguar për të siguruar kafshatën e gojës, siç jeni edhe ju që jetoni në Republikën e Turqisë, ruajnë me mall dashurinë e pastër për Shqipërinë, ku populli është bërë zot i fateve të tij, ashtu siç ëndërronin dhe luftuan për këto

---

1. Namik Hasan Bilvar me nënshtetësi turke, nga Libohova, erdhi si vizitor në Shqipëri së bashku me bashkëshorten. Për mbresat e fuqishme që i la zhvillimi i atdheut i shkroi letër shokut Enver Hoxha.

ditë paraardhësit tanë të lashtë, ata të Rilindjes Kombëtare dhe gjithë patriotët e kohëve të reja. Është për këtë arsye që gjithë shqiptarët e ndershëm, që e duan me tërë dufin e shpirtit vendin e tyre, sot e ndiejnë veten krenarë që janë bija dhe bij të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Prandaj unë uroj që kjo dashuri për atdheun tonë të përbashkët, Shqipërinë socialiste, t'ju shtohet dhe t'ju forcohet vazhdimisht.

Ju dërgoj me këtë rast të fala nga ana ime dhe urime për një jetë të lumtur.

Bashkathdhetari juaj

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO**

**Pogradec, 24 korrik 1978**

I dashuri shoku Hysni,

Letrën që më dërgove të shkruar me dorën tënde e mora dhe më gëzoi pa masë, pse shoh që jo vetëm ke dalë në studio, por rëndësi të madhe ka që gjendja jote shëndetësore është e kënaqshme. Këtë e ndien ti vetë, por ma thonë çdo ditë edhe mjekët, të cilët më mbajnë në kontakt për përmirësimet e mrekullueshme të zhvillimit të gjendjes tënde. Çdo gjë kaloi me sukses, çdo gjë do të kalojë krejtësisht dhe do të bëhesh ashtu si ke qenë më parë, vetëm se paskëtaj, kur do të ecësh, çapin nuk do ta bësh si më parë, si sorkadhe mali.

Në një pjesë muzikore, që të tingëllojë mirë, autori vë anash, në krye të saj, «Vivaçe», «Andante», «Piano», «Pianissimo», etj., kurse ne, kur e ka dashur puna, kemi ecur edhe «Vivaçissimo». (Nuk e di në ekziston ky term në vokabularin muzikor, se në vokabularin tonë revolucionar ek-

ziston.) Kjo çështje ka të bëjë vetëm me eforin<sup>1</sup> fizik, pse mendja jonë, pavarësisht nga këshillat e Fejzi Hoxhës dhe të «Mini-doktorit»<sup>2</sup> do të ecë me ritmin e mëparshëm. Është e zorshme të ngjashë ndryshe, por jeta dhe lufta na kanë mësuar, na kanë regjur t'i kemi nervat të qetë dhe t'i evitojmë sa të jetë e mundur më shumë emocionet. Zemra e zjarrtë dhe koka e ftohtë duhet të jetë deviza jonë dhe veçanërisht kur kemi kaluar nga një sëmundje e lehtë, që lyp këtë ilaç më parë nga antibiotiku i Fejziut.

Ne do të vazhdojmë të punojmë me dhjetëra e me dhjetëra vjet të tjerë për popullin dhe për Partinë tonë të dashur, i dashur shoku Hysni, punë të mëdha, të vështira, por edhe entuziaste e plot suksese kemi përpara, prandaj Partia kërkon nga ne, si nga të gjithë, që të vazhdojmë të japim kontributin tonë dhe ky kontribut do të jetë aq efikas dhe i frytshëm, sa më në formë dhe me shëndet të mirë të jemi.

Jeta dhe shëndeti ynë janë të lidhur ngushtë me jetën dhe me luftën e Partisë. Prandaj «pa ua hapur syrin doktorëve», në mes nesh, duhet të themi se lypset t'i dëgjojmë ca këshillat e tyre. Ti mund të qeshësh dhe të thuash: «Kush e thotë këtë?» Unë nuk heq dorë nga mendimi se doktorët i teprojnë ca rekomandimet, por si kujtdo dhe si në çdo gjë, duhet ca «rezervë».

---

1. Nga frëngjishtja — mobilizim të forcave fizike për të përballuar diçka.

2. Është fjala për prof. Ylli Popën, me të cilin bënin shaka.

Edhe doktorëve u duhet kjo «rezervë» për të qenë më të sigurt. Ç'të bëjmë, do të bëhemi ca «filozofë» në atë kuptim që i jep populli kësaj fjale, domethënë të një njeriu që ëndërron dhe s'i mban këmbët mbi tokë. Megjithatë ne nuk jemi të tillë, jemi të disiplinuar në këshillat e mjekëve, por jo pa diskutime, dhe pa u kërkuar atyre që të mos mbajnë shumë «rezerva», pse edhe organizmi i njeriut ka dhe krijon rezervat e tij, që bëhen «antikorpet» e rezervave të tyre. Sidoqoftë edhe ti, edhe unë, jemi bërë tash më të arsyeshëm ndaj këshillave të mjekëve. Mua më gëzon shumë çështja që ti e ke pranuar këtë disiplinë dhe kjo bëri që çdo gjë kaloi shpejt dhe mirë dhe, çdo ditë e më mirë do të kalojë.

E kam parasysh dhe e ndiej kënaqësinë tënde (siç e kam ndier edhe vetë) kur u ngrite nga krevati në kolltuk, nga kolltuku në studio, nga studioja përposh, pastaj vjen shëtitja me automobil, plazhi i Durrësit, gëzimi me kalamanët dhe më vonë takimet e punës së përditshme, që do të vazhdojmë të bëjmë së toku në Komitetin Qendror. Prandaj edhe gëzimet, edhe luftën, edhe fitoret e reja në çdo fushë i kemi përpara, as mos u mërzit, as mos u shpejto. Çdo gjë në kohë, mirë dhe me baza. Partinë e kemi çelik, popullin vigan. Çdo armik do ta mposhtim, do ta demaskojmë, do ta mundim, siç i kemi mundur njërin pas tjetrit.

Letrën renegatëve dhe tradhtarëve kinezë ua kemi qëndisur. Sot kam thirrur dhe do të vijë

në Pogradec Ramizi që ta diskutojmë përfundimisht, ta shikosh edhe ti, pastaj do të mblidhen Byroja Politike dhe Qeveria së toku dhe do ta botojmë<sup>1</sup>. Ajo do të bëjë një efekt të madh, kinezëve do t'u çirret krejtësisht maska, zjarr do t'u digjet shtëpia. «Ashtu i do mushka drutë», thotë populli. U dolëm borxhit, e mbushën kupën me helm dhe ne tash u themi: «Nani, pijeni!».

Vetëm një gjë do të të lutem: tash e tutje çdo gjë me nerva të qetë, sido që me ty s'kam pse insistoj shumë për këtë gjë, pse kurdoherë ke qenë i qetë në punë e në mendime, në punë e në marrëdhënie me shokë. Jemi mësuar me luftë, me vështirësi, me shqetësime, por të tëra i kemi kapërcyer. Ne e pritnim këtë armiqësi të kinezëve, asgjë s'na gjen në befasi. Ne s'donim që Kina të arrinte në këtë shkallë dhe bëmë çmos që të mos binte kaq poshtë. Neve na vjen keq për popullin kinez, por, duke i çjerrë maskën tradhtisë, revizionizmit kinez, ne i japim ndihmën më të madhe dhe të vërtetë këtij populli dhe revolucionit në përgjithësi.

Populli ynë do të mobilizohet si kurrë ndonjëherë, planet do t'i realizojmë, planin e ri pesëvjeçar do ta hartojmë edhe më të shëndoshë, edhe më të plotë dhe do t'u tregojmë të gjithëve se me një Parti si jona, me një popull si yni dhe me forcat tona, ne vazhdojmë dhe do të vazhdoj-

---

1. Letra e KQ të PPSH dhe e Qeverisë së RPS të Shqipërisë drejtuar KQ të PK të Kinës dhe qeverisë kineze u botua në gazetën «Zëri i popullit», më 30 korrik 1978.

më të ndërtojme me sukses socializmin. Prandaj bëhu shumë mirë sa më parë nga shëndeti, të kalosh pushime të mira e të gëzuara në Durrës me Viton, të cilën e përqafoj, me gjithë fëmijë, që i puth të tërë me radhë.

Nexhmija u gëzua shumë që je mirë, ajo të përqafon, të bën të fala e të uron shërim të plotë e të shpejtë. Ajo i bën shumë të fala edhe Vitos dhe i puth fëmijët.

Këtu, në Pogradec, kemi kohë të mirë, të freskët, shëtis nga tre orë çdo ditë, po çdo racion i ushqimit qëndron në vend numëro. Të gjitha të dhënat janë të mira, më janë qepur si gërthelat, por, siç të thashë më sipër, jam «bërë filozof».

Me sekretarin dhe kryetarin e Pogradecit u takova, do të dalin mirë, më raportuan.

Nga java presim dhe ne të na vijjnë kalamanët, pse kemi ngelur «si kukuvriqë» me Nexhmi- jen, siç thonë gjirokastritët.

Të shkrova ca gjatë, por këtë e bëra që të të pengoj të shkruash me dorë letra të gjata nga 1 - 3 apo 9 faqe.

Të puth e të përqafoj me mall dhe të uroj shëndet të plotë dhe gëzime.

Me dashuri

*Enver*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO**

**Pogradec, 30 korrik 1978**

I dashur shoku Hysni,

Më gëzoi shumë letra që më dërgove. U gëzova gjithashtu shumë që u bëre mirë, që she-tit në bahçe, që shkon shëtiti në parkun e pallatit dhe që nesër do të vesh të pushosh në plazhin e Durrësit.

Është e qartë se, me durim dhe gradualisht, çdo gjë kapërcehet, çdo gjë fitohet. Ja, tash i kapërcyem të gjitha shqetësimet, që na shkaktoi si ty, edhe neve shokëve të tu, dhe gjithë Partisë, sëmundja jote. Ti do t'i kthehesh Partisë dhe udhëheqjes plot shëndet e gjallëri, pse këto kanë kurdoherë shumë nevojë për punën, mendimin dhe udhëheqjen tënde.

Kinezët e morën përgjigjen që meritonin. Partia jonë dhe udhëheqja e saj vepruan shumë drejt në rrugën marksiste-leniniste dhe demas-

kuan me fakte një armik tjetër të madh, revizionizmin kinez, që maskohej për caq kohë nën maskën e marksizëm-leninizmit.

Kur analizojmë historinë e zhvillimit të shoqërisë kineze, zhvillimin e ideve që përplaseshin atje, karakterin e luftërave për çlirim e për «socializëm» ne shohim një specifike tipike kineze, një egocentrizëm dhe një ksenofobi të theksuar. Kjo karakteristikë, më duket mua, tek të ashtuquajturit komunistë, si Mao Ce Duni dhe shokët e tij, është më e theksuar sesa te Sun Jat Seni.

Shovinizmi kinez çdo gjë e ka për Kinën dhe e shikon nën prizmin e interesave vetëm të Kinës, kjo është një nga karakteristikat e pseudokomunistëve kinezë. Këta pseudokomunistë rrojnë me lashtësinë e popullit të tyre, rrojnë me perandorët, me perandoreshat dhe me oborrtarët e tyre, ëndërrojnë për jetën e tyre, për thëniet dhe për filozofinë e njerëzve si Konfuci, Menci e të tjerë dhe aktualisht çdo gjë e shpjegojnë dhe e gërshetojnë me filozofinë e vjetër vetëm kineze.

Zhvillimi materialist, materializmi historik dhe zhvillimi i kontradiktave nuk janë parë nga ana e tyre në prizmin dhe në zhvillimin e gjerë dhe të gjithanshëm të shoqërisë njerëzore, por vetëm në prizmin e shoqërisë kineze, në jetën, në ëndrrat dhe në legendat e saj. Kjo filozofi dhe ky shikim i këtyre problemeve kardinale, nga Mao Ce Duni mbulohen me një vello transparente, që ata e vetëquajnë marksiste. Ky është

një falsitet i madh ideologjik, është një filozofi idealiste dhe shoviniste që është orvatatur dhe orvatet të ruajë vazhdimësinë e «Perandorisë së Mesit» dhe gjithë bota ta konsiderojë Kinën si boshtin e saj, kurse këtë filozofi të sajisur, si një filozofi «avangardë» për njerëzimin.

Partia Komuniste e Kinës dhe veçanërisht Mao Ce Duni, që ka qenë një ëndërrues dhe një vizioner idealist pa kulturë të përgjithshme (përveç asaj të lashtësisë kineze), ndoqën rrjedhën e historisë së njerëzimit si diletantë nga më ksenofobët dhe parimet ideologjike, politike dhe organizative të tyre, sidomos që nga formimi i Partisë Komuniste të Kinës e tëhu, janë tepër të theksuara në këtë filozofi pragmatiste dhe në interesin vetëm të vendit të tyre. Ato janë me synime të qarta për ta bërë Kinën e «amshueme» një superfuqi që të dominojë botën, të bëjë ligjin, t'i diktojë kësaj vullnetin dhe kulturën e vet. Në analizat që kemi bërë, ne hasemi në këtë ideologji kineze, dhe shohim se format e organizimit dhe të veprimit të Maos dhe të partisë së tij koncentrohen drejt kësaj ideologjie që ata duan ta bëjnë «universale».

«Figura» e Mao Ce Dunit është pompuar si figura hyjnore e një perandori kinez dhe në fakt ky perandor modern vepron i plotfuqishëm mbi oborrtarët që kanë krijuar një burokraci të madhe dhe të tmerrshme, që zbaton «idetë gjeniale» të «Timonierit të madh». Ky ia ka hipur Partisë Komuniste të Kinës në zverk dhe kurdoherë që

i tekët, kurdoherë që ai e «gjykon» të arsyeshme, sipas zhvillimit «dialektik të të kundërtave», të shikuara këto nën prizmin e Taoizmit, rrëzon njerëz, sulmon dhe likuidon partinë, bën nga një «revolucion», balancon fuqinë e kurtizanëve dhe të gjitha këto i shpjegon me gjoja formula revolucionare, por që s'janë veçse veprime më «të kulturuara» se të perandorit Bokasa, të shahut të Iranit dhe të mbretit të Nepalit, të cilët Mao Ce Duni i ka dashur shumë, i ka pritur dhe i ka përcjellë dhe jo vetëm për arsye se ka qenë i shtyrë nga interesi material dhe nga përfitimet në politikë për t'i bërë satelitë të Kinës, por edhe sepse filozofia e tij e puqte me ta.

Partia Komuniste e Kinës në këto kushte dhe me këto koncepte nuk mund të ishte një parti marksiste-leniniste. Filozofia që e udhëhiqte atë ishte idealiste, borgjeze, retrograde, pse vetë Kina, shoqëria e saj, me gjithë revolucionin demokratiko-borgjez, mbeti një shoqëri e mbyllur, me besime dhe me mentalitete të vjetra, e dominuar nga misticizmi dhe nga parime filozofike dhe organizative shtetërore në thelb arkaikë, por në sipërfaqe gjoja të evoluara. Këtë e shohim në ndërtimin dhe në formën e shtetit, e shohim në zhvillimin e ekonomisë, e shohim në ndërtimin e arsimit dhe të kulturës, në organizimin e ushtrisë. Çdo gjë, që nga ideologjia, literatura, deri edhe te sloganet, mbante vulën specifike kineze. Sloganet kishin një burim dhe çdo njeri në Kinë, që nga më i vogli deri te më i madhi, duhej

t'i përsëritnin ato pa u lajthitur në asnjë gërmë dhe të mos u lëviznin asnjë presje. Kjo ishte lufta për mpirjen e mendimit krijues, kjo shtypte çdo formë të demokracisë, kjo ishte kulti i «Timonierit» dhe dominimi i burokracisë. Një zhvillim i tillë aberant<sup>1</sup> do të pësonte dhe do të pësojë disfata në momente të caktuara, që Mao Ce Duni i ka predikuar si «revolucione dhe kundërrevolucione» në çdo 7 vjet.

Mao Ce Duni duhet të cilësohet jo «profet» i revolucioneve, por «profet i kundërrevolucioneve». Ai përfaqëson tipin e një anarkisti, që ka në gjak konfuzionin, kaosin, minimin e diktaturës së proletariatit e të socializmit, por me kusht që kjo anarki permanente të udhëhiqej nga ai, ose nga ideologjia e tij anarkiste tipike kineze. Mao Ce Duni është një Bakunin kinez.

Revolucioni Kulturor ishte ilustrim i ideve dhe i veprimeve të këtij Bakunini kinez: Kaosi i krijuar në Kinë para Revolucionit Kulturor nga vija tradhtarë dhe antimarksiste e Mao Ce Dunit dhe e oborrtarëve të tij, kaos plot disfata në politikë, në ideologji dhe në ekonomi, u luftua nga «Timonieri i madh» me anarkinë e Revolucionit Kulturor. Ky revolucion anarkik edhe e shpëntonte autokracinë maoiste, por ai rrezikonte njëkohësisht minimin e saj. Duhej shpëtuar «pres-tigji» i «Timonierit», duhej penguar që anarkia

---

1. Nga frëngjishtja — i palogjikshëm, absurd.

të rrëzonte mitet, prandaj u përdorën edhe masat ushtarake, u ruajt thelbi i burokracisë me oborrtarin Çu En Lai-Konfucius dhe shtynë në skenë të propagandës dhe të agjitacionit elementë gjoja «të rinj», «revolucionarë», të cilëve iu ngarkua roli nga «Timonieri» që ta ilustronin anarkinë si një «revolucion» brenda në revolucion, gjoja për të zhdukur borgjezinë që ishte futur në parti. Në fakt nuk kishte parti, po kudo kishte borgjezi, kishte klane dhe fraksione që luftonin për fuqi. Ishte «revolucioni permanent» trockist që udhëhoqej nga Mao Ce Dun-Trocki.

E ashtuquajtura «katërshe» ka vepruar siç e këshillonte Maoja. Te ky e kishin ata mbështetjen, prandaj «rrojtën sa ç'rron një lule behari» dhe me helm, si të gjitha «lulet dhe shkollat» e tjera që lulëzonin dhe që lulëzojnë në Kinë. «Katërshja» ishte një grup llafazanësh pa parime, megalomane, ambicioze, intrigante, si edhe fraksionet e tjera të borgjezisë që notonin në kënetë. Mirëpo këta të fundit e kishin «kënetën» në dorë. «Katërshja» kishte «hapëset e kashtës» dhe nuk ndërmori asnjë veprim organizativ, shtetëror, ekonomik, pjesëtarët e saj shkruanin vetëm artikuj dhe organizonin balete. Ishin njerëz të dyshimtë si të gjithë të tjerët. Këta fluturonin si mendtë e Maos, kurse fraksioni i Çusë, i Tenit dhe i Jehsë punonte me sistem për të marrë fuqinë. «Katërshja» mendonte se me fjalë bombastike do të ngrinte milionat me «flamurin e Maos».

Mirëpo Teni «i rrëzuar» përkohësisht ngriti 1 milion njerëz në Tien An Men, duke bërë titur kundër «katërshes». Më vonë «katërshja» ngriti 1 milion kundër Tenit. Ishin të njëjtët njerëz që brohoritnin për njërin dhe për tjetrin. Erdhi më pas Teni në fuqi dhe 1 milion dolën prapë dhe brohoritnin për të. Ishin po ata që brohoritnin kundër tij më parë.

Kjo është «pasqyra» e hidhur dhe e errët e maocedunidesë. Katërshen bota borgjeze e quan «radikale». Kot nuk i shtojnë asaj edhe epitelin «socialiste» dhe ta quajnë «radikal-socialiste». Por ata s'kanë qenë as radikalë, as socialistë. Dikur në Francë ekzistonte një parti e fuqishme e borgjezisë që quhej radikal-socialiste dhe që kishte udhëheqës borgjezë, politikanë dhe letrarë të shquar, si Herrioi, Daladieri e të tjerë. Kjo parti pësoi disfatë të plotë, megjithatë la disa gjurmë, kurse «katërshja» «radikale» u zhduk pa lënë gjurmë, ashtu siç vdiq ose është duke vdekur edhe maocedunideja.

Elementët e reaksionit të zi, Hua Kuo Fen-Ten Hsiao Pin, që kanë marrë fuqinë në dorë në Kinë, do të ndeshen për fuqi derisa të vendosin një shtet të egër të diktaturës fashiste.

Luftohet në Kinë për hegjemoni botërore. Strategjia e vendosur prej tyre është e natyrshme; aleancat me imperializmin amerikan dhe me reaksionin botëror janë të natyrshme, janë normale, siç janë normale edhe antagjonizmat dhe

shpërthimet e luftërave grabitqare që do të rezultojnë nga këto përqafime banditësh.

Analizat që po u bëjmë ne revizionistëve kinezë, në përgjithësi, janë të drejta, objektive dhe të shikuara në prizmin e marksizëm-leninizmit. Mendoj se rruga që ndoqën ata kundër nesh, duke prerë kreditë dhe duke lënë në mes pa i plotësuar veprat civile dhe ushtarake, ka arsyet logjike të vetat. Kjo duket dhe është një rrugë e marrë, gjë që tregon egërsinë e regjimit fashist, që është vendosur në Kinë, tregon po ashtu luftën fraksioniste, kaotike dhe paqëndrueshmërinë që ekziston atje dhe nuk i lejon njerëzit, sado reaksionarë që të jenë, që të mendojnë pluset dhe minuset e të tilla veprimeve që po ndërmarrin. Këto janë «mendime kuajsh».

Por, nga ana tjetër, duhet të kemi parasysh se ky vendim arbitrar, arrogant dhe shovinist i një shteti të madh, i marrë kundër Shqipërisë socialiste, është në vijën e logjikës së revizionistëve kinezë. Këta duhej të goditnin vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë, duhej të goditnin teorinë marksiste-leniniste, pse kjo demaskonte gjithë vijën e tyre oportunisto-kapitaliste, godiste të gjitha planet hegjemone që po ndërtonte Kina maoiste. Këtu qëndron lufta në mes vijës sonë marksiste-leniniste dhe vijës borgjezo-kapitaliste të kinezëve. Ka rëndësi çështja që një shtet kapitalisto-fashist si Kina sulmon një vend të vogël socialist si Shqipëria, të cilën, si

shtet me potencial të madh, ajo mendon ta tron-  
ditë dhe ta gjunjëzojë.

Duhet pasur parasysh se Shqipëria e vogël  
dhe Partia e Punës e Shqipërisë, një Parti e vër-  
tetë marksiste-leniniste, i bën hije, e errëson dhe  
e demaskon këtë shtet të madh, siç është Kina,  
**për arsyen e ideve të mëdha të pavdekshme dhe  
triumfuese të marksizëm-leninizmit.** Pikërisht  
këtu ka synuar Kina, duke na sulmuar marrë-  
zisht dhe pikërisht në këtë fushë lufte ajo po  
pëson dhe do të pësojë disfatën më të madhe. Ne  
e pengonim Kinën në planet e saj të ekspansionit  
dhe të hegjemonizmit socialfashist, prandaj na  
sulmoi.

Lufta tash është shpallur dhe ne do ta bëj-  
më të ashpër, pa kompromis dhe do të fitojmë.  
Për Partinë tonë janë momente historike të një  
rëndësie ndërkombëtare, pse asaj i ra barra his-  
torike të udhëheqë këtë luftë sa të vështirë, por  
aq dhe të lavdishme për të mbrojtur Shqipërinë  
socialiste dhe pastërtinë e marksizëm-leninizmit  
nga shtrembërimet, deviacionet dhe sofizmat, për  
të fuqizuar revolucionin proletar botëror dhe luf-  
tërat nacionalçlirimtare të popujve kundër impe-  
rializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik  
dhe atij kinez maoist.

Maoizmi si «teori» antimarksiste është në  
agoni. Ai do të ketë të njëjtin fat që kanë pasur  
teoritë e tjera të sajuara nga kapitalizmi botëror  
dhe nga imperializmi në kalbëzim. Ekipi aktual

që sundon në Kinë, ose ekipet e tjera, që me siguri do të vijnë më vonë, si rezultat i luftës së brendshme të fraksioneve për pushtet, do ta përdorin maoizmin, por si një kufomë të vdekur antihistorike, për të ndërtuar pa skrupull, pa turp, një shtet të fuqishëm imperialist kinez në unitet dhe në divergjenca me imperialistët e tjerë, nëpërmjet shtypjes dhe shfrytëzimit të popujve që aspirojnë dhe që luftojnë për çlirim, për pavarësi dhe për socializëm.

Të gjitha mjetet e mbrapshta janë të mira për revizionistët kinezë, ashtu siç janë të mira edhe për miqtë e tyre, imperialistët amerikanë, sovjetikë e të tjerë.

Lufta jonë e drejtë do të jetë e gjatë dhe e vështirë, prandaj lypset ta kemi Partinë shumë të fortë, në unitet luftarak revolucionar, ta kalitim çdo orë e çdo ditë në beteja të vazhdueshme politike, ideologjike dhe ekonomike, ta bëjmë vigjilente në kulm, të dashur dhe të bashkuar si mishi me kockën me popullin nëpërmjet një demokracie proletare, larg çdo oportunizmi, sektarizmi e burokracie të sëmurë e rrënuese.

Vija e drejtë marksiste-leniniste do të përkrahet dhe do të mbështetet nga marksistë-leninistët revolucionarë në botë; ajo do të përkrahet nga proletariati botëror dhe nga gjithë popujt. Jeta e përditshme e luftës së Partisë sonë e provon këtë gjë.

Klikat fashiste revizioniste kineze, me pro-

pagandë e me çdo mjet tjetër do të bëjnë çmos që të zemërojnë dhe të egërsojnë popullin kinez kundër nesh, të gënjejnë edhe opinionin botëror. Por ata nuk mund t'i gënjejnë të gjithë dhe në një kohë. Valë të tmerrshme kanë kaluar dhe do të kalojnë mbi popullin kinez, por edhe atje teoria e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit do të triumfojë. Breza të sotëm dhe të ardhshëm të Kinës do të kuptojnë dhe do të thonë: «Partia e Punës e Shqipërisë na hapi sytë, ajo veprroi drejt, ajo demaskoi maocedunidenë, pse e donte revolucionin proletar kinez, pse ajo donte dhe shpërndau mitet shkatërrimtare që ishin krijuar në Kinë dhe që pengonin lumturinë e këtij populli të madh që do të rrojë në socializëm të vërtetë».

Letra që u dërguam ne kinezëve do të ketë jehonë të madhe në botë. Ajo do të jetë një fitore e madhe për marksizëm-leninizmin, për Partinë tonë dhe për revolucionin. Pjekuria, vendosmëria në rrugën e socializmit shkencor, guximi dhe trimëria e Partisë dhe e popullit tonë, do të ndihmojnë edhe shokët e miqtë kudo në botë, që na duan dhe që i duam, që na ndihmojnë dhe i ndihmojmë, pse bëjmë një luftë të përbashkët për përparimin, për lumturinë e njerëzve dhe të popujve. Forcat e bashkuara tonat janë shumë të forta dhe ato u shkaktojnë dëme të pariparueshme armiqve.

Lufta jonë fitimtare vazhdon, i dashkuri shoku Hysni, prandaj bëj pushime të mira, të kënd-

shme dhe të qeta, që të ndiheni gjithnjë të fortë  
si çeliku në betejat që na presin.

Të përqafoj e të puth me mall

*Enver*

Nexhmija të bën ty dhe Vitos shumë  
të fala. Jepi Vitos të falat e mia.

*Enver*

*Botohet për herë të parë st-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*



U gëzova shumë që më shkruan se je i lumtur në familje. Megjithatë kohën nuk e kalon vetëm pranë njerëzve të afërt dhe, megjithëse në pension, si njeri me mendime të përparuara po ndihmon akoma në punë me përvojën tënde shumëvjeçare, duke vazhduar të kontribuosh kështu me mendjen dhe zemrën tënde në ndërtimin e socializmit në atdheun tonë të dashur që po e bën lule Partia.

Më shkruan gjithashtu se je bërë gjysh për herë të parë. S'ka gjë më të bukur sesa kur të rrethojnë mbesat e nipërit e vegjël, prandaj të uroj që mbesa të ketë jetë të gjatë, ti të bëhesh gjysh edhe shumë herë të tjera, nga të gjithë fëmijët e tu dhe të rrosh e t'i gëzosh me shëndet dhe i lumtur.

Të falënderoj veçanërisht për fotografitë që më dërgove që, kur i pashë, më sollën menjëherë ndër mend vitet e rinisë.

Kur të kesh rast t'i takosh, u bëj të fala nga unë gjithë shokëve me të cilët kemi bërë së toku shkollën. Edhe një herë të uroj nga zemra gjithë të mirat.

Juaji

Enver

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR SHOKUT SPIRO KOLEKA

17 tetor 1978

I dashur shoku Spiro,

Kur më dhanë lajmin e sëmundjes tënde të papritur, të them të drejtën, u alarmuam shumë, por pastaj, të nesërmen, u qetësuam, pse ajo që ndodhi ishte diçka e rëndë, por virusale, kështu që çdo gjë kaloi. Vetëm se ashtu sikurse të kemi thënë kurdoherë, duhet të bësh shumë kujdes dhe këtej e tutje «të puthesh me Milon» me cingarin dhe me banjat e Dhërmiut, ku shkon e më shtrihe përtokë dhe mbulohe me gurë të përvëluar. Këto t'i them për shaka, se e di që je nja katër a pesë vjet më plak se unë dhe megjithatë dukesh sikur je vetëm nja 6 muaj më i vjetër.

Të falemnderit shumë për urimet që më bërë për 70-vjetorin e lindjes sime. Të jesh i sigurt se si ti, edhe unë, do t'i arrijmë të njëqindat.

E vërteta është që ti je i thantë. Po edhe unë nuk  
bie poshtë.

Të na shërohesh sa më shpejt e plotësisht,  
i dashur Spiro, dhe të na kthehesh në mes tonë.

Të përqafoj

Yti

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR KOLEKTIVIT TË UZINËS  
«ENVER» TË KOMBINATIT  
TË AUTOTRAKTORËVE «ENVER HOXHA»**

*Tiranë*

**6 nëntor 1978**

Të dashur shokë punëtorë, teknikë, inxhinierë dhe kuadro drejtues të uzinës,

Ju falënderoj nga zemra për ftesën që më bëtë për të marrë pjesë në ceremoninë e kremtimit të 30-vjetorit të krijimit të uzinës suaj, që mban titullin e lartë Hero i Punës Socialiste dhe, me këtë rast, ju dërgoj të gjithëve ju urimet dhe përshëndetjet më të zjarrta e revolucionare.

30 vjet në jetën e uzinës e të kolektivit tuaj janë të mbushura me fitore të njëpasnjëshme në kalitjen tuaj ideopolitike, në forcimin e radhëve të organizatës së Partisë, si dhe të prodhimit për nevojat e ekonomisë. Ato kanë qenë vite përpjek-

jesh të lavdërueshme për përvetësimin e dijes, të teknologjisë së përparuar e të krijimtarisë tekniko-shkencore. Sukseset që ju keni arritur, nën udhëheqjen e Partisë, gjatë këtyre tri dekadave pune e veprimtarie frytdhënëse e luftarake, janë një kontribut i rëndësishëm në luftën e të gjithë popullit tonë për ndërtimin e socializmit.

Ju ishit «dallëndyshja» e parë, lulja e parë në tokën e shumëvuajtur të atdheut tonë të dashur në ato vitet shumë të vështira menjëherë pas Çlirimit, që me kujdesin e vazhdueshëm të Partisë dhe të pushtetit popullor, hapi rrugën e zhvillimit të industrisë sonë të fuqishme e moderne mekanike që kemi sot. Themelet e uzinës suaj u ngritën mbi gjakun e kulluar e të ngrohtë të mijëra e mijëra shokëve e shoqeve tona heroike që ranë në Luftën e madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve të huaj, për çlirimin shoqëror e kombëtar të popullit.

Ju e nisët punën thuajse me asgjë. Kur shteve të tjera, që kishin bërë më pak sakrifica e kishin derdhur shumë më pak gjak, në krahasim me popullin tonë kundër nazifashizmit, iu dhanë miliarda dollarë e mjete të tjera, Shqipëria që ishte zhuritur më rëndë, megjithëse ligjërisht e me të drejtë i takonin shumë më tepër, iu dhanë si reparacione vetëm disa hekurishte të pakta e të vjetruara, të cilat na u desh t'i ndreqnim me thonj e me dhëmbë për t'i vënë në punë. Partia jonë e kishte të qartë se nuk duhej të priste asgjë prej atyre që nuk ua kanë dashur kurrë të mirën po-

pullit shqiptar dhe pushtetit të tij popullor, që i shikonin me armiqësi përpjekjet tona titanike për rindërtimin e vendit dhe ndërtimin e socializmit. Prandaj Partia futi në zemrat dhe në gjakun e punëtorëve e të teknikëve të parë të uzinës suaj dëshirën dhe vendosmërinë për ta ndërtuar atë me çdo kusht dhe për ta vënë në funksionim për interesat e lartë të atdheut. Këto dëshira dhe vendosmëria juaj ishin shumë frymëzuese e shumë më të fuqishme nga ato mbeturina që na u dhanë si «shpërblim» për dëmet e mëdha që na kishin shkaktuar pushtuesit nazifashistë, për sakrificat dhe për kontributin që dhamë në luftën e koalicionit antifashist kundër tyre.

Sa shumë mund e djersë është derdhur në këta 30 vjet në uzinën tuaj! Uzina e dikurshme, ajo lulja e parë që çeli e lulëzoi atëherë, sot është kthyer në një njësi të fuqishme prodhimi me teknologji të përparuar. U rrit uzina, së bashku me të u rrit edhe klasa punëtore në gjirin e saj. Aty u rrit një numër i madh mjeshtrish, teknikësh e inxhinierësh të zotë, që sot derdhin djersën dhe dijet e tyre të çmueshme si punëtorë, projektues e zbatues në kombinatin metalurgjik «Çeliku i Partisë», në hidrocentralin «Drita e Partisë», në uzina e degë të tjera industriale të vendit. Uzina juaj gjatë këtyre vjetëve u kthye në një shkollë të madhe për kalitjen revolucionare e përgatitjen e punëtorëve e kuadrove të kualifikuar, besnikë të klasës punëtore e të popullit tonë. Kolektivi juaj ka qenë iniciator i guximshëm në fushën e

prodhimit e të mendimit krijues, në fushën e zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor.

Kur në kovaçhanën e uzinës suaj rrahu çekani i parë, ju kishit vetëm dy teknikë e disa punëtorë, ndërsa sot aty punojnë me dhjetëra inxhinierë, me qindra teknikë, specialistë e punëtorë të talentuar. Prodhimet tuaja të fillimit numëroheshin me gisht, ndërsa sot ju prodhoni me mijëra artikuj mekanikë nga më të ndryshmit dhe të cilësisë së mirë. Në gjirin e kolektivitetit tuaj ka shumë punëtorë, teknikë e inxhinierë duarartë, që kanë projektuar e kanë zbatuar me sukses shpikje e racionalizime shumë të dobishme për prodhimin e pjesëve të ndërrimit, makina e pajisje të thjeshta e të ndërlikuara për fabrika, reparte e linja ekzistuese e të reja etj. Të gjitha këto nuk kanë si të mos e gëzojnë Partinë dhe gjithë popullin tonë. Ato janë një dëshmi e padiskutueshme e atyre objektivave të tjerë më të mëdhenj që ne do të arrijmë në ditët e në vitet e ardhshme.

Gjithçka ka ndryshuar rrënjësisht te ne. Edhe në industrinë mekanike, ashtu si në çdo degë tjetër të ekonomisë së vendit, nuk trashëguam asgjë nga e kaluara e hidhur e regjimit antipopullor zogollian. Atëherë kishte vetëm një numër të kufizuar kovaçësh, punëtorë heroikë e plot talent, të varfër, të këputur e të përbuzur, që me zor të madh fitonin bukën e gojës. Dikur ne sillnim nga jashtë deri edhe gjilpërat për qepje dhe çdo gjë e paguanim shumë shtrenjtë

me pasuritë e nëntokës sonë që grabiteshin me të dyja duart nga të huajt. Sot me krenari të ligjshme deklarojmë se nga hiçi arritëm të prodhojmë traktorin e parë të markës shqiptare.

Me prodhimin në vend të gizës e të çelikut shqiptar, duke pasur edhe një bazë të fuqishme e të përparuar mekanike, vendi ynë ka arritur në një nivel të tillë zhvillimi që prodhon makineri të veçanta e komplete për minierat, për bujqësinë e për degët e tjera të ekonomisë. Ne sot po ngremë me forcat tona fabrika e linja të plota. Ky është vetëm fillimi. Klasa punëtore shqiptare në këtë drejtim tashmë e ka thënë fjalën e vet.

Mësimet e Partisë, të shkruara me vullnetin e çeliktë, vendosmërinë dhe dijet e bijve e të bijave të devotshme të popullit tonë, do të çajné përpara, pavarësisht nga vështirësitë që na krijojnë armiqtë e egër imperialistë, socialimperialistë e revizionistë të të gjitha ngjyrave, të ndriçuara nga ato ne do të prodhojmë gjithçka që i nevojitet ekonomisë, popullit, mbrojtjes, ndërtimit të socializmit.

Ne, shqiptarët, nuk e kemi zakon të mburremi, por atë që na takon nuk ua lëmë të tjerëve të na e përvetësojnë. Armiqtë revizionistë jugosllavë, më vonë ata sovjetikë hrushovianë, dhe tash së fundi edhe revizionistët kinezë, jo vetëm u përpoqën të na pengonin, të na sabotonin e t'i vinin kazmën socializmit në Shqipëri, por pretendojnë se çdo gjë në Shqipëri na qenka «ngri-

tur e ndërtuar me ndihmën» e tyre! Jo. Ashtu sikurse lirinë popullit shqiptar nuk ia solli dhe nuk ia dhuroi njeri, por e fitoi me gjakun dhe me sakrificat shumë të mëdha të bijve të vet, edhe gjithçka e mirë dhe e bukur që kemi ndërtuar për fuqizimin e ekonomisë së atdheut socialist e të mbrojtjes së pavarësisë kombëtare, nuk është vepër e të huajve dhe e «ndihmave» të tyre, por vepër monumentale e vetë popullit shqiptar.

Të dashur shokë,

Detyra shumë të mëdha, të gjithanshme e të vështira dalin përpara jush dhe gjithë punonjësve të industrisë sonë mekanike. Bindja ime është se ashtu si deri më sot, nën udhëheqjen e Partisë së lavdishme të Punës dhe, duke vënë në jetë porositë e saj për të shpartalluar e thyer bllokadën e egër imperialisto-revizioniste, ashtu si të gjithë punonjësit tanë, ju do të mbani si kurdoherë lart flamurin e mendimit punëtor dhe të jetës revolucionare, do të mobilizoheni si deri sot që të realizoni të gjitha detyrat e planit të gjashtë pesëvjeçar dhe të Kongresit të 7-të historik të Partisë, do të zhvilloni më tej lëvizjen e iniciativave, të shpikjeve e të racionalizimeve në kuadrin e revolucionit tekniko-shkencor, për të plotësuar gjithnjë e më mirë nevojat në rritje të ekonomisë dhe të mbrojtjes kombëtare të vendit.

Sot, në këtë ditë të gëzuar, megjithëse nuk

po mundem të marr pjesë nga afër në ceremoninë festive të uzinës, pse jam mjaft i zënë me punë të tjera, me mendje dhe me zemër e ndiej veten midis jush dhe me gjithë shpirt ju uroj: gëzuar festën tuaj, 30-vjetorin e krijimit të uzinës dhe dalshi kurdoherë faqebardhë!

LETËRIM TUAJ SHQEPË OLGA PLUMBI

Juaji

*Enver Hoxha*

10 nëntor 1978

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

Libri i ndërruar shqepë Ollgë

Me rastin e 30-vjetorit të krijimit të uzinës, uroj nga zemra shëndet dhe jetë të gjatë. Partia dhe unë personalisht kemi njohur e vlerësuar në personin tuaj një grua me ide përparimtare, që ka punuar aktivisht për emancipimin e gruas. Që në ditët e errëta të regjimit të diktatorit e obskuranitistit zogolliar ju ishit ndër grata të e para të kobës që pavarësisht nga tërësit e zakonshme e kanunet që sundonin në jetën e vendit tonë, u ngritët kundër padrejtësive dhe shfrytëzimit të gruas dhe u bashkëtangul me gruan shpirtërore. Në vitet e studimeve të Luftës Nacional-Libërimitare, duke u udhëhequr nga mësimit e Partisë, përkatsh shpove të tjera, ju kontribuat për

## LETËR DREJTUAR SHOQES OLLGA PLUMBI

Tiranë

10 nëntor 1978

E nderuara shoqja Ollgë,

Me rastin e 80-vjetorit të ditëlindjes suaj ju uroj nga zemra shëndet dhe jetë të gjatë.

Partia dhe unë personalisht kemi njohur e vlerësuar në personin tuaj një grua me ide përparimtare, që ka punuar aktivisht për emancipimin e gruas. Që në ditët e errëta të regjimit të urryer e obskurantist zogollian ju ishit ndër gratë e para të kohës që, pavarësisht nga terrori, zakonet e kanunet që sundonin në jetën e vendit tonë, u ngritët kundër padrejtësive dhe shtypjes mizore që ushtrohej mbi gruan shqiptare.

Në vitet e stuhishme të Luftës Nacionalçlirimtare, duke u udhëhequr nga mësimet e Partisë, përkrah shoqeve të tjera, ju kontribuuat për

krijimin e organizatës së Bashkimit të Grave të Shqipërisë dhe për aderimin e saj në Frontin Nacionalçlirimtar. Duke çmuar veprimtarinë tuaj të shquar përparimtare e patriotike, përfaqësuesit e popullit në Mbledhjen historike të Labinotit, Përmetit e Beratit, si dhe Kongresi i Parë i BGASH-it ju zgjodhën në organet e tyre të larta, ku ju keni punuar pa u lodhur në rrugën që tregonte Partia jonë Komuniste për çlirimin e gruas e të popullit dhe me dashuri e besnikëri për atdheun tonë socialist.

Edhe një herë, e respektuara, shoqja Ollgë, ju uroj jetë të gjatë e plot shëndet dhe gjithnjë gëzime në familjen tuaj.

22 nëntor 1978

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR SHOKUT  
MUHARREM BUTKA**

*Tiranë*

**25 nëntor 1978**

I dashur shoku Muharrem,

Letra jote më gëzoi shumë. Bashkë me përshëndetjet dhe urimet miqësore, ajo më nxiti të rikujtoj vitet e rinisë, ditët e stuhishme e heroike të Luftës Nacionalçlirimtare, të cilat i dhanë shkas e jetë miqësisë sonë të madhe komuniste. Kujtimet e së kaluarës më çuan në sokakët me kalldrëm, në malet e fushat kreshnike të Korçës sonë plakë, ku, krahas qindra e qindra patriotëve e shokëve të tjerë edhe ti personalisht dhe kontributin tënd për të sotmen e bukur të atdheut

socialist. Nuk ka gjë më të gëzueshme sesa të sjellësh ndër mend veprimtarinë revolucionare dhe djersën e derdhur krahas me gjithë popullin për lirinë e ndërtimin socialist të vendit, për të ardhmen e sigurt të brezave që do të vijnë pas nesh. Sot, si gjithë ata që luftuan e punuan me ndershmëri vite të tëra për ditët e lumtura që jetojmë, edhe ti, i dashur Muharrem, ke të drejtë ta ndiesh veten të gëzuar e krenar për atë që ke bërë.

Tash Shqipëria jonë e dashur, siç më shkruaje në letër, është bërë me të vërtetë zonjë e kryezonjë. Atë e bëri Partia një vend të përparuar e të paprekshëm që nderohet e respektohet në të katër anët e botës, pra shumë më të mirë sesa e ëndërronin të parët tanë, mëmëdhetarët e mençur e të guximshëm të dekadave të shkuara, midis të cilëve Plaku yt, patrioti e luftëtari i respektuar Sali Butka. Në Shqipërinë tonë zonjë, në Shqipërinë socialiste, mosha e kaluar, edhe pse ndonjëherë shoqërohet me pasoja të rënda shëndetësore, është e bardhë dhe pa brenga. Për jetën e lumtur e të gëzuar të njerëzve tanë mendojnë e punojnë vazhdimisht Partia dhe push-teti ynë popullor.

Duke përfunduar këtë letër të shkurtër, i dashuri shoku dhe miku im i vjetër, të uroj nga zemra shëndet, lumturi në familje, të rrosh edhe shumë e shumë vjet akoma dhe të kalosh pleqëri të gëzuar me të gjitha të mirat.

Për djalin dhashë urdhër që të vendoset sa më parë me punë këtu, në Tiranë, që të bashkëjetojë me ju. Shoqes tënde i bëj shumë të fala.

Të përqafoj

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË PATRIOTIT AVDI BAJRAMI**

*Bajram Curri*

**16 prill 1979**

Me hidhërim të madh mësova për lajmin e vdekjes së njeriut tuaj shumë të dashur, mikut tim të ngushtë, patriotit të njohur, Avdi Bajrami.

Përkrah heroit të maleve Bajram Curri, Avdiu ka luftuar me vetëmohim për mbrojtjen e tokave shqiptare nga synimet grabitqare të armiqve shekullorë të Shqipërisë. Kam pasur raste ta takoja e të bisedoja personalisht me të dhe më ka lënë mbresa të forta, sidomos kur më fliste me zjarr për luftën heroike të patriotëve të mëdhenj të Rilindjes sonë Kombëtare. Me respekt kujtoj ndjenjat e pastra dhe besimin që ai kishte në forcën e pamposhtur të popullit tonë të udhëhequr nga Partia, për të cilin thoshte me krenari se është i patundur si bjeshkët tona të larta.

Ju ngushëlloj nga zemra për humbjen e Avdiut. Jam i bindur se djemtë dhe bijat, nipërit dhe mbesat e tij, ashtu siç na mëson vazhdimisht Partia dhe siç e duan interesat e lartë të atdheut tonë socialist, do t'i çojnë gjithnjë më përpara traditat e atdhedashurisë e të patriotizmit të zjarrtë, bartës i denjë e i vendosur i të cilave ishte Avdiu.

TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGTAR  
FAMILJË PATRIOTIT AVDI BAKRAMI

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË MIHAL POPIT

Tiranë

19 shtator 1979

Bashkëshortes, vajzave e djemve

Mësova me hidhërim të thellë për vdekjen e bashkëshortit dhe prindit tuaj, Artistit të Popullit, shokut tonë komunist Mihal Popit. Mihali si artist ishte shumë i dashur nga masat e popullit tonë, besnik dhe luftëtar i zbatimit të vijës së drejtë të Partisë në fushën e artit e të kulturës sonë socialiste. Me gjithë zemër e me gjithë forcën e tij krijuese, gjatë gjithë veprimtarisë së tij dhjetërvjeçare, ai interpretoi role nga më të ndryshmet, paraqiti në skenë me aftësi të rrallë artistike personazhet pozitive dhe satirizoi rreptë e me realizëm ato negativet.

Figura e tij si artist i mrekullueshëm, si

njeri me ndjenja të pastra, si një nga themeluesit e Teatrit tonë Popullor dhe mësues i pasionuar i një brezi të tërë artistësh të rinj, do të mbetet e paharruar në historinë e artit shqiptar.

Ju paraqes ngushëllimet më të përzemërta për vdekjen e burrit dhe babait tuaj shumë të dashur e të respektuar.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR SHOKUT TODI GJERMENI**

*Tiranë*

**27 dhjetor 1979**

I dashur shoku Todi,

E mora letrën me urimet për 71-vjetorin e lindjes dhe të falënderoj nga zemra për ndjenjat e tua të pastra.

Së bashku me urimet më njoftove edhe mbi përfundimin me sukses të punës tënde dhjetëvjeçare kërkimore-shkencore në përmirësimin e llojit të rrushit «Kallmet», gjë që më gëzoi së tepërmi. Ky lloj rrushi me rendiment me të vërtetë për t'u lavdëruar, që u arrit me punën tënde të gjatë e të palodhur, në bashkëpunim të vazhdueshëm me punëtorët, mjeshtërit dhe specialistët e vreshtave të Shtojit, është një dhuratë e çmuar për popullin dhe në të njëjtën kohë një fitore për shkencën tonë bujqësore socialiste në vitin jubilar të 35-vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

Këto përpjekje të kurorëzuara me sukses, tregojnë se me studime, me besim e këmbëngulje revolucionare të punonjësve shkencorë, në bash-

këpunim të ngushtë me specialistët me arsim të lartë dhe me punëtorët e mjeshtërit me eksperiencë të madhe e të gjatë pune, në çdo fushë të prodhimit bujqësor, duke gërshetuar si duhet teorinë me praktikën, mund të ecet përpara, të krijohen lloje të reja bimësh me prodhimtari e cilësi të lartë, me cikël më të shkurtër pjekjeje, që t'u rezistojnë sëmundjeve të ndryshme dhe t'u përshtaten klimës e natyrës së vendit tonë.

Për suksesin e madh që arritët, ju dërgoj urimet e mia më të mira, ty dhe punëtorëve mjeshtër e specialistë të vreshtave, me të cilët ke bashkëpunuar ngushtë. Jam plotësisht i bindur se ti, i dashuri shoku Todi, si njeri me kulturë të gjerë profesionale, me vullnet të fortë dhe i pasionuar në mjeshtërinë e nderuar të agronomit, edhe pse ke dalë në pension, do të vazhdosh akoma të punosh me frymë revolucionare e me të gjitha forcat e tua për fitore të reja në fushën e vreshtarisë dhe të kontribuosh kështu në përparimin e mëtejshëm të vitikulturës së vendit tonë për të mirën e popullit të atdheut socialist dhe të Partisë sonë të lavdishme që na udhëheq.

Të përshëndes me dashuri.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR SHOKUT  
DHIMITËR DELIJORGJI**

*Gjirokastër*

**16 janar 1980**

I dashur shoku Dhimitër,

Më gëzoi letra, me të cilën më njoftoje se planin e 6-të pesëvjeçar e plotësove në dy vjet e dhjetë muaj, se ke bërë kursime në karburant e në goma dhe, duke realizuar brenda çdo pesëvjeçari dy plane, tani po punon për llogari të vitit 2001. Ky është një qëndrim sa patriotik, aq edhe revolucionar e komunist dhe shembull i lartë për vënien në jetë të direktivave dhe të mësimëve të Partisë. Prandaj të uroj nxehëtisht për punën shumë të vlefshme që ke kryer e që vazhdon të kryesh.

Partia te ju, shoferët, ka pasur dhe ka një-rën nga brigadat më aktive të të gjithë klasës

sonë punëtore heroike. Ju jeni nga punëtorët e palodhur në betejën e madhe të përditshme që bën populli ynë për ndërtimin e jetës së re, për kalimin e vështirësive që na krijojnë armiqtë e egër imperialistë e revizionistë të të gjitha ngjyrave. Nëpër asfalt e nëpër baltë, në kohë të mirë e në kohë të keqe, pa u tërhequr nga asnjë vështirësi e sakrificë, ju çani fushave e maleve për t'i çuar popullit dhe ekonomisë ato që u nevojiten çdo ditë. Ju jeni ndër të parët që shkoni atje ku ndërtohen vepra të mëdha; që u shkoni që në çastet e para në ndihmë vëllezërve e motrave në raste fatkeqësish të natyrës dhe u lehtësoni dhimbjet; ju, duke rrezikuar shpesh jetën, shpejtoni të arrini në kohë për të shpëtuar jetën e të tjerëve. Ju jeni edhe dëshmitarët më të mirë të atyre shndërrimeve të vrullshme që kanë bërë vendi dhe populli ynë gjatë këtyre 3-4 dekadave të fundit, nën udhëheqjen e Partisë. Dhe në tërë këtë proces zhvillimi revolucionar edhe ju, shoferët, keni pjesën e punës suaj të palodhur e të nderuar.

Populli dhe Partia juve ju kanë besuar mjetet e transportit automobilistik. Sa më mirë t'i mbani e të kujdeseni që t'ua zgjatni jetën dhe t'i shfrytëzoni ato, në mënyrë racionale, të efektshme dhe ekonomike, duke kursyer sa më shumë karburante e goma, aq më i madh do të jetë kontributi juaj në luftën që bën gjithë populli për ndërtimin socialist të vendit.

Me njerëz kaq patriotë, që punojnë me ndër-

gjegje të lartë socialiste për tejkalimin e planeve, për kursimin e mirëmbajtjen e automobilave, siç bën ti, i dashur Dhimitër, ne kurdoherë do të ecim vetëm përpara.

Edhe një herë të uroj me gjithë zemër për punën që ke bërë e për sukseset që ke arritur. Le të shërbejë shembulli yt pozitiv për të ngritur më lart tek të gjithë punonjësit e vendit ndjenjën fisnike të njeriut të pararojës që nuk kursen asgjë për t'i shërbyer me të gjitha forcat çështjes së përparimit e forcimit të atdheut tonë socialist. Përshëndetjet më të mira ty dhe familjes tënde!

Juaji me dashuri

*Enver Hoxha*

«Zëri i popullit», nr. 15 (1981),  
18 janar 1980

**LETËR DREJTUAR SHOKUT  
DHIMITËR SHUTERIQI**  
11 prill 1980

I dashur shoku Dhimitër,

Ende jo të gjitha thesaret e popullit tonë të lashtë e kanë parë dritën. Ato gjenden, diku në dokumente të shkruara, në libra, në shkresa diplomatike apo tregtare etj., diku të materializuara në piktura e në skulptura të gjithëllojshme, apo në vepra të artizanëve të mrekullueshëm të vendit e në folklorin tonë të pasur. Shumë prej tyre qëndrojnë të kyçura prej shekujsh nëpër sirtaret dhe raftet e arkivave e të bibliotekave të vendeve të tjera, sidomos të atyre me të cilat ka pasur të bëjë më shumë populli ynë gjatë historisë.

Kërkimet e tua, prej rreth 30 vjetësh, për lashtësinë e gjuhës së shkruar shqipe, siç më shkruan në letrën që më dërgove para disa di-

tësh, janë një punë e dobishme, një përpjekje e lavdërueshme për të nxjerrë në dritë diçka me vlerë nga ky thesar i paçmuar i popullit tonë. Zbulimi i gjurmëve të shkrimit më të hershëm të gjuhës sonë<sup>1</sup>, nga sa njihet deri tani, është një punë që të entuziazmon e të frymëzon për kërkime të tjera këmbëngulëse. Përveç të tjerave, ai shërben me argumente për të hedhur poshtë heshtjen, mohimet, gënjeshttrat e shpifjet e disa të vetëquajturve historianë apo shkencëtarë, shovinistë e reaksionarë, që janë përpjekur e përpiqen ta fshehin lashtësinë e shqiptarëve, të gjuhës, të kulturës e të vlerave të tjera të mëdha shpirtërore të paraardhësve tanë. Unë të përgëzoj për rezultatet që ke arritur në këtë fushë kërkimesh, qofshin këto akoma të pamjaftueshme, por që hapin rrugën dhe shpreh bindjen se do të bëhen zbulime të tjera me vlerë.

Babai juaj i nderuar, Simon Shuteriqi, ishte një nga mësuesit patriotë, që në kohën e vet ka kontribuar pa u lodhur për gjuhën shqipe. Edhe ti, duke ndjekur rrugën e tij, sigurisht në kohë e në kushte shumë më të favorshme që ka krijuar në vendin tonë Partia, përveç veprave si shkrimtar i afirmuar e publicist, ke kohë që po punon me durim edhe në fushën e historisë së gjuhës e të letërsisë. Në këtë drejtim ajo që ke bërë deri më sot për grumbullimin, për regjis-

---

1. Është fjala për gjurmë të shkrimit të shqipes nëpër burime të ndryshme para Buzukut.

trimin dhe për nxjerrjen në dritë të një fjalori me fjalë shqip<sup>1</sup>, të shkruara që nga viti 879, ka mjaft rëndësi.

Prandaj edhe një herë të përgëzoj për atë që ke bërë dhe shpreh bindjen se, ashtu si deri më sot, me të gjitha forcat do t'i vazhdosh kërkimet në drejtim të pasurimit të mëtejshëm të këtij fjalori.

Të përshëndes

Yti

*Enver Hoxha*

«Për shkencën (Përmbledhje  
veprash)», vëll. II, f. 324

---

1. Ky fjalor është botuar në disa numra të revistës «Studime filologjike», në vitet 1981-1983.

**TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR  
FAMILJES SË PASHAKO REXHEPIT**

*Pirg-Korçë*

**10 maj 1980**

Djalit, mbesave, nipit,

Me hidhërim të madh mësova për vdekjen e nënës e gjyshes suaj trimëreshë, nënë Pashakos. Për mua do të mbeten të pashlyeshme në kujtesë takimet me të, gjatë të cilave njoha tek ajo një grua patriote, me zemër të madhe e besnike të Partisë, që vazhdimisht punoi pa u lodhur për të brumosur te familiarët e tek të gjithë ata që e njihnin ndjenjat e atdhedashurisë, të lirisë e të sakrificës për çështjen e popullit e të atdheut. Me jetën e saj të pastër, të ndershme, luftarake, sa që gjallë, vetitë e larta të gruas shqiptare, me të cilat që pajisur, i vuri në shërbim të çështjes së Partisë. Ajo kurrë nuk u për-

kul as përpara dhimbjeve të rënda që i shkaktoi vdekja e djemve, as përballë përpjekjeve të armiqve për ta mposhtur, prandaj do të mbetet e paharruar për të gjithë.

I dërgoj me këtë rast gjithë familjes suaj ngushëllimet e mia më të përzemërta.

Juaji

*Enver Hoxha*

Pirg-12000

10 maj 1980

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

Djalit, mësove, njiqit.

Me hidhërim të madh mësova për vdekjen e moshës e gjyshes suaj trimëreshë, nënë Pashas. Kështu për mua do të mbetet të pashlyeshme në kujtesë takimet me të, gjatë të cilave njoha tek ajo një grua patriotke, me zemër të madhe e besnikë të Partisë, që vazhdimisht punoi për ndërtimin dhe për të promovuar të famillizet e tek të gjithë ata që e njihnin ndjenjat e atdhebashmërisë të lirisë dhe të sakrificës për çështjen e popullit e të atdheut. Me jetën e saj të pastër të ndershme luftuarke, sa pe gjallë, vetitë e larta të gruas shpirtore, me të cilat de pajisur, i vuri në shërbim të çështjes së Partisë. Ajo kurse nuk u për-

## TELEGRAM DËRGUAR PRESIDIUMIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE

14 gusht 1980

Vdekja e parakohshme bëri që të ndahet nga gjiri juaj njëri nga përfaqësuesit më në zë të shkencës, të kulturës dhe të arsimit tonë kombëtar, anëtari i presidiumit, profesor Eqrem Çabej. Me vdekjen e tij shkenca humbi një njeri me aftësi të rralla krijuese, që gjithë dijen e tij e vuri në shërbim të popullit e të atdheut socialist.

Me rastin e kësaj ngjarjeje të hidhur ju dërgoj juve ngushëllimet e mia të thella.

Profesor Eqrem Çabej punoi pa u lodhur e me pasion të madh për zhvillimin dhe përpërimin e shkencës së gjuhësisë shqiptare dhe të arsimit tonë popullor. Veprimtaria e tij kërkimore-shkencore, sidomos mbi origjinën e gjuhës shqipe e mbi gjenezën e popullit shqiptar, është e pasur dhe e gjithanshme. Ajo ka rëndësi kom-

bëtare e ndërkombëtare. Me kompetencë ai ka dhënë një kontribut të çmuar në argumentimin e origjinalitetit të gjuhës shqipe, të autoktonisë së popullit shqiptar në trojet e sotme.

Vepra e profesor Çabejt në fushën e gjuhësisë mbetet një thesar i vyer në duart e studiuesve e të shkencëtarëve të sotëm e të ardhshëm të vendit tonë.

*Enver Hoxha*

«Për shkencën (Përmbledhje  
veprash)», vëll. II, f. 375

**LETËR DREJTUAR PUNONJËSVE TË  
HIDROCENTRALIT «DRITA E PARTISË»  
NË FIERZË**

**4 dhjetor 1980**

Të dashur shokë të ndërtimit dhe të shfrytëzimit të hidrocentralit «Drita e Partisë»,

Në letrën që më dërguat, ju keni përmbledhur punën e luftën tuaj të madhe e heroike, vendosmërinë për të përballuar vështirësitë e mëdha natyrore, acarin, suferinat e rrebeshet e kohës, përgatitjen e aftësitë tuaja teknike e shkencore për ngritjen e hidrocentralit «Drita e Partisë», vepër që i ka shoquet të rralla në Evropë. Ju, të dashur shokë, u vutë gjokset tuaja të hekurta të gjitha vështirësive, si dhe veprimtarisë sabotuese të revizionistëve kinezë, treguat guxim e pjekuri të lartë politike dhe dolët fitimtarë, duke i shtuar maleve të Tropojës sonë kreshnike një «mal» të ri që po i jep dritë dhe

energji atdheut tonë socialist. Puna juaj e palodhur ndërtimore është shprehje e dashurisë suaj të pakufishme për popullin e atdheun dhe fryt i frymëzimit nga vija e drejtë e Partisë. Në emër të të gjithë Partisë dhe të Komitetit të saj Qendror ju përgëzoj për përfundimin e ndërtimit me sukses të hidrocentralit dhe ju uroj fitore edhe në ndërtimin e veprës tjetër madhështore, Hidrocentralit të Komanit, që po ndërtohet mbi Drinin plak.

Edhe ne, shokë, ju njoftojmë me kënaqësi se, me vënien në shfrytëzim të hidrocentralit që ndërtuat ju, me zbulimin e fushave të reja të naftës e të gazit nga bashkëluftëtarët tuaj naf-tëtarë dhe me konkretizimin e vendburimeve të reja të qymyrgurit, u tejkaluan detyrat e cak-tuara nga Kongresi i 7-të i Partisë dhe po fute-mi në planin e shtatë pesëvjeçar me burime energjetike të mjaftueshme për të përballuar ne-vojat që do të ketë zhvillimi ynë ekonomik.

Kjo është një fitore e madhe e politikës së drejtë ekonomike të Partisë, e zbatimit me kon-sekuencë të parimit revolucionar të mbështetjes plotësisht në forcat tona, fitore që është arritur me luftë të ashpër kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, të cilët, për qëllimet e tyre anti-socialiste e antishqiptare, gjithnjë kanë fshehur burimet tona energjetike dhe janë përpjekur të sabotonin me të gjitha mënyrat zhvillimin e tyre. Partia, e udhëhequr nga mësimet e marksizëm-leninizmit, i ka kushtuar dhe i kushton vëmen-

dje të posaçme zhvillimit të energjetikës, si pararojë e zhvillimit të degëve të tjera të ekonomisë. Politika e drejtë e Partisë në këtë fushë është faktori kryesor që Shqipëria jonë socialiste indien më pak se çdo vend tjetër ndikimet negative të krizës energjetike që ka mbërthyer sot mbarë botën kapitaliste e revizioniste. Kjo krizë ka çuar edhe në kriza politike dhe ushtarake, që janë shoqëruar me grushte shteti e rrëzime qeverish, me korrupsion qeveritarësh deri në nivelet më të larta, si dhe me ndërhyrje ushtarake në vende të ndryshme të botës e sidomos në ato naftëprodhuese. Kjo krizë i ka thelluar e vazhdon t'i thellojë gjithnjë e më shumë kontradiktat midis superfuqive dhe vendeve të tjera kapitaliste e revizioniste me vendet prodhuese të naftës, ka acaruar luftën e hapët dhe të mbyllur për rindarjen e zonave me burime të mëdha energjetike. Në të njëjtën kohë, kriza energjetike ka thelluar akoma më tepër nënshtrimin e shteteve satelite e vasale të Evropës Lindore ndaj padronit të tyre, socialimperializmit sovjetik që mban në dorë rubinetin energjetik dhe e hap ose e mbyll atë sipas interesave të vet. Në botën kapitaliste e revizioniste pasojat e krizës energjetike, si të çdo krize tjetër, bien kurdoherë mbi masat punonjëse e, në radhë të parë, ato bëhen shkak për lënien e miliona punëtorëve pa punë e pa mjete jetese.

Pikërisht në këto situata të rënda krize atdheu ynë socialist, si në çdo drejtim, edhe në bu-

rimet energjetike nuk varet nga askush. Ne i kemi në duart tona këto burime dhe i përdorim vetëm për interesat e popullit shqiptar. Prandaj është detyra e Partisë, e të gjithë atyre që merren me ndërtimin e veprave të ndryshme për shfrytëzimin e burimeve tona energjetike, siç jeni ju, e atyre që merren me prodhimin dhe përdorimin e të gjitha burimeve e llojeve të energjisë, që nga nafta dhe energjia elektrike e deri te qymyret, t'i përdorin ato me llogari e me ekonomi, me synimin që të marrim sa më shumë prodhime me sa më pak harxhim energjie. Në këtë drejtim ka se çfarë të rishikojë çdo sektor i ekonomisë sonë për të kursyer çdo vat energji elektrike, çdo gram naftë e qymyr. Kjo, sigurisht, kërkon përmirësimin e mëtejshëm të teknologjisë, modifikime e përmirësime në makineri, përshtatje e përputhje sa më mirë të fuqisë që harxhohet me energjinë që kërkon në fakt prodhimi.

Njerëzit tanë, duke u mbështetur në forcat dhe në aftësitë e tyre profesionale, janë të aftë t'i bëjnë këto. Faktet tregojnë se punëtorët e specialistët tanë në këtë drejtim kanë bërë gjëra shumë të mira. Megjithëkëtë, Partia duhet të rrënjosë thellë në ndërgjegjen e çdo punonjësi ndjenjën e kursimit të energjisë kudo, në çdo ndërmarrje, në lagje, në fshat, në çdo familje, që kjo pasuri e madhe që disponohet, kjo nyjë e rëndësishme e ekonomisë sonë, në çdo hallkë e qelizë të saj, të hapet e të mbyllet «me kandar

në brez», siç thotë populli. Kështu do të kemi më shumë energji për të plotësuar gjithnjë më mirë kërkesat e zhvillimit ekonomik në rritje të vazhdueshme, për shtimin e mallrave që i nevojiten vendit dhe për eksport. Burimet energjetike asnjëherë nuk janë të tepërta, prandaj ato në asnjë rast nuk duhen përdorur pa rregull, pa ekonomi.

Të dashur shokë,

Për ndërtimin e veprave energjetike Partia dhe pushteti ynë popullor, siç e dini, kanë bërë investime kolosale dhe sot këto investime po japin fryte në dobi të përparimit e të ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Është detyra e punonjësve që punojnë në këto vepra që t'i shfrytëzojnë ato me aftësi të plotë, me rentabilitet të lartë, që energjia e prodhuar prej tyre të jetë me kosto sa më të ulët. Për këtë qëllim në hidrocentralet duhet të luftohet për një përpunim shkencor të ujërave gjatë gjithë vitit, për një shfrytëzim më racional të makinerive, për ngritjen e mëtejshme të nivelit ideopolitik e profesional të punonjësve të shfrytëzimit në këto vepra.

Ju më raportoni se në Hidrocentralin e Fierzës janë kualifikuar me mijëra veta. Kjo është një punë shumë e madhe dhe garanci për ndërtimin e hidrocentraleve të tjera më shpejt dhe me cilësi të mirë. Por asnjëherë nuk duhet të kënaqemi me nivelin e kualifikimit që kemi arritur.

Çdo punonjës, kudo që është caktuar, në sektorët e ndryshëm të jetës së vendit duhet të punojë me këmbëngulje në format ekzistuese kolektive apo individualisht, që të rritë më tej kualifikimin. Vetëm me ndërgjegje socialiste dhe me kualifikim të lartë mund të prodhohet me cilësi të lartë, me shpejtësi dhe me ekonomi. Partia si gjithnjë ka besim se kualifikimit të punonjësve në të gjithë sektorët e ekonomisë, do t'i vihet edhe më shumë rëndësi në të ardhmen.

Atdheu dhe Partia kanë besim të plotë se ju, si kurdoherë, me komunistët në ballë, të frymëzuar nga shembulli i punonjësve të dalluar e të përparuar, edhe në ndërtimin e veprës së re në Koman, do të mobilizoni të gjitha dijejtë dhe përvojën e fituar, të gjitha forcat e mjetet për ta realizuar atë para afateve dhe me cilësi të lartë.

Ju uroj me këtë rast nga zemra suksese të reja gjatë vitit 1981, vitit të parë të pesëvjeçarit të ri, vitit të jubileut të madh të 40-vjetorit të Themelimit të Partisë dhe të Kongresit të saj të 8-të.

Juaji

*Enver Hoxha*

«Zëri i popullit», nr. 291 (10 091),

5 dhjetor 1980

**LETËR DREJTUAR SHOKUT  
STERJO SPASSE**

*Tiranë*

**30 dhjetor 1980**

I dashuri shoku Sterjo,

Mora serinë prej tetë vëllimesh të veprave të tua, si dhe urimet e përzemërta që më dërgon me rastin e Vitit të Ri. Të falënderoj si për librat, ashtu edhe për urimet.

Gjithë krijimtarinë tënde letrare ti, shoku Sterjo, ia ke kushtuar vuajtjeve e luftërave të gjata e kreshnike të popullit tonë trim e heroik për çlirim kombëtar e shoqëror, për mbrojtjen e nderit, të zakoneve e të besës që e ka karakterizuar kurdoherë shqiptarin. Si e tillë ajo i ka shërbyer jo vetëm ngritjes në art dhe pavdekësisë së këtyre luftërave e përpjekjeve shekullore, por edhe edukimit të brezit të ri me frymë patriotike e devotshmëri ndaj atdheut.

Unë të uroj që, ashtu si deri tani, të vazh-  
dosh të krijosh vepra të reja, të denja për epokën  
tonë të lavdishme, me partishmëri proletare e që  
të përjetësojnë historinë e lashtë, të re dhe atë të  
tanishme të Shqipërisë sonë të dashur, luftën dhe  
punën e popullit tonë për ndërtimin dhe mbroj-  
tjen e socializmit.

Të dërgoj me këtë rast urimet e mia më të  
mira për Vitin e Ri 1981.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR SHOKUT RIZA VEIPI**

*Gjirokastër*

**20 janar 1981**

I dashur shoku Riza,

Para disa ditësh ti festove 80-vjetorin e ditëlindjes, ngjarje e rëndësishme dhe e gëzuar kjo për familjen tënde, për të afërmit e shokët e tu.

Jeta jote ka qenë kurdoherë në shërbim të popullit e të atdheut. Dhe nuk ka lumturi më të madhe sesa të luftosh e të punosh kurdoherë për çështjen e tyre. Që në rininë tënde të hershme ti ia kushtove jetën lirisë e pavarësisë së Shqipërisë. Më 1920 rrëmbeve pushkën dhe përkrah patriotëve të tjerë luftove me trimëri kundër pushtuesve italianë që nuk donin të shkuleshin nga një pjesë e rëndësishme e trojeve tona. Gjatë Luftës së madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare ti përsëri nga të parët dole malit për liri dhe, nën udhëheqjen e Partisë, çukë më çukë e gërxxh më gërxxh, u përleshe me trimëri me pushtuesit

nazifashistë dhe me tradhtarët e vendit. Edhe kur u plagose, ti nuk u tërhoqe nga fronti i betejës e i burrërisë. Vija e parë e luftës mbeti vazhdimisht vendi yt i nderit deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Pas Çlirimit dhe sot, megjithëse vitet të rëndojnë mbi supet, si aktivist e propagandist i flaktë i vijës së Partisë, ti vazhdon pa u lodhur të edukosh njerëzit me dashurinë për atdheun, punën për ndërtimin e socializmit që të jenë kurdoherë vigjilentë e në mbrojtje të fitoreve të arritura. Njerëzit e Partisë, bashkëfshatarët, rinia, pionierët, që të kanë pranë e të dëgjojnë me respekt, përfitojnë nga këshillat dhe vërejtjet e tua të mençura e dashamirëse.

Veprimtaria konsekuente revolucionare, patriotizmi, besnikëria dhe dashuria ndaj popullit, atdheut e Partisë janë cilësi të çmuara që e karakterizojnë njeriun tonë të ri dhe e bëjnë të nderuar e të respektuar. Kështu je sot ti, xha Riza, siç janë edhe gjithë shokët e tu të Luftës së 1920-ës, të Luftës së madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare e të ndërtimit socialist, shembull për edukimin e brezit të ri me ndjenjat e pastra të dashurisë për punën e për atdheun.

I dashur Riza,

Gëzohem shumë që je mirë dhe uroj të jesh i fortë kurdoherë, ashtu siç të njohim prej kohësh, që ta gëzosh atdheun, të cilin po e lulëzon

e po e çelikos çdo vit e më shumë populli dhe Partia, ashtu siç e ke ëndërruar tërë jetën, të lirë, të begatshëm, me shkolla kudo e kulturë massive, kala të pamposhtur, me njerëz të lumtur që punojnë, mësojnë dhe gjithmonë vigjilojnë.

Me rastin e 80-vjetorit të lindjes bashkohem me gëzimin tënd edhe të familjes dhe të dërgoj urimet më të mira e revolucionare. Jetë të gjatë e të lumtur.

Të përqafoj

Yti

Enver

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR NGUSHËLLIMI DREJTUAR  
FAMILJES SË SHOKUT SPIRO MOISIU**

*Tiranë*

**13 prill 1981**

E dashur motër Aspasi

Të dashur Jolanda, Alfred dhe Arqile,

Lajmi i vdekjes së bashkëshortit dhe prindit tuaj aq shumë të dashur për ju, si edhe për mua, që e kisha shok nga më të ngushtët e bashkëluftëtar të vjetër, shokut Spiro, më preku thellë. Në këto çaste të rënda për të gjithë ne, ju dërgoj ngushëllimet e mia më të ngrohta.

Shoku ynë i dashur Spiro, i brumosur me ndjenjat e patriotizmit të zjarrtë të prindërve e të familjes së tij, gjatë tërë jetës nuk ka kursyer asgjë për popullin e për atdheun. Gjatë Luftës së lavdishme Antifashiste Nacionalçlirimtare, me të cilën u lidh shpejt, në postin me përgjegjësi

të madhe ushtarake, ku e caktoi Partia, në Shtabin e Përgjithshëm, me të gjitha forcat e dijet e tij, si një nga bijtë e saj më të vendosur, ai punoi e luftoi me besnikëri, aftësi e frymë të lartë revolucionare. Shoku Spiro njihet si një komandant i shquar në betejat e fitoret që korri Ushtria jonë Partizane Nacionalçlirimtare në luftën kundër pushtuesve nazifashistë e tradhtarëve të vendit. Kontribut të rëndësishëm ka dhënë ai edhe pas Çlirimit, si anëtar besnik i Partisë që ishte, për forcimin e pushtetit popullor, si dhe ndërtimin e modernizimin e ushtrisë sonë.

Spiroja ishte i dashur e i lidhur ngushtë me masat e popullit tek të cilat frymëzohej e i frymëzonte me urtësinë që e karakterizonte, me gjuhën e tij të partishme, të ngrohtë e të shtruar. Kushdo që e njohu e punoi me të, e deshi dhe e nderoi si njeriun, si vëllanë e birin e vet. Të tillë e njoha edhe unë atë që gjatë kohës së Luftës Nacionalçlirimtare, kurdoherë optimist e sypatrembur, shok të ngushtë e të sakrificës për çështjen e popullit e të Partisë. Lufta na miqësoi e na lidhi ngushtë me të në rrugën që na udhëheq Partia, ajo na bëri të ndanim së toku edhe kafshatën e gojës. Atij asnjëherë nuk iu lëkund besimi në fitoren e popullit, në vijën e drejtë të Partisë, asnjëherë nuk iu nda Partisë, të cilën e donte dhe i qëndroi besnik deri në fund të jetës. Unë ruaj për të kujtime të paharruara.

Lufta dhe jeta e shokut të dashur Spiro Moisiu, besnikëria e tij e patundur ndaj Par-

tisë, trimëria, guximi dhe dashuria ndaj popullit kanë qenë dhe do të mbeten shembull për gjithë punonjësit tanë, për çdo ushtar e kuadër të Ushtrisë sonë Popullore, për gjithë rininë tonë heroike.

Të dashur Aspasi, Jolanda, Alfred dhe Arqile,

Janë çaste të rënda këto kur po ndahemi nga njeriu i shtrenjtë i familjes suaj, nga shoku, miku e bashkëluftëtari ynë i vjetër. Dhimbja që na shkaktoi vdekja e tij është e madhe, për ju dhe për ne, por ne do ta kthejmë atë, siç na mëson Partia, në forcë për t'i shërbyer si kurdoherë akoma më mirë popullit, ndërtimit të socializmit dhe mbrojtjes së atdheut, për të cilat ai luftoi e punoi me konsekuencë. Jeta dhe vepra e tij do të mbeten të paharruara.

Ju përqafoj me dashuri

Juaji

Enver

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**TELEGRAM DËRGUAR SHOKUT  
PANDI RAIDHI**

*Korçë*

**13 prill 1981**

I dashur shoku Pandi,

Me ndjenja të veçanta gëzimi, ty dhe pjesëtarëve të familjes ju dërgoj urimet më të mira për 60-vjetorin e lindjes tënde. Ashtu siç thotë populli ynë: edhe njëqind të tjera për të mirën e atdheut e të Partisë, për lulëzimin e mëtejshëm të artit tonë socialist.

Ti, shoku Pandi, me interpretimin e bukur shumë komunikues, origjinal, të thjeshtë, por plot art të vërtetë të shumë roleve e sidomos të fshatarit tonë trim e fisnik, je bërë i njohur dhe ke hyrë në zemrat e të gjithë spektatorëve tanë. Në të njëjtën kohë me punën e palodhur e plot entuziazëm revolucionar, ashtu siç i mëson Par-

tia jonë punonjësit e artit, një nga përfaqësuesit më të mirë të të cilit je, ti je bërë edukator she-mbullor edhe i brezit të ri të artistëve të skenës, të teatrit, të ekranit kinematografik dhe atij te-leviziv të vendit tonë. Për këtë arsye të gjithë ata, ashtu si të gjithë njerëzit tanë artdashës, të duan e të respektojnë.

Dëshiroj të kesh edhe paskëtaj jetë të begat-shme në krijimtari dhe ta mbash si kurdoherë me nder e dinjitet titullin e lartë «Artist i Popu-llit». Të uroj nga zemra shëndet të plotë e gëzime familjare.

13 prill 1981

Yti

Enver

I dashur shoku Pandi,

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR SHOKUT MIHA LAKO

Korçë

31 maj 1981

I dashur shoku Miha,

Unë thujse u befasova këto ditë kur shokët më thanë se më 1 qershor ti mbush 80 vjeç. «Nuk është e mundur, thashë, shokun Miha Lako ne e kemi pasur dhe e kemi kurdoherë të ri, ai është, e shumta, tek të 40-at».

Natyrisht shokët kishin të drejtë në atë që më thanë, por as unë nuk jam i gabuar në përshtypjen time, për arsye se gjithmonë të kam pasur e të kam parasysh si komunist dhe, dihet, komunistët s'njohin plakje, ata i sfidojnë vitet, komunistët janë rinia e të gjitha kohëve. I tillë ke qenë e do të mbetesh përherë edhe ti, militanti i orëve të para i lëvizjes sonë komuniste.

Kohët e fundit, i dashuri Miha, përgatita e dhashë për shtyp kujtimet e mia<sup>1</sup> për ato vite të paharruara kur ne, bijtë dhe bijat e këtij populli, themeluam e kalitëm Partinë tonë të dashur, udhëheqësen tonë të sprovuar, së cilës sivjet do t'i festojmë me madhështi 40-vjetorin e lindjes. Duke rijetuar luftën dhe përpjekjet vigane të atyre viteve, kuptohet, jetova gjatë edhe me ty, organizatorin dhe drejtuesin e të parit grup komunist në Shqipëri, shokun dhe bashkëluftëtarin e të paharruarit Ali Kelmendi, propagandistin dhe përhapësin e ideve komuniste në punëtorët dhe masat e gjera të popullit.

Unë që tek ti e te shokët e tu proletarë të Korçës gjeta, që në moshë të re, mësuesit e mi të parë të çështjes së madhe të komunizmit, kurrë nuk do t'i harroj virtytet e tua të rralla si komunist i vendosur e konsekuent, nuk do të harroj bashkëpunimin tonë të ngushtë për zgjerimin dhe forcimin e lëvizjes komuniste, luftën dhe përpjekjet e gjithanshme për themelimin e Partisë sonë e, më pas, për vënien në jetë të vijës së saj marksiste-leniniste.

I dashuri Miha, jeta dhe lufta jote prej komunisti, militanti revolucionar e marksist-leninisti të paepur, guximi, thjeshtësia dhe urtësia në gjykime kanë qenë e mbeten një shembull i lartë frymëzimi e edukimi për gjithë anëtarët e Partisë, për rininë e mbarë masat tona punonjëse.

---

1. Është fjala për librin «Kur lindi Partia» — Kujtime.

Këto virtyte që të kanë karakterizuar në gjithë veprimtarinë tënde prej më se gjysmë shekulli si komunist i paepur, të karakterizojnë ty edhe tani, prandaj për mua ke qenë e mbetesh gjithmonë i ri, miku, shoku dhe bashkëluftëtari im i vlefshëm.

Le të shënojnë, pra, dokumentet se ti mbushë 80 vjeç, vitet le të bëjnë të tyren, ne, komunistët, do të bëjmë tonën. Do të mbetemi e do të luftojmë gjithmonë të rinj, sepse e re është Partia jonë e lavdishme, e re është vepra e saj kosolale, i ri është socializmi që mbrojmë e forcojmë në Shqipërinë tonë të shtrenjtë.

Prandaj, i dashuri Miha, duke të uruar 80-vjetorin e lindjes, me gjithë zemër uroj të jetosh edhe 100 vjet, për të mirën e familjes tënde të nderuar, për të mirën e popullit, të atdheut e të Partisë, për gëzimin e të gjithë neve, shokëve e bashkëluftëtarëve të tu që aq shumë të duam e të respektojmë.

Të përqafoj

Yti

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË SHOKUT QIRJAKO HARITO**

*Tiranë*

**18 qershor 1981**

Jam prekur thellë nga vdekja e shokut tonë të dashur të luftës dhe të ndërtimit të socializmit, birit besnik të popullit tonë, që gjithë jetën nuk kurseu asgjë për çështjen e tij të madhe. E kam njohur bashkëshortin, prindin dhe shokun tonë të dashur në ato vite të stuhishme kur populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, luftonte për jetë a vdekje me okupatorët nazifashistë e tradhtarët e atdheut. Qirjakoja si një patriot i zjarrtë dhe që e çmonte më shumë se çdo gjë çështjen e madhe të lirisë, me besim të patundur te Partia u hodh pa rezerva në Luftën Nacionalçlirimtare. Për kontributin dhe meritat e tij pas Çlirimit, populli e zgjodhi në shumë legjislatura de-

putet në Kuvendin Popullor dhe ky e nderoi duke e zgjedhur edhe anëtar të Presidiumit të këtij organi të lartë, ku në këto detyra të larta dhe në çdo vend tjetër shërbeu me besnikëri me të tëra forcat dhe aftësitë e tij.

Në këtë dhimbje të madhe të familjes suaj e ndiej veten pranë jush dhe ju dërgoj me këtë rast ngushëllimet e mia më të përzemërta.

LETËR DREJTUAR KRYSISË  
SË KOOPERATIVËS SË TIPIT  
"PËR ARTË PËLASE"

*Enver Hoxha*

Korçë

10 gusht 1981

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

putet në Kuvendin Popullor dhe ky e ndërtoi du-  
ke e zgjedhur edhe anëtar të Presidiumit të kë-  
tij organit të lartë, ku në këto detyra të larta dhe  
në çdo vend tjetër shërbeu me besnikëri me të  
tëra forcat dhe aftësitë e tij.  
Në këtë dhimbje të madhe të familjes suaj  
e ndiej veten pranë juaj dhe ju bërtos me këtë  
rast ngushëllimet e mia me të për zemërat.

## **LETËR DREJTUAR KRYESISË SË KOOPERATIVËS SË TIPIT TË LARTË PLASË<sup>1</sup>**

*Korçë*

**10 gusht 1981**

Të dashur kooperativistë e kooperativiste,  
agronomë e specialistë të tjerë të bujqësisë, bri-  
gadierë e drejtues të Kooperativës së Tipit të  
Lartë të Plasës,

E mora letrën tuaj me të cilën më vinit në  
dijeni se përfunduat me sukses fushatën e korr-  
je-shirjes së grurit dhe se në të gjithë sipërfaqen  
prej 810 hektarësh keni marrë 50 kuintalë për  
hektar. Kjo arritje dhe rendimentet e larta e të

---

1. Për të përjetësuar emrin dhe Veprën e shokut  
Enver Hoxha Plenumi i 11-të i KQ të PPSH vendosi që  
Ndërmarrja Bujqësore me qendër në Plasë të rrethit të Kor-  
çës, të marrë emrin ndërmarrja bujqësore «Enver Hoxha».

qëndrueshme që keni siguruar edhe në kulturat e tjera, si panxharsheqeri, patate etj. më gëzuan pa masë. Ju lumtë të gjithëve! Këto fitore janë të lidhura me vijën e udhëheqjen e drejtë të Partisë për zhvillimin e ekonomisë në përgjithësi e të bujqësisë në veçanti, ato janë fryt i ngritjes suaj politike e ideologjike, i organizimit të mirë të punës, i zbatimit të shkencës dhe agroteknikës, i eksperiencës suaj që po e zbatoni për vite me radhë në fushën e përqendrimit, specializimit dhe qarkullimit bujqësor. Partia ka besim se shebullin tuaj do ta ndjekin jo vetëm kooperativat e Korçës, por gjithë ekonomitë bujqësore të vendit.

Mua dhe mbarë popullin na kanë kënaqur gjithashtu edhe njoftimet se rrethi i Fierit e tejkaloj planin e prodhimit të grurit në 40 000 kuintalë, ai i Beratit në 25 000 kuintalë etj. Këto lajme të gëzueshme tregojnë se në kuadrin e 40-vjetorit të krijimit të Partisë sonë të dashur dhe të Kongresit të 8-të të saj po punohet me emulacion për arritje sa më të mëdha.

Të dashur shokë dhe shoqe kooperativistë të Plasës,

Ju i keni të gjitha çfarë ju duhet për të ecur akoma më përpara dhe për t'i rritur rezultatet. Ju keni një organizatë partie të gjallë, me bindje të qarta për të ardhmen. Ju keni treguar

se jeni njerëz punëtorë e me vullnet, prandaj kemi bindjen se kooperativa juaj do të jetë gjithmonë në pararojë të ekonomive bujqësore të vendit.

Edhe një herë ju përhëndes dhe ju dërgoj urimet e mia më të përzemërta. Dalshi faqebardhë!

Juaji

*Enver Hoxha*

«Zëri i popullit», nr. 190 (10 303),  
11 gusht 1981

shpirtit e natyrës dhe nuk janë në gjendje t'i përfundojnë ato. Në rikujtove dhe në shprehjet e tyre, ata shprehin një dëshirë të fortë për të bërë popullin të qytetarëve të vërtetë dhe të drejtë të pavarësisht nga kushtet e kohës.

Këto janë të tjerët që kanë pasqyruar në mënyrë të saktë dhe të sinqerë gjendjen e popullit dhe të vendit në të kaluarën dhe në të ardhmen. Ata janë të tjerët që kanë bërë kontribut të vyer në luftën për liri dhe për bashkimin e popullit dhe të vendit.

## **LETËR DREJTUAR SHOQES MALLAMA SAMARA**

Korçë

7 shtator 1981

Partia ju ka gjithnjë në mendje e në zemër. Nëna ime të trimave partizanë e partizane, Shumë e dashur nënë Mallama, për dhanë tërë zemrën dhe tërë fuqinë tuaj për të edukuar ata me ndjenjat dhe për të bërë popullin tonë të edukuar dhe të ndjeshëm.

Mora letren tënde plot ndjenja të pastra të një nëne patriotike e revolucionare. Ajo më gëzoi shumë, por edhe më mallëngjeu, se në këto ditë gëzimi të përbashkët për të gjithë popullin, në pragun e 40-vjetorit të krijimit të Partisë sonë të lavdishme dhe Kongresit të saj të 8-të, më sollli ndër mend kohët e paharruara e plot heroizëm të Luftës Nacionalçlirimtare, kur qindra e mijëra bij e bija të nënave shqiptare, duke iu përgjigjur thirrjes së Partisë e zërit të atdheut, dolën malit dhe luftuan për çlirimin e vendit të robëruar. Gjaku i tyre përbën sot themelitet prej graniti të Shqipërisë së re, që nuk i brejnë dot as

stuhitë e natyrës dhe nuk janë në gjendje t'i pri-  
shin as armiqtë e egër. Më rikujtove djemtë e  
vëllezërit e tu trima që, si gjithë dëshmorët e  
tjerë, populli i quan me të drejtë të pavdek-  
shëm.

Kiçon<sup>1</sup> tënd unë e kam pasë njohur, se e ki-  
sha në Lice një nga nxënësit e mi më të mirë dhe  
e kam dashur shumë, prandaj nuk do ta harroj  
asnjëherë si një të ri revolucionar dhe si parti-  
zan. Fytyrën e tij djaloshare e ruaj të pashlyer  
në kujtesën time.

E dashur nënë Mallama,

Partia ju ka gjithnjë në mendje e në zemër  
ju, nëna trime të trimave partizanë e partizane  
që dhanë jetën për ditët e sotme të lumtura për  
popullin tonë. Ju i edukuat ata me ndjenjat fis-  
nike tradicionale të patriotizmit, të dashurisë për  
popullin, për drejtësinë shoqërore, për lirinë e  
vërtetë. Ju, me fjalët tuaja të zjarrta, duke vënë  
në jetë mësimet e Partisë dhe amanetin e të rë-  
nëve, vazhdoni përsëri sot të edukoni brezin e ri,  
nipërit e stërnipërit tuaj, me të njëjtën frymë  
atdhedashurie e patriotizmi revolucionar. Për kë-  
të meritoni përgëzimin e mbarë popullit, dashu-  
rinë dhe respektin më të madh të rinisë sonë he-  
roike.

---

1. Kiço Samara — dëshmor i Luftës Antifashiste Nacio-  
nalçlirimtare.

Të falënderoj nga zemra për përshëndetjet dhe urimet që më dërgoje. Edhe unë të përshëndes, të uroj shëndet, gëzime në gjirin e familjes tënde të nderuar. Uroj të jetosh sa më shumë për ta parë Shqipërinë akoma më të bukur e më të begatshme, ashtu si ta do zemra.

Të përqafoj si biri yt me mall e dashuri.

LETËR DREJTUAR SHOKUT  
ALEKS BUDA  
*Enver Hoxha*

8 shtator 1981

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

I dashur shoku Aleks,

Në këto çaste të gëzueshme për ju, bashkohem me pjesëtarët e familjes suaj, të shokëve të punës e të nxënësve tuaj të shumtë në të kalët angj e atdheut për t'ju dërguar urimet e mia më të mira e më të përzemërta me rastin e 70-vjetorit të lindjes dhe të dekorimit të merituar me "Urdhrit e Flamurit".

Populli dhe Partia kanë te ju, shoku Aleks, një shkencëtar të talentuar me horizont të gjerë, një lërvues të thellë e të shpurë të historisë shpirtërore të popullit shqiptar, i vlerësuar e i respektuar edhe në arenën ndërkombëtare. Një nga organizatorët e parë të arsimit të lartë në Shqipëri në popullorë e pedagog të zellshëm. Ju kemi dhënë një kontribut të madh në përgatitjen

## **LETËR DREJTUAR SHOKUT ALEKS BUDA**

**8 shtator 1981**

I dashur shoku Aleks,

Në këto çaste të gëzueshme për ju, bashkohem me pjesëtarët e familjes suaj, të shokëve të punës e të nxënësve tuaj të shumtë në të katër anët e atdheut, për t'ju dërguar urimet e mia më të mira e më të përzemërta me rastin e 70-vjetorit të lindjes dhe të dekorimit të merituar me «Urdhrin e Flamurit».

Populli dhe Partia kanë te ju, shoku Aleks, një shkencëtar të talentuar me horizont të gjerë, një lëvruer të thellë e të shquar të historisë shumëshekullore të popullit shqiptar, i vlerësuar e i respektuar edhe në arenën ndërkombëtare, një nga organizatorët e parë të arsimit të lartë në Shqipërinë popullore e pedagog të zellshëm. Ju keni dhënë një kontribut të madh në përgatitjen

e armatës së shkencëtarëve, të arsimtarëve e të punonjësve në frontin e kulturës të vendit tonë. Si kryetar i Akademisë së Shkencave, së bashku me shokët tuaj të tjerë, ju bëni një punë të rëndësishme e të dobishme për zgjidhjen me kompetencë të problemeve të mëdha e të shumanshme që shtrohen në të gjitha fushat e zhvillimit të atdheut tonë socialist. Puna juaj, si gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ashtu edhe sot, është një shembull i lartë patriotizmi e atdhedashurie.

Edhe një herë ju uroj jetë të gjatë, aktive e revolucionare ashtu si deri më sot, suksese akoma më të mëdha në punën tuaj të dobishme e të nderuar për të mirën e popullit e të shkencës sonë.

Juaji

*Enver Hoxha*

«Për shkencën (Përmbledhje  
veprash)», vëll. II, f. 440

**LETËR DREJTUAR SHOQES  
QAMILE PESHKËPIA NË LAGJEN CFAKË**

*Gjirokastër*

**28 janar 1982**

E dashura nënë Qamile,

E mora letrën që më dërgove që më kujtoi ngjarje të dashura të kohës së vegjëlisë, rrugët e Cfake, Hajsomerin, Koroveshin, Korijen e Korajve e të tjera vende ku ne djemtë loznim e kalonim një pjesë të kohës që unë nuk i harroj kurrë, prandaj të falemnderit për gëzimin që më solle.

U gëzova gjithashtu për sa më shkruan që sot të duan shumë e të respektojnë plot djem e vajza, nipër, mbesa e stërnipër. Ata e kanë për detyrë ta bëjnë këtë, se u ke bërë kokën. Edhe Partia të tillë e edukon rininë, të dojë e të respektojë prindërit, gjyshërit e gjyshet e veta.

Edhe unë, veç dy djemve dhe vajzës, që të tre të martuar, kam, gjithashtu, disa nipër e mbesa dhe ndihem i lumtur kur më vijnë rrotull, kur i marr në prehër e u tregoj ndonjë histori a ngjarje të kohëve të kaluara, midis të tjerave edhe për Gjirokastrën tonë të dashur. Unë i dua shumë të vegjlit dhe u kam thënë fëmijëve të ma mbushin shtëpinë akoma me plot vogëlushë të tjerë.

Me këtë rast ty dhe gjithë pjesëtarëve të familjes ju bëj shumë të fala dhe ju uroj jetë të gëzuar, suksese në punën që secilit i ka besuar Partia e populli dhe lumturi në familje.

Paç pleqëri të bardhë. Uroj të kesh shëndet e ta shohësh Shqipërinë akoma më të përparuar e më të begatshme.

Yti

Enver

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR SHOKUT ESAT DISHNICA

Tiranë

14 shkurt 1982

I dashur shoku Esat,

Me gëzim të veçantë të dërgoj sot urimet e mia më të përzemërta për 80-vjetorin e lindjes. Të rrosh akoma edhe shumë vjet të tjerë, i lumtur e i gëzuar, në Shqipërinë tonë të shtrenjtë socialiste, për të cilën ti ke shkruar gjithçka.

Partia tek ti, i dashuri miku dhe shoku im i vjetër i kohëve të vështira të Luftës Nacionalçlirimtare dhe të ndërtimit socialist, ka pasur dhe ka një patriot militant e konsekuent shumë të respektuar. Ti urreve regjimin antipopullor të Zogut me të gjitha forcat e zemrës. Me të njëjtin zjarr patriotizmi revolucionar e prite dhe e kundërshtove edhe pushtimin fashist italian e gjerman. Ti je nga ata patriotë me zemër të pastër

që ndjeve dhimbjen e popullit dhe u bashkove menjëherë me komunistët e parë shqiptarë dhe, më vonë, me Partinë që themeluan ata e, nën udhëheqjen e saj, more pjesë aktivisht në Luftën Nacionalçlirimtare.

Besnikëria, vendosmëria dhe gatishmëria jote për t'i shërbyer me çdo mundësi e sakrificë çlirimit të atdheut dhe çështjes së drejtë të Partisë, gjithë jeta jote kanë qenë e janë shembull për të gjithë. Të pashlyera ruaj në kujtesën time ngjarje e momente të shumta që kemi kaluar së toku, si para formimit të Partisë, ashtu edhe më vonë. Prandaj sot, në këtë ditë të shënuar të jetës tënde, bashkohem edhe unë me gëzimin që ndien ti dhe gjithë familja jote e nderuar, e lidhur si mishi me kockën me Partinë dhe të uroj edhe një herë të gjitha të mirat, shëndet e pleqëri të bardhë.

Të përqafoj me dashuri

Yti

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR FAMILJES SË ISMAIL BAJRAM POGËS**

*Kukës*

**21 qershor 1982**

Me hidhërim të thellë mësova për vdekjen e papritur të patriotit e komunistit veteran, njeriut dhe prindit tuaj më të dashur, shokut tonë të luftës e të ndërtimit socialist Ismail Bajram Pogës.

I frymëzuar nga ndjenja të pastra atdhedashurie dhe ide përparimtare, Ismaili ka luftuar me vendosmëri kundër klikave antipopullore të së kaluarës, ai mori pjesë aktive në Luftën Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve të atdheut, duke plotësuar me besnikëri e devotshmëri konsekuente detyrat e rëndësishme politike e ushtarake që i ngarkoi Partia në radhët e njërive tona partizane. Edhe pas Çlirimit të vendit, ai u qëndroi besnik deri në ditët

e fundit të jetës së tij Partisë, popullit dhe at-  
dheut socialist, prandaj me të drejtë gëzonte re-  
spektin e popullit të Kukësit dhe të të gjithë  
shokëve e miqve që e njohën në luftë e në punë.

Të gjithë juve, ju dërgoj me këtë rast ngu-  
shëllimet më të përzemërta. Jam i bindur se dhi-  
mbjen që ju shkaktoi vdekja e tij, ju do ta ktheni  
në forcë për të punuar ashtu si punoi ai, ashtu  
siç ju edukoi ai.

Juaji

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR REDAKSISË SË GAZETËS  
«ZËRI I POPULLIT»**

*Tiranë*

**24 gusht 1982**

Të dashur shokë,

Është gëzim i madh për mua t'ju përshëndes sot me rastin e 40-vjetorit të botimit të numrit të parë të gazetës «Zëri i popullit» dhe ditës së shtypit tonë popullor.

Në historinë e lavdishme të Partisë ka shumë ngjarje e data të shënuara, por 25 gushti i vitit 1942, dalja e gazetës «Zëri i popullit» në ditët e rënda të pushtimit fashist, në zjarrin e betejave të Luftës Nacionalçlirimtare, zë një vend të veçantë. «Zëri i popullit» u bë shpejt një zë i njohur e i dashur për popullin shqiptar, që ngjallte frymëzim e mobilizim, që ngrinte peshë zemrat e njerëzve. Ai çonte kudo fjalën e Partisë, mendi-

min e saj revolucionar, kushtrimin e luftës për lirinë dhe pavarësinë e atdheut.

Gazeta e Partisë, sa e shtrenjtë ishte për popullin, aq tmerr u bë për pushtuesit fashistë e tradhtarët e vendit. Armiku e ndiqte atë me egërsi, përpiquej ta zbulonte e ta shkatërronte. Por ai dështoi, sepse «Zërin e popullit» e donte dhe e mbronte populli, punëtorët, fshatarët, të rinjtë e të rejat e vendit tonë, të gjithë ata që luftonin me heroizëm në qytete e fshatra, për lirinë e popullit.

Si gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ashtu edhe në periudhën po aq heroike të ndërtimit të socializmit, për 40 vjet me radhë, në çdo hap e në çdo betejë «Zëri i popullit» dhe gjithë shtypi ynë popullor, kanë qenë kurdoherë në shërbim të kauzës së madhe të Partisë, një nga armët e saj të fuqishme për mobilizimin, organizimin dhe edukimin e masave, një ndihmës i afërt e besnik për të çuar përpara me sukses revolucionin në të gjitha fushat. «Zëri i popullit» ka dhënë një kontribut të çmuar për forcimin e vazhdueshëm të rendit tonë socialist, të unitetit të popullit rreth Partisë, për edukimin e njeriut tonë të ri me botëkuptimin marksist-leninist e me frymën e patriotizmit socialist, për zbatimin me besnikëri të vijës së drejtë të Partisë, për mbrojtjen e interesave të lartë të popullit dhe të atdheut në luftë kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm.

Tani, pas Kongresit të 8-të të Partisë, «Zëri i popullit», gjithë shtypi ynë dhe Radiotelevizioni

kanë rritur përpjekjet për mobilizimin e klasës punëtore e të mbarë punonjësve për realizimin e detyrave madhështore të planit të shtatë pesëvjeçar. Duke propaganduar arritjet e mëdha e të gjithanshme të Shqipërisë sonë të re nën udhëheqjen e Partisë, ai bën një punë të lavdërueshme për zbatimin e detyrave që ka shtruar Partia lidhur me ndërtimin e socializmit në kushtet e rrethimit të egër imperialisto-revizionist, për aplikimin kudo të shkencës e të teknologjisë së re, për përhapjen dhe përgjithësimin e përvojës së përparuar, për përsosjen e vazhdueshme të metodës së drejtimit në gjithë sektorët e jetës sonë.

«Zëri i popullit», duke pasqyruar qëndrimet e drejta të Partisë e të shtetit tonë për ngjarjet e çështjet ndërkombëtare, është bërë një gazetë me emër në botë. Në një kohë kur borgjezia e revizionistët përhapin gjithfarë shpifjesh, falsifikimesh e gënjeshtresh për të trullosur e mashtruar popujt dhe bëjnë përpjekje të shumta për t'i larguar ata nga lufta e drejtë revolucionare, «Zëri i popullit» është ngritur kurdoherë me vendosmëri në përkrahje të proletariatit e të popujve, ka dënuar politikën e agresionit e të luftës së imperializmit amerikan e sovjetik dhe të veglave të tyre, ka mbajtur kurdoherë lart e të pastër flamurin e Partisë sonë, flamurin e ideve të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit. I tillë do të jetë gjithmonë shtypi ynë, zëri i Partisë e i popullit tonë.

Të dashur shokë gazetarë e korrespondentë të «Zërit të popullit», të ATSH-së e Radiotelevizionit, të të gjithë shtypit tonë popullor,

Duke ju uruar 40-vjetorin e «Zërit të popullit» e të të gjithë shtypit tonë popullor, më lejoni të shpreh edhe dëshirën e bindjen time se, nën udhëheqjen e Partisë e duke zbatuar mësimet e saj, ju do t'i pasuroni e do t'i çoni më përpara traditat e shquara revolucionare të shtypit tonë, karakterin e tij militant, popullor e luftarak. Jam i sigurt se ju do t'i shtoni përpjekjet për të ngritur nivelin e shkrimeve tuaja në përmbajtje e në formë, për të shkruar thjeshtë, qartë e bukur, me argumentim, vërtetësi e forcë bindëse.

Qëndroni si kurdoherë të lidhur ngushtë me popullin, jetoni me gëzimet e fitoret e tij, luftoni bashkë me të për lulëzimin e përparimin e atdheut.

Për shumë vjet e gëzuar festën e «Zërit të popullit», ditën e shtypit tonë popullor.

Juaji

Enver Hoxha

«Zëri i popullit», nr. 203 (10 630),  
25 gusht 1982

**TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR  
FAMILJES SË IJE FARKËS**

*Tiranë*

**24 shtator 1982**

Të dashur djem të Ijes, Haxhi, Musa dhe Muhamet,

Me hidhërim të thellë mësova lajmin e vdekjes së nënës suaj të dashur, shoqes sonë të paharruar të luftës, Ije Farkës, që e kam njohur që në kohët e lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare, kur strehonte e ndante me bujari kafshatën e bukës me shokët trima të Partisë, me bijtë e bijat e popullit që luftonin për Shqipërinë e lirë e të pavarur.

Ija ishte grua me zemër të madhe që me zgjuarsi e si burrneshë iu përgjigj pa rezerva thirrjes së Partisë dhe vuri gjithçka në shërbim të revolucionit popullor. Trime dhe besnike e

idealeve të Partisë mbeti ajo deri në fund të jetës.

Në këto çaste të rënda e ndiej veten pranë jush, ju dërgoj ngushëllimet më të përzemërta dhe shpreh bindjen se dhimbjen do ta ktheni në forcë për t'i shërbyer, ashtu sikurse ju ka edukuar vazhdimisht ajo, çështjes së Partisë e të popullit.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR DREJTUAR UNIVERSITETIT TË TIRANËS<sup>1</sup>

6 nëntor 1982

Të dashur shokë e shoqe pedagogë e studentë,

Njëzet e pesë vjetori i themelimit të Universitetit tuaj është një ngjarje e rëndësishme në historinë e arsimit, të kulturës dhe të shkencës sonë kombëtare. Në këtë ditë të shënuar ndiej një gëzim të veçantë, që t'ju përshëndes me gjithë zemër e t'ju dërgoj urimet më të mira.

Universiteti ynë, që u ngrit nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Partisë, qysh në vitet e para të jetës së tij, u bë një vatër e zjarrrtë revolucionare e përgatitjes dhe e edukimit të kuadrove e specialistëve të rinj. Djemtë dhe vajzat e popullit, të përgatitur dhe të edukuar në Universitetin tonë, i gjen sot në të katër anët e vendit, të angazhuar në luftën e madhe që bën mbarë po-

---

1. Për të përjetësuar emrin dhe Veprën e shokut Enver Hoxha Plenumi i 11-të i KQ të PPSH vendosi që Universiteti i Tiranës të marrë emrin «Universiteti i Tiranës Enver Hoxha».

pulli ynë për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut.

Partia i ka besuar Universitetit të Tiranës një mision fisnik e të nderuar, të përgatitë specialistë me një kualifikim shumë të lartë profesional dhe të armatosur me botëkuptimin marksist-leninist. Partia dhe populli shikojnë me kënaqësi se studentët tanë, ashtu si mbarë rinia jonë e mrekullueshme, edukohen drejt politikisht e ideologjikisht, pajisen gjithnjë e më mirë me dije e kulturë, bëhen specialistë të zotë e të aftë. Por nga studentët e Universitetit dhe të shkollave të tjera të larta të vendit tonë kërkohet një zell më i madh dhe një këmbëngulje më e vendosur për të përvetësuar deri në fund programet dhe për të zgjeruar sa më shumë dijet shkencore e teknike gjatë kohës së studimeve universitare, për të dalë nga fakultetet plotësisht të pjekur në të gjitha drejtimet, teknike, politike e ideologjike.

Kongresi i 8-të i Partisë shtroi para jush, shokë pedagogë, si dhe para gjithë punonjësve të shkencës e të teknikës, detyra të reja, më të mëdha e më të ndërlikuara. Duke i arritur objektivat e shtruar nga Partia, ju do të jepni një kontribut shumë të vlefshëm edhe për zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit.

Duhet mbajtur gjithmonë parasysh se veprimtaria juaj mësimore edukative dhe veçanërisht puna juaj shkencore do t'i shërbejë më mirë përgatitjes së studentëve dhe do të integrohet më thellë në tërë kërkimin shkencor në vendin

tonë, nëqoftëse ju kapni dhe zgjidhni probleme të mëdha të ekonomisë e të kulturës sonë. Në të njëjtën kohë kjo punë do të bëjë që auditori t'ju ndjekë gjithnjë me interes e të përvetësojë në mënyrë të qëndrueshme dijet që ju transmetoni, që studentët, nga viti në vit, të dalin më të përgatitur e më të aftë për punët që i presin. Përsosja e vazhdueshme e programeve dhe e metodave mësimore, perfeksionimi i sistemit të kualifikimit pasuniversitar, përmirësimi rrënjësor i punës së katedrave kërkojnë një vëmendje të vazhdueshme nga ana e organizatës së Partisë dhe e Rektoratit të Universitetit.

Partia ka besim të plotë se ju, shokë pedagogë e studentë, do të punoni pa u kursyer e me ndërgjegje të lartë për të vënë në jetë detyrat e mëdha të shtruara para jush, do të mprehni pa-reshtur vigjilencën revolucionare në punë e në jetë, do të luftoni pa pushim për përsosjen e figurës së intelektualit revolucionar e militant, të lidhur ngushtë me interesat e lartë të socializmit, të popullit e të mbrojtjes së atdheut.

Nga mot gëzuar festën e bukur të themelimit të Universitetit tonë të Tiranës. Ju uroj suksese të reja dhe faqebardhë gjithnjë.

Juaji

*Enver Hoxha*

*«Për shkencën (Përmbledhje  
veprash)», vëll. II, f. 504*

**LETËR DREJTUAR KRYESISË  
SË KOOPERATIVËS BUJQËSORE  
KUTË-ÇORRUSH-DRIZAR**

*Kutë*

**15 dhjetor 1982**

Të dashur shokë e shoqe kooperativistë, drejtues e specialistë të kooperativës,

Mora me gëzim telegramin që më dërguat për festat e mëdha, 70-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë dhe 38-vjetorin e Çlirimit të Atdheut. Ju falënderoj për urimet e ngrohta që më bëtë. Edhe unë, në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe në emrin tim, ju uroj përzemërsisht. Në të njëjtën kohë ju përgëzoj për hapat e rëndësishëm që keni bërë në forcimin e ekonomisë së përbashkët kooperativiste dhe në përmirësimin e jetës suaj familjare.

Vëllezër e motra të Kooperativës Bujqësore të Kutë-Çorrush-Drizarit e të të gjithë Malla-kastrës,

Ashtu si gjatë Luftës Nacionalçlirimtare për çlirimin e atdheut, kur u lidhët si mishi me thoin me Partinë, edhe pas Çlirimit ju u keni qëndruar e u qëndroni vazhdimisht besnikë vijës së saj të drejtë marksiste-leniniste e interesave të lartë të atdheut dhe të popullit tonë. Tradhtia e Mehmet Shehut, pjesë përbërëse e luftës së klasave që bën Partia jonë në shkallë kombëtare e ndërkom-bëtare kundër armiqve imperialisto-revizionis-të, në asnjë mënyrë nuk e ka prekur besnikërinë tuaj ndaj atdheut, popullit e Partisë. Përkundra-zi, edhe në të ardhmen, nën udhëheqjen e saj të urtë, në sajë të punës e të atdhedashurisë suaj të zjarrtë tradicionale, jam i bindur që, si kurdo-herë, do të ecni përpara si një trup i vetëm për forcimin e mëtejshëm të unitetit të çeliktë po-pull-Parti, për lulëzimin e ekonomisë kooperati-viste, për përmirësimin e vetë jetës suaj dhe mbrojtjen e atdheut tonë socialist.

Ju uroj nga zemra të gjithë juve të keni gjithmonë suksese në punë dhe gëzime e lumturi në familjet tuaja!

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

me modesti t'i vinte në jetë në detyrat që i ki-  
shtë ngarkuar Partia. Ruajtme kujtime nga më  
të mirat për ngjarje të shumta të jetës që kemi  
pasur rastin të kalojmë me të.  
Përpëhim bindjen se dëshpërimi për vdekjen  
e tij ju do ta këbani në forcë dhe do të vërdhoni  
trugen që ndodri i parharruar për ne Sterjo.

**TELEGRAM NGUSHËLLIMI DËRGUAR  
FAMILJES SË SHOKUT STERJO GJOKORECI**

*Tiranë*

**18 prill 1983**

Bashkëshortes dhe vajzave

U hidhëruam shumë për vdekjen e bashkë-  
shortit dhe babait tuaj shumë të dashur, shokut  
e mikut tonë të vjetër, Sterjo Gjokoreci. Në këto  
çaste të dhimbshme për familjen tuaj e ndiejmë  
veten pranë jush dhe ju paraqesim ngushëllimet  
më të ngrohta.

Sterjoja deri në fund të jetës mbeti një anë-  
tar i devotshëm i Partisë dhe u shua në krye të  
detyrës. Asnjëherë ai nuk u lëkund e nuk u thye,  
as përpara ngjarjeve të rënda të jetës si ajo e  
vrasjes barbare të djalit, Viktorit, në shkurt 1944  
nga armiqtë e luftës që udhëhiqte Partia. Kul-  
turën dhe njohuritë e tij të veçanta ai u përpoq

me modesti t'i vinte në jetë në detyrat që i kishte ngarkuar Partia. Ruajmë kujtime nga më të mirat për ngjarje të shumta të jetës që kemi pasur rastin të kalojmë me të.

Shprehim bindjen se dhimbjen për vdekjen e tij ju do ta ktheni në forcë dhe do të vazhdoni rrugën që ndoqi i paharruari për ne Sterjo.

*Enver Hoxha  
Nexhmije Hoxha*

18 prill 1983

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **LETËR DREJTUAR KOLEKTIVIT PUNONJËS TË MINIERËS SË KROMIT «TODO MANÇO»**

*Bulqizë*

**28 prill 1983**

Të dashur shokë minatorë, gjeologë, specialistë të kromit,

Ju falënderoj për ftesën që më bëtë për të marrë pjesë në festimin e 35-vjetorit të krijimit të minierës suaj, baza kryesore e prodhimit të kromit dhe një nga ndërmarrjet minerare më të mëdha të vendit tonë. Punët më pengojnë që të ndodhem në këtë ngjarje të shënuar për minierën tuaj, por, me anë të kësaj letre bashkohem edhe unë në gëzimin tuaj të madh. Me këtë rast të gjithëve ju uroj nga zemra që, të udhëhequr nga Partia dhe të mobilizuar për të vënë në jetë detyrat madhështore të Kongresit të saj të 8-të, të arrini suksese akoma më të mëdha, ta fuqizo-

ni më tej minierën tuaj, të ngrini akoma më lart nivelin teknik e shkencor të punës, të rritni efektivitetin e punimeve dhe të plotësoni të gjitha detyrat e planit të shtetit.

Kromi, siç e dini shumë mirë vetë ju, të dashur shokë, është një pasuri kolosale e atdheut tonë që duhet të vihet akoma më shumë e më mirë në shërbim të objektivave të mëdhenj të Partisë për fuqizimin e ekonomisë sonë kombëtare, për modernizimin e pandërprerë të industrisë sonë socialiste, për shtimin e eksporteve tona e më në fund për realizimin e qëllimit kryesor të socializmit, rritjen e pandërprerë të mirëqenies ekonomike e kulturore të masave punonjëse.

Sot si gjithë klasa jonë punëtore, edhe ju të dashur shokë minatorë, gjeologë e specialistë të minierës «Todo Manço», me punën tuaj të palodhur për të futur në qarkullimin ekonomik pasurinë e çmuar të kromit, qëndroni në ballë të luftës për ta çuar përpara ndërtimin e socializmit në Shqipëri me forcat tona, për ta forcuar më shumë ekonominë e vendit, për të çelikosur gjithnjë më shumë aftësinë mbrojtëse të atdheut tonë socialist, që asnjë armik të mos jetë në gjendje të na godasë.

Edhe një herë, në emër të Komitetit Qendror të Partisë, si dhe në emrin tim personal, ju uroj 35-vjetorin e krijimit të minierës dhe jam i bindur se ju do të luftoni me të gjitha aftësitë tuaja, mendore e fizike, për të plotësuar me sukses detyrat e prodhimit të vitit 1983 dhe të krejt

pesëvjeçarit, për të përmirësuar pandërprerë kushtet e punës dhe të sigurimit teknik, se do të bëni përpjekje për të përmirësuar mekanizimin kompleks të punimeve në minierë, sepse këto çojnë edhe në rritjen e rendimentit të punës, se do të mbani gjithnjë lart flamurin e Partisë në zbatimin e direktivave të saj dhe do të bëni që miniera juaj të jetë vazhdimisht në pararojë, shkollë për gjithë minierat e tjera të vendit. Në të njëjtën kohë shpreh besimin se ju si kurdoherë do të mbani lart frymën e vigjilencës revolucionare kundër veprimeve e kompleteve të armiqve të egër të atdheut tonë, imperialistëve e revizionistëve të të gjitha ngjyrave.

Gëzuar të dashur shokë festën! Ju uroj shëndet, suksese në punë, gëzime e lumturi në jetën tuaj familjare.

Juaji

*Enver Hoxha*

«Zëri i popullit», nr. 104 (10 846).

30 prill 1983

## **FALENDERIM PËR URIMET E DËRGUARA ME RASTIN E 75-VJETORIT TË LINDJES**

**21 tetor 1983**

Shumë të dashur vëllezër e motra, shokë e shoqe, punëtorë e kooperativistë, punonjës të Partisë e të pushtetit, të frontit të kulturës, të arsimit, të shëndetësisë, të shkencës, aktivistë të Frontit Demokratik, heronj të punës, ndërtues të veprave të mëdha;

Shumë të dashur prindër e të afërm të të rënëve në luftë për çlirimin e atdheut dhe veteranë të luftës;

Shokë ushtarë e kuadro të Ushtrisë Popullore e të organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme;

Të rinj e të reja, pionierë e fatosa!

Me rastin e 75-vjetorit të lindjes, nga ana juaj dhe e kolektivave që përfaqësoni, kam ma-

rrë një numër të madh letrash e telegramesh urimi, për të cilat ju falënderoj nxehtësisht e me nderim të veçantë.

Gjithë ato shprehje e manifestime të dashurisë ndaj meje i përkasin Partisë, që më ndriti rrugën dhe mendjen. Nderet e mëdha që më bëri Partia, vlerësimet dhe urimet tuaja të përzemërta më kanë prekur shumë, sepse unë, si ushtar i Partisë së Punës dhe bir i këtij populli, s'kam bërë veçse detyrën dhe jam akoma shumë borxhli ndaj tyre.

Njoftimet e gëzueshme nga frontet e prodhimit, si gjithnjë, më dhanë një kënaqësi të jashtëzakonshme. Puna e njerëzve tanë të mrekullueshëm, entuziazmi e uniteti i tyre më frymëzojnë dhe më japin forca të reja për të punuar vazhdimisht pa u lodhur e pa kursyer asgjë për të mirën dhe lavdinë e popullit e të atdheut tonë të dashur, për Partinë tonë trime e të urtë.

Edhe unë ju uroj juve gëzim, lumturi e sukses në punët që ju kanë besuar populli e Partia, për ta çuar akoma më përpara zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit, për ta ngritur akoma më lart mirëqenien e punonjësve tanë, për ta bërë Shqipërinë sa më të fortë, kala të paprekshme nga armiqtë imperialistë e revizionistë dhe nga shërbëtorët e veglat e tyre.

Telegrame e letra të shumta me urime të ngrohta e të përmalluara më kanë dërguar edhe bashkatdhetarë e bashkatdhetare nga jashtë shtetit, kosovarë e të tjerë, në të cilat ata shpre-

hin ndjenjat e zjarra të atdhedashurisë dhe gëzimin e madh për përparimet që ka arritur atdheu ynë i dashur në të gjitha fushat, nën udhëheqjen e Partisë sonë të Punës, dhe për respektin që gëzon sot në botë Shqipëria socialiste, në sajë të politikës së saj të jashtme të drejtë e të guximshme. Me këtë rast, së bashku me falënderimet, u dërgoj atyre përshëndetjet më të mira vëllazërore. Mëmëdheu i ka kurdoherë në zemër e nuk i harron, ashtu sikurse edhe ata e kanë në zemër e nuk e harrojnë kurrë.

Gjithashtu falënderoj nxehetësisht gjithë miqtë e dashamirët e Shqipërisë socialiste për urimet që më dërguan.

Edhe një herë, të dashur shokë e shoqe, bashkë me falënderimet e mia, formuloj urimet më të përzemërta për gjithë bijtë e bijat e këtij populli trim e punëtor, para të cilit përulem me besim, respekt e mirënjohje të pakufishme dhe përsëris fjalën e dhënë se do të luftoj gjithë jetën për aspiratat e larta të tij, të lirisë, të pavarësisë e të begatisë së atdheut tonë socialist, të lumturisë së njerëzve të punës dhe të brezave të ardhshëm.

Me përshëndetje revolucionare

Juaj

*Enver Hoxha*

«Zëri i popullit», nr. 255 (10 997),

22 tetor 1983

## LETËR DREJTUAR KOLEKTIVIT TË KINOSTUDIOS «SHQIPËRIA E RE»

Tiranë

21 tetor 1983

Të dashur shokë,

Këto ditë mora dhuratën e bukur që më dërguat, filmin «Kujtime për Gjirokastrën», të cilin e pashë me kënaqësi të veçantë, si edhe letrën ku më shkruanit për sukseset që keni arritur në punën tuaj fisnike. Me këtë rast unë ju falënderoj e ju përgëzoj të gjithë ju, punonjësit e palodhur e të talentuar të kinostudios «Shqipëria e re», që po i jepni popullit e Partisë vepra gjithnjë e më dinjitoze, me larmi tematike e me nivel të lartë ideoartistik.

Puna e kineastit është e tillë që reflekton në vite e shekuj, prandaj Partia e ka vlerësuar gjithmonë kinematografinë dhe i ka qëndruar kurdoherë pranë. Me përpjekjet, mundin dhe pasionin

tuaj krijues ju keni shfrytëzuar kushtet e mundësitë që ju janë krijuar dhe keni bërë që edhe ky art i ri, i lindur e i rritur tërësisht në vitet e Partisë, të ecë përpara dhe të militojë e të qëndrojë denjësisht përkrah letërsisë dhe llojeve të tjera të arteve tona të realizmit socialist.

Kurdoherë që shoh filmat e kinostudios «Shqipëria e re», mbushem me emocione e kënaqësi të veçantë. Tashmë kanë mbetur larg ato vite kur kënaqeshim vetëm me disa dokumentarë e ndonjë film artistik në vit. Megjithatë që atëherë ne gëzoheshim me hapat e parë që po hidhte kinematografia e re dhe ishim të sigurt se ju vit pas viti do t'i shtonit veprat tuaja në sasi e në nivel dhe do të arrinit në rezultatet e lavdëruara të dhjetëvjeçarit të fundit, për të cilat ju përgëzojnë Partia dhe populli. Në filmat tuaj ju, të dashur shokë, keni fiksuar e po fiksoni me besnikëri e mjeshtëri historinë luftarake e të lavdishme të popullit tonë, luftën dhe përpjekjet e tij për liri, përparim e zhvillim. Në mënyrë të veçantë, unë ju përgëzoj për faktin që ju, pa lënë mënjanë temën historike, vendin kryesor në ekran ua keni dhënë temave që pasqyrojnë epokën e ndritur të Partisë, Luftën heroike Nacionalçlirimtare, transformimet rrënjësore socialiste, punën dhe luftën kolosale të Partisë e të popullit për ta bërë vendin, jetën dhe figurën e njeriut tonë gjithnjë e më të bukur, më të lulëzuar, më të sigurt.

Rritja e pandërprerë në sasi e cilësi e veprës

së kinematografisë sonë të re, tregon se ju jeni një kolektiv entuziast, një kolektiv që nuk vetëkënaqet. Nga gjiri juaj kanë dalë e janë rritur regjisorë të tillë të talentuar, si Viktor Gjika, Dhimiter Anagnosti, Xhanfise Keko, Kristaq Dhamo, Pirro Milkani e të tjerë, operatorë të pasionuar, si Ilia Terpini, Petraq Lubonja, Lionel Konomi e të tjerë, të cilët, bashkë me skenaristët, aktorët, kompozitorët, piktorët, montazhierët dhe punonjësit e tjerë të artit tuaj kompleks, kanë shkruirë tërë aftësitë e tyre krijuese për të realizuar filma me përmbajtje të shëndoshë dhe nivel të lartë artistik.

Në një kohë që kinematografia borgjezo-revizioniste po brehet nga kriza e thellë, ju, kineastët shqiptarë, po vërtetoni se kur arti përshkohet nga ideologjia marksiste-leniniste, kur vihet në shërbim të masave, të revolucionit, ashtu si e keni vënë ju artin tuaj, ai nuk njuh kriza, por lulëzim. Prandaj, të dashur shokë e shoqe të kinostudios «Shqipëria e re», përvetësoni sa më thellë ideologjinë marksiste-leniniste, vazhdoni të frymëzoheni, ashtu si gjer më sot, nga jeta dhe vepra e Partisë dhe e masave, për të çuar më tej sukseset e arritura, për t'i dhënë popullit filma dhe dokumentarë edhe më të bukur, edhe më frymëzues.

**Kam** besim se kolektivi revolucionar i kinostudios «Shqipëria e re» do të shumëfishojë forcat për të ecur krahas realizimeve të mrekullueshme të popullit tonë në tërë fushat e jetës dhe

të veprimtarisë, duke fiksuar me aparatet tuaja madhësitinë e epokës së Partisë.

Ju uroj suksese të pandërprera!

Ju këndoftë ekrani, siç u këndojnë goja e zemra mbarë krijuesve tanë, mbarë popullit tonë punëtor, trim e të talentuar!

Juaji

*Enver Hoxha*

*Gazeta «Drita», nr. 43 (1 196),  
23 tetor 1983*

**LETËR NGUSHËLLIMI  
DREJTUAR SHOKUT ZEQI AGOLLI**

*Tiranë*

**10 maj 1984**

I dashur shoku Zeqi,  
Të dashura Esmë dhe Semiha,

Me dhimbje të thellë mësova për vdekjen e nënës suaj të nderuar, patriotes së zjarrtë e sypatrembur Adivije, motrës e shoqes sonë të Luftës Nacionalçlirimtare e të ndërtimit të socializmit.

Emri i nënë Adivijes është i rrënjosur në zemrat e të gjithë neve. Ajo ishte një grua e thjeshtë e popullit, që veprën e Partisë e nuhati me zgjuarsiri dhe me intuitën e saj të fortë, duke kuptuar se një botë e re, e ndryshme, më e mirë për

të gjithë njerëzit tanë do të lindte. Menjëherë, sapo Partia i drejtoi popullit Thirrjen e saj për luftë me okupatorët fashistë, spiunët e tradhtarët, vegla e bashkëpunëtorë të tyre, ajo vuri pa hezitim në shërbim të çështjes së madhe të çlirimit të atdheut çdo gjë që kishte, ju, fëmijët e saj, veten dhe shtëpinë. Asaj në asnjë rast nuk iu tremb syri dhe nuk iu shmang sakrificave. Në të kundërtën, nënë Adivija na ka pritur me dashuri e bujari si bijtë e saj, me ngrohtësinë e nënës në shtëpinë tuaj, na ka strehuar, na ka ushqyer dhe na ka ruajtur nga çdo rrezik në ato kohë shumë të vështira të luftës dhe kurrë nuk u ligështua, po me gjakftohtësi shembullore përballoi rreziqet që mund t'i kanoseshin nga çasti në çast familjes suaj.

Të gëzuar e gjeti atë çlirimi i atdheut. Po ajo vendosmëri e thjeshtësi, si në luftën kundër pushtuesve e karakterizoi atë vazhdimisht. Ajo nuk u lodh kurrë së punuari e propaganduari tërë jetën me zjarr për veprën e madhe të Partisë dhe për një kohë të gjatë dyzetvjeçare rrojtje e lumtur e pa me sytë e vet përparimet e vrullshme që u bënë në vendin tonë në të gjitha fushat dhe u gëzohej atyre me gjithë zemër.

Të pashlyera do të mbeten për mua kujtimet e shumta që ruaj për nënën trimëreshë Adivije, që gjithë shokët dhe unë vetë personalisht e kemi njohur dhe i jemi mirënjohës për të gjitha ato që ka bërë për Partinë dhe për popullin tonë.

E ndiej veten me mendje e me zemër aty  
pranë jush në këto çaste hidhërimi të përbashkët  
dhe ju dërgoj juve e fëmijëve tuaj ngushëllimet  
më të ngrohta.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

30 nëntor 1984

**LETËR DREJTUAR SHOKUT  
SHEVQET MUSARAJ**

*Tiranë*

**20 nëntor 1984**

Shoku im i dashur Shevqet,

Kushdo në vendin tënd do të ndihej krenar për jetën e veprimtarinë tënde të palodhur revolucionare në shërbim të çështjes së popullit e të Partisë gjatë këtyre 70 vjetëve.

I lindur në gjirin e popullit fukara, ti u rreshtove që në moshën më të re në radhët e lëvizjes antizogiste, më vonë antifashiste e komuniste, punove e luftove me devotshmëri shembullore këtu, në Tiranë, si anëtar i Komitetit Qarkor të Partisë dhe pas Çlirimit kreve me nder çdo detyrë që të besoi Partia. E nise jetën jo vetëm si militant revolucionar, po edhe si shkrimtar e publicist i shquar dhe i tillë mbete tërë jetën, besnik i çështjes së popullit e i Partisë, që të futi që në fillim

në radhët e saj, krijues i talentuar e i papërtuar, optimist e kurdoherë gjithë humor.

70 vjet është një jetë njeriu, por për ty ato janë pak. Populli dhe Partia të duan e të respektojnë për gjithçka ke bërë për ta si revolucionar e si shkrimtar, për penën tënde të fuqishme, për veprat e tua militante me vlera artistike të njohura kudo në vendin tonë, që ti i ke krijuar si kurdoherë për popullin e për Partinë, të cilat janë shumë të dashura e të afërta edhe për ne, shokët dhe bashkëluftëtarët e tu. Personalisht ruaj kujtime shumë të çmuara gjatë kohës që kemi qenë edhe bashkë në Tiranë në vitet e vështira të Luftës Nacionalçlirimtare. Vepra jote e çmuar është shembull i partishmërisë së lartë e i frymës popullore, nga e cila kanë mësuar e do të mësojnë brezat e rinj të krijuesve tanë.

Të uroj me gjithë zemër me rastin e 70-vjetorit të lindjes, i dashuri shoku Shevqet, jetë të gjatë e gjithnjë e më tepër punë krijuese, ku të ndritë si kurdoherë mendimi yt revolucionar në shërbim të popullit e të Partisë. Qofsh i lumtur e i gëzuar me gjithë familje.

Yti

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **PËRSHËNDETJE ME RASTIN E 40-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË SHQIPËRISË**

**29 Nëntor 1984**

Gëzuar festat e nëntorit,

Shqipëri e shtrenjtë!

Gëzuar, populli ynë i mrekullueshëm!

Atdheu im i dashur! U mbushën 72 vjet që kur shpalle pavarësinë. U bënë 40 vjet që rron e përparon në socializëm, i çliruar përgjithmonë nga shtypja e shfrytëzimi, nga intrigat e poshtërsitë e pushtuesve të jashtëm dhe të armiqve të brendshëm. Vuajtje e mjerime pa fund ke hequr Shqipëria ime gjatë gjithë shekujve. Jeta jote ishte e mbushur plot me luftëra të përgjakshme, që janë zhvilluar cep më cep të truallit tënd, në male e në fusha, në kështjella e në kasollet me baltë. Gjaku yt, o popull, u derdh që ti të jetosh

i lirë dhe i pavarur si shqiponja e maleve, ashtu siç ishte ti vetë, me shpirt të lirë e karakter të papërkulur, me mendje të urtë e të kthjellët, me zemër të madhe, të guximshme e bujare, me dëshira dhe aspirata të flakta. Ty s'të trembi kurrë robëria, as shpata e armikut, as dredhitë e tij, as djegiet, as vrasjet; ti kurrë s'e ule kokën përpara të huajve e përpara tradhtisë, por kurdoherë qëndrove shtatlartë, ballëhapët. Në brez mbaje koburet me serm, në sup dogratë dhe malisherët, në dorë shpatën zhveshur dhe luftoje me tërbim. Të godisnin nga të gjitha anët, shumë herë edhe të thyenin, por kurrë nuk të mposhtnin, Shqipëria ime, populli im!

Vështirë të gjendet në botë një vend i vogël si Shqipëria jonë, me një popull të tillë si populli shqiptar, që të ketë luftuar kaq shumë, që të ketë guxuar kaq shumë, që të ketë treguar kaq shumë trimëri e mençuri, që t'i ketë thyer të gjithë armiqtë dhe të ketë dalë kryelartë përpara historisë, të ketë dalë i lirë e sovran, ta ketë rrëmbyer fuqinë me armët e tij, pa pasur e pa kërkuar ndihmën e kurrkuajt. Armiq nga më të egrit janë sulur e kanë kërkuar ta zhduknin këtë popull trim nga faqja e dheut, ta fshinin Shqipërinë nga harta e botës, ta copëtonin e ta ndanin në mes fqinjëve të saj, sundimtarët e të cilëve ishin agjencia të fuqive të mëdha. Por më kot. Shqipëria e shqiptarët luftuan e fituan, ata ishin, janë e do të jenë të pavdekshëm.

Për këto merita të mëdha, Shqipëria ime,

populli im, flet historia. Flet historia me të madhe tash, por ajo ka folur edhe më përpara, megjithëse armiqtë e huaj kanë bërë çmos që zëri yt të mos dëgjohej askund. Megjithatë, ky zë s'mund të mbytej, sepse jehona e luftërave të shqiptarëve ka çarë male, ka kapërcyer hapësira e i ka treguar botës se si një popull i paepur, me Skënderbeun në krye, u bë tmerri i osmanëve. Ndërsa Evropa dridhej nga hordhitë e sulltanëve turq, në malet e Shqipërisë luftonte e rezistonte një popull, i udhëhequr nga një hero, që mbronte atdheun dhe Evropën nga invadimi. Gjakun e derdhe lumë, por askush s'ta diti për të mirë, o popull trim, megjithatë ti s'u dekurajove, sepse jeta të kishte mësuar që fatin tënd duhej ta kishe vetë në dorë e atdheun vetë ta çliroje e ta mbroje.

Armiq të shumtë kanë shkelur mbi tokën tonë amtare, romakët e Cezarit e të Mark Antonit, osmanët, hordhitë serbe që nga Stefan Dushani e gjer te Karagjorgjeviçët, grekët e Venizellosit e të Zografos, italianët e Luftës së Parë Botërore dhe ata të Musolinit, austro-hungarezët e Franc Jozefit, gjermanët e Hitlerit. Por ti, popull shqiptar, u bërë ballë tërë këtyre invadorëve, duke dalë pas çdo pushtimi më i bashkuar, më i përtërirë, më i vendosur për të mos e ulur kokën para kurrkuajt.

Arkivat e kancelarive të shteteve të Evropës janë mbushur me dokumente që vërtetojnë luftën tënde, trimëritë e aspiratat e tua të zjarrta për liri. Por këto arkiva nuk hapen, akoma edhe

tash e kësaj dite ato qëndrojnë të mbyllura. Të mbyllura mbeten arkivat e Stambollit, të Beogradit, të Athinës, të Italisë, të Austrisë, të Francës. Por më mirë e më qartë sesa në shkresat e kancelarive të huaja, historia jote e madhërishme, o popull heroik, është shkruar me gjak e me djersë dhe është kënduar brez pas brezi nga ti vetë. Këngët e tua përshkruajnë me besnikëri historinë tënde të madhe, ato u thurin himn trimërisë, qëndresës, besës e bujarisë, jetës në zhvillimin e saj të harmonishëm, zakoneve, dokeve, kostumeve.

Kështu ti i këndoje vetes tënde, gjakut tënd, përjetësisë tënde. Këto këngë frymëzonin brezat njëri pas tjetrit, i armatosnin ata me dashurinë për atdheun, për lirinë, u tregonin për guximin, vendosmërinë, palëkundshmërinë e gjyshërve të tyre, u tregonin se vetëm me gjak e me djersë mund të mbroheshin liria, nderi, gjuha, zakonet, kultura.

Në këngët e tua evokohet ndihma që ti, popull shqiptar, u ke dhënë popujve të tjerë gjatë historisë. Ato janë këngë për Skënderbeun e trimat e tij shqiptarë që ndihmuan Huniadin, që ndihmuan mbretërinë e Napolit të çlirohej; janë këngë për bijtë e tu që shkuan e luftuan edhe në Francë me mareshalin Dë Kersi<sup>1</sup>; janë këngë për trimat e kësaj toke që ndihmuan revolucionin

---

1. Mareshal francez në gjysmën e dytë të shekullit të 15-të nën të cilin luftuan edhe disa arbëreshë për bashkimin e Francës në një shtet të vetëm.

për pavarësinë e Greqisë. E ku nuk ka luftuar për lirinë shqiptari, ku nuk ka treguar trimëri, ku nuk ka treguar vitalitet e mençuri.

Njerëz të mëdhenj ke nxjerrë nga gjiri yt ti, populli im, njerëz të pushkës e të penës, që kanë frymëzuar brezat dhe i kanë mbryjtur me atdashedashurinë, me ndjenjën e lirisë. Këta njerëz kanë ëndërruar, kanë punuar e janë përpjekur që mëmëdheu të rronte i lirë, që shqiptarët të mësonin, të përvetësonin diturinë dhe të ndërtonin një Shqipëri të lirë, pa zinxhirë, pa të huaj, ku të merrte zhvillim të mbarë gjuha shqipe, «gjuha jonë kaq e bukur e kaq e dëlirë», aq tingëlluese në këngët e malësorëve e të fusharakëve, të grave, vajzave e djemve si azganë. Sa shumë e kanë dashur dhe e kanë çmuar atë patriotët e shquar të çdo kohe, veçanërisht të Rilindjes sonë Kombëtare, të cilët me mendjen e tyre të mprehtë dëshironin që kjo gjuhë të fiksohej e të mësohej në shkollat shqipe dhe që këto shkolla të zhduknin në popull errësinën, influencën e gjuhëve të vendeve që na kishin shtypur, të zhduknin errësinën e mesjetës e të feve, që helmonin shpirtin e popullit shqiptar. Këta pionierë të gjuhës shqipe u sakrifikuan në altarin e atdheut, gjaku i tyre u bë pishtar, vepra e tyre hodhi rrënjë, u rrit e u zhvillua në mes furtunave, në mes mjerimit, në mes varfërisë. Nga shkollat shqipe, që u hapën me përpjekjet e këtyre patriotëve të shquar, dolen njerëz që qëmtuan këngët e historisë sonë e zakonet e popullit, që forcuan vendosmërinë e

shqiptarit për t'u çliruar, që na dhanë neve dritë, forcë e dituri, gjersa më së fundi ti, popull i dashur, i kapërceve tërë këto mjerime.

Historia të kishte mësuar se ata popuj që nuk luftojnë, zhduken, ndaj ti, populli im, luftove për lirinë, për gjuhën, për zakonet, për truallin tënd të shenjtë dhe nuk u zhduke, por fitove. Shekuj kaluan në luftëra të pareshtura, u dogje, u vrave, por s'u përkule e s'u shove gjersa në 29 Nëntorin e 1944-ës bashkë me lirinë fitove edhe pushtetin, u bëre zot i fateve të tua, dole në dritë përgjithmonë, sepse në ballë të luftës tënde kishe Partinë heroike Komuniste, që ti, popull, e nxore nga gjiri yt, e mbrojte dhe e ushqeve me gjakun e bijve të tu më të mirë, që ajo të rritej e fortë siç e donin momentet, e ardhmja jote dhe e atdheut tonë. Kjo ishte një fitore e merituar.

Rrallë popull tjetër i ka merituar këto fitore siç i meriton ti, populli im, pse ke qenë i fortë, i guximshëm, optimist e gjithmonë e ke dashur jetën. Nga gjiri yt nxore bij e bija kreshnikë, zemërzjarrtë, syshqiponjë e të fortë si shkëmbinj të e alpeve, që sulmonin mbi armikun si rrufe e vetëtima. Të tillë ishin bijtë dhe bijat e tua, që të prinë në beteja, që këngëve ua thanë tok me britmat e luftës e që ti, popull trim e me shpirt të madh, u këndove historinë, u këndove përpjekjet, u këndove sakrificat.

Jo një e dy, as disa mijëra njerëz, por një popull i tërë u frymëzua në çdo çast, në çdo kohë,

në gjithë momentet e turbullta të historisë, nga e kaluara jote e lavdishme, atdheu im. Kurrë koka e shqiptarit nuk u turbullua në tufane e suferina, kurrë populli shqiptar s'u përkul, por ai çau furtunat dhe i mposhti armiqtë, sado të mëdhenj, të egër e të armatosur që ishin.

Ti, popull i dashur, nuk ishe barbar, të tjerët u sollën si barbarë ndaj teje; ti, populli im, nuk ishe pa kulturë, të tjerët donin të të imponin kulturën e tyre skllavëruese. Ti nuk kishe vetëm muskuj të fortë, por edhe një mendje të mprehtë e zemër të madhe, ndaj edhe invadorët as të asimiluan dot, as të zhdukën. Armiqtë s'kanë lënë gjë pa thënë kundër teje, por jeta, lufta, historia kanë provuar të kundërtën. Ti ke qenë superior në çdo pikëpamje mbi armiqtë e tu.

E tërë jeta jote, o populli im, ka qenë revolucion, edhe kur ishe me barkun bosh, zhveshur apo veshur me zhele, me trupin të gjakosur nga plagët, por me shpirtin e zjarrtë dhe të papërkulur. Jeta jote nuk ka qenë asnjë çast pa kuptim, përkundrazi, çdo vit, çdo ditë e jetës tënde është e mbushur me luftëra e me përpjekje për liri, për drejtësi, për zhvillim e përparim ekonomik e shoqëror. Kjo mënyrë të jetuari na ka mbajtur e na mban gjallë dhe këtë Partia jonë e Punës e ka pasur dhe e ka vazhdimisht në rend të ditës. Traditat revolucionare të popullit tonë Partia i ka bërë pjesë të pandarë të jetës sonë: datat, ngjarjet e shënuara e figurat e shquara të popullit festohen, për to këndohet e shkruhet. Kudo

është krijuar një situatë e mrekullueshme, ngri-  
tja politike, patriotizmi i shquar i popullit s'kanë  
mortje kurrë. Kjo gjendje e shëndoshë e bën  
Shqipërinë të përparojë e të ndërtojë socializmin  
me sukses, i bën njerëzit të ndërgjegjshëm në pu-  
në e në veprim, luftëtarë të çështjes së madhe të  
socializmit e të komunizmit, e bën të madh e të  
vogël ta duan me gjithë shpirt Partinë tonë he-  
roike.

Të gjitha të mirat që krijuam e gëzojmë gja-  
të viteve të socializmit, i solli Lufta Nacionalçli-  
rimtare e popullit, e udhëhequr nga Partia Ko-  
muniste, që është ndriçuar kurdoherë nga busulla  
e saj e pagabueshme, marksizëm-leninizmi. E  
udhëhequr nga kjo ideologji qysh në krijimin e  
saj, Partia diti ta brumosë dhe ta kalitë njeriun  
e ri të Shqipërisë socialiste me patriotizmin e she-  
kujve, diti ta bashkojë e ta mobilizojë mbarë po-  
pullin në luftën e shenjtë për liri, diti ta udhë-  
hiqte në atë rrugë që bashkë me lirinë populli të  
merrte në duart e tij edhe fuqinë, të vendoste  
pushtetin popullor dhe t'i hynte punës për ta bërë  
Shqipërinë tonë të dashur kopsht të lulëzuar, ve-  
ndin e lirë të njerëzve të lirë.

Luftuam dhe fituam. E tërë Shqipëria u  
ngrit në këmbë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.  
Të gjitha fshatrat tona u bënë çerdhe të parti-  
zanëve. Populli i tërë arriti të bëhej një grusht  
i fortë rreth Partisë, shporri një herë e përgjith-  
monë nga trualli i tij shkelësit e huaj barbarë,  
përmbysi nga pushteti feudalët, bejlerët, kapita-

listët dhe u dha dënimin e merituar tradhtarëve. Shumë bij nga më të mirët e këtij populli ranë në fushën e nderit, por ata u bënë pishtarë dhe sot anekënd Shqipërisë prehen eshtrat e tyre në varrezat monumentale, ku populli vazhdimisht shkon e përulet me nderimin më të madh, pse gjaku i tyre çimento i themelet e Shqipërisë së re.

Të gjithë të huajt që vizitojnë vendin tonë, përulen me respekt përpara varrezave të heronjve tanë dhe me bindje e admirim thonë se ky popull ka luftuar, ka derdhur gjak e se në këtë vend në çdo pëllëmbë tokë është bërë luftë.

Pas Çlirimit ti, populli im, e vazhdove luftën me heroizëm. Partia të udhëhoqi në beteja akoma më të mëdha, akoma më të vështira, në betejat për socializmin, që duhej t'i fitojë me punë e djersë, me dituri e vendosmëri. Ti përditë punon, fiton dhe ecën përpara pa e hequr pushtën nga dora e pa e ulur kokën para armiqve të vjetër e të rinj me maska shumëngjyrëshe.

Partia, populli dhe socializmi e mbushën Shqipërinë me fabrika, kombinatë e hidrocentrale të mëdha, lulëzuan fushat, qëndisën kodra e male me brezare, i ngjiten pyjet deri në alpe, zhvilluan bagëtinë e bujqësinë që me aq pasion u ka kënduar Naimi, e mbushën vendin me shkolla, institucione kulturore e shkencore, zhdukën analfabetizmin, errësirën e prapambetjen e së kaluarës dhe bënë që kudo të vërshojë drita e diturisë, e zhvillimit dhe e përparimit shkencor. Shqipëria socialiste është sot i vetmi vend që e ndërton so-

cializmin krejtësisht me forcat e veta, pa marrë kredi nga askush dhe pa i pasur borxhe askujt, vend pa taksa, pa inflacion e papunësi, vend me arsim e shërbim shëndetësor falas. U transformua nga themelet çdo cep i Shqipërisë, jeta e popullit tonë të shumëvuajtur ndryshoi rrënjësisht, u bë e sigurt, e ndritur dhe e begatë. Mbi të gjitha, në tërë këtë proces Partia bashkoi më fort gjithë popullin dhe e bëri të ndërgjegjshëm për rolin e tij të madh e vendimtar në histori.

Kjo Shqipëri e bukur, që e ndërtove ti, Partia ime, përmes kaq furtunash, luftërash e intrigash kjo jetë e lumtur që gëzojmë sot, ky njeri i ri që farkëtove, janë vepra jote e lavdishme, që e realizove me forcat e popullit tënd, me vendosmërinë e pjekurinë tënde, me mendjen e ndritur nga marksizëm-leninizmi, pa ua shtrirë dorën të huajve. Ndihamat e të huajve kanë qenë kurdoherë jo vetëm shumë të kufizuara, por, siç e provoi jeta, ndonëse jepeshin nën maskën e internacionalizmit proletar, në thelb kishin karakter imperialist skllavërues. Populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë i morën këto ndihma për të mëkëmbur vendin me bindjen se ato nuk kishin karakter skllavërues. Por, kur pamë se, qoftë titistët, qoftë revizionistët sovjetikë apo ata të vendeve të Lindjes, qoftë Kina e Mao Ce Dunit, me ndihmat që jepnin kishin qëllime të tjera, armiqësore, robëruese ose synonin ta kthenin Shqipërinë në një bisht të tyre, të varur nga ata, që ajo të humbiste lirinë dhe pavarësinë, ne ua ço-

rëm maskën dhe u thamë hapur e qartë se Shqipëria socialiste, Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar nuk shiten për tri lecka, as për tri rubla, as për dinarë dhe as për juanë, ashtu siç nuk u shitën për tri lecka-lëmoshë të imperialistëve anglo-amerikanë, për stërlinat e dollarët e tyre.

Për 40 vjet me radhë ti, Shqipëria trime, mban lart me nder flamurin e marksizëm-leninizmit, ashtu siç ke mbajtur lart shekuj me radhë flamurin e lirisë, flamurin e kuq me shkabën dykrenore, të cilit i shtove një yll pesëcepësh, yllin e lirisë, yllin e socializmit e të komunizmit.

Ti, populli im, me Partinë e Punës në krye, për asnjë çast gjatë 40 vjetëve të jetës në socializëm nuk i le armiqtë e rinj, të pabesë e të fuqishëm të të mposhtnin. Ti zhveshe përsëri shpatën që tash ishte më e mprehtë, e kalitur në zjarrin e sa e sa betejave, e rrahur në kudhrën e historisë. Me këtë shpatë ti, Partia ime, godite pa mëshirë imperialistët e reaksionarët, godite revizionistët modernë të të gjitha ngjyrave dhe i detyrove të hiqnin maskat ata revizionistë të fshehtë që, për qëllimet e tyre hegjemoniste, dukeshin e hera-herës hiqeshin sikur ishin marksistë-leninistë dhe miqtë tanë. Ti, Partia ime, me këto qëndrime e me shembullin tënd të lartë bëje detyrën tënde internacionaliste dhe njëkohësisht u thoshe të tjerëve se nuk duhet pushuar lufta kundër korrenteve revizioniste, se nuk mund të ketë ujdi me ta, nuk mund të ketë kompromise me ta, se ata ishin renegatë e tradhtarë. Fjala e

Partisë sonë, mendimi i saj i qartë, kuraja dhe vendosmëria e saj shkëlqyen, u bënë pishtarë për popujt dhe për revolucionarët kudo në botë.

Këtë luftë heroike, ti, atdheu im socialist, i udhëhequr nga Partia e Punës, e bëre me një *brio*<sup>1</sup> të çuditshme dhe zëri yt i fuqishëm u dëgjua, pse ti u ngrite me vendosmëri kundër titizmit, i cili u demaskua në sytë e të gjithë botës si një agjunkturë ideologjike e politike e imperializmit amerikan dhe e reaksionit botëror. Lufta jote dhe zëri yt, ashtu siç qenë dëgjuar prej kohësh e kurdoherë kundër imperializmit amerikan dhe gjithë borgjezisë reaksionare botërore, që kërkon të mbajë nën thundrën e vet popujt dhe proletariatin e gjithë botës, u dëgjuan edhe kundër socialimperialistëve sovjetikë, të cilët luftojnë për hegjemoninë botërore, për të shtypur popujt, duke i kërcënuar ata me forcën e armëve e me bombat atomike. Më pas zëri yt i fuqishëm u ngrit në qiellin e kësaj bote të turbullt kundër teorisë dhe praktikës së Mao Ce Dunit e të krejt udhëheqjes kineze, e cila tradhtoi marksizëm-leninizmin dhe u fut në rrugën revizioniste për ta bërë Kinën një superfuqi imperialiste botërore.

Të tërbuar nga qëndrimet e drejta, nga vendosmëria dhe nga guximi i një populli të vogël e i një Partie trimëreshë, armiqtë imperialistë e revizionistë s'lënë gjë pa thënë kundër nesh. Ata flasin e shkruajnë me zemërim e ligësi: «Ç'është

1. Nga italishtja — pasion, shpirt.

ky popull, ç'është kjo Parti që po bëjnë kaq zhurmë, ç'janë këta kokëfortë që u kundërvihen shteteve të fuqishme e që s'kanë frikë?! Këta duhen shtypur, duhen likuiduar, këta duhen përkulur me bllokada, që të vdesin urie...». Mirëpo ata gabohen rëndë, siç janë gabuar kurdoherë, sepse nuk e kanë njohur e nuk kanë dashur ta njohin historinë e popullit shqiptar, karakterin burrëror të shqiptarit, nuk kanë dashur të njohin ç'kuptim të lartë kanë pasur dhe kanë për shqiptarin liria, pavarësia dhe sovraniteti i atdheut. Ata kanë menduar e mendojnë si kapitalistë, si imperialistë e si reaksionarë që janë, se asgjë nuk mund t'i rezistojë forcës ekonomike e ushtarake dhe ideologjisë së tyre. Por ja që popujt, të mëdhenj ose të vegjël qofshin, kanë forca t'u rezistojnë armiqve. Popujt që luftojnë, kurdoherë fitojnë; partitë marksiste-leniniste që qëndrojnë të patundura në parimet, armiku nuk mund t'i shkatërrojë dot. Marksizëm-leninizmi, që udhëheq proletariatin, partitë e vërteta komuniste dhe popujt që kërkojnë çlirim e të drejtat e tyre, është i pamposhtur.

Lufta kundër revizionizmit sovjetik dhe gjithë revizionizmit modern është një nga epopetë e tua më të shkëlqyera, Partia ime. Kjo luftë heroike është nder e krenari për ty, klasë punëtore e Shqipërisë, për ty, popull shqiptar, për ty, Shqipëria jonë socialiste! Të gjitha shtetet e botës, të çfarëdo regjimi qofshin, të gjithë popujt, të gjitha rrymat politike, miq dhe armiq, nuk

mund të mos pranojnë, që ti je krejtësisht e lirë, e pavarur dhe qëndron si shkëmb graniti.

Shqipëria jonë socialiste, ti u qëndrove vavëve të tërbuara të armiqve e nuk përkulesh. Qëndrimet e tua të drejta, burrërore, marksiste-leniniste, revolucionare bënë që rreth teje të grumbullohen miq të shumtë, dashamirë nga të gjitha vendet; edhe pse ti ishe e vogël, proletariati botëror të shikonte e të sheh me shpresë e besim, sepse te rruga dhe vendosmëria jote ai sheh të realizuar e të pamposhtur idenë e madhe të tij, marksizëm-leninizmin, luftën për revolucionin, luftën për përmbysjen e forcave reaksionare që i shtypin e i shfrytëzojnë. Ti u ke thënë e u thua proletariatit e popujve të vërtetën dhe e vërtetën ka rëndësi të jashtëzakonshme. E vërteta të gjallëron, nuk të lë të thyesh qafën në humnerë, të ndrit rrugën, të hap shtigje të reja, shpërthen nga gjiri i popullit forca madhështore për të mposhtur të gjithë armiqtë, të gjitha vështirësitë, të gjitha intrigat.

Shqipëria socialiste dhe Partia e Punës e Shqipërisë, me qëndrimet e me mendimet e veta u kanë dhënë e u japin të gjithëve zemër e besim dhe u kanë thënë e u thonë proletariatit e popujve: qëndroni siç qëndrojmë ne, luftoni siç luftojmë ne, se do të fitoni siç kemi fituar dhe po fitojmë ne. Fitorja jonë është e sigurt, fitorja jonë është e përbashkët, prandaj duhet të shtrëngojmë radhët në zjarrin e luftës kundër armiq-

ve. Zjarr kundër revizionistëve, tradhtarëve të klasës punëtore dhe të popujve, zjarr kundër planeve imperialiste të kapitalit të madh botëror, pse vetëm kështu fitohet liria, pavarësia dhe sovraniteti i atdheut, zhvillohet e triumfon revolucioni. Janë përralla ato që thuhet për marrjen e pushtetit nëpërmjet reformave. Borgjezia dhe kapitalizmi kurrë nuk mund të bien dakord që ta marrë fuqinë klasa punëtore, klasa më e përparuar në botë, së cilës i përket e ardhmja. Përkundrazi, çdo ditë armiqtë e popujve e të proletariatit përgatitin sheqerka me helm, farkëtojnë zinxhirë të rinj skllavërimi, prandaj vetëm duke luftuar kundër sistemit të vjetër të pushtetit të kapitalit popujt dhe proletariati mund të fitojnë hap pas hapi e të marrin fuqinë në duart e tyre. Këtë rrugë ndoqi Partia e Punës, kështu u çlirua populli shqiptar, kështu u ndërtua dhe ecën përpara Shqipëria socialiste.

Në të gjitha veprimet e tua, ti, Parti heroike, ke pasur një qëllim të lartë dhe ke ecur kurdoherë me kujdes e jo me frikë. Kurrë nuk ke mbajtur qëndrim prej zvarraniku, kurrë s'ke qenë oportuniste, por as sektare s'ke qenë. Ti ke ecur kurdoherë drejt, në rrugën marksiste-leniniste. Popujve u ke dashur dhe u do kurdoherë vetëm të mirën. Marksistë-leninistët e vërtetë i ke dashur sinqerisht, i ke mbrojtur deri në fund dhe kurdoherë kështu do t'i mbrosh. Fjalën tënde kurdoherë e ke thënë hapur, butë kur du-

hej, por kur e ka dashur puna ke ngritur tonin. Ata që kanë gabuar je përpjekur t'i korrigjosh me durim, i ke këshilluar me urtësi dhe njëkohësisht çdo këshillë me vlerë e ke dëgjuar me kujdes dhe e ke bërë mësim. Veprimet e tyre të drejta i ke përkrahur, por kur ato kanë qenë të gabuara, i ke kritikuar. Këtë rrugë ke ndjekur kurdoherë, por kur është mbushur kupa dhe ti je bindur plotësisht se s'ka rrugë tjetër veç asaj të luftës, nuk u trembe, por u shpalle luftë armiqve dhe kurrë nuk e ke pushuar këtë luftë.

Ne nuk jemi tërhequr e nuk u kemi bërë asnjë lëshim armiqve. Këtë na e ka mësuar historia, na e kanë mësuar vuajtjet dhe mjerimet jo vetëm tonat, por të të gjithë popujve të botës, luftërat e tyre të panumërta gjatë shekujve.

Marksizëm-leninizmi na ka hapur sytë me konkluzionet e nxjerra nga analiza që i ka bërë zhvillimit të shoqërisë për luftën e klasave. Ai na mëson se lufta e klasave është motori i shoqërisë, ajo të mban gjallë, të jep forca, të jep kurajë, të jep fitoren. Po e shove këtë luftë borgjezia dhe kapitalizmi të mbytin, të skllavërojnë dhe skllavërinë s'e ka dashur kurrë populli ynë, përkundrazi, kurdoherë ka luftuar kundër kthetrave të saj, prandaj luftën e klasave, si brenda ashtu dhe në arenën ndërkombëtare, Partia jonë s'e ka pushuar dhe nuk do ta pushojë për asnjë moment. Për 40 vjet me radhë populli dhe Partia jonë iu kundërvunë dhe luftuan me vendosmëri gjithçka të vjetër e konservatore, oportuniste e liberale, të

gjithë ata që përpiqeshin hapur apo në fshehtësi të na devijonin nga rruga jonë e drejtë, luftuam çdo forcë e ideologji që ka synuar të molepsë ndërgjegjen e njerëzve tanë, të pengojë marshimin tonë drejt ditëve më të mira, drejt të sotmes e të ardhmes më të sigurt. Luftën klasore e mbajtëm dhe e mbajmë kurdoherë nderur dhe pikërisht kjo forcë e madhe lëvizëse e revolucionarizuese e ka bërë atdheun tonë të vogël të patundur «as nga topi, as nga kumbaraja», siç thotë një këngë e popullit, pra as nga revizionizmi, as nga kapitalizmi, as nga reaksioni.

Ne kemi në botë shumë miq e dashamirë, kemi miq gjithë popujt e botës, që kanë një dashuri dhe një respekt të madh për Shqipërinë, flasin me admirim për vendin tonë, për realitetin tonë socialist dhe duan të dinë ku e gjejmë ne këtë forcë, sepse akoma nuk e kuptojnë si është arritur ky realitet. Prandaj, detyra jonë është që fitoret e Partisë së Punës, të popullit shqiptar e të Shqipërisë socialiste t'i bëjmë të njohura në të gjitha aspektet e tyre, t'i shpjegojmë jo vetëm me të tashmen, por me gjithë të kaluarën e lavdishme të popullit tonë. Këto fitore janë si një zinxhir i çeliktë, hallkat e të cilit janë ngjarje revolucionare të pashkëputura nga njëra-tjetra, që përfaqësojnë, në etapa të ndryshme, idealet e përhershme të lirisë, të pavarësisë, të demokracisë, të unitetit të kombit tonë, të mirëqenies, të kulturës, të përparimit tonë të pandërprerë. T'u shpjegojmë vëllezërve dhe miqve dashamirës që

ky zinxhir i jetës së popullit shqiptar në ditët e sotme ka arritur një kalitje të paparë në sajë të marksizëm-leninizmit, të cilin ne bëjmë përpjekje ta kuptojmë thellë në të gjitha aspektet dhe të zbatojmë me besnikëri parimet e tij në kushtet e vendit tonë dhe të gjendjes ndërkombëtare.

Parimet e politikës sonë të jashtme nuk kemi lejuar të merren nëpër këmbë nga koniunkturat e rastit. Koniunkturat politiko-ekonomike ndërkombëtare ne i kemi pasur e i kemi parasysh, por kurdoherë në marrëdhëniet tona me shtete të tjera, në qëndrimet tona jemi udhëhequr nga parimet marksiste-leniniste, pse ato janë kyçi i kuptimit dhe i vlerësimit të drejtë të ngjarjeve botërore, të koniunkturave që krijohen, të intrigave dhe të synimeve të imperializmit ndaj aspiratave të forcave revolucionare të popujve e të proletariatit të çdo vendi dhe të mbarë botës.

Për të gjitha këto, kur afrohen datat e shënuara të 28 dhe 29 Nëntorit Shqipëria socialiste është me tërë kuptimin e fjalës në festë. Kudo ka gëzime për punën, për arritjet, për jetën e re e të bukur. Mbarë populli u këndon e u gëzohet fitoreve të mëdha që ka arritur në të tëra fushat, jetës së re socialiste, sigurisë dhe perspektivave të qarta e të mëdha të së ardhmes.

Ndiej një kënaqësi të pakufishme kur shikoj në televizor, dëgjoj në radio e lexoj në shtyp për punën e madhe ndërtimore që zhvillohet anembanë atdheut, për fitoret e sukseset e një-

pasnjëshme që po arrihen në të gjitha fushat. Më bëhet zemra mal e behar kur shoh punëtorët e specialistët tanë të palodhur e duarartë tek ngrenë diga, ndërtojnë makineri e vënë në lëvizje me kompetencë e shkathtësi uzina e kombinate moderne; kur shoh kooperativistët në fusha, në bregore e male tek u rrinë bimëve te koka dhe marrin rendimente të nivelit botëror; kur shoh armatën e madhe të inteligjencies sonë të re socialiste, nxënësit e studentët të përkulur mbi libra e në laboratorë, mbi skica e projekte; kur shoh kudo, krahas burrave, vajzat e gratë shqiptare që Partia i nxori në dritë, që punojnë e këndojnë, që prodhojnë e drejtojnë, që rritin fëmijë të shëndetshëm e të lumtur, të ardhmen e atdheut. E tërë Shqipëria është në lëvizje, në zhvillim, në përparim të pandalshëm. Çdo pëllëmbë e saj është sot edhe kantier ndërtimi e krijimi, edhe shkollë, edhe barrikadë e pakapërcyeshme për armiq të, edhe podium ku njerëzit tanë, krijuesit e gjithçkaje, këndojnë për Partinë, për popullin, për lirinë dhe socializmin.

Një situatë të tillë e ka krijuar vetë populli me Partinë e tij në krye, prandaj populli ynë, që punon e gëzon, sidomos kur vijnë festat, shpreh me një forcë të mahnitshme ndjenjat e tij të pastra e të bukura që e frymëzojnë për vepra akoma më të mëdha.

Për ne, ushtarët e Partisë, nuk mund të ketë kënaqësi më të madhe se kjo, kur të shohim ty, o popull, zot të fateve të tua, të gëzuar, të lum-

tur, të lirë, në një Shqipëri sovraane dhe të pavarur, në një Shqipëri të kthyer në kështjellë të pamposhtur e me zhvillim të pandërprerë socialist. Kënaqësia e krenaria që ndiejmë është fryt i fitoreve të mëdha që kemi arritur, i përpjekjeve tona të pandërprera, i preokupimit tonë të përhershëm për ta pasur Partinë tonë si kurdoherë në krye, udhërrëfyese të sprovuar.

Dyzet vjetët që kaluan i jetuam ashtu siç dinë të jetojnë, të ndërtojnë e të mbrojnë revolucionarët. Shqipëria jonë e shtrenjtë, në këto vite të epokës së Partisë, u transformua nga themelet, njohu atë rritje, atë rinim, atë zhvillim të gjithanshëm që s'i kishte provuar për shekuj të tërë. Gjithçka tek ajo është e re dhe e shëndetshme, pamja dhe përmbajtja e saj, jeta që lulëzon e fiton përmasa të reja, njeriu i ri i pajisur me virtytet e larta të ideologjisë komuniste, i lumtur e krenar për ato që janë arritur, i bindur e i ndërgjegjshëm për vazhdimësinë e rrugës sonë, të përpjekjeve tona, të nderit e të prestigjit tonë.

Në vitet e dekadat që vijjnë, popull e Parti, si kurdoherë të bashkuar grusht, akoma më tepër do të bëjnë për këtë truall të shtrenjtë, për këtë vend shqiptonjash. Ta ruajmë, pra, si sytë e ballit gjithçka kemi arritur, ta zhvillojmë me konsekuencë më tej, t'u lëmë brezave të ardhshëm një Shqipëri kurdoherë e më të fortë, kurdoherë të kuqe, si flaka e pashuar e zemrave dhe e idealeve komuniste e partizane, një Shqipëri që të rro-

jë e të përparojë në shekuj. Jam i bindur se populli e Partia lart e më lart do ta mbajnë flamurin tonë fitimtar, lart e më lart do ta ngrenë nderin, prestigjin dhe emrin e Shqipërisë socialiste në botë.

Gëzuar festat e Nëntorit, Shqipëri e shtrenjtë socialiste!

Gëzuar festat, populli ynë hero, populli ynë i mrekullueshëm!

«Për shkencën (Përmbledhje  
veprash)», f. 602

## L È N D A

Parathënie .....		3
1. Letër drejtuar shokut Hysni Kapo .....	<b>28 gusht 1945</b>	7
2. Letër drejtuar Fan S. Nolit .....	<b>25 shtator 1945</b>	13
3. Letër drejtuar Këshillit të Bashkimit të Gruas Antifashiste të Gjirokastrës .....	<b>6 nëntor 1945</b>	15
4. Letër drejtuar të rinjve vullnetarë të rrugës Kukës—Peshkopi .....	<b>27 tetor 1946</b>	17
5. Letër drejtuar zonjës Vasilja Paçuka .....	<b>8 shkurt 1947</b>	29
6. Telegram dërguar Velo Alikajt .....	<b>1948</b>	31
7. Letër drejtuar oficerëve pensionistë Riza Kodheli dhe Ahmet Staravecka .....	<b>26 gusht 1949</b>	32
8. Letër drejtuar fshatarëve të Turanit .....	<b>12 qershor 1951</b>	34

9. Përshëndetje dërguar kolektivit punonjës të ndërmarrjes së ndërtimit të hidrocentralit «Lenin» .....	39
<b>3 nëntor 1951</b>	
10. Letër drejtuar pionierëve të shkollës së Lukovës .....	41
<b>17 shkurt 1952</b>	
11. Letër drejtuar prindërve të ushtarit Gor Trifoni, Dhimitër dhe Fotina Trifoni .....	43
<b>25 maj 1957</b>	
12. Letër drejtuar pionierëve të çetës së shkollës 7-vjeçare «Naim Gjylbegu», Shpal .....	45
<b>19 tetor 1957</b>	
13. Letër drejtuar shokut Masar Shkoza .....	47
<b>Dhjetor 1957</b>	
14. Letër drejtuar Byrosë Politike të KQ të PPSH .....	49
<b>7 janar 1958</b>	
15. Letër dërguar fshatarëve të Zhavarës .....	51
<b>2 mars 1958</b>	
16. Letër drejtuar Kostandina Londarit .....	54
<b>10 mars 1958</b>	
17. Letër drejtuar shokut Hajdar Shehdulla .....	56
<b>17 prill 1959</b>	
18. Letër drejtuar shokut Idhomene Bratko .....	58
<b>22 tetor 1959</b>	
19. Letër drejtuar nxënësve dhe pedagogëve të shkollës pedagogjike «Luigj Gurakuqi» .....	60
<b>30 nëntor 1959</b>	
20. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Iljaz Hoxhës .....	65
<b>21 mars 1960</b>	
21. Letër drejtuar shokut Hysni Kapo në Bukuresht .....	66
<b>22 qershor 1960</b>	

22. Letër drejtuar shokut Hysni Kapo në Moskë .....	76
<b>1 tetor 1960</b>	
23. Letër drejtuar shokut Hysni Kapo në Moskë .....	81
<b>13 tetor 1960</b>	
24. Letër drejtuar shoqes Polikseni Luarasi .....	85
<b>7 maj 1961</b>	
25. Radiogram dërguar shokëve Hysni Kapo dhe Ramiz Alia .....	87
<b>23 maj 1962</b>	
26. Radiogram dërguar shokëve Hysni Kapo dhe Ramiz Alia .....	90
<b>13 qershor 1962</b>	
27. Radiogram dërguar shokëve Hysni Kapo dhe Ramiz Alia .....	95
<b>15 qershor 1962</b>	
28. Letër drejtuar nxënësve dhe mësuesve të gjim- nazit «Asim Zeneli» Gjirokastrë .....	101
<b>17 shtator 1962</b>	
29. Letër falënderimi drejtuar profesorit të shkencave matematike Kristaq Fundos .....	107
<b>3 maj 1964</b>	
30. Letër drejtuar shoqatës patriotike «Skënderbeu» Argjentinë, me rastin e 20-vjetorit të themelimit të saj .....	110
<b>11 maj 1964</b>	
31. Përhëndetje drejtuar punonjësve të teatrit me rastin e 20-vjetorit të krijimit të Teatrit Popullor .....	114
<b>30 maj 1964</b>	
32. Letër drejtuar nënave dhe familjeve të dëshmo- rëve të rrethit të Tepelenës .....	122
<b>8 nëntor 1964</b>	

33. Përshëndetje drejtuar forcave të kufirit .....	125
<b>25 prill 1965</b>	
34. Letër drejtuar arbëreshit Josif de Rada .....	129
<b>7 shtator 1965</b>	
35. Telegram dërguar familjes së patriotit Selim Hasani (Brataj) .....	132
<b>4 dhjetor 1965</b>	
36. Letër drejtuar shokut Zihni Sako .....	134
<b>17 shkurt 1966</b>	
37. Letër drejtuar shokut Manush Myftiu .....	136
<b>27 maj 1966</b>	
38. Letër drejtuar profesor Spiro N. Kondës .....	139
<b>19 korrik 1966</b>	
39. Telegram dërguar shoqeve Gjela Pal Gega dhe Marie Pal Çupi .....	140
<b>21 dhjetor 1966</b>	
40. Letër drejtuar pionierëve të qytetit të Beratit .....	142
<b>27 janar 1967</b>	
41. Letër drejtuar pleqve të kooperativës Lapardha— —Moravë .....	144
<b>4 shkurt 1967</b>	
42. Letër drejtuar kuvendit të 75 pleqve të rrethit të Kukësit .....	147
<b>14 shkurt 1967</b>	
43. Letër drejtuar popullit të katundit Shëmri të rrethit të Tiranës .....	154
<b>8 mars 1967</b>	
44. Letër drejtuar shokut Riza Hasimaj .....	157
<b>26 korrik 1967</b>	
45. Letër drejtuar prindërve të 108 çikave të brigadës vullnetare «Gjelosh Rama» Lekbibaj .....	160
<b>12 gusht 1967</b>	

46. Letër drejtuar shokut Pal Vata .....	163
<b>9 nëntor 1967</b>	
47. Letër drejtuar shokut Fuat Çela .....	166
<b>15 nëntor 1967</b>	
48. Letër drejtuar familjes së Pjetër Lleshit .....	169
<b>20 nëntor 1967</b>	
49. Letër drejtuar Tatjana Rekës .....	172
<b>22 nëntor 1967</b>	
50. Letër drejtuar të rinjve dhe të rejave dropullite të katundit Bularat .....	175
<b>22 nëntor 1967</b>	
51. Letër drejtuar veteranëve të luftës dhe të punës të rrethit të Vlorës .....	178
<b>3 janar 1968</b>	
52. Letër drejtuar Makbule dhe Besim Rexhës .....	182
<b>19 mars 1968</b>	
53. Letër drejtuar prindërve të Ismet Bruçajt .....	184
<b>7 dhjetor 1968</b>	
54. Letër drejtuar brigadierit Alo Qosja nga Sojniku i Gramshit .....	187
<b>23 janar 1969</b>	
55. Letër drejtuar shoqes Athina Mile, mësuese në Orosh .....	192
<b>4 shkurt 1969</b>	
56. Letër drejtuar Lindita Saserit .....	202
<b>13 shkurt 1969</b>	
57. Letër drejtuar shokut Bib Preng Hyseni, Shkopet .....	204
<b>31 mars 1969</b>	
58. Letër drejtuar shokut Dul Alia në kooperativën bujqësore Dragobi .....	207
<b>3 prill 1969</b>	

59. Letër drejtuar skulptorëve Kristaq Rama, Muntaz Dhrami e Shaban Hadëri ..... 210  
**26 qershor 1969**
60. Letër drejtuar shokut Mark Gjoka në katundin Mashtërkor të Oroshit ..... 217  
**26 qershor 1969**
61. Letër drejtuar shokut Aleks Çaçi ..... 221  
**14 shtator 1969**
62. Letër drejtuar malësorëve të kooperativës bujqësore të Lëpushës të krahinës së Kelmendit ..... 223  
**22 shtator 1969**
63. Letër drejtuar familjes së Heroit të Punës Socialiste Isuf Pllaçi ..... 227  
**14 nëntor 1969**
64. Letër drejtuar punëtores së ndërmarrjes bujqësore «Gjergj Dimitrov», Lije Xhaja ..... 231  
**11 dhjetor 1969**
65. Telegram dërguar zotit Sotir Pando, Australi ..... 234  
**19 dhjetor 1969**
66. Letër drejtuar shokut Shaban Rexhë Hajdarmataj në kooperativën bujqësore të katundit Zogaj ..... 235  
**26 janar 1970**
67. Telegram ngushëllimi dërguar shokut Haki Keta ..... 238  
**19 shkurt 1970**
68. Letër drejtuar 300 grave të kuvendit të Kukësit ..... 239  
**28 korrik 1970**
69. Letër drejtuar 40 vajzave të rrethit të Elbasanit që mbaruan të parat shkollën 3-vjeçare të mamive ..... 243  
**12 shtator 1970**
70. Letër drejtuar shokut Haki Toska ..... 247  
**19 shtator 1970**

71. Letër drejtuar fotografit Gegë Marubi .....	248
<b>29 shtator 1970</b>	
72. Telegram ngushëllimi dërguar Shefike dhe Shero Bakirit .....	250
<b>23 janar 1971</b>	
73. Letër drejtuar shokut Jani Nushi (Zegali) .....	252
<b>28 prill 1971</b>	
74. Letër drejtuar shokut Shyqyri Kanapari .....	254
<b>21 shtator 1971</b>	
75. Letër ngushëllimi drejtuar familjes së Kolë Kaçorrit .....	257
<b>23 shtator 1971</b>	
76. Telegram dërguar shokut Myslim Peza .....	261
<b>30 prill 1972</b>	
77. Letër drejtuar grupit të këngëve karakteristike korçare .....	262
<b>31 tetor 1972</b>	
78. Letër drejtuar shokut Miti Bozo .....	264
<b>4 nëntor 1972</b>	
79. Letër drejtuar Bajame e Islam Sopit, punëtorë në Fabrikën e Miellit .....	266
<b>13 nëntor 1972</b>	
80. Telegram ngushëllimi dërguar Stilian Eftimiut .....	269
<b>28 nëntor 1972</b>	
81. Letër drejtuar shokut Spiro Lera .....	271
<b>5 janar 1973</b>	
82. Letër drejtuar nxënësve, mësuesve dhe komunistëve të shkollës «11 Janari» .....	274
<b>7 maj 1973</b>	
83. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Mehmet Halil Gashit .....	276
<b>22 maj 1973</b>	

84. Përshëndetje drejtuar ushtarëve dhe oficerëve me rastin e 30-vjetorit të themelimit të Ushtrisë Popullore .....	277
<b>9 korrik 1973</b>	
85. Letër drejtuar familjes së shoqes Zeliha Allmeta .....	287
<b>17 gusht 1973</b>	
86. Letër drejtuar shokut Mihal Dhima .....	289
<b>1 shtator 1973</b>	
87. Përshëndetje me rastin e 50-vjetorit të shkollës së mesme «Asim Zeneli» .....	291
<b>9 nëntor 1973</b>	
88. Letër drejtuar shokut Odise Paskali, «Skulptor i Popullit» .....	307
<b>27 dhjetor 1973</b>	
89. Letër drejtuar shokut Durro Alushani .....	309
<b>9 korrik 1974</b>	
90. Letër ngushëllimi drejtuar familjes së Ilia Qiqit në fshatin Zervat .....	312
<b>30 tetor 1974</b>	
91. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së shokut Rexhep Duraku .....	315
<b>21 janar 1975</b>	
92. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Naim Frashërit .....	316
<b>18 shkurt 1975</b>	
93. Letër drejtuar kolektivit punonjës të sharrave të Pukës .....	318
<b>2 shtator 1975</b>	
94. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së shokut Kahreman Ylli .....	321
<b>4 shtator 1975</b>	

95. Letër drejtuar kooperativisteve të Këmishtajt dhe kooperativisteve të dalluara të rrethit të Lushnjës ..... 323  
**25 shtator 1975**
96. Letër drejtuar popullit të fshatrave Dhivër, Cer-kovicë, Shëndre, Memoraq e të tjerë ..... 333  
**25 nëntor 1975**
97. Përshëndetje drejtuar shkollës së mesme të përgjithshme «Qemal Stafa» me rastin e 50-vjetorit të saj ..... 336  
**12 dhjetor 1975**
98. Letër drejtuar shoqes File Habili në fshatin Okshtun ..... 340  
**29 dhjetor 1975**
99. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Qerim Ukë Mukës ..... 342  
**8 janar 1976**
100. Letër drejtuar tipografëve veteranë ..... 344  
**15 prill 1976**
101. Letër drejtuar grave dhe vajzave punëtore të ndërmarrjes së prodhimeve artistike ..... 348  
**17 nëntor 1976**
102. Përshëndetje popullit të Gjirokastrës me rastin e inaugurimit të qendrës muzeale dhe të obeliskut ..... 352  
**24 maj 1977**
103. Telegram dërguar shokut Kristo Kono ..... 365  
**22 shtator 1977**
104. Letër drejtuar kolektivit të shkollës së mesme të përgjithshme «Raqi Qirinxhi» ..... 367  
**1 dhjetor 1977**
105. Letër drejtuar shoqes Sadakate Desha ..... 374  
**30 dhjetor 1977**
106. Letër drejtuar shokut Kristaq Antoniu ..... 380  
**23 janar 1978**

107. Letër drejtuar shokut Laver Nurka (Bariu) .....	383
<b>27 janar 1978</b>	
108. Letër drejtuar shokut Namik Hasan Bilvar .....	386
<b>24 maj 1978</b>	
109. Letër drejtuar shokut Hysni Kapo .....	388
<b>24 korrik 1978</b>	
110. Letër drejtuar shokut Hysni Kapo .....	393
<b>30 korrik 1978</b>	
111. Letër drejtuar shokut Asllan Muhedini .....	405
<b>11 tetor 1978</b>	
112. Letër drejtuar shokut Spiro Koleka .....	407
<b>17 tetor 1978</b>	
113. Letër drejtuar kolektivit të uzinës «Enver» të kombinatit të autotraktorëve «Enver Hoxha» .....	409
<b>6 nëntor 1978</b>	
114. Letër drejtuar shoqes Ollga Plumbi .....	416
<b>10 nëntor 1978</b>	
115. Letër drejtuar shokut Muharrem Butka .....	418
<b>25 nëntor 1978</b>	
116. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së patriotit Avdi Bajrami .....	421
<b>16 prill 1979</b>	
117. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Mihal Popit .....	423
<b>19 shtator 1979</b>	
118. Letër drejtuar shokut Todi Gjermani .....	425
<b>27 dhjetor 1979</b>	
119. Letër drejtuar shokut Dhimitër Delijorgji .....	427
<b>16 janar 1980</b>	
120. Letër drejtuar shokut Dhimitër Shuteriqi .....	430
<b>11 prill 1980</b>	

121. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Pashako Rexhepit .....	433
<b>10 maj 1980</b>	
122. Telegram dërguar Presidiumit të Akademisë së Shkencave .....	435
<b>14 gusht 1980</b>	
123. Letër drejtuar punonjësve të hidrocentralit «Drita e Partisë» në Fierzë .....	437
<b>4 dhjetor 1980</b>	
124. Letër drejtuar shokut Sterjo Spasse .....	443
<b>30 dhjetor 1980</b>	
125. Letër drejtuar shokut Riza Veipi .....	445
<b>20 janar 1981</b>	
126. Letër ngushëllimi drejtuar familjes së shokut Spiro Moisiu .....	448
<b>13 prill 1981</b>	
127. Telegram dërguar shokut Pandi Raidhi .....	451
<b>13 prill 1981</b>	
128. Letër drejtuar shokut Miha Lako .....	453
<b>31 maj 1981</b>	
129. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së shokut Qirjako Harito .....	456
<b>18 qershor 1981</b>	
130. Letër drejtuar kryesisë së Kooperativës së Tipit të Lartë Plasë .....	458
<b>10 gusht 1981</b>	
131. Letër drejtuar shoqes Mallama Samara .....	461
<b>7 shtator 1981</b>	
132. Letër drejtuar shokut Aleks Buda .....	464
<b>8 shtator 1981</b>	

133. Letër drejtuar shoqes Qamile Peshkëpia në Lagjen Cfakë .....	466
<b>28 janar 1982</b>	
134. Letër drejtuar shokut Esat Dishnica .....	468
<b>14 shkurt 1982</b>	
135. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Ismail Bajram Pogës .....	470
<b>21 qershor 1982</b>	
136. Letër drejtuar redaksisë së gazetës «Zëri i popullit» .....	472
<b>24 gusht 1982</b>	
137. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së Ije Farkës .....	476
<b>24 shtator 1982</b>	
138. Letër drejtuar Universitetit të Tiranës .....	478
<b>6 nëntor 1982</b>	
139. Letër drejtuar kryesisë së Kooperativës Bujqësore Kutë-Çorrush-Drizar .....	481
<b>15 dhjetor 1982</b>	
140. Telegram ngushëllimi dërguar familjes së shokut Sterjo Gjokoreci .....	483
<b>18 prill 1983</b>	
141. Letër drejtuar kolektivit punonjës të minierës së kromit «Todo Manço» .....	485
<b>28 prill 1983</b>	
142. Falënderim për urimet e dëguara me rastin e 75-vjetorit të lindjes .....	488
<b>21 tetor 1983</b>	
143. Letër drejtuar kolektivit të kinostudios «Shqipëria e re» .....	491
<b>21 tetor 1983</b>	
144. Letër ngushëllimi drejtuar shokut Zeqi Agolli .....	495
<b>10 maj 1984</b>	

145. Letër drejtuar shokut Shevqet Musaraj .....	498
<b>20 nëntor 1984</b>	
146. Përshëndetje me rastin e 40-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë .....	500
<b>29 nëntor 1984</b>	